



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 632 Akti

Nr. 710 Vendimi
Tiranë, më 30.10.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bektashi	Kryesuese
Etleda Çiftja	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 19.10.2023 mori në shqyrtim mbi bazën e dokumenteve të administruara çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Herila Çela**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, B, C, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Herila Çela në seancë dëgjimore dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Znj. Herila Çela, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, ka mbajtur funksionin e gjyqtarës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për rrjedhojë, në zbatim të pikës 3 të kësaj dispozite dhe parashikimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, gëzon statusin e subjektit të rivlerësimit dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.

2. Znj. Herila Çela, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.12.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Brunilda Bekteshi dhe Etleda Çiftja.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin datë 15.12.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisioneren Brunilda Bekteshi. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 13.1.2021, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe mbi përbërjen e trupit gjykues, si dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Komisioni gjithashtu i kërkoi subjektit informacion shtesë sipas pyetësorit standard.

6. Trupi gjykues, me vendimin datë 27.9.2023, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Herila Çela, bazuar në relativimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016, të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta dhe po në të njëjtën datë 27.9.2023, përmes postës elektronike², i njoftoi subjektit të rivlerësimit vendimin mbi përfundimin e hetimit paraprak.

¹ Email datë 13.1.2021, ora 12:40, “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

² Email datë 27.9.2023, ora 10:50, “Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin e rivlerësimit”.

7. Subjekti i rivlerësimit u ftua të paraqesë prova dhe shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht administrativ brenda datës 12.10.2023. Në datën 11.10.2023³, subjekti i rivlerësimit kërkoi zgjatjen e afatit minimalisht 10 ditë. Pas shqyrtimit të kërkesës, Komisioni vendosi të zgjasë afatin deri në datën 17.10.2023⁴.

8. Në datën 17.10.2023, subjekti i rivlerësimit paraqiti me anë të postës elektronike⁵ shpjegime dhe prova në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht dhe njëkohësisht i paraqiti në zyrën e protokollit pranë Komisionit, administruar me shkresën nr. *** prot., datë 17.10.2023.

9. Subjekti i rivlerësimit u njoftua me anë të postës elektronike⁶ se trupi gjykues, me vendimin e datës 17.10.2023, vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 19.10.2023, ora 14:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

10. Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Herila Çela bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

11. Në datën 19.10.2023 u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe të vëzhgueses ndërkombëtare, z. Elka Ermenkova, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

12. Relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e hetimit administrativ nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryera mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

13. Znj. Herila Çela, e përfaqësuar në seancë nga av. A. S., pasi dëgjoji relacionin shprehu qëndrimin e saj, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj.

14. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Herila Çela, duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit.

15. Seanca dëgjimore e datës 19.10.2023 u ndërpre, për të rifilluar në datën 30.10.2023, ora 09:45, për shpalljen e vendimit.

16. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 19.10.2023, subjekti i rivlerësimit Herila Çela kërkoi konfirmimin në detyrë.

³ Email datë 11.10.2023, ora 08:31.

⁴ Email datë 12.10.2023, ora 10:32.

⁵ Email datë 17.10.2023, ora 12:21, 12:28 dhe 14:43.

⁶ Email datë 17.10.2023, ora 14:32, "Ftesë për t'u paraqitur në seancën dëgjimore për procesin tuaj të rivlerësimit".

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

17. Subjekti i rivlerësimit Herila Çela ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

18. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

19. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit; (iii) KLGJ-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili, në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

20. Referuar vendimit nr. 2/20177 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

21. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Herila Çela, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

⁷ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni, ndërsa sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

22. Subjekti i rivlerësimit, në datën 27.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti ka përfituar të ardhura në kushtet e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

23. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2003 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaramet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit dhe, në vijim, gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

24. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarameve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarameve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

25. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruar në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017 nga subjekti i rivlerësimit

1. Apartament me sipërfaqe 68,62 m², ndodhur në Vlorë, me vlerë 2.965 lekë

1.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartament banimi me sip. 68,62 m², ndodhur në lagjen “****”, blv. “****”, pallati nr. ***, Vlorë. Vlera: 2.965 lekë. Pjesa takuese: 50%. Përfituar me anë të kontratës së privatizimit datë 14.7.1993 (apartament i vitit 1957). Për vërtetimin e deklarameve subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues⁸.

⁸ Mandatarkëtim nr. ***, datë 13.7.1973, pagesë nga shtetasi A. Ç., në vlerën 3.265 lekë; kontratë për privatizimin e banesës me palë shitëse NK Banesa dhe palë blerëse A. Ç., të apartamentit në rrugën “****” p. ***, vërtetim nr. ***, datë 14.7.1993; planimetri e banesës dhe planvendosja; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 11.10.2010.

1.2. Më tej, në fund të seksionit të pasurive të deklaratës *Vetting*⁹, subjekti ka deklaruar: “*Shtesë e apartamentit të banimit me sip. 68,62 m². Shtesa është ndërtuar në vitin 1997, me sip. 42,8 m² dhe ndodhet në proces legalizimi*”. Subjekti nuk ka deklaruar vlerën e investuar. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: ndërtuar prej prindërve me kursimet e tyre. Për vërtetimin e deklaramëve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹⁰.

1.3. Lidhur me këtë pasuri, babai i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e personit të lidhur, ka deklaruar shtesë në këtë apartament banimi, ndërtuar në vitin 1997, me sip. 42,8 m², në proces legalizimi. Burimi i krijimit: kursimet ndër vite të tij dhe të bashkëshortes E. Ç..

1.4. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur kontratën për privatizimin e banesës me palë shitëse NK Banesa dhe palë blerëse A. Ç., të apartamentit në rrugën “****”, p. ***, Vlorë, me çmim 2.965 lekë. Subjekti ka paraqitur kartelën e pasurisë dhe certifikatën e pronësisë nr. ***, datë 11.10.2010, të apartamentit me sip. 68,62 m², në emër të shtetasve A., E. dhe Herila Çela, si dhe lejen e legalizimit nr. ***, datë 21.1.2017, të objektit shtesë anësore 3 kate, e kombinuar në objektin ekzistues 3 kate, në emër të shtetasve A. M., E. M., A. Ç., P. M., të pasurisë nr. ***.

1.5. Sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, ZVRPP-ja Vlorë¹¹ ka vënë në dispozicion praktikën e privatizimit të këtij apartamenti. ASHK Drejtoria Vendore Vlorë, me anë të postës elektronike datë 19.9.2019, ka konfirmuar gjithashtu se pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit apartament, me sip. 68,62 m², është në pronësi të bashkëpronarëve A., Herila dhe E. Ç., me 1/3 pjesë takuese secili. Kjo pasuri është përfituar me kontratë privatizimi banesash. ZVRPP-ja Vlorë, me anë të *email*-it datë 13.7.2019, ka përcjellë pranë ILDKPKI-së dokumentacionin për lejen e legalizimit shtesë kati në ndërtesën ekzistuese në emër të shtetasit A. Ç..

1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se shtetasja E. V.¹² ka paraqitur formularin e vetëdeklarimit nr. *** prot., datë 24.8.2006, për legalizimin e objektit pa leje, viti i ndërtimit 1997, sipërfaqja e ndërtimit 50 m². Vetëdeklarimi është nënshkruar në fund nga shtetasit E. V., A. Ç. dhe P. M.. Më tej është lëshuar leja e legalizimit nr. ***, datë 16.1.2017, për objektin shtesë anësore 3 kate, e kombinuar në objektin ekzistues 3 kate, në emër të shtetasve A. e E. M. dhe A. Ç. e P. M., sipërfaqe totale e ndërtimit 133,4 m², për aktivitet 42,8 m². Në këtë leje pasqyrohet sipërfaqja e parcelës ndërtimore 24 m² + 18,8 m², si dhe sipërfaqja ndërtimore 24 m² + 18,8 m².

1.7. Në pyetësin standard, subjekti paraqiti dy certifikata pronësie, lëshuar në datën 27.2.2017 në emër të babait të saj, konkretisht certifikatë për pasurinë apartament nr. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 33,80 m², nga e cila 4,9 m² verandë, si dhe certifikatë për pasurinë apartament nr. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 32,90 m², nga e cila 11,7 m² verandë.

⁹ Pasuria me numër rendor 21.

¹⁰ Leje legalizimi nr. ***, datë 21.1.2017, të objektit shtesë anësore 3 kate, e kombinuar në objektin ekzistues 3 kate, në emër të shtetasve A. M., E. M., A. Ç., P. M., të pasurisë nr. ***, me sip. 133,4 m² dhe me aktivitet 42,8 m²; gentplan, planimetria e katit përdhe, planimetria e katit të parë dhe planimetria e katit të dytë.

¹¹ Shkresa e protokolluar në ILDKPKI me nr. *** prot., datë 19.9.2017.

¹² Më vonë këtë pasuri ia ka kaluar shtetasve A. dhe E. M..

1.8. Me anë të pyetësorit nr. 1¹³, Komisioni i kërkoi subjektit të specifikojë sipërfaqen e saktë të shtesës lidhur me mospërputhjen e evidentuar ndërmjet deklaramit të sipërfaqes 42,8 m² në deklaratën *Vetting* dhe certifikatave të pronësisë të paraqitura në pyetësorin standard, ku rezultojnë sipërfaqet 33,8 dhe 32,9 m². Në përgjigje¹⁴, subjekti sqaroi se në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* nuk ishin lëshuar certifikatat e pronësisë, për këtë arsye, nga ana e saj është deklaruar sipërfaqja e bazës së ndërtimit sipas lejes së legalizimit, në mungesë të një dokumentacioni zyrtar për sipërfaqen e ndërtimit të katit të dytë¹⁵.

Sa më lart, Komisioni vëren se deklarata *Vetting* është dorëzuar në datën 27.1.2017, ndërsa certifikatat e pronësisë mbajnë datën 27.2.2017, pra pas deklaratës *Vetting*.

1.9. Lidhur me vitin e ndërtimit, vlerën e kostos dhe burimin e krijimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 1¹⁶ subjekti deklaroi se shtesa e objektit është kryer në vitin 1997 dhe ka përfunduar plotësisht në vitin 1998 dhe se vlera e investimit ka qenë rreth 750.000 lekë, nga të cilat 650.000 lekë janë investuar në vitin 1997 dhe në vitin 1998 janë kryer punimet e brendshme në vlerën 100.000 lekë.

1.10. Si burim krijimi për ndërtimin e shtesës deklaroi se kanë shërbyer të ardhurat familjare të prindërve deri në momentin e investimit, të ardhurat e subjektit gjatë vitit 1996, periudhë në të cilën ka jetuar me ta, si dhe të ardhurat nga interesi i përfutur nga firmat rentiere. Subjekti paraqiti dokumentacion lidhur me të ardhurat e prindërve nga pensionet¹⁷, ndërsa lidhur me të ardhurat nga firmat rentiere paraqiti një shkresë nga Shoqëritë Huamarrëse në Administrim¹⁸, sipas së cilës nuk gjenden kontrata në emër të shtetasit A. Ç. për depozitimin e shumave monetare në shoqërinë “***”.

1.11. Për të përcaktuar vitin e ndërtimit, Komisioni verifikoi imazhet në platformën *Google Earth*¹⁹, imazhe të cilat konstatohet t’i përkasin periudhës korrik 2004 e në vijim. Referuar këtyre imazheve, nuk vërehet të ketë ndryshime thelbësore në strukturën e objektit.

1.12. Në këto kushte, Komisioni iu referua dokumentacionit të administruar, konkretisht formularit të vetëdeklarimit nr. *** prot., datë 24.8.2006, ku paraqitet viti 1997 si vit ndërtimi, e konfirmuar kjo edhe nga deklarimi i subjektit në përgjigje të pyetësorit se shtesa e objektit është kryer në vitin 1997 dhe ka përfunduar plotësisht në vitin 1998. Për rrjedhojë, Komisioni konsideroi si periudhë ndërtimi vitet 1997 – 1998. Rezulton se gjatë periudhës së ndërtimit të shtesës, subjekti banonte me prindërit e bashkëshortit.

1.13. Për sa i përket kostos së ndërtimit, referuar certifikatave të pronësisë dhe planimetrisë së katit të dytë, sipërfaqja totale e shtesës është 66,7 m², nga të cilat 16,6 m² verandë. Bazuar në VKM-në nr. 13, datë 5.1.1998, kostoja mesatare vjetore e ndërtimit për qytetin e Vlorës, të

¹³ Dërguar në datën 2.7.2023.

¹⁴ Përgjigje datë 12.7.2023.

¹⁵ Subjekti më tej sqaroi se sipërfaqja e katit të dytë ndryshon nga sipërfaqja e bazës së ndërtimit për shkak të shtimit të verandave në katin e dytë dhe një sipërfaqe të vogël në katin e parë që ishte hapësirë shkalle dhe nuk mund të ndërtohej nga pronari i objektit në këtë kat, ndërkohë është ndërtuar prej tyre në katin e dytë dhe në katin e tretë.

¹⁶ Përgjigje datë 12.7.2023.

¹⁷ Vërtetime nr. *** prot., datë 10.7.2023, nr. *** prot., datë 10.7.2023 dhe nr. *** prot., datë 6.7.2023 të DRSH-së Vlorë.

¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 11.7.2023.

¹⁹ Koordinatat e përcjella nga subjekti (***).

banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 1997, është përcaktuar 15.097 lekë/m² sipërfaqe ndërtimi, çka do të thotë që shtesa e ndërtuar vlerësohet me një kosto prej 1.006.970 lekësh²⁰.

1.14. Më tej, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1992 – 1998, duke konsideruar: (i) të ardhurat e prindërve të subjektit²¹; (ii) të ardhurat e subjektit për vitin 1996 (vit në të cilin kanë jetuar së bashku); (iii) shpenzimet e jetesës, përlllogaritur si 66% e të ardhurave, në kuadër të arsyetimit të përdorur nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit²²; (iv) shpenzimet për ndërtimin e shtesës së apartamentit. Në përfundim, nga analiza financiare konstatohet një balancë negative në vlerën 631.777 lekë.

1.15. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: *Subjekti dhe prindërit kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 631.777 lekë, për investimin në shtesën e apartamentit në periudhën 1997 – 1998.*

1.16. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, paraqiti propozimet e saj, si në vijim:

1.17. *Së pari, në lidhje me koston e ndërtimit*, subjekti fillimisht deklaroi se gjatë periudhës së ndërtimit (vitit 1997) ajo ishte shkëputur nga familja e saj dhe jetonte së bashku me prindërit e bashkëshortit. Për të përcaktuar koston e ndërtimit, subjekti i është drejtuar ekspertës vlerësuese, znj. L. V., e cila ka arritur në përfundimin se sipërfaqet e verandave në dy shtesat (16,6 m²) nuk duhet të llogariten me të njëjtën kosto, pasi kostoja e verandës nuk është e barabartë me koston e ndërtimit për sipërfaqe të brendshme. Vlera gjithsej e ndërtimit e përlllogaritur nga ekspertja sipas koston së EKB-së është 881.665 lekë²³. Më tej, subjekti kërkoi që kësaj kostoje duhet t'i zbritet 10% fondi rezervë dhe fitimi neto sipas praktikës së Kolegjit në raste të ngjashme²⁴. Për rrjedhojë, shtesa e ndërtuar duhet të vlerësohet me një kosto prej 793.499 lekësh. Në cilësinë e provës, subjekti i rivlerësimit paraqiti aktin e ekspertimit të hartuar nga eksperti i licencuar L. V..

1.18. *Së dyti, në lidhje me përlllogaritjen e të ardhurave*, subjekti shpjegoi se për vitin 1996 Komisioni ka përfshirë në analizë vetëm të ardhurat e subjektit referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 19.1.2017, që i përkasin periudhës shkurt – maj 1996, në shumën 48.269 lekë. Subjekti kërkoi që të përfshihen të ardhurat neto nga paga për të gjithë vitin 1996, sikurse rezultojnë nga librezat e

²⁰ Sipërfaqe 66,7 m² x 15.097 lekë/m².

²¹ Vërtetim nr. *** prot., datë 10.7.2023, nr. *** prot., datë 6.7.2023 dhe nr. *** prot., datë 10.7.2023. Të ardhurat përpara vitit 1992 nuk u pasqyruan në përputhje me orientimin e Kolegjit, vendimi nr. ***, datë 18.6.2021.

²² Vendim nr. ***, datë 18.6.2021, paragrafi 21.42: *“Organet e rivlerësimit sigurisht që duhet të kryejnë një analizë logjike e të arsyeshme për përlllogaritjen e këtyre shpenzimeve në raste në të cilat ndërthuren elemente të tjera, duke mbajtur në çdo rast në konsideratë se masa prej 66% e shpenzimeve në raport me të ardhurat nga punësimi para vitit 2000, do të merrte kuptim vetëm kur të trajtoheshin të ardhura mesatare të sektorit publik që shkojnë përfaqësisht në vlerën rreth 800 USD në vit, sipas referencës së Bankës së Shqipërisë, dhe duke e vlerësuar këtë orientim në drejtim të përcaktimit të një analize logjike dhe jo si një referim ligjor i detyrueshëm për zbatim”.*

²³ Për pasurinë nr. ***, me sip. 33,80 m², janë përlllogaritur 473.291 lekë, ndërsa për pasurinë nr. ***, me sip. 32,9 m², janë përlllogaritur 408.374 lekë.

²⁴ Subjekti i është referuar vendimit nr. ***, datë 17.3.2022, pasi objekti është një ndërtim informal i kryer nga tre familje dhe ka shpjeguar se në disa raste zbritja ka shkuar deri në 30%, p.sh. në vendimin nr. 15/2009 D. Rr.

punës dhe vërtetimi i lëshuar nga DRSSH-ja Vlorë, paraqitur në përgjigje të pyetësorit nr. 1. Subjekti kërkoi që për vitin 1996 të përlllogaritet paga neto në shumën 97.746 lekë.

1.19. *Së treti, në lidhje me përlllogariten e shpenzimeve të jetesës*, subjekti kërkoi që këto shpenzime të llogariten në masën 30% të të ardhurave për subjektin dhe për nënën, duke qenë se të ardhurat e tyre vjetore kanë qenë mbi 800 USD dhe, për rrjedhojë, shpenzimet e jetesës për periudhën të paraqiten në shumën 430.131 lekë.

1.20. Më tej, subjekti paraqiti analizën e saj financiare, ku reflektohet një pamundësi në shumën 70.645 lekë dhe shpjegoi se këtu nuk janë përfshirë të ardhurat nga firmat rentiere që babai i saj ka përfituar gjatë periudhës, si dhe të ardhurat e dhuruara nga ceremonia e dasmës në vitin 1996.

1.21. Në përfundim, subjekti shpjegoi se – pavarësisht se mënyra e mësipërme e përlllogaritjes së kostos së ndërtesës është një prej metodave që mund të arrijë tek vlera reale – vlera e ndërtimit të shtesës sipas deklarimeve të prindërve ka qenë rreth 750.000 lekë dhe, për rrjedhojë, analiza financiare për ndërtimin e shtesës do të paraqitet me vlerë pozitive.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.22. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 - 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarinimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

1.23. *Lidhur me aspektin deklarativ*, subjekti nuk ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore bashkëpronësinë në këtë apartament, bazuar në parashikimet e shkronjës “a” të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, sipas të cilit mbart detyrimin të deklarojë pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to.

1.24. Më tej, *në lidhje me koston e ndërtimit*, Komisioni konstaton se në aktin e ekspertimit të paraqitur kostoja e ndërtimit për metër katror sipërfaqe verande është e barabartë me 50% të kostos së ndërtimit për sipërfaqe të brendshme.

1.25. Në vijim, Komisioni kreu një analizë të kuadrit ligjor rregullator të kostove të ndërtimit në kohën respektive, nga e cila u konstatua që nuk gjenden referenca për përcaktimin e kostove të ndërtimit për objektin verandë. Sa rezulton, Komisioni vendosi të analizojë raste të objekteve që nuk përlllogariten me koston e plotë të ndërtimit siç janë karabinaja apo garazhi, për të dalë në një vlerësim më të përafërt dhe të saktë për përlllogaritjen e kostos së ndërtimit të objektit verandë. Referuar udhëzuesit për zbatimin e VKM-së nr. 173, datë 29.3.2006 “Për miratimin e kostos minimale fiskale në ndërtim dhe për mënyrën e përcaktimit të çmimit të shitjes së banesave”, si dhe marrëveshjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë, parashikohet se në praktikë mund të hasen raste kur kërkohet analizë më e thellë e strukturës dhe e kostove të ndërtimit sipas fazës së ndërtimit të objektit, duke paraqitur një orientim për përcaktimin e kostos së ndërtimit të garazheve për qëllime fiskale, përafërsisht sa ½ koston për metër katror të ndërtimit të përfunduar që i përket ky garazh. Pra, sipas këtij udhëzuesi, kostoja e

ndërtimit të një garazhi do të llogaritet sa ½ e kostos së ndërtimit të objektit që i përket ky garazh. Pra, kostoja e një ndërtimi të tipit garazh, të cilit i mungojnë shumë elemente strukturore në raport me një objekt të përfunduar të tipit banesë, nga ato për të cilat EKB-ja, në bazë të VKM-ve përkatëse përcakton çmimet referuese, është pa dyshim e ndryshme dhe duhet të trajtohet si e tillë edhe për qëllime fiskale, diferencë e cila orientohet të jetë në masën 50% të çmimit referues²⁵.

1.26. Në këtë këndvështrim, duke pasur parasysh se garazhi është një objekt, i cili për nga pikëpamja strukturore i përafrohet karabinasë (për të cilat Kolegji ka mbajtur një qëndrim orientues në përlllogaritjen e kostos së ndërtimit në masën 40-42%) dhe faktit që objekti garazh ka një kosto më të lartë (duke pasur parasysh se përbëhet prej mureve rrethuese dhe pjesës së tavanit), Komisioni i gjen të drejta dhe shteruese pretendimet e subjektit për llogaritjen e kostos së verandës në masën 50% për metër katror.

1.27. Më tej, Komisioni, bazuar në pretendimin e subjektit në prapësime për llogaritjen e kostos së ndërtimit, duke zbritur disa elemente të kostos si fitimi i planifikuar dhe fondi rezervë nga kostoja e ndërtimit, zbriti vlerat që i korrespondojnë fondit rezervë dhe fitimit të planifikuar në masën 8,83%²⁶ për vitin 1997, nga ku rezultoi se kostoja totale e ndërtimit për këtë shtesë do të ishte 803.814 lekë²⁷.

1.28. *Së dyti, për sa i përket pretendimit të subjektit për të ardhurat e vitit 1996*, Komisioni vëren se referuar vërtetimit të lëshuar nga DRSSH-ja Vlorë subjekti ka përfituar të ardhura nga paga edhe për periudhën qershor – nëntor (të paraqitura në vlerën bruto), periudhë e cila nuk paraqitej në vërtetimin nr. *** prot., datë 19.1.2017, të dorëzuar në deklaratën *Vetting*. Kjo periudhë punësimi konfirmohet edhe në librezën e punës së subjektit²⁸.

1.29. Sa më lart, Komisioni vlerëson se pretendimi i subjektit është i bazuar dhe në vijim përlllogaritje të ardhurat neto bazuar në legjislacionin e kohës në fuqi²⁹, nga ku rezultoi se për periudhën qershor – nëntor të ardhurat kanë qenë 63.722 lekë. Për rrjedhojë, të ardhurat e subjektit nga paga për vitin 1996 përlllogariten në shumën 111.991 lekë³⁰.

1.30. *Lidhur me pretendimin e subjektit për shpenzimet e jetesës*, Komisioni vlerëson se qëndron pretendimi i subjektit për përlllogaritjen e shpenzimeve në masën 30% mbi të ardhurat e subjektit për vitin 1996 (pas rilllogaritjes së kryer më lart) dhe për të ardhurat e nënës për vitet 1995 – 1998³¹. Pas përlllogaritjes, shuma e shpenzimeve të jetesës për periudhën 1992 – 1998 rezulton 490.045 lekë.

²⁵ Paragrafi 15.2, vendimi nr. 34/2022, i Kolegjit.

²⁶ Vendim nr. 06-2022 (JR), datë 17.3.2022, paragrafi 14.8, i Kolegjit të Posaçëm i Apelimit.

²⁷ Kostos prej 881.665 lekësh i është zbritur 8,83%.

²⁸ Paraqitur në përgjigje të pyetësorit nr. 1, datë 3.7.2023.

²⁹ (i) Ndalesat për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore përlllogaritur sipas VKM nr. 42, datë 23.1.1995, ku parashikohet se: “Pas kësaj date punëdhënësi mban 7.7% nga paga e personave të punësuar në kufijtë e pagave minimale 3.180 lekë dhe maksimale 9.540 lekë dhe i derdh si kontribut të detyrueshëm së bashku me pjesën e tij”; (ii) ndalesat për tatimin mbi të ardhurat u përlllogaritën bazuar në ligjin nr. 8091, datë 21.3.1996, ku parashikohet se: “Të ardhurat nga 10.001 - 20.000 lekë në muaj, shuma mbi 10.000 lekë në muaj tatóhet 5%”.

³⁰ Shuma e vlerës 48.269 me vlerën 63.722 lekë.

³¹ Për vitet 1992 – 1994 të ardhurat vjetore kanë qenë nën 800 USD dhe, për rrjedhojë, shpenzimet e jetesës për këtë periudhë mbetën të pandryshuara, në masën 66% të të ardhurave.

1.31. Sa më lart, pas rikryerjes së analizës financiare, rezulton një mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 126.628 lekë³².

1.32. Në përfundim, duke konsideruar në këtë bilanci negative disa rrethana, të tilla si: (i) faktin që shtesa është ndërtuar në vitin 1997, rreth 6 vjet përpara fillimit të detyrës së subjektit; (ii) në kohën e ndërtimit të shtesës subjekti nuk jetonte me prindërit – Komisioni çmon se këto problematika nuk mund të ndikojnë në vlerësimin e kësaj pasurie për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

2. Pasuritë e deklaruar në deklaratën Vetting (numër rendor 2-12)

2.1. Në deklaratën Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar 11 pasuri të paluajtshme, si në vijim:

2.1.1. Katër apartamente banimi dhe dy njësi shërbimi, në rrugën “****”, Vlorë, me pjesë takuese 50%, me burimi krijimi pasuri trashëgimore nga nëna (vendimi nr. ***, datë 24.3.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë) si pronare e truallit, përfituar sipas kontratës së shkëmbimit nr. ***, datë 19.1.2015. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues³³. Apartamentet dhe njësitë e shërbimit janë si më poshtë vijon:

- apartament me sip. 88 m², certifikatë pronësie nr. ***, nr. pasurie ***;
- apartament me sip. 73 m², certifikatë pronësie nr. ***, nr. pasurie ***;
- apartament me sip. 73 m², certifikatë pronësie nr. ***, nr. pasurie ***;
- apartament me sip. 73 m², certifikatë pronësie nr. ***, nr. pasurie ***;
- njësi me sip. 42,6 m², certifikatë pronësie nr. ***, nr. pasurie ***;
- njësi me sip. 50,6 m², certifikatë pronësie nr. ***, nr. pasurie ***.

2.1.2. Një njësi shërbimi dhe tri garazhe, në rrugën “****”, Vlorë dhe në rrugën “****”, Vlorë, me pjesë takuese 50%, me burim krijimi pasuri trashëgimore nga nëna (vendimi nr. ***, datë 24.3.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë) si pronare e truallit, përfituar sipas kontratës së shkëmbimit nr. ***, datë 23.2.2012. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues³⁴. Njësia e shërbimit dhe garazhet janë si më poshtë vijon:

³² Të ardhurat totale 1.167.231 lekë, shpenzimet e jetesës 490.045 lekë, kostoja e ndërtimit 803.814 lekë.

³³ Kontratë shkëmbimi, pasuri e paluajtshme nr. ***, datë 19.1.2015 (truall me apartamente banimi, njësi shërbimi, garazhe), midis pronarëve të truallit A. Ç. dhe Herila Çela dhe shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k.; certifikatë nr. ***, datë 27.1.2015, kartela e pasurisë së paluajtshme, harta treguese; certifikatë pronësie e pasurisë nr. ***, datë 7.1.2015, kartela e pasurisë, harta treguese, planimetria e apartamentit; Certifikatë për vërtetim të pronësisë së pasurisë nr. ***, datë 13.11.2011, kartela e pasurisë, harta treguese; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 7.1.2015, kartela e pasurisë, harta treguese; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 7.1.2015, kartela e pasurisë, harta treguese; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 7.1.2015, kartela e pasurisë, harta treguese; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 7.1.2015, kartela e pasurisë, harta treguese; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 7.1.2015, kartela e pasurisë, harta treguese; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 7.1.2015, kartela e pasurisë, harta treguese; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 7.1.2015, kartela e pasurisë, harta treguese; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 7.1.2015, kartela e pasurisë, harta treguese; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 7.1.2015, kartela e pasurisë, harta treguese; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 7.1.2015, kartela e pasurisë, harta treguese; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 7.1.2015, kartela e pasurisë, harta treguese; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 7.1.2015, kartela e pasurisë, harta treguese; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 7.1.2015, kartela e pasurisë, harta treguese; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 7.1.2015, kartela e pasurisë, harta treguese; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 27.1.2015, kartela e pasurisë, harta treguese; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 27.1.2015, kartela e pasurisë së paluajtshme, harta treguese; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 27.1.2015, kartela e pasurisë së paluajtshme, harta treguese; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 27.1.2015, kartela e pasurisë së paluajtshme, harta treguese.

³⁴ (1) Kontratë shkëmbimi, pasuri e paluajtshme nr. ***, datë 23.2.2012; (2) certifikatë nr. ***, datë 7.5.2011, kartela e pasurisë, harta treguese; (3) vendim nr. ***, datë 24.3.2010, për çeljen e trashëgimisë pas vdekjes së shtetasës E. Ç.; (4) certifikatë nr. ***, datë 29.2.2012, kartela e pasurisë, harta treguese; (5) certifikatë pronësie e pasurisë nr. ***, datë 16.5.2011, kartela e pasurisë së

nr. ***; njësi me sip. 50.6 m², certifikatë nr. ***; garazh me sip. 18 m², certifikatë nr. ***; garazh me sip. 24 m², certifikatë nr. ***.

2.4. ASHK Drejtoria Vendore Vlorë³⁶, me shkresën e datës 12.5.2023 informon se shtetasit A. Ç. dhe Herila Çela kanë qenë bashkëpronarë të pasurisë nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit truall me sip. 2.680 m², e cila është ndarë dhe ka vijuar në pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit truall me sip. 1.800 m², ndodhur në z. k. ***, dhe në pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit truall me sip. 880 m², ndodhur në z. k. ***, pasuri në të cilat shtetasit e sipërpërmendur janë bashkëpronarë në 32/100 pjesë secili.

2.5. Më tej bëhet me dije se këta shtetas rezultojnë bashkëpronarë në 1/2 pjesë secili në pasuritë nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit njësi me sip. 42,6 m², ndodhur në z. k. ***; nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit njësi me sip. 50,6 m², ndodhur në z. k. ***; pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit njësi me sip. 78 m², ndodhur në z. k. ***. Po ashtu, ata rezultojnë bashkëpronarë me 1/3 pjesë takuese në pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit apartament me sip. 68,62 m².

2.6. Sa i përket personit të lidhur, Th. L., prej verifikimit të kryer rezultoi të jetë pronar i pasurisë nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit apartament me sip. 77 m², ndodhur në z. k. ***³⁷.

2.7. Komisioni vëren se që nga momenti i dorëzimit të deklaratës *Vetting* deri në përgjigjen e ASHK-së Vlorë janë transkriptuar disa pasuri, siç pasqyrohet në vijim:

Nr.	Deklaruar në deklaratën <i>Vetting</i>	Periudha 28.1.2017 – 12.5.2023
1	Njësi shërbimi, pasuri nr. ***, sip. 78 m ²	Në pronësi (konfirmuar shkresë ASHK, datë 12.5.2023)
2	Njësi shërbimi, pasuri nr. ***, sip. 42.6 m ²	
3	Njësi shërbimi, pasuri nr. ***, sip. 50.6 m ²	
4	Truall me sip. 880 m ² , nr. pasurie ***	
5	Garazh, pasuri nr. ***, sip. 24 m ²	Kontratë shitjeje nr. ***, datë 16.3.2022 (noter S. H.)
6	Garazh, pasuri nr. ***, sip. 24 m ²	
7	Garazh, pasuri nr. ***, sip. 17 m ²	
8	Apartament, pasuri nr. ***, sip. 73 m ²	Kontratë shitjeje nr. ***, datë 9.9.2019 (noter S. H.)
9	Apartament, pasuri nr. ***, sip. 88 m ²	Transkriptim i konfirmuar nga ASHK, email datë 19.9.2019, drejtuar ILDKPKI-së
10	Apartament, pasuri nr. ***, sip. 73 m ²	
11	Apartament, pasuri nr. ***, sip. 73 m ²	

2.8. Sa më lart, rezulton se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e administruar nga ASHK-ja Vlorë.

Lidhur me origjinën e pasurisë truall, nga shkëmbimi i të cilit rrjedhin pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting* (numër rendor 2-12)

2.9. Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti dhe atë të administruar nga hetimi, konstatoi se pasuritë e mësipërme, si dhe disa të tjera të transkriptuara, kanë të njëjtën origjinë dhe, për këtë arsye, do të trajtohet në mënyrë kronologjike dinamika e veprimeve/ngjarjeve juridike, si në vijim:

³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 12.5.2023.

³⁷ Kjo pasuri është trajtuar në seksionin “Të tjera”.

2.10. Datë 30.6.2003 – Vendim nr. *, datë 30.6.2003, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë**

2.10.1. Sipas vendimit nr. ***, datë 30.6.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë³⁸, në vitin 1950 ka qenë në pronësi të shtetasës E. Ç. (B.³⁹) një pronë tokë + banesë, me sip. 8.200 m², në lagjen ***, e cila i është shtetëzuar kërkueses në vitin 1952 për nevoja të parkut të qytetit, pronë e ndodhur brenda vijës së verdhë të qytetit të Vlorës. Sa rezulton, është provuar edhe me dëshmitë e dëshmitarit M. Rr., i cili është kufitar me kërkuesen. Kjo e fundit ka qenë jashtë shtetit që nga viti 1999 deri sot, në këto kushte gjykata ka çmuar se për shkaqe të arsyeshme nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të paraqitur kërkesën para KKKP-së.

2.10.2. Gjykata ka vendosur vërtetimin e faktit juridik të pronësisë së kërkueses E. Ç. mbi një sipërfaqe truall prej 8.200 m², që ndodhet në lagjen ***, Vlorë, dhe rivendosjen në afat për të paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin përkatës pranë KKKP-së Vlorë. Ky vendim ka marrë formë të prerë pasi nuk është ankimuar⁴⁰.

2.11. Datë 31.7.2006 – Vendim i Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

2.11.1. Sipas akt-verifikimit të KVKKP-së Vlorë, datë 10.7.2006⁴¹, mbi verifikimin në terren të pronës së pretenduar në sipërfaqe truall prej 8.200 m² janë ngritur 5 ndërtime pa leje, ndërkohë në një parcelë ka filluar një ndërtim. Vetëm sipërfaqja prej 2.680 m² është e lirë në kuptim të ligjit.

2.11.2. Në këto kushte, me vendimin nr. ***, datë 31.7.2006, KKKP-ja Vlorë ka vendosur: (i) t'i njohë të drejtën e pronësisë subjektit të shpronësuar E. Ç. për sipërfaqen tokë truall 8.200 m²; (ii) të kthejë në natyrë sipërfaqen prej 2.680 m², (iii) të kompensojë sipërfaqen prej 5.520 m². Sipas shënimit, vendimi ka marrë formë të prerë në datën 5.10.2006 (kundërshtimi i këtij vendimi është trajtuar në paragrafin 2.17).

2.11.3. Referuar dokumentacionit të administruar nga ILDKPKI-ja⁴², në kartelën e pasurisë së truallit me sip. 2.680 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, pasqyrohet data e regjistrimit, 8.1.2007, me vendim të KKKP-së Vlorë.

2.12. Datë 21.3.2007 – Kontratë shitjeje të 35% të truallit me sip. 2.680 m²

2.12.1. Referuar dokumentacionit të përcjellë nga ASHK-ja⁴³ rezulton se shtetasja E. Ç. ka lidhur kontratën e shitblerjes së truallit nr. ***, datë 21.3.2007, me shtetasit L. N. dhe P. Ç., të cilëve nga prona truall me sip. 2.680 m² u shet 35% të pasurisë, e barabartë me 938 m² dhe secili blerës përfiton 17.5% (469 m²), me çmim 1.000.000 lekë (secili nga 500.000 lekë).

2.12.2. Sa rezulton, provohet me kartelën e pasurisë dhe certifikatën e pronësisë nr. ***, datë 7.6.2011, pasuria truall me sip. 2.680 m², nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, në emër të shtetasve A. dhe Herila Çela, të cilët janë bashkëpronarë me 32.5% secili, dhe shtetasve L. N. dhe P. Ç., të cilët janë bashkëpronarë me 17.5% secili⁴⁴. Referuar kontratës së shitjes, mbi këtë pronë është

³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 4.4.2023, Agjencia e Trajtimit të Pronave.

³⁹ Nga certifikatat e lëshuara nga Zyra e Gjendjes Civile Vlorë, kërkuesja E. Ç. para martesë ka pasur mbiemrin B.

⁴⁰ Shënimi i kancelares në fund të vendimit të administruar me shkresën nr. *** prot., datë 4.4.2023, të ATP-së.

⁴¹ Administruar në dosjen nr. ***, datë 3.5.2006, lidhur me vendimin nr. ***, datë 31.7.2006 të ish-KVKKP-së Qarku Vlorë, administruar me shkresën nr. *** prot., datë 4.4.2023, të ATP-së.

⁴² ASHK Drejtoria Vendore Vlorë, me anë të *email*-it datë 8.11.2019, ka përcjellë informacion pranë ILDKPKI-së.

⁴³ ASHK Drejtoria Vendore Vlorë, me anë të *email*-it datë 8.11.2019, ka përcjellë informacion pranë ILDKPKI-së.

⁴⁴ Paraqitur në deklaratën *Vetting*.

ndërtuar një objekt 8-9-katësh nga shoqëria “****” sh.p.k., regjistruar me nr. ***, me 62 apartamente banimi, 13 ambiente shërbimi dhe 30 garazhe.

2.12.3. Pikërisht kjo sipërfaqe prej 2.680 m² ka qenë objekt shkëmbimi në kontratën e shkëmbimit nr. ***, datë 23.2.2012, me shoqërinë “****” sh.p.k. (trajtuar në vijim, në paragrafin 2.16 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht).

2.13. *Datë 30.5.2008 – Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, me shoqërinë “****” sh.p.k.*

2.13.1. Në dokumentacionin e përcjellë nga noteri publik S. H.⁴⁵ është administruar kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 30.5.2008, me palë E. Ç., L. N. dhe P. Ç., në cilësinë e pronarëve të truallit dhe shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit. Pronarët e truallit kanë rënë dakord që të vënë në dispozicion të ndërtuesit pasurinë truall me sipërfaqe totale 2.680 m², me nr. ***⁴⁶, vol. ***, f. ***, z. k. ***, për ndërtimin e një banese 8-9-katëshe, me 7-8 kate apartamente banimi, 1-2 kate dyqan dhe parkim të nëndheshëm. Numri dhe pozicioni i apartamenteve të banimit, dyqaneve dhe parkimeve të nëndheshme dhe çdo mjedisi e hapësire që iu takon pronarëve të truallit do të caktohet nga të dy palët kontraktuese me akt noterial të sipërmarrësit me pronarët e truallit dhe duhet realizuar jo më vonë se 45 ditë pas miratimit të lejes së ndërtimit nga KRRT, Bashkia Vlorë dhe para fillimit të punimeve. Në këtë akt noterial pronarët e truallit kanë të drejtë të zgjedhin pozicionet e pjesëve që ju takojnë në masën 50%, ndërsa pjesa tjetër prej 50% do të caktohet për ta nga sipërmarrësit. Përqindja që përfitojnë pronarët e truallit nga sipërmarrësi do të jetë në masën apartamente 15%, dyqane 25%, parkim i nëndheshëm 25%.

2.13.2. Nga hetimi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë⁴⁷ nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me ndërtuesit, shoqëria “****” sh.p.k.⁴⁸.

2.14. *Datë 24.3.2010 – Lëshimi i trashëgimisë*

Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vendimin nr. ***, datë 24.3.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për çeljen e trashëgimisë pas vdekjes së shtetases E. Ç. (nëna e subjektit), ku trashëgimtarët ligjorë janë bashkëshorti A. dhe vajza Herila Çela, me 1/2 pjesë të pasurisë.

2.15. *Datë 5.10.2010 – Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë*

2.15.1. Nga hetimi administrativ⁴⁹ rezultoi se vendimi nr. ***, datë 31.7.2006, i KKKP Qarku Vlorë, është kundërshtuar dhe ka qenë objekt gjykimi në gjykatë.

2.15.2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 5.10.2010, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, duke ndryshuar vendimin nr. ***, datë 31.7.2006, të KKKP Qarku Vlorë, e duke i kthyer në natyrë të ndjerës E. Ç. edhe 820 m² tokë truall.

⁴⁵ Shkresë datë 18.3.2023 e noterit publik S. H., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.3.2023.

⁴⁶ Sipas certifikatës së pronësisë, pasuria mban numrin ***.

⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 1.6.2023.

⁴⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 14.7.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe shkresë nr. *** prot., datë 10.7.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁴⁹ Dokumentacion i përcjellë nga ILDKPKI-ja, shkresë nr. *** prot., datë 3.3.2023.

2.15.3. Në vendim arsyetohet se është kthyer në natyrë një sipërfaqe prej 2.680 m². Sipërfaqet e tjera të kësaj pasurie rezultojnë se aktualisht janë të zëna me ndërtime shumëkatëshe apo objekte të vetëdeklaruarra për legalizim dhe, për efekt të ligjit, konsiderohen si të zëna. Ndërkohë që nga akti i ekspertimit rezulton se e vetmja sipërfaqe e lirë dhe e pakthyer në natyrë është sipërfaqja S1 prej 820 m². Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 22.12.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

2.15.4. Sa rezulton, provohet me kartelën e pasurisë dhe certifikatën e pronësisë nr. ***, datë 13.1.2011, pasuria truall me sip. 820 m², nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, në emër të shtetasve A. dhe Herila Çela⁵⁰.

2.15.5. Pikërisht kjo sipërfaqe prej 820 m² ka qenë objekt shkëmbimi në kontratën e shkëmbimit nr. ***, datë 19.1.2015, me shoqërinë “****” sh.p.k. (trajtuar në vijim në paragrafin 2.18 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht).

2.16. *Datë 23.2.2012 – Kontratë shkëmbimi nr. *** me shoqërinë “****” sh.p.k.*

2.16.1. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kontratën e shkëmbimit për pasurinë e paluajtshme nr. ***, datë 23.2.2012⁵¹, me palë pronarët e truallit A. Ç. dhe Herila Çela, me 32.5% të truallit secili, L. N. dhe P. Ç. me 17.5% të truallit secili, si dhe shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k., në të cilët shtetasit A. e Herila Çela dhe L. N. e P. Ç. janë pronarë të truallit me sip. 2.680 m², regjistruar në z. k. ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, Vlorë, ndërsa pronari i ndërtesës “****” sh.p.k. rezulton pronar mbi objektin 8-9-katësh të regjistruar në z. k. ***, pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, në të cilën 62 janë apartamente banimi, 13 ambiente shërbimi dhe 30 garazhe.

2.16.2. Pronarët e truallit dhe pronarët e ndërtesës pas një marrëveshjeje paraprake kanë rënë dakord të realizojnë shkëmbime, nga të cilët shtetasit A. dhe Herila Çela do të përfitojnë: (1) apartament me sip. 117 m², regjistruar në z. k. ***, me nr. ***, vol. ***, f. ***; (2) njësi shërbimi me sip. 78 m², regjistruar në z. k. ***, me nr. ***, vol. ***, f. ***; (3) garazh me sip. 24 m², regjistruar në z. k. ***, me nr. ***, vol. ***, f. ***; (4) garazh me sip. 24 m², regjistruar në z. k. ***, me nr. ***, vol. ***, f. ***; (5) garazh me sip. 17 m², regjistruar në z. k. ***, me nr. ***, vol. ***, f. ***; (6) garazh me sip. 17 m², regjistruar në z. k. ***, me nr. ***, vol. ***, f. ***.

2.16.3. Pasuritë e mësipërme janë marrë në dorëzim nga pronarët e truallit dhe janë vënë në shfrytëzim prej tyre. Në këtë kontratë specifikohet se meqenëse në zonën jugore të truallit në bashkëpronësi, jashtë zonës funksionale të objektit banesë 8-9-katësh, ka studim urbanistik për ndërtim objekti, bashkëpronarët e truallit në raportin 25% dhe shoqëria “****” sh.p.k. në raportin 75% do të krijojnë një marrëveshje të re bashkëpunimi. Kjo kontratë zëvendëson të gjitha komunikimet e mëparshme me shkrim ose verbale. Prona truall me sip. 2.680 m² është hipotekuar në favor të shoqërisë në datën 4.5.2009, me kontratë hipotekimi nr. ***, e legalizuar në datën 4.5.2011, deri në momentin e redaktimit të kësaj kontrate shkëmbimi. Bashkëpronari L. N. do të përfitojë dy apartamente me sip. 117 dhe 71 m², si dhe dy garazhe me sip. 18 m² secili. Bashkëpronari tjetër P. Ç. do të përfitojë njësi shërbimi me sip. 66 m² dhe dy garazhe me sip. 24

⁵⁰ Paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*.

⁵¹ Shkresë datë 18.3.2023 e noterit publik S. H., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.3.2023.

m² secili. Apartamentet, njësitë dhe garazhet janë marrë në dorëzim nga pronarët e truallit dhe janë vënë në shfrytëzim prej tyre.

2.16.4. Nga hetimi rezultoi se për dy nga pasuritë e përfituara deri në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* janë lidhur kontratat e shitblerjes vijuese:

i. Për pasurinë apartament me sip. 117 m², me nr. ***, është lidhur kontrata e shitjes nr. ***, datë 24.12.2014, blerës F. dhe M. A., me çmim 50.000 euro⁵².

2.16.5. Lidhur me likuidimin e çmimit, nga analizimi i llogarive bankare rezultoi se noteri publik S. H., në datën 9.1.2015 ka transferuar shumën 50.000 euro në llogaritë e bashkëshortit të subjektit, konkretisht shumën 11.000 euro në llogarinë pranë BKT-së dhe shumën 39.000 euro në llogarinë pranë Raiffeisen Bank.

2.16.6. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur një kontratë kapari nr. ***, datë 22.7.2014, me shtetasit F. dhe M. A., për shitjen e këtij apartamenti në vlerën 50.000 euro, sipas së cilës pala blerëse ka paguar vlerën 1.000 euro si kapar, ndërsa kësti i dytë prej 49.000 euro do të likuidohet deri në datën 31.12.2014.

2.16.7. Sa më sipër, në kushtet që shuma e likuiduar rezultoi 51.000 euro përkundrejt çmimit prej 50.000 euro të përcaktuar në kontratën e shitjes, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1, i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit. Në përgjigje⁵³, subjekti shpjegoi se vlera e kaparit prej 1.000 euro është disponuar prej babait të saj A. Ç. që nga momenti i lidhjes së kontratës së kaparit dhe kjo është arsyeja e mosdeklarimit në DIPP/2014. Blerësi kishte kërkuar të blinte edhe një garazh dhe verbalisht ishte rënë dakord që në momentin e transferimit të shumave monetare në llogarinë e noterit shuma e kaparit, paguar tepër prej 1.000 euro, do të shërbente si kapar për blerjen e garazhit. Apartamenti u likuidua plotësisht nga blerësi në fund të vitit 2014 në llogarinë e noterës, e cila i transferoi në llogarinë e bashkëshortit në datën 9.1.2015.

2.16.8. Ndërsa, lidhur me pagesën për blerjen e garazhit, blerësi ka paguar vlerën 4.000 euro në datën 21.7.2016 në llogarinë e noterës pranë BKT-së, ndërsa pjesën tjetër prej 1.000 euro (kaparin) babai i subjektit ia ka dhënë bashkëshortit të kësaj të fundit dhe, më tej, ky i fundit e ka depozituar në llogarinë e noterës, çka provohet me kopje të mandatit të depozitimit bankar, datë 27.7.2016, me përshkrimin “F. A. derdh për blerje garazhi, arkëtoi Th. L.”, nënshkruar nga bashkëshorti Th. L.⁵⁴.

2.16.9. Sa më lart, Komisioni paraqiti në analizën financiare të vitit 2014 vlerën prej 1.000 euro, të marrë si kapar për garazhin, dhe në analizën financiare të vitit 2015 shumën prej 50.000 euro, si të ardhura nga shitja e këtij apartamenti.

⁵² (i) Kontratë e administruar me shkresën datë 18.3.2023 nga noteri publik S. H., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.3.2023. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 24.12.2014 dhe kontratë kapari nr. ***, datë 22.7.2014; (ii) në DIPP-në e vitit 2014, plotësuar në datën 27.3.2015, subjekti ka deklaruar shitje apartamenti në Vlorë me anë të kontratës nr. ***, datë 24.12.2015 (viti 2015 duhet të jetë lapsus), në shumën 50.000 euro. Më tej, në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar shitje apartamenti me sip. 117 m², me anë të kontratës nr. ***, datë 24.12.2014, në vlerën 50.000 euro, derdhur në llogarinë e bashkëshortit pjesërisht në BKT 11.000 euro dhe pjesërisht në Raiffeisen Bank 39.000 euro; (iii) ASHK Drejtoria Vendore Vlorë, me anë të postës elektronike drejtuar ILDKPKI-së, datë 12.9.2019, konfirmon se kjo pasuri figuron e regjistruar në pronësi të shtetasve F. dhe M. A..

⁵³ Datë 12.7.2023.

⁵⁴ Subjekti paraqiti kopje të mandatit të depozitimit në BKT.

ii. Për pasurinë garazh me sip. 17 m², me nr. ***, është lidhur kontrata e shitjes nr. ***, datë 15.9.2016, blerës F. dhe M. A., me çmim 5.000 euro⁵⁵.

2.16.10. Lidhur me likuidimin e çmimit, nga analizimi i llogarive bankare rezultoi se noteri publik S. H. ka transferuar shumën 5.000 euro në llogarinë e bashkëshortit të subjektit pranë BKT-së (në dy këste)⁵⁶, në datën 23.9.2016. Siç u shpjegua më lart, kapari i arkëtuar në vitin 2014 ka shërbyer për garazhin dhe, për rrjedhojë, në analizën financiare të vitit 2016 u paraqit shuma 4.000 euro, si të ardhura nga shitja e këtij garazhi.

2.16.11. Në përfundim, pasuritë e fituara nga kjo kontratë shkëmbimi, të cilat rezultojnë në pronësi të subjektit në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*⁵⁷, përkojnë me ato të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit (paragrafi 2.1.2 i relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht).

2.17. Datë 18.11.2013 – Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

2.17.1. Nga hetimi rezultoi se babai i subjektit/A. Ç. ka kërkuar në gjykatë veçimin e pasurisë me sip. 2.680 m² nga leja dhe sheshi i ndërtimit (të miratuara me vendimet nr. *** dhe ***, datë 24.11.2008, të KRRT-së Vlorë, për ndërtimin e një objekti 8-9-katësh, 1-2 kate dyqane dhe 6-7 kate + 1 kat parkim nëntokë) dhe regjistrimin e pjesës së veçuar në regjistrat e pasurive të paluajtshme të ZVRPP-së Vlorë.

2.17.2. Sipas vendimit nr. ***, datë 18.11.2013⁵⁸, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ekspertja e thirrur në këtë gjykim bën me dije se në planimetrinë e sheshit të ndërtimit sipërfaqja e sheshit është 2.680 m², sipërfaqja që është në funksion të pallatit 8-9-katësh është 1.800 m² dhe sipërfaqja e mbetur pa përdorur për ndërtim është 880 m².

2.17.3. Sa rezulton, gjykata ka vendosur veçimin prej pasurisë nr. ***, me sip. 2.680 m², të sipërfaqes prej 880 m² nga sheshi i ndërtimit, duke detyruar ZVRPP-në Vlorë të pajisë me certifikatë pronësie paditësin A. Ç..

2.17.4. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur certifikatën nr. ***, datë 25.9.2015, për pasurinë truell me sip. 880 m², e cila figuron e regjistruar në emër të shtetasve A. dhe Herila Çela, me 32% pjesë takuese secili dhe L. N. e P. Ç. me 18% pjesë takuese secili. Në kartelën e pasurisë së paluajtshme identifikohet ndarja nëpërmjet vendimit të gjykatës nr. ***, datë 17.12.2013.

2.17.5. Pikërisht kjo sipërfaqe prej 880 m², me nr. pasurie ***, është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* (paragrafi 2.1.3. i relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht).

2.18. Datë 19.1.2015 – Kontratë shkëmbimi nr. ***, me shoqërinë “****” sh.p.k.

2.18.1. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kontratë shkëmbimi të pasurive të paluajtshme nr. ***, datë 19.1.2015 (truall prej 820 m² me apartamente banimi, njësi shërbimi,

⁵⁵ Kontratë e paraqitur në deklaratën *Vetting* dhe e administruar nga noteri publik S. H., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.3.2023. ZVRPP-ja Vlorë, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 14.9.2017, drejtuar ILDKPKI-së, informon se kjo pasuri është regjistruar në emër të shtetasve M. A. dhe F. A..

⁵⁶ Vlerat 4.000 euro dhe 1.000 euro, në datën 23.9.2023.

⁵⁷ (i) Njësi shërbimi me sip. 78 m², regjistruar në z. k. ***, me nr. ***, vol. ***, f. ***; (ii) garazh me sip. 24 m², regjistruar në z. k. ***, me nr. ***, vol. ***, f. ***; (iii) garazh me sip. 24 m², regjistruar në z. k. ***, me nr. ***, vol. ***, f. ***; (iv) garazh me sip. 17 m², regjistruar në z. k. ***, me nr. ***, vol. ***, f. ***.

⁵⁸ Administruar nga ILDKPKI-ja.

garazhe)⁵⁹, të lidhur midis pronarëve të truallit A. e Herila Çela dhe shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k., lidhur me ndërtimin e bërë, nga ku rezulton se subjekti dhe babai i saj kanë përfituar pasuritë si vijon: (1) apartament me sip. 88 m²; (2) apartament me sip. 73 m²; (3) apartament me sip. 92 m²; (4) apartament me sip. 76 m²; (5) apartament me sip. 73 m²; (6) apartament me sip. 92 m²; (7) apartament me sip. 73 m²; (8) apartament me sip. 73 m²; (9) apartament me sip. 92 m²; (10) njësi shërbimi me sip. 42,6 m²; (11) njësi shërbimi me sip. 50,6 m²; (12) garazh me sip. 18 m²; (13) garazh me sip. 24 m².

2.18.2. Pasuritë e mësipërme janë marrë në dorëzim nga pronarët e truallit dhe janë vënë në shfrytëzim prej tyre. Në marrëveshje citohet se ndërmjet palëve ka pasur një marrëveshje paraprake.

Në dokumentacionin e përcjellë nga noteri publik S. H.⁶⁰ është administruar një deklaratë noteriale nr. *** datë 30.5.2014, lëshuar nga A. dhe Herila Çela, ku rezulton se këta shtetas kanë lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k. kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 10.2.2011, për ndërtimin e një objekti shumëkatësh në truallin që kanë në pronësi me nr. pasurie ***, z. k. ***. Ndër të tjera, deklarojnë se nuk kanë asnjë pretendim për ndarjen fizike dhe kanë marrë pjesën e tyre takuese prej 26% të sipërfaqes ndërtimore.

Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkua që të paraqesë marrëveshjen paraprake të lidhur me shoqërinë e ndërtimit “****” sh.p.k., e cila në përgjigje⁶¹ vendosi në dispozicion kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 10.2.2011, nënshkruar midis palëve, nëpërmjet së cilës është rënë dakord se përqindja e përfitimit në ndërtim do të jetë 26%.

2.18.3. Nga hetimi rezultoi se deri në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* për 7 nga pasuritë e përfituara janë lidhur kontratat e shitblerjes, si vijon:

i) Për pasurinë apartament me sip. 92 m², nr. pasurie ***, është lidhur kontratë shitblerjeje me rezervë nr. ***, datë 25.5.2016, me blerës D. dhe F. T., me çmim 40.000 euro⁶².

Lidhur me likuidimin e çmimit, nga analizimi i llogarive bankare rezultoi se noteri publik S. H. ka kryer këto transfertat bankare: (i) në datën 23.9.2016, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit pranë BKT-së, vlerat 6.000 euro, 3.000 euro dhe 1.000 euro; (ii) në datën 4.8.2016, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit pranë ABI Bank, vlerën 10.000 euro; (iii) në datën 27.1.2017, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit pranë ABI Bank, vlerën 19.700 euro.

Në kushtet që shuma totale e transferuar rezultoi 300 euro më pak se çmimi i përcaktuar në kontratë, me anë të pyetësorit nr. 1 Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit, e cila në përgjigje⁶³ deklaroi se erdhi në dijeni të këtij fakti vetëm pas pyetjes së Komisionit. Subjekti shpjegoi se pas verifikimeve të kryera nga ana e saj dhe, më pas, edhe nga noteri publik, rezultoi se blerësi e ka transferuar shumën 300 euro në datën 27.1.2017 në llogarinë bankare të noterit publik, por kjo e

⁵⁹ Kontratë e paraqitur në deklaratën *Vetting* dhe e administruar nga noteri publik S. H., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.3.2023.

⁶⁰ Shkresë datë 18.3.2023 e noterit publik S. H., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.3.2023.

⁶¹ Përgjigje datë 12.7.2023.

⁶² Kontratë e paraqitur në deklaratën *Vetting* dhe e administruar nga noteri publik S. H., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.3.2023

⁶³ Përgjigje datë 12.7.2023.

fundit nuk e kishte transferuar këtë shumë në llogarinë e subjektit apo të bashkëshortit. Në datën 10.7.2023, noteri publik e ka transferuar shumën 300 euro në llogarinë e bashkëshortit në BKT. Subjekti paraqiti deklaratën personale datë 10.7.2023 të noterit publik S. H., person fizik, si dhe mandatpagesat e datës 10.7.2023, kryer pranë BKT-së dhe mandatpagesën e datës 27.1.2017, kryer nga NBG Bank.

Për rrjedhojë, në analizën financiare të vitit 2016 u paraqit shuma 20.000 euro, si të ardhura nga shitja e këtij apartamenti.

ii) Për pasurinë apartament me sip. 76 m², nr. pasurie ***, është lidhur kontrata e shitjes nr. ***, datë 27.9.2016, me blerës R. dhe B. M., me çmim 33.000 euro⁶⁴.

Lidhur me likuidimin e çmimit, nga analizimi i llogarive bankare rezultoi se noteri publik S. H. ka transferuar në llogarinë e bashkëshortit të subjektit pranë BKT-së shumën 7.000 euro në datën 23.9.2016 dhe shumën 26.000 euro në datën 13.10.2016. Për rrjedhojë, në analizën financiare të vitit 2016 u paraqit shuma 33.000 euro, si të ardhura nga shitja e këtij apartamenti.

iii) Për pasurinë apartament me sip. 92 m², nr. pasurie ***, është lidhur kontrata e shitjes nr. ***, datë 10.11.2016, me blerës E. M. dhe M. P., me çmim 38.000 euro⁶⁵.

Lidhur me likuidimin e çmimit, nga analizimi i llogarive bankare rezultoi se noteri publik S. H. ka transferuar shumën 38.000 euro (në 5 këste) në llogarinë e bashkëshortit të subjektit pranë BKT-së, në datën 29.12.2016. Për rrjedhojë, në analizën financiare të vitit 2016 u paraqit shuma 38.000 euro, si të ardhura nga shitja e këtij apartamenti.

iv) Për pasurinë apartament me sip. 73 m², nr. pasurie *** dhe për pasurinë garazh me sip. 18 m², nr. pasurie ***, është lidhur kontrata e shitjes nr. ***, datë 6.3.2015, blerës G. V. dhe A. I., me çmim total 35.000 euro⁶⁶.

Lidhur me likuidimin e çmimit, nga analizimi i llogarive bankare rezultoi se noteri publik S. H. ka transferuar shumën 35.000 euro në llogarinë e bashkëshortit të subjektit në BKT, në datën 11.5.2015. Për rrjedhojë, në analizën financiare të vitit 2015 u paraqit shuma 35.000 euro, si të ardhura nga shitja e këtij apartamenti dhe garazhi.

v) Për pasurinë apartament me sip. 92 m², nr. pasurie ***, është lidhur kontrata e shitjes nr. ***, datë 7.12.2016, me blerës B. dhe L. J., me çmim 41.000 euro⁶⁷.

Lidhur me likuidimin e çmimit, nga analizimi i llogarive bankare rezultoi se noteri publik S. H. ka transferuar shumën 41.000 euro në llogarinë e bashkëshortit të subjektit pranë FiBank, në datën

⁶⁴ Kontratë e paraqitur në deklaratën *Vetting* dhe e administruar nga noteri publik S. H., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.3.2023. ASHK-ja, me anë të *email*-it datë 19.9.2019 drejtuar ILDKPKI-së, konfirmon se kjo pasuri është e regjistruar në emër të shtetasve B. dhe R. M..

⁶⁵ Kontratë e paraqitur në deklaratën *Vetting* dhe e administruar nga noteri publik S. H., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.3.2023.

⁶⁶ Kontratë e paraqitur në deklaratën *Vetting* dhe e administruar nga noteri publik S. H., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.3.2023. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar shitje apartamenti me sip. 73 m², me anë të kontratës nr. ***, datë 6.3.2015, në vlerën 30.000 euro, arkëtuar në llogarinë e bashkëshortit për lehtësi veprimi, dhe shitje garazhi me sip. 18 m², me anë të kontratës nr. ***, datë 6.3.2015, në vlerën 5.000 euro, arkëtuar në llogarinë e bashkëshortit për lehtësi veprimi.

⁶⁷ Kontratë e paraqitur në deklaratën *Vetting* dhe e administruar nga noteri publik S. H., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.3.2023.

30.12.2016. Për rrjedhojë, në analizën financiare të vitit 2016 u paraqit shuma 41.000 euro, si të ardhura nga shitja e këtij apartamenti.

vi) Për pasurinë garazh me sip. 24 m², nr. pasurie ***, është lidhur kontratë shitjeje nr. ***, datë 11.6.2016, e shtetasve G. V. dhe A. I., me çmim 5.000 euro⁶⁸.

Lidhur me likuidimin e çmimit, nga analizimi i llogarive bankare rezultoi se noteri publik S. H. ka transferuar shumën 5.000 euro në llogarinë e bashkëshortit të subjektit pranë BKT-së, në datën 23.9.2016. Për rrjedhojë, në analizën financiare të vitit 2016 u paraqit shuma 5.000 euro, si të ardhura nga shitja e këtij apartamenti.

2.18.4. Në përfundim, pasuritë e fituara nga kjo kontratë shkëmbimi, të cilat rezultojnë në pronësi të subjektit në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*⁶⁹, përkrijnë me ato të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit (paragrafi 2.1.1. relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht).

2.19. Datë 9.5.2019 – Vendim i Agjencisë së Trajtimit të Pronave për kompensim

2.19.1. Referuar dokumentacionit të përcjellë nga ILDKPKI-ja⁷⁰, në procesverbalin e mbajtur në datën 30.6.2021 subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 5.7.2021, të Agjencisë së Trajtimit të Pronave, ku citohet se nga verifikimi në regjistrin e vendimeve të vitit 2006 rezulton se vendimi nr. ***, datë 31.7.2006, i ish-KVKKP-së Vlorë, është publikuar i vlerësuar financiarisht në vlerën 51.244.100 lekë.

2.19.2. Në vijim, shtetasi Th. L., në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar E. Ç. (B.), ka paraqitur pranë ATP-së kërkesën nr. *** prot., datë 5.4.2016, në Sektorin e Trajtimit të Kërkesave të Veçanta, duke kërkuar në formën e kompensimit financiar me 40% të vlerësimit të vendimit nr. ***, datë 31.7.2006, si dhe duke hequr dorë nga pjesa tjetër. Në përfundim, ATP-ja, me vendimin nr. ***, datë 9.5.2019, ka vendosur kompensimin financiar me kërkesë të veçantë në masën 40% të vlerësimit financiar të pronës së njohur me vendimin nr. ***, datë 31.7.2006, ish-KVKKP Vlorë, ndryshuar me vendimin nr. *** datë 15.10.2010, të Gjykatës së Rrethit Vlorë, përlllogaritur në vlerën 20.497.640 lekë⁷¹, të ndarë në 5 këste, përkatësisht 4.099.528 lekë/vit.

2.20. Në vijim, nga analizimi i kontratave të shkëmbimit dhe informacionit të përcjellë nga shoqëria “****” sh.p.k.⁷², Komisioni konstatoi se: Referuar kontratës së shkëmbimit nr. ***, datë 23.2.2012 (kontrata e sipërmarrjes nr. *** mban datën 30.5.2005), në këmbim të truallit⁷³ prej 1.170 m² (pjesa takuese e subjektit dhe babait) janë përfituar: 1 apartament me sip. 117 m²; 1 njësi shërbimi me sip. 78 m²; 4 garazhe me sipërfaqe totale 82 m², pra në total 277 m². Sipërfaqja totale e shfrytëzimit, referuar aktit të kolaudimit tekniko-ekonomik, ka qenë 6.334 m². Referuar kontratës

⁶⁸ Kontratë e administruar edhe me shkresë nga noteri publik S. H., datë 18.3.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.3.2023, si dhe e paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

⁶⁹ (i) Apartament me sip. 88 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, kati ***, ap. ***; (ii) apartament me sip. 73 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, kati ***, ap. ***; (iii) apartament me sip. 73 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, kati ***, ap. ***; (iv) apartament me sip. 73 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, kati ***, ap. ***; (v) njësi shërbimi me sip. 42,6 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ****; (vi) njësi shërbimi me sip. 50,6 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***.

⁷⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 3.3.2023.

⁷¹ Përlllogaritur 40% x 51.244.100 lekë.

⁷² Shkresë nr. *** prot., datë 12.7.2023, nga shoqëria “****” sh.p.k.

⁷³ Nga sipërfaqja përfundimtare prej 1.800 m², pjesa takuese e subjektit dhe babait të saj është 65%, pra 1.170 m².

së shkëmbimit nr. ***, datë 19.1.2015, në këmbim të truallit prej 820 m² janë përfituar: 9 apartamente me sipërfaqe totale 732 m²; 2 njësi shërbimi me sipërfaqe totale 93,2 m²; 2 garazhe me sipërfaqe totale 42 m², pra në total 867 m². Sipërfaqja totale e shfrytëzimit, referuar aktit të kolaudimit tekniko-ekonomik, ka qenë 4.400 m².

2.21. Sa më lart, Komisioni vëren se sipërfaqja e përfituar në vitin 2015 për shkëmbimin e truallit prej 820 m², ka qenë dukshëm më e lartë se sipërfaqja e përfituar në vitin 2008⁷⁴ për shkëmbimin e truallit prej 1.170 m².

2.22. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: (i) Mbetet e paqartë për Komisionin se përse në vitin 2015 është përfituar një sipërfaqe ndërtimi shumëfish më e lartë se ajo e përfituar në vitin 2008 (në raport me truallin e dhënë), duke konsideruar se bëhet fjalë për të njëjtën vendndodhje të truallit dhe për të njëjtën shoqëri ndërtimi, pasi në vitin 2015 janë përfituar pasuri të paluajtshme me një sipërfaqe totale prej 867 m² në këmbim të një trualli me sip. 820 m², pra është përfituar rreth 106% e sipërfaqes së truallit të dhënë për ndërtim, ndërkohë që në vitin 2008 janë përfituar pasuri të paluajtshme me një sipërfaqe totale prej 277 m² në këmbim të një trualli me sip. 1.170 m², pra rreth 23.67% e sipërfaqes së truallit të dhënë për ndërtim; (ii) Nuk ka logjikë ekonomike që shoqëria “****” sh.p.k. të investojë dhe ndërtojë mbi një truall dhe subjekti të përfitojë një sipërfaqe shumë herë më të lartë në raport me interesat financiarë që shoqëria e ndërtimit mund të ketë në investimin e kryer.

2.23. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se:

i) Sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 30.5.2008, lidhur midis palës pronare të truallit E. Ç., bashkëpronare në 65% të truallit, L. N. e P. Ç., secili bashkëpronar në 17.5% të truallit, dhe shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. për ndërtimin e një banese 8-9-katëshe me 7-8 kate apartamente banimi, 1-2 kate dyqane, parkim të nëndheshëm, përqindja që përfitojnë pronarët e truallit nga sipërmarrësi do të jetë në masën: në apartamente banimi 15%; dyqane 25%; parkime 25%. Referuar aktit të kolaudimit tekniko-ekonomik, sipërfaqja e shfrytëzimit ka qenë 6.334 m² dhe sipërfaqja totale, përfshirë sipërfaqet e përbashkëta, është 7.302 m². Bazuar në raportin teknik privat të përgatitur nga ing. L. V. rezulton se sipërfaqja totale që duhet të përfitonin ka qenë 827,9 m², e ndarë në 153,6 m² garazh, 136,3 m² njësi dhe 538 m² apartamente. Ndërkohë që subjekti deklaroi se ka përfituar 339,6 m² (133,6 m² garazh, 78 m² njësi, si dhe 128 m² apartament). Arsyeja e diferencës së 483,3 m² ndërtim të papërfituar ka qenë për faktin se në këtë truall ka pasur ndërtime informale nga individë të ndryshëm, të cilët kanë përfituar apartamente banimi dhe sipërfaqja e përfituar nga këto ndërtime informale është zbritur nga pjesa takuese e subjektit dhe babait të saj, pa përfshirë dy bashkëpronarët e tjerë L. N. dhe P.Ç.. Gjithashtu, edhe shoqëria “****” sh.p.k. ka përballuar nga fitimit i saj, duke u dhënë një pjesë të sipërfaqes personave të tretë me ndërtime informale. Përqindja e shkëmbimit të truallit me sipërfaqe ndërtimi ishte në masën 15%.

⁷⁴ Viti kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 30.5.2008. Kontrata e shkëmbimit lidhur në datën 23.3.2012.

Pikërisht se trualli ka pasur ndërtime informale, ndërtuesi ka dhënë nga pjesa e tij takuese, si dhe ka prishur të gjitha ndërtimet informale të ndodhura mbi këtë truall.

Për të vërtetuar deklaratimet, subjekti paraqiti në cilësinë e provës deklaratën noteriale nr. ***, datë 15.10.2023, të lëshuar nga administratori i shoqërisë “****” sh.p.k., ku deklarohet se përveç subjektit dhe babait të saj, një pjesë e sipërfaqes së dhënë këtyre shtetasve që kanë pasur ndërtime informale në këtë truall është përballur edhe nga shoqëria. Ndërmjet shoqërisë dhe shtetasve Herila e A. Çela nuk është lidhur marrëveshje për zbritjen e sipërfaqeve nga sipërfaqja e pronarëve të truallit, por palët kanë nënshkruar kontratën e shkëmbimit duke përcaktuar përfundimisht pjesët takuese, duke konfirmuar kështu marrëveshjen verbale që kishin për kalimin nga pjesët e tyre takuese. Ndërkohë që dy bashkëpronarët e tjerë kanë përfituar, sikurse ishte parashikuar në kontratën e sipërmarrjes datë 30.5.2008⁷⁵.

Subjekti bën me dije se shtetasit që kanë pasur ndërtime informale dhe kanë përfituar apartamente janë: (a) B. D.– sipërfaqja e përfituar prej tij është zbritur nga pjesa takuese e subjektit, e cila referuar aktit të vlerësimit është 214 m²; (b) J. T.– sipërfaqja e përfituar prej tij është zbritur nga pjesa takuese e subjektit, e cila referuar aktit të vlerësimit është 83 m²; (c) M. F. – sipërfaqja e përfituar prej tij është zbritur nga pjesa takuese e subjektit, e cila referuar aktit të vlerësimit është 77 m²; (ç) A. V. – sipërfaqja e përfituar prej tij është përballuar nga shoqëria e ndërtimit “****” sh.p.k.

Si përfundim, subjekti deklaroi se nga kjo kontratë shkëmbimi ka përfituar 277 m² sipërfaqe të shfrytëzueshme, 63 m² sipërfaqe të përbashkët, ose sipërfaqe gjithsej 340 m².

ii) Sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 10.2.2011, lidhur midis palës pronare të truallit A. e Herila Çela dhe shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., për ndërtimin e një banese 10-katëshe me 9 kate apartamente banimi, 1 kat dyqane e 1 kat parkim të nëndheshëm, përqindja që përfitojnë pronarët e truallit nga sipërmarrësi do të jetë në masën: apartamente banimi 26%; dyqane 26%; parkime 26%. Trualli prej 820 m² nuk kishte ndërtime informale dhe ka qenë bosh, dhe objekti është një kat më shumë se pallati i parë i ndërtuar. Për këto arsye ndryshon edhe sipërfaqja neto e përfituar ndërmjet dy objekteve⁷⁶. Referuar aktit të vlerësimit teknik të përgatitur nga ing. L.V. rezulton se sipërfaqja totale (përfshirë sipërfaqet e përbashkëta) që duhet të përfitojnë shtetasit A. dhe Herila Çela ka qenë 1.306,8 m², ndërkohë sipërfaqja faktike e përfituar është 991,2 m². Sa rezulton nga akti i ekspertimit, nga zhvillimi i truallit prej 820 m² bazuar në kontratën e sipërmarrjes datë 10.2.2011 dhe kontratës së shkëmbimit nr. ***, datë 19.1.2015, subjekti së bashku me babain nuk kanë përfituar 315,6 m² sipërfaqe totale (1.306,8 m² – 991,2 m²).

2.24. Në konkluzion, subjekti deklaroi: *“Rezulton e provuar që arsyeja e këmbimit të truallit me sip. 1.170 m², duke përfituar 277 m² sipërfaqe të shfrytëzueshme, është për faktin e zbritjes së sipërfaqeve të dhëna personave të tretë që kanë pasur ndërtime informale mbi këtë truall, si dhe faktin që përqindja e shkëmbimit për apartamentet, duke pasur parasysh këtë problematikë, ka*

⁷⁵ Shtetasi L. N. do të përfitojë 2 apartamente me sip. 117 dhe 71 m², si dhe dy garazhe me sip. 18 m² secili. Bashkëpronari tjetër P. Ç. do të përfitojë njësi shërbimi me sip. 66 m² dhe 2 garazhe me sip. 24 m² secili.

⁷⁶ Në pallatin e ndërtuar sipas kontratës së sipërmarrjes datë 30.5.2008 do të përfitoja 827,9 m² sipërfaqe totale (përfshirë edhe sipërfaqet e përbashkëta), ndërsa në kontratën e sipërmarrjes të datës 10.2.2011 ka përfituar 867,2 m² sipërfaqe të shfrytëzueshme ose 991 m² sipërfaqe totale.

qenë në masën 15%. Ndërkohë, për truallin me sip. 820 m², duhet të kisha marrë edhe 315,6 m² sipërfaqe totale më shumë se sipërfaqja e marrë nga kontrata e shkëmbimit datë 19.1.2015”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

2.25. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

2.26. Referuar hartës treguese të regjistrimit të pasurisë nr. *** dhe kartelës së pasurisë, konstatohet se në këtë truall ndodhen të piketuara këto ndërtesa: ***, ***, ***, ***, ***, ***. Sipas dokumentacionit të paraqitur në prapësime⁷⁷, pronarët e këtyre ndërtesave kanë qenë shtetasit A. V., B. D., G. F., M. F. dhe J. T., të cilët kanë lidhur kontratat e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, sa vijon: (i) Kontrata nr. ***, datë 5.9.2012, e lidhur nëpërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit M. F., ku rezulton se ky i fundit ka përfituar apartament me sip. 71 m² në këmbim të shtëpisë së prishur (apartamenti është vlerësuar në shumën 3.500.000 lekë); (ii) Kontrata nr. ***, datë 15.1.2015, e lidhur nëpërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit B. D., ku rezulton se ky i fundit ka përfituar dy apartamente, secili nga 99 m². Çmimi total i këtyre dy pasurive, në bazë të kontratës së premtim shitjes nr. ***, datë 8.8.2009, është 200.000 lekë, të likuiduara me mandatarëkëtimin nr. ***, datë 13.8.2010. Pronësia e këtyre apartamenteve është përfituar nga marrëveshja midis palëve, si rezultat i prishjes së banesës, e cila ishte në proces legalizimi; (iii) Kontrata nr. ***, datë 23.8.2013, e lidhur nëpërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit J. T., ku rezulton se ky i fundit ka përfituar apartament me sip. 99 m² dhe garazh me sip. 17 m². Çmimi total i paguar për dy pasuritë është 17.000 euro. Në këtë vlerë është paguar nga blerësi një dhomë e apartamentit me sip. 16 m² dhe garazhi. Diferenca prej 83 m² është përfituar si kompensim nga prishja e objektit në proces legalizimi; (iv) Kontrata nr. ***, datë 29.10.2012, e lidhur nëpërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit A. V., ku rezulton se ky i fundit ka përfituar dy apartamente me sip. 71 m² secili, një apartament me sip. 99 m² dhe një njësi me sip. 63 m². Këto pasuri janë përfituar në këmbim të objekteve në legalizim, të prishura për ndërtimin e godinës së banimit.

2.27. Komisioni vëren se subjekti arriti të provojë bindshëm se arsyeja e këmbimit të truallit me sip. 1.170 m², duke përfituar 277 m² sipërfaqe të shfrytëzueshme, është për faktin e zbritjes së sipërfaqeve të dhëna personave të tretë që kanë pasur ndërtime informale mbi këtë truall, dhe se në truallin prej 820 m² nuk rezultoi të ketë pasur ndërtime informale. Gjithashtu, objekti i dytë është ngritur me një kat më shumë⁷⁸ se ndërtimi i parë, çka bën të ndryshojë edhe sipërfaqja neto e përfituar nga subjekti ndërmjet dy objekteve.

⁷⁷ Në cilësinë e provës, subjekti ka paraqitur aktin e vlerësimit teknik të përgatitur nga ing. L. V. (gjithsej 374 fletë) dhe kontratat e lidhura me ish-pronarët e ndërtimeve informale.

⁷⁸ Referuar aktit të kolaudimit tekniko-ekonomik të objektit banesë 1-10-11-katëshe, me 1 kat dyqane dhe 1 kat parkim nën tokë, sipërfaqja totale, përfshirë sipërfaqet e përbashkëta, është 5.026 m².

2.28. Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016, lidhur me sipërfaqen neto të përfitur nga subjekti në dy objektet e ndërtuara.

3. Automjet tip “Opel Corsa” (1999), me targë *, me vlerë 1.800 euro**

3.1. Në deklaratën Vetting 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjet tip “Opel Corsa”, prodhim i vitit 1999, me targë ***, blerë më 8.3.2016 nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. ***, në vlerën 1.800 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat e shitjes së apartamenteve të përfituara nga trashëgimia. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues⁷⁹.

3.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: Në DIPP-në vitit 2016, subjekti ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në vlerën 1.800 euro, me burim krijimi të ardhurat e shitjes së apartamenteve të përfituara nga trashëgimia. Në deklaratën Vetting, subjekti ka paraqitur kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 8.3.2016, me palë shitëse G. Xh. dhe palë blerëse Herila Çela, të automjetit tip “Opel Corsa”, me targë ***, në vlerën 1.800 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale⁸⁰.

3.3. Referuar dokumentacionit të administruar nga DPSHTRR-ja⁸¹ konfirmohet pronësia në emër të subjektit e këtij automjeti, sipas kontratës së sipërcituar. Vetë shitësi i automjetit, shtetasi G. Xh., e ka zhdoganuar këtë automjet në datën 1.1.2015, referuar deklaratës doganore nr. ***, në vlerën 500 euro dhe ka paguar shpenzimet doganore në vlerën 32.271 lekë, pra ka paguar një kosto totale prej 102.136 lekësh⁸².

3.4. Nga dokumentacioni i administruar nga Raiffeisen Bank⁸³ u konstatua se në datën 8.3.2016 bashkëshorti i subjektit ka tërhequr nga llogaria e tij shumën 1.800 euro, me përshkrimin “Th. L. tërheq nga llogaria 1.800 blerje autoveture”.

3.5. Origjina e kësaj shume janë të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë së paluajtshme apartament, me nr. pasurie *, konkretisht kësti prej 39.000 euro, transferuar nga noteri publik S. H. në këtë llogari bankare, në datën 9.1.2015 (trajtuar në paragrafin 2.16.4. të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht).**

3.6. Nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, rezulton se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e këtij automjeti, pasi ai ka si burim të ardhurat nga shitja e pasurisë së paluajtshme apartament, me nr. pasurie *, përfitur me kontratën e shkëmbimit nr. ***, datë 23.2.2012.**

3.7. Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në lidhje me këtë

⁷⁹ Vërtetim nr. *** rep., datë 25.1.2017; certifikatë pronësie në emër të subjektit; leje qarkullimi; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 8.3.2016; certifikatë pronësie të mjetit me targë *** në emër të shtetasis G. Xh.; vërtetim nr. *** prot., datë 8.3.2016, nga DPSHTRR-ja.

⁸⁰ Kontratë e administruar edhe nga noteri publik S. H., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.3.2023.

⁸¹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.2.20121.

⁸² Çmimi i blerjes prej 500 euro u vlerësua me kursin e këmbimit të paraqitur në deklaratën doganore, 1 euro = 139,73 lekë.

⁸³ Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2021.

pasuri dhe se nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

4. Depozitë në Societe Generale Albania, në vlerën 944.735 lekë

Depozitë në Societe Generale Albania, në vlerën 630.507 lekë

4.1. Në deklaratën *Vetting 2017*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) depozitë në Societe Generale Albania (ish-Banka Popullore), çelur në datën 29.9.2006, me nr. ***, shuma 944.735,05 lekë, pjesa takuese 100%; (ii) depozitë në Societe Generale Albania (ish-Banka Popullore), çelur në datën 29.9.2006, me nr. ***, shuma 630.507,13 lekë, pjesa takuese 100%. Burimi i krijimit: dhuratë nga prindërit (kursime të tyre) dhe interesat bankarë në vite. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues⁸⁴.

4.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti ka deklaruar depozitë bankare në Bankën e Kursimeve Vlorë, me vlerë 0,5 milion, me burim krijimi dhuratë për martesë nga prindërit. Në DIPP/2006, subjekti ka deklaruar depozitë bankare të vitit, të kaluar në Raiffeisen Bank, transferuar në Bankën Popullore, me gjithë interesat e përfituar, përkatësisht: (i) nr. depozite ***, në shumën 600.000 lekë; (ii) nr. ***, në shumën 600.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Në DIPP/2016, subjekti ka deklaruar: (i) depozitë në Societe Generale Albania me nr. ***, pakësuar 300.000 lekë, gjendja në datën 31.12.2016 është 630.507 lekë; (ii) depozitë në Societe Generale Albania me nr. ***, shtuar me 16.760 lekë, gjendja e depozitës gjendja në datën 31.12.2016 është 944.734 lekë.

4.3. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarive të përcjella nga OTP Bank⁸⁵ rezulton se në datën 29.9.2006 në llogarinë e subjektit është kryer një depozitim me vlerë 1.200.000 lekë, me përshkrimin “Derdhje *cash* Th. L.” dhe po në të njëjtën datë janë krijuar dy depozita, secila me vlerë 600.000 lekë.

4.4. Depozita e parë, me nr. ***, është maturuar në datën 31.5.2016, në vlerën 930.541,66 lekë⁸⁶, vlerë e cila është transferuar në një llogari tjetër në emër të subjektit, në të njëjtën datë. Më tej, në datën 31.5.2016, subjekti ka kryer një tërheqje në vlerën 300.000 lekë dhe, për rrjedhojë, vlera e mbetur në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting*, pas zbritjes së komisioneve bankare, ka qenë 630.507 lekë, e njëjtë me atë të deklaruar nga subjekti.

4.5. Depozita e dytë, me nr. ***, e krijuar në datën 29.9.2006 dhe e maturuar në datën 29.9.2017, rezulton që në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting* ka pasur një vlerë prej 944.735 lekësh⁸⁷, e njëjtë me atë të deklaruar nga subjekti.

⁸⁴ (i) Lëvizjet e llogarisë së depozitës nr. ***, për periudhën 1.1.2004 – 24.1.2017, në emër të znj. Herila Çela, me gjendje në vlerën 944.735 lekë; (ii) nxjerrje llogari bankare Societe Generale Albania, datë 24.1.2017, në emër të znj. Herila Çela, me gjendje në vlerën 630.507 lekë.

⁸⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 18.2.2021, nga OPT Bank (ish-Banka Popullore, më pas Societe Generale).

⁸⁶ Vlera e investuar 600.000 lekë, interesa të përfituar 330.542 lekë (afati i maturimit rreth 10 vjet).

⁸⁷ Referuar lëvizjeve të llogarisë së depozitës nr. ***, për periudhën 1.1.2004 – 24.1.2017, në emër të znj. Herila Çela, paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting*. Vlera e investuar 600.000 lekë; interesa të përfituar 344.735 lekë (afati i maturimit 10 vjet).

4.6. Në vijim, bazuar në deklaratimet në DIPP-të vjetore, Komisioni analizoi edhe lëvizjet e llogarive pranë Raiffeisen Bank⁸⁸, ku u konstatua se në datën 2.10.2006 subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën 1.154.079 lekë⁸⁹.

4.7. Për sa i përket origjinës së shumës së tërhequr nga Raiffeisen Bank, konstatohet se ato rrjedhin nga disa balanca të mbartura nga ish-Banka e Kursimeve, konkretisht llogaria nr. ***, në emër të subjektit, është çelur në datën 30.9.2004, me një vlerë prej 535.948 lekësh dhe llogaria nr. ***, në emër të subjektit, është çelur në datën 30.9.2004, me një vlerë prej 539.346 lekësh (këto depozita janë trajtuar në pikën 11 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht).

4.8. Me anë të pyetësorit nr. 1, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë burimin e krijimit të shumës së depozituar në datën 29.9.2006 nga bashkëshorti i saj në shumën 1.200.000 lekë, si dhe të paraqesë dokumentacion ligjor lidhur me të ardhurat e prindërve, që kanë shërbyer si burim për dhurimin e deklaruar. Në përgjigje⁹⁰, subjekti shpjegoi se shuma e tërhequr nga depozitat pranë Raiffeisen Bank, pra shuma 1.154.079 lekë, në datën 2.10.2006, i është kthyer nënës së saj, e cila tre ditë më parë i kishte dhënë të gjitha kursimet e disponuara prej saj, prej 1.200.000 lekësh, për të krijuar dy depozita, për secilën vajzë, në shumën përkatëse prej 600.000 lekësh. Subjekti sqaroi se nuk pranoi t'i mbante kursimet e nënës dhe, për këtë arsye, tre ditë më vonë tërhoqi depozitat pranë Raiffeisen Bank dhe ia ktheu nënës⁹¹.

4.9. Lidhur me burimin e kursimeve të nënës, për shumën 1.200.000 lekë, subjekti shpjegoi se ato kanë pasur si burim vlerën e arkëtuar prej 1.000.000 lekësh për shitjen e tokës, sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 21.3.2007. Subjekti sqaroi se transaksioni i vlerës së blerjes ishte kryer kohë më parë dhe pas regjistrimit të tokës në datën 8.1.2007 dhe lëshimit të certifikatës së pronësisë në datën 11.1.2007, në mars të vitit 2007 kanë nënshkruar kontratën midis palëve. Në kontratë përcaktohet se: *“Likuidimin e shumës 1.000.000 lekë palët në kontratë e kanë kryer jashtë studios noteriale”*. Ky likuidim ishte kryer nga blerësit *cash* ose gjatë vitit 2005, ose në fillim të vitit 2006 dhe verbalisht palët kishin rënë dakord si për çmimin, ashtu edhe për sipërfaqen që do të blinin, në pamundësi për të nënshkruar kontratën, përfundoi subjekti.

4.10. Sa më lart, duke konsideruar se: (i) kontrata është nënshkruar në datën 21.3.2007, ndërsa depozitimi është kryer në datën 29.9.2006; (ii) deklarimi i subjektit se shuma prej 1.000.000 lekësh është arkëtuar në fund 2005/fillim 2006 është në nivel deklarativ – Komisioni nuk e mori në konsideratë vlerën prej 1.000.000 lekësh si burim për shumën prej 1.200.000 lekësh të deklaruar, të marrë nga nëna për një periudhë 3-ditore.

4.11. Lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme për krijimin e diferencës prej 200.000 lekësh, Komisioni kreu analizën financiare duke konsideruar të ardhurat e prindërve të subjektit për

⁸⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2021.

⁸⁹ Konkretisht, shumën 574.215 lekë nga llogaria nr. *** dhe shumën 579.864 lekë nga llogaria nr. ***.

⁹⁰ Përgjigje datë 12.7.2023.

⁹¹ Gjithashtu, subjekti deklaroi: *“Të gjitha kursimet e disponuara prej prindërve janë dhënë për të krijuar dy depozita, të cilat do të ishin për secilën vajzë gjatë kësaj periudhe dhe jetonim në të njëjtin apartament me ta. Pavarësisht se pranuan si fillim shumën e dhuruar prej tyre, kam tërhequr dy depozitat që disponoja në Raiffeisen Bank sh.a. dhe të ktheja shumën. Për këtë arsye, dy depozitat e tërhequra në Raiffeisen Bank sh.a. u përdorën për t'i dhënë prindërve shumën e dhuruar dy vajzave”*.

periudhën gusht 2003⁹² – shtator 2006, ku konstatohet se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi financiare për kursimin e shumës 200.000 lekë.

4.12. Ndërkohë që nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: *Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 1.000.000 lekë për krijimin e depozitave pranë OTP Bank, pasi nuk provohet që të ardhurat e përfituara nga nëna e subjektit nga shitja e tokës (burimi fillestar për depozitimin e datës 29.9.2006) të jenë arkëtuar përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes në datën 21.3.2007.*

4.13. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se si burim krijimi për depozitimin e shumës 1.200.000 lekë kanë shërbyer kursimet e prindërve, si dhe arkëtimi i shumës 1.000.000 lekë nga shitja e tokës. Subjekti shpjegoi se kontrata nuk përcakton moment kohor kur është kryer likuidimi i çmimit dhe se pala blerëse ka qenë e interesuar të paguajë sa më herët të ishte e mundur vlerën 1.000.000 lekë. Në momentin kur nëna e subjektit kishte dakordësuar me shitësit blerjen e një pjese të truallit, interesat në zonë nuk ishin shumë të mëdha dhe sapo kishte filluar të ndërtohej dhe se palët kanë qenë dakordësuar për shitjen e truallit shumë kohë më përpara se data e lidhjes së kontratës⁹³, vijoi subjekti. Nëse dakordësia për blerjen e kësaj prone do të ishte bërë në mars të vitit 2007, atëherë vlera e saj nuk do të ishte në asnjë rast dhe kurrsesi 1.000.000 lekë, pasi me anë të kontratës së sipërmarrjes të lidhur një vit më vonë, nr. ***, datë 30.5.2008, bashkëpronarët kanë përfutur pasuri nga kjo pronë, theksoi subjekti.

4.14. Për të vërtetuar faktin se shtetasja E. Ç. e ka arkëtuar shumën 1.000.000 lekë përpara lidhjes së kontratës, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës deklaratën noteriale nr. ***, datë 15.7.2023, të një prej blerësve, shtetasit L. N.⁹⁴, i cili deklaroi se kanë paguar bashkë me z. P. Ç., respektivisht 500.000 lekë për blerjen e pasurisë së llojit truall dhe se të gjithë vlerën prej 1.000.000 lekësh ia kanë dorëzuar në dorë shitëses E. Ç. jashtë zyrës noteriale, rreth 6 muaj para nënshkrimit të kontratës, pasi njiheshin më parë me njëri-tjetrin dhe kishin besim reciprok.

4.15. Më tej, subjekti shpjegoi se në përgjigje të pyetësorit nr. 1, ka deklaruar se pagesa e tokës duhet të jetë bërë në fund të vitit 2005 ose në fillim të vitit 2006 për shkak se kujtonte që blerësit, për arsye edhe të njohjes familjare me ta, takoheshin shpesh me nënën dhe diskutonin, por pagesa është bërë 6 muaj përpara lidhjes së kontratës, pasi është marrë vendimi nr. *** prot., datë 2.8.2006, për njohjen e së drejtës së pronësisë kthimin dhe/ose kompensimin e pronës. Blerësi L. N. në momentin e hartimit të deklaratës e ka informuar se momenti i kryerjes së pagesës është pak ditë pasi Komisioni Vendor i Kthimit dhe Kompensimit të Pronës ka vendosur për kthimin e kësaj prone.

⁹² Të ardhurat e prindërve u përlogaritën duke filluar nga muaji gusht 2003, pasi të ardhurat për periudhat e mëparshme janë përfshirë në analizën financiare të pikave 1 dhe 11 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

⁹³ Ndërkohë që njohja e tokës mori kohë, nga qershori i vitit 2003 (vendimi nr. ***, datë 30.6.2003, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë) deri në momentin e regjistrimit në janar të vitit 2007.

⁹⁴ Blerësi tjetër P. Ç. jeton prej vitësh në SHBA dhe subjekti nuk ka pasur kontakt me të.

4.16. Gjithashtu, nga komunikimi verbal me blerësin, subjekti është informuar se ndërmjet tyre ishte firmosur një mandatarkëtim me 3 dublikata, ku secili prej blerësve ishte pajisur me një kopje, duke paraqitur në cilësinë e provës mandatarkëtimin nr. ***, datë 17.9.2006, nëpërmjet të cilit deklaroi se vërtetohet që pagesa është kryer në shtator të vitit 2006, me përshkrimin “Arkëtim nga shitja e truallit me sip. 938 m², në vlerën 1.000.000 lekë”. Më tej, sqaroi se nga hetimi administrativ nuk rezultoi që shuma e tërhequr nga Raiffeisen Bank⁹⁵ të jetë përdorur, pasi kjo shumë i është kthyer prindërve⁹⁶, dhe se në deklaratën *Vetting* nuk ka deklaruar burimin përfundimtar, që ishte tërheqja e depozitës në Raiffeisen Bank, por ka deklaruar burimin e krijimit fillestar, që ishte dhurata e prindërve.

4.17. Në seancën dëgjimore, përfaqësuesja ligjore e subjektit deklaroi: “[...] zonja Çela me bashkëshortin e saj kanë vendosur që, meqenëse në atë moment ata (prindërit e subjektit) ishin vetëm pensionistë – pavarësisht se më pas situata e tyre ekonomike, për shkak të kontratave të shkëmbimit dhe të përfitimit të pasurive nga trashëgimia u rregullua – por në atë moment ishte një moment që ata përfitonin vetëm të ardhurat nga pensioni, dhe kanë menduar që nuk është e drejtë që t’i mbanin këto të ardhura të tyre [...]”.

4.18. Në përfundim, subjekti kërkoi që në analizën financiare të kryer nga Komisioni duhet të përfshihet shuma prej 1.000.000 lekësh, pasi rezultoi se prindërit kanë pasur të ardhura të ligjshme për të dhuruar shumën 1.200.000 lekë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

4.19. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratet në seancë dëgjimore – arsyetoi se:

4.20. Referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, rezultoi se pasuria truall me sip. 2.680 m², është regjistruar në emër të nënës së subjektit, znj. E. Ç., në datën 8.1.2007 dhe se kontrata e shitblerjes së truallit me shtetasit L. N. dhe P. Ç. është lidhur në datën 21.3.2007. Sa rezultoi, nuk dukën bindëse shpjegimet e subjektit se likuidimi i çmimit të truallit është bërë në muajin shtator, pra rreth 4 muaj para se vetë nëna e subjektit të bëhej pronare dhe kjo pasuri të regjistrohej në emrin e saj.

4.21. Lidhur me mandatarkëtimin nr. ***, datë 17.9.2006, të paraqitur nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, Komisioni vëren se ky mandat i paraqitur në këtë fazë të procesit nuk provon dhe nuk mund të shërbejë si provë, pasi:

⁹⁵ Konkretisht, shuma 574.215 lekë nga llogaria nr. *** dhe shuma 579.864 lekë nga llogaria nr. ***.

⁹⁶ Subjekti deklaroi se: “Prindërit e mi kanë qenë pensionistë dhe të ardhurat e tyre buronin nga pensionet. Kur ata arkëtuan çmimin e shitjes si gjyshër të dashur e të dhimbsur, në momentin kohor që ka arkëtuar çmimin e shitjes së një pjese të truallit, më kanë dhënë ta depozitoj në bankë në emër të mbesave të tyre shumat e deklaruara rregullisht në DPV-në vjetore. Unë ua plotësova dëshirën, por, nga ana tjetër, duke menduar se ata jetojnë me pensione, tre ditë më vonë bashkëshorti ka shkuar në Raiffeisen Bank sh.a. dhe ka mbyllur dy depozitat, me qëllimin kthimin e shumës 1.200.000 lekë”.

4.22. *Së pari*, ky mandat nuk është paraqitur në formën e kërkuar ligjore, pasi subjekti ka paraqitur vetëm fotokopje dhe jo dokumentin origjinal ose të njehsuar.

4.23. *Së dyti*, mbeti e pashpjegueshme se përse ky mandat nuk u paraqit në përgjigje të pyetësorit nr. 1, ku subjektit iu kërkuar shpjegime dhe dokumentacion justifikues lidhur me këto depozita, çka e bën jo të besueshëm në këtë fazë ekzistencën e një dokumenti të mbajtur me shkrim dore, i cili nuk është në harmoni me provat e tjera të administruara gjatë hetimit dhe mund të hartohet në çdo kohë, duke mos e krijuar në këtë mënyrë bindjen se është përpiluar në kohën e pretenduar.

4.24. *Së treti*, nuk bindin për vërtetësinë e tyre deklaratimet e subjektit se nuk mund të pranonte të mbante kursimet e nënës, pasi, siç do të trajtohet në vijim të këtij vendimi, këto kursime u pretenduan nga subjekti si burim për depozitat e krijuara në vitin 2010, ndërkohë që gjenerimi i të ardhurave nga qiradhënia/shitja e pasurive të paluajtshme – të cilat sipas deklaratimit të përfaqësues ligjore të subjektit në seancën dëgjimore rregulluan situatën financiare të prindërve të saj – filloi rreth dy vite më vonë (në vitin 2012).

4.25. Sa më sipër u arsyetua, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë që të ardhurat e përfituara prej nënës nga shitja e tokës në vlerën 1.000.000 lekë – si një nga burimet për dhënien e shumës 1.200.000 lekë subjektit, të përdorura nga ana e bashkëshortit për depozitim të kryer në datën 29.9.2006 – të jenë arkëtuar përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes datë 21.3.2007.

4.26. Në konkluzion, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1.000.000 lekë, për krijimin e depozitave pranë OTP Bank në vitin 2006, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

5. Llogari page në Tirana Bank, në vlerën 58.000 lekë

5.1. *Në deklaratën Vetting 2017*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar llogari page në Tirana Bank, në vlerën 58.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga.

5.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: Referuar informacionit të përcjellë nga Tirana Bank⁹⁷, rezulton se subjekti ka llogari në lekë çelur në vitin 2007 dhe se teprica e kësaj llogarie në datën 27.1.2017 ka qenë 58.324 lekë. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë konstatohet se kreditimet në këtë llogari vijnë nga pagat e subjektit.

5.3. Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në lidhje me këtë pasuri dhe se nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

6. Llogari rrjedhëse në Raiffeisen Bank, në vlerën 24.240 euro

6.1. *Në deklaratën Vetting 2017*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar llogari rrjedhëse në euro në Raiffeisen Bank, nr. ***, në bashkëpronësi me babain A. Ç., hapur me datë 30.12.2014 prej bashkëshortit Th. L., i autorizuar prej tyre. Vlera: 24.239,76 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: kontratë shitblerjeje apartament banimi nr. ***, datë 24.12.2014. Çmimi i shitjes 50.000

⁹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 12.2.2021.

euro, derdhur pjesërisht 39.000 euro. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁹⁸.

6.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: Në DIPP/2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitje apartamenti në Vlorë me anë të kontratës nr. ***, datë 24.12.2015⁹⁹, në shumën 50.000 euro (shuma e paderdhur). Në DIPP/2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitje apartamenti me sip. 117 m², me anë të kontratës nr. ***, datë 24.12.2014, në vlerën 50.000 euro, derdhur në llogarinë e bashkëshortit pjesërisht në BKT 11.000 euro dhe pjesërisht në Raiffeisen Bank 39.000 euro.

6.3. Raiffeisen Bank¹⁰⁰ konfirmon tepricën prej 24.329,76 euro në llogarinë e shtetasit Th. L., në datën 27.1.2017. Komisioni konstatoi se veprimet në këtë llogari fillojnë në datën 9.1.2015, pikërisht me transfertën bankare nga noteri publik S. H., në vlerën 39.000 euro, për pagesën pjesore të çmimit të kontratës për shitjen e pasurisë nr. ***, me përshkrimin “Likuiduar M. A. për blerje apartamenti nga A. dhe Herila Çela” (trajtuar paragrafin 2.16.4. të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht).

6.4. Pas kryerjes së disa tërheqjeve në shumën totale 14.650 euro, si dhe debitimeve për mbajtjen e komisioneve bankare, balanca e kësaj llogarie në datën 27.1.2017 rezulton 24.329,76 euro.

6.5. Nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, rezulton se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për këtë llogari bankare, pasi ka si burim të ardhurat nga shitja e pasurisë së paluajtshme apartament me nr. ***, përfituar me kontratën e shkëmbimit nr. ***, datë 23.2.2012.

6.6. Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në lidhje me këtë pasuri dhe se nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

7. Llogari rrjedhëse në FiBank sh.a., në vlerën 40.999 euro

7.1. Në deklaratën Vetting 2017, subjekti i rivlerësimit deklaron: “Llogari rrjedhëse në FiBank sh.a. nr. ***, në euro, në bashkëpronësi me babain A. Ç., hapur me datë 5.12.2016 prej bashkëshortit Th. L., i autorizuar prej nesh. Vlera: 40.999 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: kontratë shitblerjeje apartament banimi nr. ***, datë 7.12.2016”. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹⁰¹.

⁹⁸ Certifikatë pronësie nr. ***, datë 16.5.2011, kartela e pasurisë së paluajtshme, harta treguese; certifikatë pronësie nr. ***, datë 16.5.2011, kartela e pasurisë së paluajtshme, harta treguese; vërtetim nr. *** prot., datë 24.1.2017, e Raiffeisen Bank, në emër të shtetasit Th. L., nxjerrje llogarie në monedhën lekë dhe në monedhën euro; vërtetim nr. *** rep., datë 25.1.2017; kontratë shitblerjeje apartament banimi nr. ***, datë 24.12.2014, transferim nga llogaria në llogari, datë 24.12.2014; kontratë kapari nr. *** datë 22.7.2014; kontratë shitblerjeje garazhi nr. ***, datë 15.9.2016; certifikatë pronësie nr. ***, datë 29.2.2012, kartela e pasurisë së paluajtshme, harta treguese; transaksion nga ABI Bank, datë 21.7.2016, në vlerën 4.000 euro, derdhje në BKT, datë 27.7.2016, në vlerën 1.000 euro.

⁹⁹ Viti 2015 duket lapsus.

¹⁰⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2021.

¹⁰¹ Certifikatë datë 25.1.2017, nga FiBank, në emër të shtetasit Th. L.; vërtetim nr. *** rep., datë 25.1.2017; kontratë shitblerjeje apartamenti nr. ***, datë 7.12.2016, pagesa kryer në llogarinë e noterit në FiBank, në datën 5.12.2016; certifikatë pronësie nr. ***, datë 27.1.2015, kartela e pasurisë, harta treguese; urdhër pagesë datë 5.12.2016, e FiBank; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 7.1.2015, kartela e pasurisë, harta treguese.

7.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar depozitë në FiBank në bashkëpronësi me babain A. Ç., hapur në datën 5.12.2016 prej bashkëshortit Th. L., i autorizuar prej tyre, vlera 40.999 euro. Burimi: kontratë shitblerjeje apartament banimi nr. ***, datë 7.12.2016. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur vërtetimin datë 25.1.2017, lëshuar nga FiBank, ku konfirmohet se shtetasi Th. L. ka llogari me balancë në vlerën 40.999 euro.

7.3. FiBank¹⁰² konfirmon tepricën prej 40.999 euro në llogarinë e shtetasit Th. L., në datën 27.1.2017. Komisioni konstatoi se i vetmi transaksion në këtë llogari është transfera e kryer nga noteri publik S. H., në datën 30.12.2016, në vlerën 41.000 euro, për pagesën e çmimit të kontratës nr. ***, për shitjen e pasurisë nr. ***, me përshkrimin “S. H.-person fizik, kalim sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 7.12.2016” (trajtuar në paragrafin 2.18.3 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht).

7.4. Nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, rezulton se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për këtë llogari bankare, pasi ajo ka si burim të ardhurat nga shitja e pasurisë së paluajtshme apartament, me nr. ***, përfituar me kontratën e shkëmbimit nr. ***, datë 19.1.2015.

7.5. Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në lidhje me këtë pasuri dhe se nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

8. Llogari rrjedhëse në BKT, në vlerën 84.544 euro

8.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Llogari rrjedhëse në euro në BKT sh.a., me nr. ***, në bashkëpronësi me babain A. Ç., hapur në datën 6.1.2015 prej bashkëshortit Th. L., i autorizuar prej nesh. Vlera: 84.544 euro. Pjesa takuese: 50%”. Burimi i krijimit: (i) kontratë shitblerjeje apartament banimi nr. ***, datë 24.12.2014, çmimi i shitjes 50.000 euro, derdhur pjesërisht në BKT 11.000 euro; (ii) kontratë shitblerjeje apartament banimi dhe garazh nr. ***, datë 6.3.2015, çmimi i shitjes 35.000 euro, derdhur tërësisht; (iii) kontratë shitblerjeje apartament banimi nr. ***, datë 25.5.2016, çmimi i shitjes 40.000 euro, derdhur pjesërisht në BKT 10.000 euro; (iv) kontratë shitblerjeje garazh nr. ***, datë 11.6.2016, çmimi i shitjes 5.000 euro, derdhur tërësisht; (v) kontratë shitblerjeje apartament nr. ***, datë 27.9.2016, çmimi i shitjes 33.000 euro, derdhur tërësisht; (vi) kontratë shitblerjeje apartament nr. ***, datë 10.11.2016, çmimi i shitjes 38.000 euro, derdhur tërësisht. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹⁰³.

¹⁰² Shkresë nr. *** prot., datë 8.2.2021.

¹⁰³ Nxjerrje llogarie bankare datë 24.1.2017 në BKT, në emër të shtetasit Th. L., me gjendje në vlerën 84.544 euro; kontratë shitblerjeje apartament banimi nr. ***, datë 24.12.2014; kontratë shitblerjeje garazhi nr. ***, datë 15.9.2016; kontratë shitblerjeje apartament banimi e garazhi nr. ***, datë 6.3.2015; kontratë shitblerjeje garazhi nr. ***, datë 11.6.2016; vërtetim nr. *** rep., datë 26.1.2017; kontratë shitblerjeje me rezervë nr. ***, datë 25.5.2016; vërtetim nr. *** rep., datë 25.1.2017; kontratë shitblerjeje apartament banimi nr. ***, datë 27.9.2016; vërtetim nr. *** rep., datë 25.1.2017; kontratë shitblerjeje apartament banimi nr. ***, datë 10.11.2016.

8.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: Në DIPP/2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitje apartamenti në Vlorë me anë të kontratës nr. ***, datë 24.12.2015, në shumën 50.000 euro (shuma e paderdhur). Në DIPP/2015, subjekti ka deklaruar: (i) shitje apartamenti me sip. 73 m², me anë të kontratës nr. ***, datë 6.3.2015, në vlerën 30.000 euro, arkëtuar në llogarinë e bashkëshortit për lehtësi veprimi; (ii) shitje garazhi me sip. 18 m², me anë të kontratës nr. ***, datë 6.3.2015, në vlerën 5.000 euro, arkëtuar në llogarinë e bashkëshortit për lehtësi veprimi; (iii) shitje apartamenti me sip. 117 m², me anë të kontratës nr. ***, datë 24.12.2014, në vlerën 50.000 euro, derdhur në llogarinë e bashkëshortit pjesërisht në BKT 11.000 euro dhe pjesërisht në Raiffeisen Bank 39.000 euro.

8.3. BKT¹⁰⁴ konfirmon tepicën prej 84.544 euro në llogarinë e shtetasit Th. L., në datën 27.1.2017. Komisioni analizoi veprimet e kryera në këtë llogari, nga ku rezultoi se:

i) Në datën 9.1.2015 janë kredituar 11.000 euro, të transferuara nga noteri publik S. H. për pagesën pjesore të çmimit të kontratës nr. ***, datë 24.12.2014, për shitjen e pasurisë nr. ***, me përshkrimin “S. H. këst apartamenti për A. dhe Herila Çela kësti i M. e F. A.”.

ii) Në datën 11.5.2015 janë kredituar 35.000 euro, të transferuara nga noteri publik S. H. për pagesën pjesore të çmimit të kontratës nr. ***, datë 6.3.2015, për shitjen e pasurive nr. *** dhe nr. ***, me përshkrimin “S. H. këst apartamenti për A. dhe Herila Çela kësti i G. V.”.

iii) Në datën 10.11.2015 janë transferuar (debituar) 42.000 euro në favor të noterit publik H. Sh. për pagesën e çmimi të kontratës nr. ***, datë 10.11.2015, me përshkrimin “Th. L. për H. Sh. PF tjetërsim pasurie pagese për blerje apartamenti sipas kontratës së shitblerjes 10.11.2015, me palë shitëse A. B., A. B. dhe L. B.” (apartamenti në Tiranë blerë nga bashkëshorti i subjektit, trajtuar në pikën 16 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht).

iv) Në datën 23.9.2016 janë kredituar 5.000 euro (me dy këste), të transferuara nga noteri publik S. H. për pagesën pjesore të çmimit të kontratës nr. ***, datë 15.9.2016, për shitjen e pasurisë nr. ***, me përshkrimin “S. H. kalon për Th. L. këst nga F. A.”.

v) Në datën 23.9.2016 janë kredituar 10.000 euro (me tre këste), të transferuara nga noteri publik S. H. për pagesën pjesore të çmimit të kontratës nr. ***, datë 25.5.2016, për shitjen e pasurisë nr. ***, me përshkrimin “S. H. kalon për Th. L. këst nga D. T.”.

vi) Në datën 23.9.2016 janë kredituar 5.000 euro, të transferuara nga noteri publik S. H. për pagesën pjesore të çmimit të kontratës nr. ***, datë 11.6.2016, për shitjen e pasurisë nr. ***, me përshkrimin “S. H. kalon për Th. L. këst nga G. V.”.

vii) Në datën 23.9.2016 janë kredituar 7.000 euro, të transferuara nga noteri publik S. H. për pagesën pjesore të çmimit të kontratës nr. ***, datë 27.9.2016, për shitjen e pasurisë nr. ***, me përshkrimin “S. H. kalon për Th. L. këst nga D. M.”.

viii) Në datën 13.10.2016 janë kredituar 26.000 euro, të transferuara nga noteri publik S. H. për pagesën e mbetur të çmimit të kontratës nr. ***, datë 27.9.2016, për shitjen e pasurisë nr. ***, me përshkrimin “S. H. kalon për Th. L. këst nga R. M.”.

¹⁰⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 12.2.2021.

ix) Në datën 29.10.2016 janë kredituar 38.000 euro (me 5 këste), të transferuara nga noteri publik S. H. për pagesën e çmimit të kontratës nr. ***, datë 10.11.2016, për shitjen e pasurisë nr. ***, me përshkrimin “S. H. kalon për Th. L. (me prokurë) këst nga E. M. dhe M. P.”.

8.4. Në përmbledhje të sa më lart, rezulton se në këtë llogari bankare gjatë periudhës 2015 – 2016 janë kredituar 137.000 euro si të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme, janë paguar 42.000 euro për blerjen e apartamentit në Tiranë, si dhe janë paguar 2.500 euro për Universitetin *** të Tiranës¹⁰⁵ dhe janë tërhequr 7.950 euro¹⁰⁶ nga bashkëshorti i subjektit.

8.5. Nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, rezulton se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për këtë llogari bankare, pasi ajo ka si burim të ardhurat nga shitjet e pasurive të paluajtshme, të përfituara me kontrata shkëmbimi.

8.6. Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në lidhje me këtë pasuri dhe se nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

9. Llogari rrjedhëse në NBG Bank, në vlerën 29.700 euro

9.1. Në deklaratën *Vetting 2017*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Llogari rrjedhëse në NBG Bank në bashkëpronësi me babain A.Ç., hapur në datën 26.1.2017 prej bashkëshortit Th. L., i autorizuar prej nesh. Vlera: 29.700 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: kontratë shitblerjeje apartament banimi nr. ***, datë 25.5.2016, derdhur pjesërisht në NBG Bank në shumën 29.700 euro”. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹⁰⁷.

9.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: ABI Bank¹⁰⁸ konfirmon tepricën prej 29.694 euro në llogarinë e shtetasit Th. L., në datën 27.1.2017. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë u konstatuan dy kreditime me vlerë totale 29.700 euro nga noteri publik S. H. për pagesën pjesore të çmimit të kontratës nr. ***, datë 25.5.2016, për shitjen e pasurisë nr. ***, me përshkrimin “Kalim sipas kontratë shitjeje apartamenti nr. ***, datë 25.5.2016, shitës Herila Çela etj., blerës F. e D. T., notere S. H.”, konkretisht 10.000 euro në datën 4.8.2016 dhe 17.000 euro në datën 27.1.2017.

9.3. Nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, rezultoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për këtë llogari bankare, pasi ka si burim të ardhurat nga shitja e pasurisë së paluajtshme apartament me nr. ***, përfituar me kontratën e shkëmbimit nr. ***, datë 19.1.2015.

¹⁰⁵ Datë 13.10.2015, vlera 1.250 euro dhe datë 12.10.2015, vlera 1.250 euro.

¹⁰⁶ Datë 16.4.2015, vlera 1.000 euro; datë 6.8.2015, vlera 1.000 euro; datë 14.7.2015, vlera 750 euro; datë 18.11.2016, vlera 200 euro; datë 13.12.2016, vlera 2.000 euro dhe datë 30.12.2016, vlera 3.000 euro.

¹⁰⁷ Derdhje datë 26.1.2017 në NBG Bank nga “S. H.”, person fizik, në llogari të shtetasit Th. L. në vlerën 19.700 euro; kontratë shitblerjeje me rezervë nr. ***, datë 25.5.2016.

¹⁰⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 2.2.2021.

9.4. Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në lidhje me këtë pasuri dhe se nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

10. Të ardhurat nga qiratë

10.1. Në deklaratën *Vetting 2017*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) të ardhura nga qiraja e ambientit njësi shërbimi, sipas kontratës nr. ***, datë 6.11.2014, në vlerën 25.000 lekë bruto dhe 21.200 lekë neto; (ii) të ardhura nga qiraja e ambientit njësi shërbimi, sipas kontratës nr. ***, datë 29.11.2016, në vlerën 25.000 lekë bruto dhe 21.200 lekë neto; (iii) të ardhura nga qiraja e ambientit njësi shërbimi, sipas kontratës nr. ***, datë 22.9.2016, në vlerën 45.000 lekë bruto dhe 38.250 lekë neto. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹⁰⁹.

10.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se:

a. Lidhur me të ardhurat nga qiraja e ambientit njësi shërbimi me sip. 42,6 m²

10.3. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja e ambientit me nr. ***, datë 6.11.2014, në vlerën 25.000 lekë bruto dhe 21.200 lekë neto. Në DIPP-në e vitit 2014 ka deklaruar të ardhura neto nga qiraja e dyqanit 2 për muajin nëntor – dhjetor 2014, kontrata e lidhur në datën 6.11.2014, vlera 50.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2015 ka deklaruar të ardhura neto nga qiraja e dyqanit, vlerë *cash* 300.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar të ardhura nga qiraja e ambientit njësi shërbimi, sipas kontratës nr. ***, datë 6.11.2014, në vlerë bruto 25.000 lekë dhe neto 21.200 lekë.

10.4. Sipas dokumentacionit të dorëzuar në deklaratën *Vetting*, rezulton se palët qiradhënëse A. Ç. dhe Herila Çela kanë lidhur tre kontrata për dhënien me qira të ambientit njësi me sip. 42,6 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, sa më poshtë vijon:

10.5. *Kontratë qiraje nr. ***, datë 6.11.2014*, me palë qiramarrëse E. B., në vlerën 25.000 lekë/muaj, për një periudhë 2-vjeçare, nga data 1.11.2014 deri më 30.10.2016. Objekti do të përdoret me destinacion “****”¹¹⁰. Në kontratë nuk është parashikuar se cila palë do të paguajë tatimin në burim.

10.5.1. Komisioni vëren se pasuria e dhënë me qira është përfituar me kontratën e shkëmbimit të pasurive të paluajtshme nr. ***, datë 19.1.2015, pra rreth dy muaj pas lidhjes së kontratës së qirasë.

10.5.2. Kjo situatë është përshkruar në objektin e kontratës, ku është parashikuar se: “*Pala qiradhënëse ka në pronësi të saj një njësi shërbimi me sipërfaqe 42,6 m² në katin 0, njësia e shërbimit nr. ***, e përfituar me cilësinë e pronarëve të truallit në objektin që ka përfunduar së ndërtuari shoqëria “****” sh.p.k. një banesë 10 kate me një kat dyqan dhe një parkim nën tokë, të ndodhur në rrugën “****”, Vlorë. Ndërtimi bëhet në truallin me pronarë A. Ç. dhe Herila Çela. Investitor shoqëria “****” sh.p.k. Me vendimin nr. ***, datë 28.9.2011, të KRRT-së është miratuar*

¹⁰⁹ Vërtetim nr. *** rep., datë 25.1.2017; kontratë qiraje nr. ***, datë 23.11.2011; kontratë qiraje nr. ***, datë 3.2.2016; kontratë qiraje nr. ***, datë 22.9.2016; vërtetim nr. *** rep., datë 25.1.2017; kontratë qiraje nr. ***, datë 1.9.2016; kontratë qiraje nr. ***, datë 6.11.2014; kontratë qiraje nr. ***, datë 17.11.2015; vërtetim nr. *** rep., datë 25.1.2017; kontratë qiraje nr. ***, datë 29.11.2016.

¹¹⁰ Kontratë e administruar edhe nga noteri publik S. H., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.3.2023.

*destinacioni i sheshit të ndërtimit dhe me vendimin nr. ***, datë 28.9.2011, po të KRRT-së Vlorë, është miratuar leje ndërtimi për projekt zbatim të objektit të mësipërm (aktualisht në proces hipotekimi për t'u pajisur me certifikatë)”*.

10.5.3. Komisioni përlloritari të ardhurat bruto nga qiradhënia e kësaj njësie për këtë kontratë, nga ku rezultoi një vlerë prej 50.000 lekësh gjatë periudhës 1.11.2014 – 31.12.2014 (2 muaj x 25.000 lekë/muaj) dhe një vlerë prej 275.000 lekësh gjatë periudhës 1.1.2015 – 30.11.2015¹¹¹ (11 muaj x 25.000 lekë/muaj).

10.5.4. Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore, DRT Vlorë¹¹² informon se individi E. B., me të cilën është lidhur kontrata e qirasë nr. ***, ka operuar me adresë sekondare të subjektit “****” sh.a., me NIPT ***. Referuar ekstraktit historik të shoqërisë “****” sh.a.¹¹³, kjo shoqëri në datën 20.3.2015 ka shtuar si adresë dytësore të aktivitetit: “Vlorë, lagjja “****”, rruga “****”, pallati 9-katësh, nr. ***, dyqani nr. ****”. Kjo shoqëri tregtare ka paraqitur pranë QKB-së vendimin nr. ***, datë 19.3.2015, për hapjen dhe mbylljen e adresave sekondare të pikave të shitjes, midis të tjerave edhe një pikë në rrethin e Vlorës, me adresën e sipërcituar dhe me të punësuar shtetasen E. B..

10.5.5. Komisioni kërkoi informacion lidhur me tatimin mbi qiranë të paguar nga subjekti “****” sh.a., dhe në përgjigje DRT-ja Tiranë¹¹⁴ bëri me dije se ky subjekt ka paguar tatim mbi qiranë për periudhën dhjetor 2014 – tetor 2016, por nuk mund të përcaktohet se për cilën kontratë qiraje janë kryer këto pagesa.

10.5.6. Sa më lart, në kushtet që: (i) qiramarrësja E. B. rezulton e punësuar nga shoqëria “****” sh.a.; (ii) në objektin në pronësi të subjektit ushtron aktivitetin tregtar pikërisht kjo shoqëri tregtare, e cila rezulton ta ketë deklaruar këtë adresë si adresë sekondare; (iii) në të dhënat e përcjella nga DRT-ja shuma e detyrimit për objektin në fjalë është më e lartë se shuma totale e detyrimi të paguar nga shoqëria “****” sh.a.; (iv) në ligjin nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar¹¹⁵, është parashikuar detyrimi i mbajtjes në burim nga qiramarrësi (kur është person fizik/juridik) të tatimit për të ardhurat që realizohen nga marrëdhënia e qirasë – Komisioni konstaton se pagimi i tatimit për të ardhurat nga qiraja për periudhën 1.11.2014 – 30.11.2015 ka qenë detyrim ligjor i qiramarrësit.

10.5.7. Për më tepër, referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit¹¹⁶, mospagimi i detyrimeve tatimore, të cilat sipas ligjit i takojnë një personi të tretë, nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuptim të këtij procesi.

¹¹¹ Përlloraritjet u kryen deri në nëntor të vitit 2015, pasi për periudhën në vijim është lidhur kontratë me një qiramarrës tjetër.

¹¹² (i) Shkresë nr. *** prot., datë 17.5.2023; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 25.1.2021 (paraqitur në pyetësin standard).

¹¹³ Verifikuar në faqen zyrtare online të QKB-së.

¹¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 11.8.2023.

¹¹⁵ Referuar në ligjin nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, në ndryshimet e këtij ligji me ligjin nr. 8841/2001, në nenin 33/1 dhe 34/4 u shtuan përcaktimet: “Një person i cili i paguan një individ rezident të ardhura nga kontratat e qirasë mban tatimin për këto të ardhura në masën 10%. Ky do të jetë tatimi përfundimtar i pagueshëm për këto të ardhura nga qiradhënia dhe kushtet e parashikuara në nenin 8, dhe ato në paragrafin e dytë të nenit 9 të këtij ligji, nuk zbatohen”.

¹¹⁶ Vendim nr. 23-2022 (JR), datë 28.6.2022, subjekti A. Sh.

10.5.8. Në përfundim lidhur me këtë kontratë, Komisioni paraqiti në analizën financiare të vitit 2014 të ardhura neto në vlerën 45.000 lekë¹¹⁷ dhe në analizën financiare të vitit 2015 të ardhura neto në vlerën 233.750 lekë¹¹⁸.

10.6. Kontratë qiraje nr. ***, datë 17.11.2015, me palë qiramarrëse K. B., person fizik, me NIPT ***, në vlerën 25.000 lekë/muaj, me afat 2-vjeçar, nga data 1.12.2015 deri më 1.12.2017. Objekti do të përdoret me destinacion “Bar-Kafe”¹¹⁹. Tatimi në burim do të mbahet nga qiramarrësi dhe do të zbritet nga vlera e qirasë së qiradhënësit dhe do të depozitohet në bankë në llogarinë e Drejtorisë së Tatimeve.

10.6.1. Komisioni përllogariti të ardhurat bruto nga qiradhënia e kësaj njësie për këtë kontratë, nga ku rezultoi një vlerë prej 25.000 lekësh gjatë periudhës 1.12.2015 – 31.12.2015 dhe një vlerë prej 200.000 lekësh (8 muaj x 25.000 lekë/muaj), gjatë periudhës 1.1.2016 – 31.8.2016, në total 225.000 lekë.

10.6.2. Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore, DRT Vlorë¹²⁰ informon se K. B., person fizik, ka paguar një shumë totale prej 33.750 lekësh për periudhën 1.11.2015 – 31.8.2016, e cila përkon me detyrimin e përllogaritur për të ardhurat bruto bazuar në legjislacionin në fuqi¹²¹.

10.6.3. Në përfundim lidhur me këtë kontratë, Komisioni paraqiti në analizën financiare të vitit 2015 të ardhura neto në vlerën 21.250 lekë¹²² dhe në analizën financiare të vitit 2016 të ardhura neto në vlerën 170.000 lekë¹²³.

10.7. Kontratë qiraje nr. ***, datë 1.9.2016, me palë qiramarrëse D. Xh., person fizik, me NIPT ***, në vlerën 25.000 lekë/muaj, për një periudhën 2-vjeçare, nga data 1.9.2016 deri më 1.9.2018. Objekti do të përdoret me destinacion “Bar - Kafe”¹²⁴. Tatimi në burim do të mbahet nga qiramarrësi dhe do të zbritet nga vlera e qirasë së qiradhënësit dhe do të depozitohet në bankë në llogarinë e Drejtorisë së Tatimeve.

10.7.1. Sa më lart, të ardhurat bruto nga qiradhënia e kësaj njësie për këtë kontratë përllogariten në masën 100.000 lekë gjatë periudhës 1.9.2016 – 31.12.2016 (4 muaj x 25.000 lekë/muaj).

10.7.2. Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore, DRT Vlorë¹²⁵ informon se D. Xh., person fizik, ka paguar një shumë totale prej 33.750 lekësh për periudhën 1.9.2016 – 31.12.2016, e cila përkon me detyrimin e përllogaritur për të ardhurat bruto bazuar në legjislacionin në fuqi¹²⁶.

¹¹⁷ Përllogaritur si diferencë midis të ardhurave bruto (50.000 lekë) me shumën e detyrimit të tatimit (5.000 lekë). Për vitin 2014, norma e tatimit në burim ka qenë 10%.

¹¹⁸ Përllogaritur si diferencë midis të ardhurave bruto (275.000 lekë) me shumën e detyrimit të tatimit (41.250 lekë). Për vitin 2015, norma e tatimit në burim ka qenë 15%.

¹¹⁹ Kontratë e administruar edhe nga noteri publik S. H., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.3.2023.

¹²⁰ (i) Shkresë nr. *** prot., datë 17.5.2023; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 25.1.2021 (paraqitur në pyetësorin standard).

¹²¹ 15% x 225.000 lekë = 33.750 lekë.

¹²² Përllogaritur si diferencë midis të ardhurave bruto (25.000 lekë) me shumën e detyrimit të tatimit (3.750 lekë). Për vitin 2015, norma e tatimit në burim ka qenë 15%.

¹²³ Përllogaritur si diferencë midis të ardhurave bruto (200.000 lekë) me shumën e detyrimit të tatimit (30.000 lekë). Për vitin 2016, norma e tatimit në burim ka qenë 15%.

¹²⁴ Kontratë e administruar edhe nga noteri publik S. H., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.3.2023.

¹²⁵ (i) Shkresë nr. *** prot., datë 17.5.2023; (ii) shkresë nr. *** prot., date 25.1.2021.

¹²⁶ 15% x 100.000 lekë = 15.000 lekë.

10.7.3. Në përfundim lidhur me këtë kontratë, Komisioni paraqiti në analizën financiare të vitit 2016 të ardhura neto në vlerën 85.000 lekë¹²⁷.

b. Lidhur me të ardhurat nga qiraja e ambientit njësi shërbimi me sip. 50,6 m²

10.8. Në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja e ambientit njësi shërbimi, sipas kontratës nr. ***, datë 29.11.2016, në vlerën 25.000 lekë bruto dhe 21.200 lekë neto.

10.9. Nga hetimi¹²⁸ rezulton se palët qiradhënëse A. Ç. dhe Herila Çela kanë lidhur kontratën e qirasë nr. ***, datë 29.11.2016, për dhënien me qira të ambientit njësi me sip. 50,6 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me palë qiramarrëse shoqëria “****” sh.p.k., me NIPT ***, me afat 1+4-vjeçar, nga data 1.11.2016 deri më 1.11.2021. Qiraja në vitin e parë do të jetë 25.000 lekë/muaj dhe për 4 vitet në vazhdim 30.000 lekë/muaj. Njësia do të përdoret me destinacion “Tregti aksesor celularësh”. Tatimi në burim do të mbahet nga qiramarrësi dhe do të zbritet nga vlera e qirasë së qiradhënësit dhe do të depozitohet në bankë në llogarinë e Drejtorisë së Tatimeve.

10.10. Në përmbledhje të sa më lart, të ardhurat bruto nga qiradhënia e kësaj njësie gjatë periudhës 1.11.2016 – 31.12.2016 përllogariten në masën 50.000 lekë (2 muaj x 25.000 lekë/muaj).

10.11. Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore, për periudhën 1.11.2016 – 31.12.2016 ky detyrim, bazuar në legjislacionin në fuqi, përllogaritet në vlerën 7.500 lekë (2 muaj x 25.000 lekë/muaj x 15%).

10.12. Detyrimi i mësipërm rezulton i paguar nga shoqëria “****” sh.p.k., e konfirmuar nga: (i) DRT Tiranë, me anë të postës elektronike datë 17.9.2019, informon se shoqëria “****” sh.p.k. ka paguar tatim mbi qiranë për kontratën e qirasë nr. ***, datë 29.11.2016, konkretisht në vlerën 3.750 lekë për secilin nga muajt nëntor 2016, dhjetor 2016; (ii) Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë¹²⁹ informon se shoqëria “****” sh.p.k. ka paguar për kontratën nr. ***, datë 29.1.2016, tatim në burim në shumën 45.000 lekë për periudhën nëntor 2016 – tetor 2017.

10.13. Nga dokumentacioni i administruar nga BKT-ja dhe Raiffeisen Bank konstatohet që shoqëria “****” sh.p.k. e ka kryer pagesën për qiranë në datat 2.11.2016 dhe 5.12.2016.

10.14. Në përfundim, Komisioni paraqiti në analizën financiare të vitit 2016 të ardhura në vlerën 42.500 lekë¹³⁰ nga qiraja e njësisë me sip. 50,6 m².

c. Lidhur me të ardhura nga qiraja e ambientit njësi shërbimi me sip. 78 m²

10.15. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja e njësisë së shërbimit, sipas kontratës nr. ***, datë 22.9.2016, në vlerën 45.000 lekë bruto dhe 38.250 lekë neto. Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja e dyqanit, me kontratën nr. ***, në vlerën 540.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti dhe babai i saj kanë deklaruar të ardhura

¹²⁷ Përllogaritur si diferencë midis të ardhurave bruto (100.000 lekë) me shumën e detyrimit të tatimit (15.000 lekë). Për vitin 2016, norma e tatimit në burim ka qenë 15%.

¹²⁸ Paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* dhe e administruar edhe nga noteri publik S. H., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.3.2023.

¹²⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, paraqitur në pyetësorin standard.

¹³⁰ Përllogaritur si diferencë midis të ardhurave bruto (100.000 lekë) me shumën e detyrimit të tatimit (15.000 lekë). Për vitin 2016, norma e tatimit në burim ka qenë 15%.

nga qiraja e lokalit (sipas deklaramit të vjetshëm, i njëjti objekt) *cash*, në bashkëpronësi me babain, në vlerën 540.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2014 ka deklaruar të ardhura neto nga qiraja e dyqanit 1, në vlerën 540.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar të ardhura neto nga qiraja e dyqanit, në vlerën 540.000 lekë *cash*. Në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar të ardhura nga qiraja e ambientit njësi shërbimi, sipas kontratës nr. ***, datë 22.9.2016, në vlerën 45.000 lekë bruto dhe 38.250 neto.

10.16. Nga hetimi¹³¹ rezulton se palët qiradhënëse A. Ç.dhe Herila Çela kanë lidhur tri kontrata për dhënie me qira të ambientit njësi me sip. 78 m², me nr. pasurie ***, sa më poshtë vijon:

10.17. *Kontrata nr. ***, datë 23.11.2011*, me palë qiramarrëse H. Z., në vlerën mujore 45.000 lekë, me afat nga data 1.1.2012 deri më 31.12.2016. Objekti do të përdoret me destinacion “Bar, loto, sportive”. Në kontratë parashikohet se periudha nga data e nënshkrimit deri në datën 31.12.2011 do të shërbejë si periudhë prove për klientin dhe nuk do të jepet me pagesë. Qiramarrësi duhet t’i dorëzojë qiradhënësit faturat origjinale ose fotokopje të pagesës së tatimit mbi burim, të cilat do të paguhen në emër të qiradhënësit prej qiramarrësit.

10.17.1. Komisioni vëren se pasuria e dhënë me qira është përfituar me kontratë shkëmbimi, pasuri e paluajtshme nr. ***, datë 23.2.2012, pra rreth tre muaj pas lidhjes së kontratës së qirasë.

10.17.2. Kjo situatë është përshkruar në nenin 1 të kontratës, ku është parashikuar se: “*Pronësinë për pasurinë e mësipërme qiradhënësi e ka përfituar me cilësinë e pronarit të truallit. Aktualisht pritet nënshkrimi i kontratës së shkëmbimit me shoqërinë ****”.

10.17.3. Komisioni përllorarit të ardhurat bruto nga qiradhënia e kësaj njësie për këtë kontratë, nga ku rezultoi një vlerë prej 540.000 lekësh për vitet 2012, 2013 e 2014 dhe në masën 450.000 lekë për periudhën 1.1.2015 – 30.10.2015¹³² (10 muaj x 45.000 lekë/muaj).

10.17.4. Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore, DRT Vlorë¹³³ informon se individi H. Z., me të cilën është lidhur kontrata e qirasë nr. ***, ka operuar me adresë sekondare të subjektit “****” sh.a., me NIPT ***.

10.17.5. Referuar ekstraktit historik të shoqërisë “****” sh.a.¹³⁴, kjo shoqëri në datën 12.1.2012 ka shtuar si adresë dytësore të aktivitetit “*Vlorë, lagjja “****”, rruga “****”, pallati ***, përbri Rrugës *****”. Kjo shoqëri tregtare ka paraqitur pranë QKB-së vendimin nr. ***, datë 6.1.2012, për hapjen e pikave të shitjes së biletave nga shoqëria “****” sh.a., midis të tjerave edhe një pikë në rrethin e Vlorës, me adresën e sipërcituar dhe me agjent të punësuar shtetasen H. Z.

10.17.6. Komisioni kërkoi informacion lidhur me tatimin mbi qiranë të paguar nga subjekti “****” sh.a., dhe në përgjigje DRT Tiranë¹³⁵ bëri me dije se ky subjekt ka paguar tatim mbi qiranë për periudhën janar 2012 – dhjetor 2016, por nuk mund të përcaktohet se për cilën kontratë qiraje janë kryer këto pagesa.

¹³¹ Kontrata të paraqitura në deklaratën *Vetting* dhe të administruara edhe nga noteri publik S. H., protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.3.2023.

¹³² Përlloraritjet u kryen deri në tetor të vitit 2015, pasi për periudhën në vijim është lidhur kontratë me një qiramarrës tjetër.

¹³³ (i) Shkresë nr. *** prot., datë 17.5.2023; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 25.1.2021 (paraqitur në pyetësorin standard).

¹³⁴ Verifikuar në faqen zyrtare *online* të QKB-së.

¹³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 11.8.2023.

10.17.7. Në kushtet që: (i) qiramarrësja H. Z. rezulton e punësuar nga shoqëria “****” sh.a.; (ii) në objektin në pronësi të subjektit ushtron aktivitetin tregtar pikërisht kjo shoqëri tregtare, e cila rezulton ta ketë deklaruar këtë adresë si adresë sekondare; (iii) në të dhënat e përcjella nga DRT-ja shuma e detyrimit për objektin në fjalë është më e lartë se shuma totale e detyrimi të paguar nga shoqëria “****” sh.a., (iv) në ligjin nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar¹³⁶, është parashikuar detyrimi i mbajtjes në burim nga qiramarrësi (kur është person fizik/juridik) të tatimit për të ardhurat që realizohen nga marrëdhënia e qirasë; (v) në kontratë parashikohet se qiramarrësi duhet t’i dorëzojë qiradhënësit faturat origjinale ose fotokopje të pagesës së tatimit mbi burim, të cilat do të paguhet në emër të qiradhënësit prej qiramarrësit – Komisioni konstaton se pagimi i tatimit për të ardhurat nga qiraja për periudhën 1.1.2012 – 30.10.2015 ka qenë detyrim ligjor dhe kontraktual i qiramarrësit.

10.17.8. Për më tepër, referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit¹³⁷, mospagimi i detyrimeve tatimore, të cilat sipas ligjit dhe rrethanave faktike të përcaktuara në kontratën noteriale i takojnë një personi të tretë, nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuptim të këtij procesi.

10.17.9. Në përfundim lidhur me këtë kontratë, Komisioni paraqiti në analizën financiare të viteve 2012, 2013 dhe 2014 të ardhura neto në vlerën 486.000 lekë¹³⁸ dhe në analizën financiare të vitit 2015 të ardhura neto në vlerën 382.500 lekë¹³⁹.

10.18. *Kontratë qiraje nr. ***, datë 3.2.2016*, me palë qiramarrëse M. S., person fizik, me NIPT ***, në vlerën 45.000 lekë/muaj, me afat 5-vjeçar, nga data 1.11.2015 deri më 1.11.2020. Objekti do të përdoret me destinacion “Bar”. Tatimi në burim do të paguhet nga qiramarrësi dhe do të zbritet nga vlera e qirasë së qiradhënësit e do të depozitohet në bankë në llogarinë e Drejtorisë së Tatimeve.

10.18.1. Sa më lart, të ardhurat bruto nga qiradhënia e kësaj njësie për këtë kontratë përlllogariten në masën 90.000 lekë për periudhën 1.11.2015 – 31.12.2015 (2 muaj x 45.000 lekë/muaj) dhe në masën 360.000 lekë për periudhën 1.1.2016 – 31.8.2016¹⁴⁰ (8 muaj x 45.000 lekë/muaj).

10.18.2. *Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore*, DRT Vlorë¹⁴¹ informon se M. S., person fizik, ka paguar tatimin në burim vetëm për periudhën prill – qershor 2016, në një vlerë totale prej 9.450 lekësh.

10.18.3. Në kushtet që: (i) në kontratë është parashikuar që tatimi në burim do të paguhet nga qiramarrësi dhe do të zbritet nga vlera e qirasë së qiradhënësit, si dhe do të depozitohet në bankë në llogarinë e Drejtorisë së Tatimeve; (ii) në ligjin nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i

¹³⁶ Referuar në ligjin nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, në ndryshimet e këtij ligji me ligjin nr. 8841/2001, në nenet 33/1 dhe 34/4 u shtuan përcaktimet: “Një person i cili i paguan një individ rezident të ardhura nga kontratat e qirasë mban tatimin për këto të ardhura në masën 10%. Ky do të jetë tatimi përfundimtar i pagueshëm për këto të ardhura nga qiradhënia dhe kushtet e parashikuara në nenin 8, dhe ato në paragrafin e dytë të nenit 9 të këtij ligji, nuk zbatohen”.

¹³⁷ Vendim nr. 23-2022 (JR), datë 28.6.2022, subjekti A. Sh.

¹³⁸ Përlllogaritur si diferencë midis të ardhurave bruto (540.000 lekë) me shumën e detyrimit të tatimit (54.000 lekë). Për vitet 2012, 2013 dhe 2014, norma e tatimit në burim ka qenë 10%.

¹³⁹ Përlllogaritur si diferencë midis të ardhurave bruto (450.000 lekë) me shumën e detyrimit të tatimit (67.500 lekë). Për vitin 2015, norma e tatimit në burim ka qenë 15%.

¹⁴⁰ Përlllogaritjet u kryen deri në gusht të vitit 2016, pasi për periudhën në vijim është lidhur kontratë me një qiramarrës tjetër.

¹⁴¹ (i) Shkresë nr. *** prot., datë 17.5.2023; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 25.1.2021 (paraqitur në pyetësorin standard).

ndryshuar¹⁴², është parashikuar detyrimi i mbajtjes në burim nga qiramarrësi (kur është person fizik/juridik) të tatimit për të ardhurat që realizohen nga marrëdhënia e qirasë – Komisioni konstaton se pagimi i tatimit për të ardhurat nga qiraja për periudhën 1.11.2015 – 31.8.2016 ka qenë detyrim ligjor dhe kontraktual i qiramarrësit.

10.18.4. Referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit¹⁴³, mospagimi i detyrimeve tatimore, të cilat sipas ligjit dhe rrethanave faktike të përcaktuara në kontratën noteriale i takojnë një personi të tretë, nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuptim të këtij procesi.

10.18.5. Në përfundim lidhur me këtë kontratë, Komisioni paraqiti në analizën financiare të vitit 2015 të ardhura neto në vlerën 76.500 lekë¹⁴⁴ dhe në analizën financiare të vitit 2016 të ardhura neto në vlerën 306.000 lekë¹⁴⁵.

10.19. *Kontratë qiraje nr. ***, datë 22.9.2016*, me palë qiramarrëse V. S. dhe S. Sh., në vlerën 45.000 lekë/muaj, me afat 5-vjeçar, nga data 1.9.2016 deri më 1.9.2021. Objekti do të përdoret me destinacion “Bar”. Tatimi në burim do të paguhet nga qiramarrësi dhe do të zbritet nga vlera e qirasë së qiradhënësit dhe do të depozitohet në bankë në llogarinë e Drejtorisë së Tatimeve. Kjo kontratë është revokuar në datën 12.10.2016, me kontratë revokimi nr. ***, datë 12.10.2016 dhe po në të njëjtën datë është lidhur midis palëve kontratë qiraje nr. ***, datë 12.10.2016, në vlerën 45.000 lekë/muaj, me afat 5-vjeçar, nga data 1.9.2016 deri më 1.9.2021. Objekti do të përdoret me destinacion “Bar”. Tatimi në burim do të mbahet nga qiramarrësi dhe do të zbritet nga vlera qirasë së qiradhënësit dhe do të depozitohet në bankë në llogarinë e Drejtorisë së Tatimeve¹⁴⁶.

10.19.1. Sa më lart, të ardhurat bruto nga qiradhënia e kësaj njësie për këtë kontratë përllogariten në masën 180.000 lekë për periudhën 1.9.2016 – 31.12.2016 (4 muaj x 45.000 lekë/muaj).

10.19.2. *Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore*, DRT Vlorë¹⁴⁷ informon se individët V. S. dhe S. Sh. nuk rezultojnë të kenë deklaruar apo paguar tatim në burim për qiranë.

10.19.3. Në kushtet që kuadri nënligjor i ligjit për tatimin mbi të ardhurat ka përcaktuar se në rastin kur qiraja paguhet nga një person i cili nuk mund të bëjë mbajtjen e pagimit të tatimit në burim, detyrimi për pagimin e tatimit i ngarkohet qiradhënësit¹⁴⁸, Komisioni konstaton që detyrimi ligjor për pagesën e tatimit në burim ka qenë i qiradhënësit, pra i subjektit.

¹⁴² Referuar në ligjin nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, në ndryshimet e këtij ligji me ligjin nr. 8841/2001, në nenet 33/1 dhe 34/4 u shtuan përcaktimet: “Një person i cili i paguan një individ rezident të ardhura nga kontratat e qirasë mban tatimin për këto të ardhura në masën 10%. Ky do të jetë tatimi përfundimtar i pagueshëm për këto të ardhura nga qiradhënia dhe kushtet e parashikuara në nenin 8, dhe ato në paragrafin e dytë të nenit 9 të këtij ligji, nuk zbatohen”.

¹⁴³ Vendim nr. 23-2022 (JR), datë 28.6.2022, subjekti A. Sh.

¹⁴⁴ Përllogaritur si diferencë midis të ardhurave bruto (90.000 lekë) me shumën e detyrimit të tatimit (13.500 lekë). Për vitin 2015, norma e tatimit në burim ka qenë 15%.

¹⁴⁵ Përllogaritur si diferencë midis të ardhurave bruto (360.000 lekë) me shumën e detyrimit të tatimit (54.000 lekë). Për vitin 2016, norma e tatimit në burim ka qenë 15%.

¹⁴⁶ Paraqitur nga subjekti në pyetësorin standard, email datë 30.1.2021, ora 17:55.

¹⁴⁷ (i) Shkresë nr. *** prot., datë 17.5.2023; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 25.1.2021 (paraqitur në pyetësorin standard).

¹⁴⁸ Referuar udhëzimit të ministrit të Financave nr. ***, datë 30.1.2006, sipas pikës 2.6.4, për të ardhura të paguara nga persona, të cilët nuk mund të bëjnë mbajtjen e tatimit në burim për llogari të organeve tatimore shqiptare, individit përfitues i të ardhurave është i detyruar të deklarojë dhe të paguajë në organin tatimor përkatës tatimin në masën 15% të të ardhurave të realizuara, jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa.

10.19.4. Në përfundim lidhur me këtë kontratë, Komisioni nuk paraqiti në analizën financiare të ardhura nga qiraja, për sa kohë nuk u provua pagesa e detyrimeve tatimore (në këtë rast detyrim i qiradhënësit).

10.20. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: *Mungon dokumentacioni ligjor justifikues mbi tatimin e paguar për të ardhurat e realizuara nga qiraja për periudhën nëntor – dhjetor 2016.*

10.21. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se në lidhje me kontratën e qirasë nr. ***, datë 22.9.2016, me palë qiramarrëse V. S. dhe S. Sh., në vlerën 45.000 lekë/muaj, duke u nisur nga fakti se këta shtetas do të kryenin aktivitet privat, me objekt “Bar”, detyrimi do të ishte mbi tatimpaguesin që do të ushtronte aktivitet në ambientin e marrë me qira. Në kontratën e qirasë nr. ***, datë 12.10.2016, nuk ka pasur kufizim ndaj palës qiramarrëse që ta japë me nënqira objektin. Qiramarrësit do të lidhnin kontratë qiraje me subjektin tatimpagues të regjistruar në organet tatimore dhe subjekti i regjistruar do të paguante tatimin në burim. Subjekti shpjegoi se ka përfituar shumë neto të qirasë, pra 38.250 lekë/muaj (45.000 – 6.750 lekë) dhe në këtë kuptim është zhveshur nga tatimi duke e paguar atë, pavarësisht që ky detyrim nuk është derdhur, pasi ka qenë detyrim i palës qiramarrëse. Subjekti deklaroi se kontrata e qirasë e ka rregulluar këtë situatë dhe ka parashikuar që deklarimi do të bëhej nga tatimpaguesi i regjistruar në organet tatimore dhe qiramarrësi do të vendoste në dispozicion mandatpagesën e tatimit të paguar.

Me marrjen dijani të shkresës nr. ***prot., datë 5.7.2021, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, ka paraqitur padi civile pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjykata, me vendimin nr. ***, datë 28.4.2023, ka vendosur: “Pranimin e padisë të paditësit A. Ç.; Detyrimin e të paditurve V. S. e S. Sh. të përmbushin detyrimet kontraktore të rrjedhura nga kontrata e qirasë nr. ***, datë 12.10.2016, duke paguar tatimin në burim në vlerën 319.500 lekë dhe kamatat ligjore të lindura nga mospagesa në kohë e tyre”.

10.22. Në përfundim, subjekti deklaroi se bazuar në kontratën e qirasë datë 12.10.2016, ligjin nr. 8438/1998, si dhe vendimin e gjykatës nr. ***, të ardhurat nga qiraja për periudhën shtator – dhjetor 2016 janë të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pasi detyrimi për pagesë ka qenë i qiramarrësit, një qëndrim ky tashmë i konsoliduar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, duke filluar nga vendimi nr. 14/2021.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

10.23. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

10.24. Pasi u analizua vendimi nr. ***, datë 28.4.2023, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, u konstatua se paditësi A. Ç. ka ngritur padi ndaj shtetasve V. S. dhe S. Sh., me objekt “Përmbushje e detyrimit kontraktor që rrjedh nga kontrata e qirasë nr. ***, datë 12.10.2016, pagesa e tatimit në burim. Detyrimi i të paditurve të paguajnë kamatëvonesat mbi shumën e tatimit në burim prej ditës që ka lindur detyrimi, si kamatat ligjore të lindura nga mospagesa në kohë e tyre”. Kjo padi është vënë në lëvizje pasi DRT-ja Vlorë, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 5.7.2021, ka njoftuar paditësin se gjatë periudhës së kohëzgjatjes së qirasë pala e paditur nuk ka kryer pagesat në burim. Për periudhën 1.9.2016 – 31.12.2018, gjatë së cilës vlera e qirasë ka qenë 45.000 lekë/muaj, vlera e tatimit në burim ka qenë 6.750 lekë për çdo muaj, gjithsej 175.000 lekë. Sa rezulton, Gjykata ka vendosur: “Pranimin e padisë së paditësit A. Ç. dhe detyrimin e të paditurve V. S. e S. Sh. të përmbushin detyrimet kontraktore të rrjedhura nga kontrata e qirasë nr. ***, datë 12.10.2016, duke paguar tatimin në burim në vlerën 319.500 lekë dhe kamatat ligjore të lindura nga mospagesa në kohë e tyre”.

10.25. Subjekti, me anë të vendimit gjyqësor të paraqitur në prapësime në cilësinë e provës, arriti të provojë në radhë të parë se detyrimi ligjor për pagesën e tatimit në burim nuk ka qenë i qiradhënësit, pra i subjektit, por i qiramarrësit, pasi ky i fundit rezulton person fizik. Nga ana e gjykatës detyrimi i qiramarrësit është përlllogaritur mbi shumën bruto të qirasë së përfituar nga qiradhënësi. Për pasojë, subjekti rezulton të ketë përfituar të ardhura mujore ekuivalente me vlerën neto të çmimit të qirasë, bazuar në nenin 33, shkronja “dh” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “...dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim nga shuma bruto e pagesave për qiratë”.

10.26. Komisioni vlerëson se pagimi i tatimit për të ardhurat nga qiraja për periudhën 1.9.2016 – 31.12.2016 ka qenë detyrim ligjor dhe kontraktual i qiramarrësit, bazuar në ligjin nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar¹⁴⁹, ku parashikohet detyrimi i mbajtjes në burim nga qiramarrësi (kur është person fizik/juridik) të tatimit për të ardhurat që realizohen nga marrëdhënia e qirasë. Të mosprovuarit e pagesës së tatimit të mbajtur nga subjektet tregtare në llogarinë e buxhetit të shtetit nuk sjell asnjë efekt në vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga subjekti i rivlerësimit me burim qiranë, për sa kohë e ardhura prej kësaj të fundit, e përfituar nga qiramarrësi, është zvogëluar me vlerën e detyrimit tatimor që përcakton ligji dhe për sa kohë pagimi i kësaj shume nuk është detyrim i tij¹⁵⁰.

10.27. Sa rezulton, lidhur me këtë kontratë qiraje, Komisioni vendosi të paraqesë në analizën financiare të ardhurat neto për periudhën shtator – dhjetor 2016, në shumën 153.000 lekë.

11. Të tjera – Depozitat në ish-Bankën e Kursimeve

¹⁴⁹ Referuar në ligjin nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, në ndryshimet e këtij ligji me ligjin nr. 8841/2001, në nenet 33/1 dhe 34/4 u shtuan përcaktimet: “Një person i cili i paguan një individ rezident të ardhura nga kontratat e qirasë mban tatimin për këto të ardhura në masën 10%. Ky do të jetë tatimi përfundimtar i pagueshëm për këto të ardhura nga qiradhënia dhe kushtet e parashikuara në nenin 8, dhe ato në paragrafin e dytë të nenit 9 të këtij ligji, nuk zbatohen”.

¹⁵⁰ Qëndrim ky tashmë i konsoliduar edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, vendimi nr. 14/2021 (JR), datë 15.6.2021.

11.1. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarive bankare në emër të subjektit pranë Raiffeisen Bank¹⁵¹ u konstatua se llogaria nr. *** është çelur në datën 30.9.2004, me një vlerë 535.948 lekë dhe llogaria nr. *** është çelur në datën 30.9.2004, me një vlerë 539.346 lekë.

11.2. Komisioni kërkoi informacion pranë Raiffeisen Bank lidhur me dinamikën e krijimit të këtyre depozitave, e cila në përgjigje¹⁵² informoi se shtetasja Herila Çela ka pasur një depozitë kursimi me nr. ***, çelur në datën 9.4.1999 dhe se gjendja e depozitës në datën 31.12.1999 ka qenë 20.000 lekë, ndërsa në datën 31.12.2001 ka qenë 21.858 lekë.

11.3. Me anë të pyetësorit nr. 1, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë dinamikën e krijimit të depozitave pranë ish-Bankës së Kursimeve dhe burimin e krijimit, shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues, e cila në përgjigje¹⁵³ shpjegoi se:

- Llogaria nr. ***, e çelur me tepricë 535.948,60 lekë, derivon nga depozita e krijuar në datën 9.7.2003, në shumën 500.000 lekë, e cila është maturuar dhe është shtuar me interesa bankarë. Kjo është depozita e deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, ku është specifikuar edhe burimi i krijimit “dhuratë për martesë nga prindërit”. Subjekti vijoi duke shpjeguar se, përveç dhuratës nga prindërit me rastin e martesës, që u krijua nga shumat monetare si kontribut nga të afërmit, pasi është fëmijë i vetëm, ka si burim edhe kursimet e saj të mbetura nga paga, të krijuara gjatë viteve të punës, nga viti 1996 e deri në momentin e krijimit të depozitës.

- Llogaria nr. ***, e çelur me tepricë 539.346 lekë, ka si burim krijimi kursimet ndër vite. Subjekti paraqiti një shkresë nga Raiffeisen Bank¹⁵⁴, bashkëlidhur së cilës ndodhen fletë të regjistrit të inventarit të depozitave me afat deri më 31.12.2001. Nga leximi i regjistrit, vijoi subjekti, rezulton se shuma e depozitës me afat e shprehur në vlerë është 21.858 lekë. Në fakt, vlera duhet të ketë qenë 218.580 lekë, por për efekt të shprehuri (në 0/dhjetë) të depozitave vlera e paraqitur ka qenë 21.858 lekë. Kjo depozitë është shtuar gjatë viteve 2002 dhe 2003, duke pasur një gjendje në shumën 539.346 lekë.

11.4. Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare për verifikimin e burimeve të ligjshme për krijimin e depozitave pranë ish-Bankës së Kursimeve.

11.5. Lidhur me depozitën bankare të krijuar në datën 9.7.2003 (nr. ***), konkretisht për sa i përket burimit të krijimit, Komisioni konstaton se në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti ka deklaruar si burim krijimi dhuratë për martesë nga prindërit. Më tej, në pyetësorin nr. 1, subjekti ka shpjeguar se përveç dhuratës nga prindërit me rastin e martesës, krijuar nga shumat monetare si kontribut nga të afërmit, pasi është fëmijë i vetëm, ka si burim edhe kursimet e saj të mbetura nga paga, të krijuara gjatë viteve të punës, nga viti 1996 deri në momentin e krijimit të depozitës. Komisioni, në kushtet që subjekti nuk paraqiti dokumentacion për shumat monetare si kontribut nga të afërmit, si dhe duke konsideruar se të ardhurat nga paga e saj për vitin 1996 janë përfshirë në analizën financiare të shpenzimeve për shtesën e apartamentit të prindërve, kreu përlllogaritjet duke konsideruar të ardhurat dhe shpenzimet e prindërve të subjektit të rivlerësimit për periudhën

¹⁵¹ Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2021.

¹⁵² Shkresë nr. *** prot., datë 20.6.2023.

¹⁵³ Përgjigje datë 12.7.2023.

¹⁵⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 6.7.2023, e Raiffeisen Bank.

1999 – korrik 2003¹⁵⁵, nga ku rezultoi se prindërit e subjektit kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 84.341 lekë për dhurimin e shumës 500.000 lekë. Për rrjedhojë, në analizën financiare u paraqit shuma 415.659 lekë, si dhurim i prindërve për subjektin.

11.6. Lidhur me depozitën bankare nr. ***, fillimisht Komisioni përcaktoi kohën e krijimit të saj për efekt të paraqitjes në analizën financiare, konkretisht: (i) shtesë depozite në ish-Bankën e Kursimeve në vlerën 20.000 lekë, në datën 31.12.1999¹⁵⁶; (ii) interesa të fituar në vlerën 1.858 lekë dhe në të njëjtën vlerë edhe shtesë depozite në datën 31.12.2001¹⁵⁷; (iii) interesa të përlllogaritur për periudhën 2002 – 2003, në vlerën 39.346 lekë¹⁵⁸; (iv) shtesë depozite në ish-Bankën e Kursimeve në vlerën 517.488 lekë¹⁵⁹.

Më tej, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1997 – 2003, duke konsideruar: (i) të ardhurat e subjektit nga pagat¹⁶⁰; (ii) të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga pagat¹⁶¹; (iii) shpenzime jetese për periudhën 1997 – 1999, përlllogaritur si 30% e të ardhurave, në kuadër të arsytimit të përdorur nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit¹⁶² për rastet që niveli i pagave i kalon 800 USD/vit; (iv) shpenzime jetese për periudhën 2000 – 2003 sipas informacionit të përcjellë nga INSTAT-i¹⁶³; (v) shpenzimet për blerjen e dy automjeteve (trajtuar në pikat 20.2. dhe 20.3. të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht); (vi) shtesat dhe interesat e depozitave në ish-Bankën e Kursimeve, sipas arsytimit të mësipërm; (vii) gjendjen e llogarive bankare të bashkëshortit në Raiffeisen Bank, për të cilat subjekti deklaroi në pyetësorin nr. 1 se ato i përkasin llogarive personale dhe të personit fizik të regjistruar në emër të tij dhe se është në pamundësi për të identifikuar se kur janë krijuar këto llogari, lëvizjet që kanë pasur dhe se kujt i përket secila llogari (personit fizik apo llogarisë personale të bashkëshortit).

Nga analiza financiare u konstatua një balancë negative në vlerën 1.318.906 lekë për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzime për periudhën 1997 – 2003 (përfshirë të ardhurat që kanë shërbyer si burim për depozitën 2.000.000 lekë¹⁶⁴ dhe për depozitën nr. ***, 500.000 lekë¹⁶⁵).

11.7. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: *(i) Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 84.341 lekë për krijimin e depozitës bankare*

¹⁵⁵ Depozitimi në shumën 500.000 lekë është kryer në datën 9.7.2003, në llogarinë me *** (paraqitur nga subjekti në pyetësorin nr. 1).

¹⁵⁶ Konfirmuar nga Raiffeisen Bank.

¹⁵⁷ Konfirmuar nga Raiffeisen Bank.

¹⁵⁸ Si diferencë midis vlerës së depozitës prej 539.346 lekësh dhe vlerës prej 500.000 lekësh (në mungesë të informacionit për datën e saktë të shtimit të depozitës, u përcaktuan interesat në vlerën 39.346, duke marrë si referencë vlerën e interesave për depozitën nr. ***, për shkak të vlerave të përafërta).

¹⁵⁹ Në mungesë të informacionit, përlllogaritur si diferencë midis gjendjes së llogarisë prej 539.346 lekësh dhe shtesave të mëparshme (20.000 lekë dhe 1.858 lekë).

¹⁶⁰ (i) Vërtetim nr. *** prot., datë 19.1.2017, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë; (ii) vërtetim nr. *** prot., datë 25.1.2017, nga Bashkia Vlorë.

¹⁶¹ (i) Vërtetim për bazën e vlerësuar për periudhat 1998, janar – mars 1999 dhe shkurt – qershor 2001, lëshuar nga DRSSH Vlorë; (ii) vërtetim për bazën e vlerësuar për periudhën 2003 – 2011, lëshuar nga DRSSH Vlorë.

¹⁶² Vendim nr. ***, datë 18.6.2021, paragrafët 21.40-21.42.

¹⁶³ Shkresë INSTAT – ILDKPKI, me nr. ***, datë 4.3.2019.

¹⁶⁴ Trajtuar në seksionin (a) të pikës 17 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

¹⁶⁵ Trajtuar në paragrafin 11.5 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

pranë Raiffeisen Bank (nr. ***), pasi prindërit e subjektit nuk justifikojnë plotësisht me burime të ligjshme shumën e dhuruar; (ii) Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në periudhën 1997 – 2003, në vlerën 1.318.906 lekë, për krijimin e depozitës bankare pranë Raiffeisen Bank (nr. ***), si dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera.

11.8. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se:

11.9. Lidhur me depozitën e parë, deklaroi se llogaria nr. ***, e çelur me tepricë në shumën 535.948,60 lekë, derivon nga depozita e krijuar në datën 9.7.2003, në shumën 500.000 lekë, e cila është maturuar dhe është shtuar me interesa bankarë. Kjo është depozita e deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, ku është specifikuar edhe burimi i krijimit “dhuratë për martesë nga prindërit”. Shuma prej 500.000 lekësh, dhuruar nga prindërit, është depozituar në datën 9.7.2003, disa muaj para se të emërohej gjyqtare.

11.10. Subjekti kërkoi të përfshihen në analizën financiare edhe të ardhurat e dhuruara nga të afërm dhe miq të familjes, të cilët kanë kontribuar në momentin e martesës, në shumën e dokumentuar prej 4.000 USD, çka do të bënte që prindërit të rezultonin me burime të ligjshme financiare për të dhuruar vlerën 500.000 lekë. Për të provuar deklaratimet e saj subjekti paraqiti deklaratata nga miq e të afërm¹⁶⁶.

11.11. Lidhur me depozitën e dytë, subjekti deklaroi se në analizën financiare për periudhën 1997 – 2003 nuk janë përfshirë të ardhurat nga aktiviteti i personit fizik, i regjistruar në emër të bashkëshortit. Bashkëshorti është regjistruar si person fizik në datën 30.10.2001, me objekt aktiviteti “Tregtim i mallrave të ndryshëm në fushën e kancelarisë e pajisjeve të zyrës” dhe të ardhurat nga ky aktivitet kanë qenë burimi kryesor në vitin 2001, dhe kryesisht në vitin 2002, vijoi subjekti. Këto të ardhura janë të dokumentuara dhe duhet të përfshihen në analizën financiare, edhe pse në deklaratën *Vetting* nuk janë deklaruar për shkak të vështirësisë në deklaram, duke qenë se në këtë periudhë deklarohej vetëm xhiro dhe jo fitim.

Më tej, subjekti deklaroi se në vitin 2003 u themelua shoqëria “****” sh.p.k., me aktivitet “****”, ndërkohë që bashkëshorti vazhdoi të mbante dyqanin e kancelarisë që kishte hapur si person fizik. Subjekti shpjegoi se përveç formularëve të njoftim-tatimit për vitet 2001 dhe 2002¹⁶⁷, në arkivin e

¹⁶⁶ (i) Kontributi nga i afërmi A. E., nëpërmjet deklaratës noteriale nr. ***, datë 13.10.2023, ka deklaruar se prej vitit 1994 ka jetuar në SHBA; ai dhe familjarë e znj. Herila Çela njihen prej shumë vitesh, kanë pasur miqësi të vjetër mes tyre që e ruajnë edhe sot. Në verën e vitit 1996 ka ardhur në ceremoninë e martesës së znj. Herila Çela me z. Th. L. dhe për shkak të lidhjes shumë të afërt me ta i ka dhuruar prindërve të saj në dasmë, si dhe për të ardhur në ndihmë për shkak të jetesës së vështirë në Shqipëri, shumën prej rreth 1.000 USD amerikanë; (ii) Kontributi nga i afërmi E. M., e cila me deklaratën noteriale pranë noterit publik V. B. në shtetin e New York deklaroi se nëna e saj E. D. me babanë e znj. Herila Çela kanë qenë kushërinj të parë. Është shumë e afërt me familjen e A. dhe Herilën e kanë parë gjithnjë si motrën e tyre, meqenëse ajo është vajza e vetme e kësaj familjeje. Ka marrë pjesë në ceremoninë e martesës, si dhe nga fakti që në muajin dhjetor të po atij viti do të largohej në SHBA; me dëshirën e saj të plotë i ka dhuruar prindërve të subjektit shumën 1.500 USD. Mundësia financiare e saj ishte prej nënës E. D., motrës V. D. dhe vëllait të quajtur G. D., të cilët jetonin në New York, SHBA; (iii) Kontributi nga i afërmi S. T., e cila ndërmjet deklaratës noteriale të datës 10.4.2023 pranë noterit publik J. Xh. në shtetin Philadelphia, deklaroi se në verën e vitit 1996 ka qenë në Shqipëri, në Vlorë, që është vendlindja e saj. Duke qenë se në atë kohë subjekti, të cilën e konsideronte si motër, po martohej me z. Th. L., për shkak të lidhjes shumë të afërt me ta, me dëshirë të plotë i ka dhuruar sipas zakonit që është nëpër dasma shumën prej 2.000 USD, nga këto 1.000 USD nga vet ajo dhe 1.000 USD nga babi i saj, pasi po martonte vajzën e mikut të tij më të mirë, z. A.. Këto para i kishin nga të ardhurat nga puna që kishin bërë në SHBA, vend të cilin u zhvendosën që nga viti 1992.

¹⁶⁷ Subjekti, ndër të tjera, deklaroi se: “Në datën 1.11.2001 është lëshuar fletënjoftim tatimi, nëpërmjet të cilit ai ka paguar 15.000 lekë. Për vitin 2002 është lëshuar fletënjoftim tatimi i datës 29.3.2002, nëpërmjet të cilit është paguar shuma 40.000 lekë”.

dokumenteve në atë periudhë bashkëshorti ka gjetur edhe tabelën e llogaritjes për taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2003 (si dhe dokumente të tjera tatimore që tregojnë ushtrimin e aktivitetit gjatë atij viti). Në këtë formular është deklaruar xhiro për vitin 2003 në shumën 3.000.000 lekë dhe tatimi i paguar 120.000 lekë. Fitimi neto i vitit 2003 është tërhequr nga personi fizik pas mbylljes së vitit 2003 dhe likuidimit të të gjitha të drejtave dhe detyrimeve për personin fizik¹⁶⁸. Me tërheqjen e fitimit dhe mbylljen e aktivitetit të personit fizik, bashkëshorti ka derdhur në bankë shumën 1.100.000 lekë. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti kopje të njehsuar të formularit “Tabela e llogaritjes për taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2003”.

11.12. Subjekti pretendon se, për sa kohë provohet me dokumentacion ligjor se bashkëshorti, në cilësinë e personi fizik, ka paguar detyrimet tatimore për vitet 2001, 2002 dhe 2003, duhet të përfshihen në analizën financiare fitimet neto të realizuara.

11.13. Në lidhje me fitimin neto të realizuar, subjekti shpjegoi se në fillim të këtyre viteve ka pasur një kërkesë të madhe për produktet kancelarike dhe fotokopjet dhe se dyqani kancelari ka pasur marzh relativisht të lartë, në masën 50-60% të qarkullimit. Konkretisht, rezulton se për vitin 2001 fitimi neto ka qenë 150.000 lekë dhe për vitin 2002 fitimi neto i realizuar ka qenë 900.000 lekë (2.000.000 qarkullimi x 50% marzh fitimi – tatime të paguara), sqaroi subjekti.

11.14. Subjekti deklaroi se është e vërtetë që këto të ardhura nuk janë deklaruar si burim në deklaratën *Vetting*, por në kushtet kur: (i) ushtrimi i aktivitetit; (ii) xhironja e realizuar gjatë vitit; dhe (iii) pagesa e detyrimeve tatimore u provua me prova të pakundërshtueshme, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm – pasaktësia në mosdeklarim e këtyre të ardhurave mbetet e karakterit formal dhe pa pasoja në procesin e rivlerësimit. Këto të ardhura janë reale, të matshme me metoda alternative dhe plotësojnë kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, deklaroi subjekti.

11.15. Në përfundim, subjekti paraqiti analizën financiare për periudhën 1997 – 2003, të përpiluar nga ana e saj, me një balancë negative në shumën 268.906 lekë, analizë në të cilën evidentohet një fitim në masën 150.000 lekë për vitin 2001, në masën 900.000 lekë për vitin 2002, ndërsa për vitin 2003 nuk paraqitet fitim nga ky aktivitet.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

11.16. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, propësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

¹⁶⁸ Subjekti deklaroi se i është drejtuar Bashkisë Vlorë për të marrë informacion në lidhje me personin fizik. Në përgjigje të shkresës nr. *** prot., datë 12.7.2023, Bashkia Vlorë i ka informuar se për personin fizik me kod fiskal ***, i regjistruar me aktivitet shitje kancelari, nuk rezulton asnjë e dhënë në regjistrat e taksapaguesve në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, Bashkia Vlorë. Gjithashtu, edhe DRT Vlorë, në përgjigje të shkresës nr. *** prot., datë 6.9.2023, informon se subjekti Th. N. L., me kod fiskal ***, ka kryer pagesat për detyrimet dhe për periudhat tatimore që ka qenë aktiv, nuk disponojnë dosje fizike, si rrjedhojë nuk disponojnë kërkesë për çregjistrim për vitin 2002 – 2004, as vendim gjykatë për mbyllje dhe certifikatë regjistrimi.

11.17. Lidhur me depozitën bankare të krijuar në datën 9.7.2003, Komisioni vëren se në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 subjekti ka deklaruar si burim krijimi dhuratë për martesë nga prindërit dhe, më tej, në pyetësoin nr. 1, ka shpjeguar se pjesë e dhuratës nga prindërit me rastin e martesës kanë qenë edhe shumat monetare si kontribut nga të afërmit. Për të provuar shumat monetare si kontribut nga të afërmit, subjekti paraqiti në cilësinë e provës 3 deklarata noteriale: (i) kontribut nga i afërmi A. E., i cili nëpërmjet deklaratës noteriale nr. ***, datë 13.10.2023, ka deklaruar se i ka dhuruar shumën prej rreth 1.000 USD; (ii) kontribut nga e afërmja E. M., e cila me deklaratën noteriale pranë noterit publik V. B. në shtetin New York deklaroi se ka dhuruar shumën 1.500 USD¹⁶⁹; (iii) kontribut nga e afërmja S. T., e cila nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 10.4.2023 pranë noterit publik J. Xh. në shtetin Philadelphia, deklaroi se ka dhuruar shumën 2.000 USD, nga këto 1.000 USD nga vetë ajo dhe 1.000 USD nga babai i saj¹⁷⁰.

11.18. Komisioni vëren se, pas arsytimit në paragrafin 1.30 të këtij vendimi, lidhur me përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës në masën 30% mbi të ardhurat e nënës së subjektit – në rastin konkret për vitin 1999 – balanca negative do të reduktohej në -18.740 lekë¹⁷¹.

11.19. Komisioni vlerëson se deklaratat noteriale të paraqitura në këtë fazë të procesit mbeten në nivel deklarativ, por duke qenë se mungesa e burimeve të ligjshme financiare të prindërve është në një vlerë jo të konsiderueshme prej 18.740 lekësh, Komisioni vendosi t’i marrë në konsideratë të ardhurat e pretenduara, duke dalë në konkluzionin se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e depozitës bankare pranë Raiffeisen Bank (nr. ***).

11.20. Lidhur me depozitën bankare nr. ***, Komisioni konstatoi se subjekti nuk e ka deklaruar këtë llogari në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, sipas të cilit subjekti mbart detyrimin të deklarojë pasuritë e luajtshme të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to sipas Kodit Civil.

11.21. Lidhur me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i bashkëshortit si person fizik¹⁷², Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, vlerëson të përfshijë në analizën financiare vetëm të ardhurat e realizuara në vitet 2001 – 2002 dhe jo për vitet 2003 – 2004, duke arsyetuar se:

i) Subjekti nuk ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti si person fizik në deklaratën e pasurisë së viteve 2003 dhe 2004, ndërkohë që ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti i shoqërisë “****” sh.p.k.¹⁷³.

ii) Gjatë hetimit nuk u administrua asnjë shkresë nga organet tatimore, ku të konfirmohej zhvillimi i aktivitetit gjatë viteve 2003 dhe 2004.

¹⁶⁹ Komisioni vëren se noteri publik që ka hartuar deklaratën e shtetases E. M. ka vendosur shënimin se vula apostile, e cila duhet t’i bashkëngjitet këtij dokumenti, kërkon një kohë prej 2 - 3 javë nga Departamenti i Shtetit.

¹⁷⁰ Noteri publik që ka hartuar deklaratën e shtetases S. T. ka vendosur shënimin se koha për të marrë një vulë apostile në shtetin e Pensilvanisë varion nga 3-5 javë.

¹⁷¹ Shpenzimet e jetesës në shumën 845.322 lekë reduktohen në shumën 779.722 lekë.

¹⁷² Në vijim të trajtimit në pikën 17 të këtij vendimi.

¹⁷³ Në prapësime, subjekti ka deklaruar: “Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 (830.000 lekë të ardhura nga aktiviteti i bashkëshortit “Kancelari”) dhe në DIPP/2004 (3.000.000 lekë të ardhura nga paga e bashkëshortit), i përkasin fitimit neto të realizuar nga shoqëria “****” sh.p.k. Për vitin 2003 fitimi neto pas tatimit është në shumën 762.762 lekë dhe për vitin 2004 fitimi neto pas tatimit është në shumën 2.703.288 lekë”.

iii) Në datën 28.1.2003, bashkëshorti i subjektit ka themeluar shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “****” sh.p.k., çka do të thotë që duke filluar nga periudha janar 2003 e në vijim, bashkëshorti zhvillonte aktivitet tregtar nëpërmjet shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

11.22. Më tej, në kushtet e mungesës së informacionit mbi xhiron e realizuar¹⁷⁴, si dhe të fitimit të realizuar, Komisioni përlllogarit një fitim të mundshëm, duke aplikuar një marzh fitimi në masën 20%, duke iu referuar natyrës së aktivitetit të zhvilluar dhe faktit se ky aktivitet tregtar ishte në fillesat e tij.

11.23. Në përcaktimin e këtij raporti u mbajt në konsideratë fakti se norma e fitimit prej 20% është përdorur nga Komisioni në përcaktimin e fitimit në rastet e aktiviteteve tregtare të shitjes me pakicë të mallrave, praktikë e cila është lënë në fuqi edhe në vendimmarrjet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit¹⁷⁵.

11.24. Sa më lart, Komisioni aplikoi normën 20% mbi qarkullimin, duke konsideruar këtu nivelin maksimal të nivelit të xhiros ku është kategorizuar ky aktivitet, duke përlllogaritur fitimin nga aktiviteti tregtar si person fizik në shumën 70.833 lekë për vitin 2001¹⁷⁶ dhe në shumën 400.000 lekë për vitin 2002¹⁷⁷.

11.25. Në konkluzion, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në periudhën 1997 – 2003, në shumën 848.073 lekë, për krijimin e depozitës bankare pranë Raiffeisen Bank, si dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

12. Lidhur me adresat e banimit

12.1. Në deklaratat periodike të pasurisë ndër vite, subjekti ka deklaruar: (i) në DIPP-të e viteve 2003 – 2006, adresë banimi: lagjja “****”, rruga “****”, nr. ***, Vlorë; (ii) në DIPP-të e viteve 2007 – 2009, adresë e gjendjes civile: lagjja “****”, Njësia Administrative Nr. ***, rruga “****”, ap. ***, Vlorë. Në DIPP-të e viteve 2009, 2010, 2012, 2014 e 2015, nuk ka deklaruar adresë të gjendjes civile apo adresë banimi. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar adresën e gjendjes civile: lagjja “****”, p. ***, blv. “****”, Vlorë. Si vendqëndrim tjetër subjekti ka deklaruar adresën: lagjja “****”, rruga “****”, kompleksi “****”, h. ***, kati ***, ap. ***, Tiranë¹⁷⁸.

12.2. Në përgjigje të pyetësorit standard¹⁷⁹, subjekti deklaroi se ka banuar në familjen e prindërve A. dhe E. Ç., të cilët kanë qenë pronarë të banesës së apartamentit të ndodhur në lagjen “****”, blv. “****”, p. ***, kati ***, Vlorë. Pasi ka lidhur martesë ligjore në vitin 1996, deri në vitin 2005 ka jetuar te familja e prindërve të bashkëshortit Th. L., provuar me vërtetimin datës 19.1.2021, lëshuar nga Rajoni nr. *** i Bashkisë Vlorë. Pronarë të banesës kanë qenë prindërit e bashkëshortit,

¹⁷⁴ Fletët e njoftim-tatimit të datave 1.11.2001 dhe 29.3.2002 përmbajnë informacion mbi nivelet e xhiros dhe jo xhiron e realizuar faktikisht.

¹⁷⁵ Vendim nr. 2-2023 (JR), datë 2.2.2023, paragrafët 18.13, 18.14, 18.16; vendim nr. 47-2022 (JR), datë 14.12.2022, paragrafi 19.12.4.

¹⁷⁶ Përlllogaritur 20% e xhiros në shumën 2.125.000 lekë, si shumatore e 2.000.000 lekë dhe 125.000 lekë (5.000 lekë tatim/normën e tatimit 4%).

¹⁷⁷ Përlllogaritur 20% e xhiros në shumën 2.000.000 lekë.

¹⁷⁸ Kjo adresë i përket apartamentit të ndodhur në Tiranë ku ka jetuar vajza e subjektit gjatë ndjekjes së studimeve në Tiranë (pasuri e trajtuar në pikën 15 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht).

¹⁷⁹ Email datë 30.1.2021, ora 17:55.

shtetasit N. dhe F. L., fëmijët e tyre, djali Th. L. dhe vajza A. L., provuar nëpërmjet certifikatës së pronësisë me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***. Më tej, që prej vitit 2005 e në vazhdim, subjekti deklaroi se jeton në apartamentin e prindërve.

12.3. Referuar informacionit të administruar nga Drejtoria e Hartimit të Procedurave dhe Dokumenteve Biometrike¹⁸⁰, konfirmohet se subjekti ka lidhur martesë ligjore me shtetasin Th. L. në datën 1.12.1996. Sipas informacionit të përcjellë, subjekti është veçuar nga familja e prindërve të bashkëshortit në datën 12.8.2005 dhe po në këtë datë ka ndërruar vendbanimin në Rajonin nr. ***, Bashkia Vlorë, me adresë: lagjja “****”, blv. “****”, p. ***, Vlorë.

12.4. Sa më lart, *lidhur me periudhën 2003 – 2004*, Komisioni vëren se ka mospërputhje midis deklaramit të subjektit në pyetësin standard me atë në DIPP-të vjetore, pasi në këto të fundit subjekti ka deklaruar se ka banuar në banesën e prindërve të saj, ndërkohë që në pyetësin standard ka deklaruar banesën e prindërve të bashkëshortit. Nga ana tjetër, deklarimi i subjektit në pyetësin standard përputhet me dokumentacionin e administruar nga Drejtoria e Hartimit të Procedurave dhe Dokumenteve Biometrike.

12.5. Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në lidhje me këtë pasuri dhe se nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

PASURITË E BABAIT TË SUBJEKTIT, Z. A. Ç.

13. Në deklaratën *Vetting* 2017, babai i subjekti të rivlerësimit ka deklaruar se zotëron pasuritë, të cilat janë trajtuar më sipër, në seksionin e pasurive të subjektit të rivlerësimit Herila Çela, sa më poshtë vijon:

*1) Apartament banimi me sip. 68,62 m², ndodhur në lagjen “****”, blv. “****”, p. ***, Vlorë. Vlera: 2.965 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: përfituar me anë të kontratës së privatizimit datë 14.7.1993 (apartament i vitit 1957). Më tej, ka deklaruar shtesë të apartamentit të banimit me sip. 68,62 m², ndërtuar në vitin 1997, me sip. 42,8 m², i cili ndodhet në proces legalizimi. Nuk deklarohet vlera e investimit. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: ndërtuar prej meje dhe bashkëshortes nga të ardhurat e kursyera ndër vite.*

*2) 4 apartamente banimi dhe 2 njësi shërbimi në rrugën “****”, Vlorë. Pjesa takuese: 50%. Apartament me sip. 88 m², certifikatë pronësie nr. ***, nr. pasurie ***. Apartament me sip. 73 m², certifikatë pronësie nr. ***, nr. pasurie ***, hyrja ***, ap. ***. Apartament me sip. 73 m², certifikatë pronësie nr. ***, nr. pasurie ***, hyrja ***, ap. ***. Apartament me sip. 73 m², certifikatë pronësie nr. ***, nr. pasurie ***, hyrja ***, ap. ***. Njësi me sip. 42,6 m², certifikatë pronësie nr. ***, nr. pasurie ***. Njësi me sip. 50,6 m², certifikatë pronësie nr. ***, nr. pasurie ***. Burimi i krijimit: pasuri trashëgimore nga bashkëshortja (vendimi nr. ***, datë 24.3.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë) si pronare e truallit, përfituar sipas kontratës së shkëmbimit nr. ***, datë 19.1.2015.*

¹⁸⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 1.3.2023.

3) 1 njësi shërbimi dhe 3 garazhe në rrugën “****”, Vlorë, Pjesa takuese: 50%. Njësi me sip. 78 m², certifikatë pronësie nr. ***, nr. pasurie ***. Garazh me sip. 24 m², certifikatë pronësie nr. ***, nr. pasurie ***. Garazh me sip. 17 m², certifikatë pronësie nr. ***, nr. pasurie ***. Garazh me sip. 24 m², certifikatë pronësie nr. ***, nr. pasurie ***. Burimi i krijimit: pasuri trashëgimore nga bashkëshortja (vendimi nr. ***, datë 24.3.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë) si pronare e truallit, përfituar sipas kontratës së shkëmbimit nr. ***, datë 23.2.2012.

4) Tokë truall me sip. 880 m² (në bashkëpronësi), me adresë: lagja “****”, Vlorë, z. k. ***, certifikatë pronësie nr. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***. Pjesa takuese: 32%. Burimi i krijimit: pasuri trashëgimore nga bashkëshortja (vendimi nr. ***, datë 24.3.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë) si pronare e truallit.

5) Llogari rrjedhëse në Raiffeisen Bank nr. ***, në euro, në bashkëpronësi me vajzën Herila Çela, hapur në datën 30.12.2014 prej bashkëshortit Th. L., i autorizuar prej nesh. Vlera: 24.239,76 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: kontratë shitblerjeje apartament banimi me nr. ***, datë 24.12.2014, çmimi i shitjes 50.000 euro, derdhur pjesërisht 39.000 euro.

6) Llogari rrjedhëse në FiBank sh.a. nr. ***, në euro, në bashkëpronësi me vajzën Herila Çela, hapur në datën 5.12.2016 prej bashkëshortit Th. L., i autorizuar prej nesh. Vlera: 40.999 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: kontratë shitblerjeje apartament banimi nr. ***, datë 7.12.2016.

7) Llogari rrjedhëse në BKT sh.a., nr. ***, në euro, në bashkëpronësi me vajzën Herila Çela, hapur në datën 6.1.2015 prej bashkëshortit Th. L., i autorizuar prej nesh. Vlera: 84.544 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: (i) kontratë shitblerjeje apartament banimi nr. ***, datë 24.12.2014, çmimi i shitjes 50.000 euro, derdhur pjesërisht në BKT 11.000 euro; (ii) kontratë shitblerjeje apartament banimi dhe garazh nr. ***, datë 6.3.2015. Çmimi i shitjes 35.000 euro, derdhur tërësisht; (iii) kontratë shitblerjeje apartament banimi nr. ***, datë 25.5.2016, çmimi i shitjes 40.000 euro, derdhur pjesërisht në BKT 10.000 euro; (iv) kontratë shitblerjeje garazh nr. ***, datë 11.6.2016. Çmimi i shitjes 5.000 euro, derdhur tërësisht; (v) kontratë shitblerjeje apartament nr. ***, datë 27.9.2016. Çmimi i shitjes 33.000 euro, derdhur tërësisht; (vi) kontratë shitblerjeje apartament nr. ***, datë 10.11.2016. Çmimi i shitjes 38.000 euro, derdhur tërësisht.

8) Llogari rrjedhëse në NBG Bank në bashkëpronësi me vajzën Herila Çela, hapur në datën 26.1.2017 prej bashkëshortit Th. L., i autorizuar prej nesh. Vlera: 29.700 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: kontratë shitblerjeje apartament banimi nr. ***, datë 25.5.2016, derdhur pjesërisht në NBG Bank në shumën 29.700 euro.

PASURITË E BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT, Z. TH. L.

14. Automjet tip “Opel Astra”, me targë **, prodhim i vitit 2005, me vlerë 1.476.000 lekë**

14.1. Në deklaratën Vetting 2017, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar autoveturë tip “Opel Astra”, prodhim i vitit 2005, me targë ****, me vlerë 1.476.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: kredi 1.000.000 lekë në Bankën Popullore, me afat 5-vjeçar dhe pjesa tjetër

kursime (shlyer plotësisht). Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹⁸¹.

14.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar automjet tip “Opel Astra”, 1.4, prodhim i vitit 2005, blerë në qershor të vitit 2005, në shumën 1.4 milionë lekë.

14.3. DPSHTRR-ja¹⁸² konfirmon se në emër të bashkëshortit të subjektit është i regjistruar mjete me targë *** dhe ka përcjellë kopje të faturës tatimore të shitjes me nr. ***, datë 22.6.2005, shitës shoqëria “****” sh.p.k., vlera 1.476.000 lekë. Gjithashtu, DPSHTRR-ja ka përcjellë edhe kopje të deklaratës doganore nr. ***, datë 3.6.2005, sipas së cilës ky automjet është blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. në vlerën 8.523 euro, si dhe është paguar taksë doganore në vlerën 21.300 lekë dhe TVSH në vlerën 217.256 lekë.

14.4. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se shuma totale e shpenzuar nga shoqëria “****” sh.p.k. për këtë automjet ka qenë 1.303.590 lekë¹⁸³, ndërsa çmimi i shitjes 1.476.000 lekë, pra 172.410 lekë më shumë.

14.5. Lidhur me burimin e krijimit: Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar: “*Detyrim 1 milion lekë ndaj Bankës Popullore për riparim banese (banesa e prindërve, ku unë dhe familja ime jetojmë), marrë në datën 20.6.2005, me afat 5-vjeçar, me nr. ***. Kredia e marrë është përdorur për blerjen e automjetit me vlerë 1.4 milionë lekë, nga të cilat 1 milion kredia dhe kursime të vitit 2005*”.

14.6. OTP Bank¹⁸⁴ ka përcjellë kontratën për hua afatmesme nr. ***/20.6.2005, ku është parashikuar se huaja prej 1.000.000 lekësh do të përdoret nga huamarrësi për rikonstruksion. Gjithashtu, në këtë kontratë parashikohet se pagesa e kësaj huaje do të sigurohet nga pasuria e luajtshme në pronësi të huamarrësit Th. L., automjet tip “****”, ngjyrë gri, prodhim i vitit 2004, me targë ***¹⁸⁵.

14.7. Në kushtet që në llogaritë bankare nuk u evidentua lëvrimi i kësaj kredie, Komisioni i kërkoi informacion OTP Bank, e cila dhe në përgjigje¹⁸⁶ bëri me dije se: “*Për sa i përket kërkesës suaj mbi lëvizjet bankare të llogarisë para datës 5.10.2006, ju bëjmë me dije se për klientët disponojmë nxjerrje llogarie vetëm prej datës 5.10.2006, që mund të vijë edhe për shkak të ndryshimit të sistemit informatik të bankës përpara kësaj periudhe*”.

14.8. Në këto kushte, duke konsideruar deklarinimin e subjektit në DIPP-në e vitit 2005 lidhur me përdorimin e kredisë për blerje automjeti, si dhe parashikimin në pikën 2 të seksionit D “Të ndryshme”, ku citohet se “*Marrëveshja në fjalë hyn në fuqi dhe ekzekutohet sot, në datën 20.6.2005*”, Komisioni e mori në konsideratë kredinë si burim për blerjen e automjetit.

¹⁸¹ Leje qarkullimi të mjetit me targë *** në emër të shtetasit Th. L.: faturë tatimore shitjeje nr. ***, datë 22.6.2005, me palë shitëse “****” sh.p.k. dhe palë blerëse Th. L. të mjetit tip “Opel Astra”, në vlerën 1.476.000 lekë.

¹⁸² Shkresë nr. *** prot., datë 18.2.20121.

¹⁸³ Çmim blerjeje 1.065.034 lekë (8.523 euro x 124,96 lekë), taksë doganore 21.300 lekë, TVSH 217.256 lekë.

¹⁸⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 22.6.2023.

¹⁸⁵ Marrëveshje siguruese nr. ***, datë 29.6.2005.

¹⁸⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 22.6.2023.

14.9. Në kushtet që shoqëria “****” sh.p.k. nuk i ktheu përgjigje kërkesës së Komisionit për datën e saktë të kryerjes së pagesës së çmimit të blerjes, Komisioni e kreu analizën financiare në datën e faturës, pra 22.6.2005.

14.10. Sipas analizës financiare për të ardhurat, pasuritë, detyrimet dhe shpenzimet¹⁸⁷, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e këtij automjeti.

14.11. Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në lidhje me këtë pasuri dhe se nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

15. Automjet tip “Chevrolet”, me targë *, prodhim i vitit 2012, me vlerë 1.890.000 lekë**

15.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar automjet tip “Chevrolet”, prodhim i vitit 2012, me targë ***, vlera 1.890.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: dividend dhe kursime (shlyer plotësisht). Për vërtetimin e deklaramëve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹⁸⁸.

15.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Chevrolet, në pronësi të bashkëshortit, me targë ***, në vlerën 13.500 euro, me burim krijimi: kontributi i dividendit të bashkëshortit për vitin 2011, të ardhurat nga depozitat, si dhe qiraja e dyqanit. Në deklaratën *Vetting* ka paraqitur certifikatën e pronësisë së mjetit me targë *** në emër të shtetasit Th. L., si dhe faturën tatimore të shitjes nr. ***, datë 14.1.2012, me palë shitëse “****” sh.p.k. dhe palë blerëse Th. L., të mjetit tip “****”, në vlerën 13.500 euro, e konvertuar në 1.890.000 lekë.

15.3. Referuar dokumentacionit të administruar nga DPSHTRR-ja¹⁸⁹, rezulton se bashkëshorti i subjektit ka pasur të regjistruar mjetin me targë ***¹⁹⁰. Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, konfirmohet fatura tatimore nr. ***, datë 14.1.2012. DPSHTRR-ja ka përcjellë edhe kopje të deklaratës doganore nr. ***, datë 21.12.2011, sipas së cilës ky automjet është blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. në vlerën 9.585,95 euro, si dhe është paguar TVSH në vlerën 267.097 lekë (taksë doganore 0 lekë).

15.4. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se shuma totale e shpenzuar nga shoqëria “****” sh.p.k. për këtë automjet ka qenë 1.606.738 lekë¹⁹¹, ndërsa çmimi i shitjes 1.890.000 lekë, pra 283.262 lekë më shumë. Në kushtet që shoqëria “****” sh.p.k. nuk i ktheu përgjigje kërkesës së

¹⁸⁷ U përlogaritën shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur; prindërit e subjektit nuk u përfshinë në analizë, pasi të ardhurat/shpenzimet për këtë periudhë janë përfshirë në analizën e kryer për verifikimin e mundësive financiare për dhurimin e shumës 500.000 lekë.

¹⁸⁸ Certifikatë e pronësisë së mjetit me targë *** në emër të shtetasit Th. L.; leje qarkullimi të mjetit me targë ***; faturë tatimore shitjeje nr. ***, datë 14.1.2012, me palë shitëse “****” sh.p.k. dhe palë blerëse Th. L. të mjetit tip “****”, në vlerën 13.500 euro, e konvertuar në 1.890.000 lekë.

¹⁸⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.2.2021 dhe shkresë nr. *** prot., datë 29.5.2003.

¹⁹⁰ Referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se ky automjet është shitur me kontratën nr. ***, datë 19.9.2017, në çmimin 7.000 euro.

¹⁹¹ Çmim blerjeje 1.339.641 lekë (9.585,95 euro x 139,75 lekë), taksë doganore 0 (zero) lekë, TVSH 267.097 lekë.

Komisionit për datën e saktë të kryerjes së pagesës së çmimit të blerjes, Komisioni e kreu analizën financiare në datën e faturës, pra 14.1.2012.

15.5. Për sa i përket burimit të krijimit, *lidhur me të ardhurat nga dividendi*, nga analizimi i këtyre të ardhurave rezultoi se dividendi i përfutur në vitin 2012 ka qenë në shumën 900.000 lekë (trajtuar në pikën 18 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht).

15.6. Komisioni vëren se pasqyrat financiare të vitit 2011 – vit të cilit i përket dividendi i shpërndarë në vitin 2012 – janë mbyllur në datën 12.3.2012, çka do të thotë se dividendi duhet të jetë shpërndarë pas kësaj date. Për rrjedhojë, për sa kohë nuk është paraqitur dokumentacion për përfitimim e dividendit gjatë periudhës 1.1.2012 – 14.1.2012, të ardhurat e përfutuara nga dividendi nuk mund të kenë shërbyer për blerjen e automjetit në datën 14.1.2012.

15.7. *Më tej, për sa i përket kursimeve*, Komisioni konstaton se subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* jashtë sistemit bankar¹⁹² në vitet paraardhëse e, po kështu, nuk evidentohen tërheqje nga llogaritë bankare¹⁹³.

15.8. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: *Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 1.890.000 lekë, për blerjen e automjetit tip “Chevrolet”, në datën 14.1.2012.*

15.9. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se ky automjet është porositur pranë shoqërisë koncesionare në fillim të muajit dhjetor 2011 dhe është tërhequr në datën 14.1.2012. Më tej, subjekti shpjegoi se bashkëshorti ka arritur të gjejë kontratën e porosisë për blerjen e automjetit tip “Chevrolet”, që mban datën 7.12.2011, ku rezulton se vlera 13.500 euro është parapaguar plotësisht. Pra, automjeti tip “Chevrolet” është porositur në fillim të muajit dhjetor 2011 dhe është tërhequr në datën 14.1.2012, dhe blerja është shtrirë më shumë se 1 muaj, shpjegoi subjekti.

Subjekti vijoi duke shpjeguar se, referuar dokumentacionit të blerjes¹⁹⁴, rezulton se automjeti është porositur në datën 14.12.2011 dhe automjeti është zhdoganuar në Shqipëri në datën 21.12.2011.

Fatura e blerjes është lëshuar në datën 14.1.2012, moment kur bashkëshorti ka tërhequr mjetin dhe shoqëria koncesionare si rregull ka anuluar faturën e parapagimit dhe ka lëshuar faturën për vlerën e blerjes së automjetit, procedurë që ndodh normalisht në çdo rast të blerjes së mjeteve të reja në shoqëritë koncesionare, sqaroi subjekti.

15.10. Subjekti deklaroi se në momentin e dorëzimit të DIPP-së së vitit 2011, pra në datën 30.3.2012, e kishte marrë automjetin dhe kishte disa muaj që e përdorte. Nga kjo situatë ka ndodhur

¹⁹² Nëse subjekti do të kishte disponuar likuiditete *cash* jashtë sistemit bankar, do duhet t'i kishte deklaruar referuar nenit 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, ku parashikohet se subjektet detyrohen të deklarojnë “vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj” dhe referuar nenit 7, pika 1 e ligjit më sipër, “në deklarinim periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë”.

¹⁹³ Përveç disa tërheqjeve në vlera të vogla.

¹⁹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 7.6.2023, dërguar nga Opel ***.

ngatërresa dhe nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 pagesën për automjetin, megjithatë momenti i pagesës është në datën 7.12.2011, kur palët kanë nënshkruar për porositjen e automjetit¹⁹⁵.

Në deklarimin e bashkëshortit në DIPP-në e vitit 2012, ky i fundit i është referuar pasqyrave financiare të vitit 2010, fitim i cili është tërhequr në vitin 2011. Ky fitim ka shërbyer si një nga burimet e krijimit për blerjen e mjetit.

15.11. Subjekti sqaroi se qëndron pasaktësia e mosdeklarimit në DIPP-në e vitit 2011 të një shpenzimi të kryer paradhënie për blerjen e automjetit, por duke mbajtur në vlerësim se në vitin 2011 nuk deklaroheshin shpenzimet dhe duke pasur parasysh se automjeti është deklaruar një vit më pas, vlerëson se kjo pasaktësi është e karakterit formal dhe pa pasoja në procesin e rivlerësimit.

15.12. Në përfundim, subjekti deklaroi se bazuar në kontratën e porosisë, për efekt të analizës financiare, blerja e mjetit duhet të përfshihet në vitin 2011, vit në të cilin analiza financiare e kryer nga Komisioni rezulton me balancë pozitive në vlerën 1.730.725 lekë, e cila është e përafërt me vlerën e automjetit, si dhe luhatjet e kursit të këmbimit. Për pasojë, subjekti pretendon se rezulton me një diferencë negative vetëm në shumën 136.325 lekë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

15.13. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

15.14. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës një kontratë porosie, me datë 7.12.2011, të lidhur ndërmjet palëve “***” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori A. M. dhe porositësi Th. L., e cila konstatohet të jetë një kontratë e thjeshtë, jo e lidhur para noterit publik dhe, si e tillë, nuk mund të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm që kjo kontratë është lidhur në datën 7.12.2011, për sa kohë subjekti nuk e ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011, siç parashikohet nga neni 4 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, sipas të cilit subjektet e deklarimit detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive brenda datës 31 mars të çdo viti gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive dhe burimet e krijimit të tyre.

15.15. Më tej, në shpjegimet e saj, subjekti pretendoi që shoqëria koncesionare si rregull ka anuluar faturën e parapagimit dhe ka lëshuar faturën për vlerën e blerjes së automjetit.

15.16. Komisioni vëren se në nenin 13 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, parashikohet se: “*Kur personi që kryen një furnizim të tatuueshëm arkëton pagesën më*

¹⁹⁵ “Nga shoqëria koncesionare ka qenë kusht i porositjes së automjetit, parapagim për vlerën e plotë të blerjes. Nëse bashkëshorti nuk do të kishte parapaguar automjetin, atëherë shoqëria koncesionare nuk do ta kishte blerë këtë mjet pranë furnitorit Chevreolet Central and ***. Porositja e automjetit është bërë 1 javë pasi bashkëshorti ka kryer pagesën e blerjes së mjetit”.

përpara se mallrat të livrohen a të bëhen të disponueshme, ose shërbimet të jenë kryer, ai është i detyruar të lëshojë një faturë për furnizimin në momentin që pagesa është arkëtuar prej tij”.

Më tej, në udhëzimin nr. ***, datë 3.1.2006, të këtij ligji, parashikohet se: “Kjo faturë do të regjistrohet menjëherë në librin e shitjes dhe do të pasqyrohet në FDP-në e po atij muaji në të cilin është bërë marrja e pagesës”. Bazuar në udhëzimin nr. ***, datë 2.9.2008, i ndryshuar, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në rastet kur arkëtimi i pagesës bëhet para lëvrimin të mallit ose kryerjes së shërbimit, shitësi lëshon faturë për arkëtimin e pagesës paradhënie (për efekt të pagimit të TVSH-së), e cila stornohet (anulohet, zbritet) pasi lëshohet fatura e shitjes së mallit.

15.17. Komisioni arsyeton se bazuar në përcaktimet ligjore të sipërpërmendura, në rast se parapagimi do të ishte kryer në datën 7.12.2011 – siç deklaroi subjekti – shoqëria “****” sh.p.k. do të kishte lëshuar një faturë parapagimi po në këtë datë dhe më tej në vitin 2012 do duhet së paku të ekzistonte një faturë tjetër stornimi (anulimi, zbritjeje), përveç faturës ku përshkruhet shitja e automjetit. Në një skenar tjetër të ngjashëm, saktësimi i parapagimit do duhet të ishte reflektuar në faturën nr. ***, datë 14.1.2012, e cila në këtë rast do të pasqyronte në njërin rresht faturimin e automjetit me vlerë 13.500 euro dhe në rreshtin tjetër parapagimin prej 13.500 euro (me minus), pra totali i kësaj fature do të ishte zero. Fatura e datës 14.1.2012 nuk përmban asnjë prej këtyre elementeve për të provuar anulimin e faturës së parapagimit, sikundër pretendoi subjekti në prapësime, pretendim ky që gjithashtu nuk gjen mbështetje në legjislacionin tatimor.

15.18. Komisioni vëren se shoqëria “****” sh.p.k., në përgjigjen e saj, ka bërë me dije se i ka përcjellë Komisionit praktikën e blerjes dhe shitjes për automjetin, për të cilin është kërkuar informacion dhe në dokumentacionin e administruar nuk evidentohet as kontrata e porosisë dhe as ndonjë faturë parapagimi.

15.19. Po kështu, as subjekti nuk e ka paraqitur faturën e parapagimit të përmendur nga ana e saj, duke e bërë kështu jo të besueshëm deklarin e saj gjatë prapësimeve se pagesa e automjetit është kryer në vitin 2011.

15.20. Sa më sipër rezulton, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor provues se momenti i pagesës së automjetit tip “Chevrolet” është data 7.12.2011 dhe jo data 14.1.2012, sikundër rezulton në faturën tatimore të shitjes.

15.21. Në konkluzion, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1.890.000 lekë, për blerjen e automjetit tip “Chevrolet”, në datën 14.1.2012, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

16. Apartament banimi me sipërfaqe 69,3 m², në Tiranë, vlera 42.000 euro

16.1. Në deklaratën Vetting 2017, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se zotëron apartament banimi me sip. 69,3 m², në lagjen “****”, rruga “****”, kompleksi “****”, hyrja ***, kati ***, në pronësi të bashkëshortes dhe vjehrrit 50/50, me vlerë 42.000 euro. Pjesa takuese:

100%. Burimi i krijimit: shitja e apartamenteve nga trashëgimia e nënës së bashkëshortes. Për vërtetimin e deklaramëve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹⁹⁶.

16.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se: Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar blerje apartament në Tiranë 1+1, me sip. 69,3 m², në rrugën “****”, sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 10.11.2015, në vlerën 42.000 euro, paguar nga llogaria e bashkëshortit pranë BKT-së, përfituar nga shitblerjet e pasurive të paluajtshme. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur kontratën nr. ***, datë 10.11.2015, me palë shitëse A. B., A. dhe L. B. dhe palë blerëse Th. L., të apartamentit me sip. 69,3 m², me nr. pasurie ***, në vlerën 42.000 euro. PAGESA do të kryhet në llogarinë e noterit në BKT. Me anë të transfertës datë 10.11.2015, në BKT, shtetasi Th. L. ka kaluar në llogarinë e H. Sh., person fizik, vlerën 42.000 euro.

16.3. Sipas dokumentacionit të administruar nga ASHK Tiranë¹⁹⁷, rezulton se në emër të bashkëshortit të subjektit figuron i regjistruar apartamenti me sip. 69,3 m², me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, në katin e 7-të në rrugën “****”, Tiranë, certifikatë pronësie nr. ***, datë 16.11.2015.

16.4. Me qëllim analizimin e vlerës së blerjes së këtij apartamenti dhe nëse ka pasur apo jo ndonjë trajtim preferencial për subjektin, Komisioni iu referua udhëzimit nr. ***, datë 30.9.2015 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015”. Bazuar në këtë udhëzim, referuar tabelës nr. *** “Të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës për vitin 2015”, vlera në tregun e lirë përlllogaritet 5.890.500 lekë¹⁹⁸, përkundrejt çmimit prej 5.814.060 lekësh¹⁹⁹, paguar nga subjekti.

16.5. Komisioni vëren se ky apartament është deklaruar si adresë banimi (vendqëndrim tjetër) në deklaratën *Vetting*²⁰⁰. Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me këtë deklaram, si dhe nëse ky apartament është shfrytëzuar për banim që prej momentit të blerjes (datë 10.11.2015). Në përgjigje, subjekti deklaroi se ky apartament është shfrytëzuar për banim që prej momentit të blerjes së tij. Kjo pasuri është blerë për shkak se vajza e subjektit Xh. L. nisi studimet e larta në Universitetin European të Tiranës.

16.6. Lidhur me arredimin e këtij apartamenti, subjekti deklaroi se ai ka qenë i mobiluar që në momentin e blerjes, fakt ky i pasqyruar në faqen e dytë, paragrafi i parë i kontratës së shitjes²⁰¹, dhe se nga ana e tyre janë kryer shpenzime nga viti 2019 e në vijim²⁰².

16.7. Nga hetimi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë²⁰³ nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me shitësit/ndërtuesit e këtij apartamenti.

¹⁹⁶ Vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 16.11.2015, në emër të shtetasit Th. L., harta treguese e regjistrimit; kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme – apartament banimi nr. ***, datë 10.11.2015, transferim nga llogaria në llogari, datë 10.11.2015, në BKT, kërkesë për transaksion në BKT.

¹⁹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 15.3.2023.

¹⁹⁸ Zona ***, çmim reference 85.000 lekë/sipërfaqe shfrytëzimi (69,3 m² x 85.000 lekë/m²).

¹⁹⁹ 42.000 euro x 138.43 lekë (kursi i këmbimit, referuar faqes zyrtare *online* të Bankës së Shqipërisë, datë 10.11.2015, 1 euro = 138,43 lekë).

²⁰⁰ Subjekti ka deklaruar si adresën: Lagjja “****”, rruga “****”, kompleksi “****”, hyrja ***, kati ***, ap. ***, Tiranë.

²⁰¹ Deklaruar në pyetësorin nr.1

²⁰² Deklaruar në pyetësorin standard

²⁰³ Shkresa nr. *** prot., datë 1.6.2023

16.8. *Lidhur me burimin e krijimit* – Komisioni vëren se pagesa e çmimit prej 42.000 euro është kryer nga llogaria bankare e bashkëshortit të subjektit pranë BKT-së. Siç është trajtuar në pikën 8 të këtij vendimi, referuar analizimit të kësaj llogarie bankare konstatohet se burim për këtë pagesë janë të ardhurat nga shitja e pasurisë nr. *** (kontratë nr. ***, datë 24.12.2014) dhe nga shitja e pasurive nr. *** dhe nr. *** (kontratë nr. ***, datë 6.3.2015).

16.9. Nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, rezulton se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e apartamentit në Tiranë, pasi si burim kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme nr. ***, *** dhe nr. ***, të fituara me kontrata shkëmbimi.

16.10. Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në lidhje me këtë pasuri dhe se nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

17. Depozitë në vlerën 2.800.000 lekë, në Intesa Sanpaolo Bank

Depozitë në vlerën 2.776.000 lekë, në Union Bank

17.1. *Në deklaratën Vetting 2017,* bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se zotëron: (i) depozitë në Intesa Sanpaolo Bank, në vlerën 2.800.000 lekë (në emër të vjehrrit A. Ç.). Pjesa takuese: 100%; (ii) depozitë në Union Bank, në vlerën 2.776.000 lekë (në emër të vjehrrit A. Ç.). Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat nga emigracioni në shtetin italian për periudhën 1992 – 1997, si dhe nga firmat piramidale. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues²⁰⁴.

17.2. *Nga hetimi i Komisionit konstatohet se:* Intesa Sanpaolo Bank²⁰⁵ ka konfirmuar se babai i subjektit/A. Ç. zotëron depozitë bankare në vlerën 2.800.000 lekë. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë rezulton se kjo depozitë është çelur në datën 14.2.2011, me një depozitim në shumën 2.788.000 lekë, me përshkrimin “Cash depozitë Th. Ç.²⁰⁶”.

17.3. Union Bank²⁰⁷ ka konfirmuar se babai i subjektit/A. Ç. zotëron depozitë bankare në vlerën 2.770.000 lekë, çelur në datën 17.2.2015. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë rezulton se kjo depozitë është çelur në datën 19.12.2011, me një depozitim në shumën 2.776.000 lekë, me përshkrimin “Depozitim në llogari A. Ç.”.

17.4. Kronologjia e krijimit të këtyre depozitave – Fillimisht Komisioni analizoi deklaratimet e subjektit ndër vite lidhur me këto depozita, si dhe lëvizjet e të gjitha llogarive bankare që prej vitit 2003 deri në momentin e krijimit të këtyre depozitave, nga ku rezultuan transaksionet vijuese:

17.5. Në datën 30.4.2003 është kryer një depozitim me vlerë 2.000.000 lekë në llogarinë dyemërore të babait dhe të bashkëshortit të subjektit pranë BKT-së, me përshkrimin “Cash

²⁰⁴ (i) Nxjerrje llogari bankare datë 25.1.2017, Intesa Sanpaolo Bank, në emër të shtetasit A. Ç., me gjendje në vlerën 2.800.000 lekë; (ii) nxjerrje e llogarisë bankare datë 25.1.2017, Union Bank, i autorizuar në depozitën në emër të shtetasit A. Ç., me gjendje në vlerën 2.770.000 lekë.

²⁰⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 23.2.2021.

²⁰⁶ Përshkrimi i evidentuar në lëvizjen e llogarisë duket të ketë një lapsus, pasi emri është i bashkëshortit, ndërsa mbiemri i babait.

²⁰⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 13.2.2021.

depozitë”. Më tej, në datën 2.5.2003 është krijuar një depozitë bankare me të njëjtën vlerë. Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti ka deklaruar depozitë bankare në emër të shtetasit Th. L., në BKT, me vlerë 2 milionë lekë, me burim krijimi kursimet nga emigracioni në vitet 1992 – 1997.

17.6. Në datën 18.5.2004 është kryer një depozitim me vlerë 1.100.000 lekë në llogarinë dyemërore të babait dhe të bashkëshortit të subjektit pranë BKT-së, me përshkrimin “Cash depozitë”. Më tej, në datën 19.5.2004 është krijuar një depozitë bankare me të njëjtën vlerë. Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar depozitë bankare në emër të shtetasit Th. L., data e krijimit 18.4.2004.

17.7. Në datën 29.5.2009 është maturuar depozita bankare e krijuar në vitin 2004, në vlerën 1.419.275 lekë (përfshirë interesat). Në datën 1.6.2009 është maturuar depozita bankare e krijuar në vitin 2003, në vlerën 2.814.608 lekë (përfshirë interesat).

17.8. Në datën 1.6.2009, pasi kryhen dy tërheqje në shumën totale 30.000 lekë²⁰⁸, shuma e mbetur nga depozitat e maturuara, konkretisht vlera 4.203.883 lekë²⁰⁹, transferohet në llogarinë rrjedhëse dyemërore (në emër të babait dhe të bashkëshortit të subjektit).

17.9. Në datat 9.6.2009, 22.6.2009 dhe 25.6.2009, bashkëshorti i subjektit kryen këto tri transaksione: (i) transfertë në shumën 397.200 lekë shtetasit L. N. për kambizëm; (ii) tërheqje në shumën 1.000.000 lekë; (iii) transfertë në shumën 2.715.300 lekë, për shoqërinë “****” sh.p.k., me përshkrimin “Blerje 21.000 euro me kurs 129,3”.

Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar: “Depozitë bankare në BKT, hapur në datën 30.4.2003 dhe mbyllur. Tërhequr principali dhe interesat cash të bashkëshortit. Të disponueshme cash, vlera 4.200.000 lekë”. Komisioni vëren se shuma totale e tre debitimeve të mësipërme (4.112.500 lekë) është pothuajse e barabartë me shumën e deklaruar cash nga subjekti (4.200.000 lekë).

17.10. Në datën 15.12.2010 kryhen dy depozitime në llogaritë dyemërore në emër të babait dhe të bashkëshortit të subjektit, konkretisht depozitim në vlerën 20.000 euro pranë Union Bank, me përshkrimin “Depozitim në llogari A. Ç.” dhe depozitim në vlerën 20.000 euro pranë OTP Bank, me përshkrimin “Depozituar nga: A. Ç. ose Th. L./A.Ç.”.

Lidhur me këto depozitime, në DIPP-në e vitit 2010, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: (i) depozitë në Bankën Popullore, çelur si llogari rrjedhëse më 15.12.2010, në pronësi me vjehrrin, nga vlera cash e derdhur më parë plus kontribut nga dividendi i vitit 2010, vlera 20.000 euro, pjesa takuese 50%; (ii) depozitë në Union Bank, datë 15.12.2010, në pronësi me vjehrrin, nga vlera cash e derdhur më parë plus kontribut nga dividendi i vitit 2010, vlera 20.000 euro, pjesa takuese 50%.

Për sa i përket depozitës pranë Union Bank, konstatohet se në datën 17.12.2010 bashkëshorti i subjektit ka tërhequr shumën 20.000 euro (të depozituar dy ditë më parë) dhe në të njëjtën datë ka

²⁰⁸ Datë 29.5.2009, vlera 10.000 lekë dhe datë 1.6.2009, vlera 20.000 lekë (tërhequr nga bashkëshorti i subjektit).

²⁰⁹ Shumat 1.389.275 lekë dhe 2.814.608 lekë.

depozituar shumën 2.776.000 lekë, me përshkrimin “Depozitim *cash* Th. L. këmbim me kurs preferencial”²¹⁰. Në të njëjtën datë fondet kanë kaluar në depozitë me afat.

17.11. Në datën 19.12.2011, bashkëshorti i subjektit ka tërhequr shumën 2.790.418 lekë²¹¹ (shuma e maturuar në datën 17.12.2011 nga depozita e krijuar në datën 17.12.2010) dhe po në këtë datë ka kryer një depozitim në vlerën 2.776.000 lekë në një llogari tjetër pranë Union Bank, në emër të babait të subjektit. Pikërisht ky depozitim është origjina e depozitës prej 2.770.000 lekësh, e ndodhur në një llogari në emër të babait të subjektit, e deklaruar në deklaratën *Vetting* nga bashkëshorti i s subjektit²¹².

17.12. Gjatë vitit 2011, për sa i përket depozitës pranë Intesa Sanpaolo Bank, bashkëshorti i subjektit e ka tërhequr shumën 20.000 euro të depozituar në vitin 2010 në OTP Bank dhe ka depozituar shumën 2.778.400 lekë në një llogari dyemërore në monedhën lekë pranë OTP Bank²¹³.

17.13. Në datën 14.2.2011, bashkëshorti i subjektit e ka tërhequr të gjithë shumën që kishte depozituar në llogarinë në lekë pranë OTP Bank, pra 2.788.400 lekë, dhe po në të njëjtën datë është kryer një depozitim në vlerën 2.788.000 lekë në llogarinë e babait të subjektit pranë Intesa Sanpaolo Bank. Pikërisht ky depozitim është origjina e depozitës prej 2.800.000 lekësh, e ndodhur në një llogari në emër të babait të subjektit, e deklaruar në deklaratën *Vetting* nga bashkëshorti i subjektit.

17.14. Burimi financiar i krijimit këtyre depozitave – Referuar transaksioneve sa më lart, Komisioni analizoi burimin e krijimit për këto shuma: (a) depozitim në vlerën 2.000.000 lekë në datën 30.4.2003; (b) depozitim në vlerën 1.100.000 lekë në datën 18.5.2004; (c) të ardhurat e bashkëshortit nga dividendi gjatë periudhës 1.1.2010 – 15.12.2010²¹⁴, në vlerën 1.352.000 lekë, e përlllogaritur si diferencë midis vlerës 5.552.000 lekë (40.000 euro të depozituara në datën 15.12.2010)²¹⁵ me vlerën 4.200.000 lekë²¹⁶.

17.15. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti deklaroi se depozitimet e shumave monetare në vitet 2003 dhe 2004 kanë si burim: të ardhurat nga emigracioni, firmat rentiere, të ardhurat nga personi fizik, si dhe të ardhurat nga paga dhe se depozitat janë maturuar dhe riinvestuar deri në vitin 2009, moment që bashkëshorti ka tërhequr shumat monetare për shkak të frikës së krizës financiare në vitet 2008 – 2011.

a) Depozitim në vlerën 2.000.000 lekë, në datën 30.4.2003

²¹⁰ Në llogarinë nr. ***.

²¹¹ Pas maturimit të depozitës së krijuar në datën 17.12.2010.

²¹² Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar vlerën 2.776.000 lekë, pra 6.000 lekë më shumë.

²¹³ Konkretisht ka kryer këto transaksione: në datën 25.1.2011 ka tërhequr 13.000 euro dhe ka depozituar 1.807.000 lekë; në datën 8.2.2011 ka tërhequr 6.000 euro dhe ka depozituar 590.700 lekë; në datën 9.2.2011 ka tërhequr 1.000 euro dhe ka depozituar 390.700 lekë.

²¹⁴ Në datën 15.12.2010 kryhen dy depozitime në llogaritë dyemërore në emër të babait dhe të bashkëshortit të subjektit, konkretisht depozitim në vlerën 20.000 euro pranë Union Bank, me përshkrimin “Depozitim në llogari A.Ç.” dhe depozitim në vlerën 20.000 euro pranë OTP Bank, me përshkrimin “Depozituar nga A. Ç. ose Th. L./A. Ç.”.

²¹⁵ Depozitimi prej 20.000 euro në Union Bank është tërhequr dy ditë më vonë dhe është depozituar shuma 2.776.000 lekë. Edhe depozita prej 20.000 euro në OTP Bank u vlerësua me të njëjtën vlerë kundërvlerë në lekë.

²¹⁶ Gjendja e deklaruar *cash* në DIPP/2009, me burim fillestar dy depozitimet prej 2.000.000 lekësh dhe 1.100.000 lekësh.

17.16. Në kushtet që një nga burimet e deklaruara nga subjekti ishin të ardhurat nga emigracioni në shtetin italian për periudhën 1992 – 1997 dhe të ardhurat nga firmat piramidale, me anë të pyetësorit nr. 1, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues.

17.17. Në përgjigje²¹⁷, subjekti deklaroi se ky depozitim ka pasur si burim të ardhurat nga emigracioni i bashkëshortit në vitit 1992 – 1997, si dhe të ardhurat nga firmat piramidale. Konkretisht, të ardhurat e bashkëshortit nga puna në emigracion në periudhën 1992 – 1997 kanë qenë rreth 1.850.000 lekë dhe rreth 150.000 lekë janë përfituar nga interesat e shumave të depozituara në shoqëritë rentiere.

17.18. *Lidhur me të ardhurat e përfituara në emigracion (1.850.000 lekë)*, subjekti shpjegoi se bashkëshorti ka qenë emigrant ekonomik në Itali gjatë periudhës 1992 – 1997 dhe deri në fund të vitit 1995 nuk ka pasur dokumente të rregullta. Për të vërtetuar marrëdhënien e punësimit kanë marrë deklaratë nga administratori i shoqërisë ku bashkëshorti ka punuar në vitet 1992 – 1995, në funksionin e magazinierit. Subjekti paraqiti deklaratën e administratorit të vetëm të shoqërisë “****” s.r.l., V. G., i cili deklaroi se bashkëshorti ka punuar në funksionin e magazinierit në periudhën shkurt 1992 - nëntor 1995, me një pagë mujore 800.000 lireta.

Pas kësaj periudhe, vijoi subjekti, bashkëshorti është vendosur në qytetin e *** dhe është pajisur me dokumente të rregullta qëndrimi. Në periudhën 1.1.1996 – 30.7.1996 ka qenë i punësuar në shoqërinë “****” s.r.l., duke përfituar të ardhura neto nga paga në shumën 5.464,63 euro. Në gusht të vitit 1996 është kthyer në Shqipëri dhe në dhjetor 1996 kanë lidhur martesë ligjore. Gjatë vitit 1997 ka qenë në Itali për një periudhë të shkurtër kohë, me sa kujtojnë, ka qenë rreth 3-4 muaj, gjatë periudhës së verës dhe vjeshtës të vitit 1997.

Pasi është kthyer, shpjegoi subjekti, ka filluar punë në shoqërinë “****” sh.p.k., duke paraqitur edhe konfirmimin nga DRSSH Vlorë për pagën bruto duke filluar nga viti 1998. Në vërtetim është bërë sqarimi se për periudhën prill 1999 – janar 2001 dhe për vitin 1997 nuk figuron emri. Bashkëshorti gjatë kësaj periudhe ka qenë në marrëdhënie pune në shoqërinë “****” sh.p.k., përveç periudhës 1.7.2000 – 18.10.2000, ku rezulton se ka qenë i punësuar në Itali në shoqërinë “****” s.r.l., duke përfituar të ardhura nga paga në shumën 4.658,44 euro.

Subjekti paraqiti dokumentin e lëshuar nga INPS në datën 4.7.2023 për të ardhurat nga paga të realizuara gjatë viteve 1996 dhe 2000. Më tej, theksoi se pothuajse të gjitha të ardhurat nga emigracioni janë krijuar përpara lidhjes së martesës ligjore (depozitimi i shumës 2.000.000 lekë është kryer në datën 30.4.2003, disa muaj para se të emërohej në funksionin e gjyqtares).

17.19. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni vëren se provohet qëndrimi i bashkëshortit në shtetin italian në vitet 1995, 1996 dhe 2000, referuar kjo kartës së lëshuar nga Ministria e Financave të Republikës Italiane²¹⁸ (për vitin 1995) dhe ekstraktit të llogarisë së sigurimeve shoqërore (për vitet 1996 dhe 2000).

17.20. Për sa i përket të ardhurave të përfituara, konstatohet se: (i) referuar deklaratës së shtetasit V. G., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” s.r.l., bashkëshorti i subjektit ka përfituar

²¹⁷ Përgjigje datë 12.7.2023.

²¹⁸ Dokumenti “tesserino” ku pasqyrohen të dhënat personale të bashkëshortit të subjektit dhe kodi i tij fiskal.

një pagë mujore prej 800.000 lireta italiane gjatë periudhës shkurt 1992 – nëntor 1995, çka do të thotë që ka realizuar një shumë totale prej 36.800.000 lireta, ekuivalenti në lekë 2.107.536 lekë²¹⁹; (ii) referuar ekstraktit të llogarisë së sigurimeve shoqërore, bashkëshorti i subjektit ka përfituar një shumë totale prej 10.123 euro gjatë periudhave 1.1.1996 – 30.7.1996 dhe 1.7.2000 – 18.10.2000, ekuivalenti në lekë 1.342.117 lekë²²⁰. Në total, të ardhurat e pretenduara të realizuara jashtë vendit kanë qenë rreth 3.449.653 lekë.

17.21. Sa më sipër, Komisioni vëren se të ardhurat e përfituara nga emigracioni, të provuara me dokumentacion ligjor justifikues, janë në shumën 10.123 euro, periudhë gjatë së cilës provohet edhe qëndrimi i bashkëshortit të subjektit në shtetin italian në vitet 1996 dhe 2000. Ndërkohë që deklarata e administratorit të shoqërisë “****” s.r.l. për të ardhurat e përfituara në periudhën 1992 – 1995, mbetet në nivel deklarativ, pa u provuar me dokumentacion ligjor justifikues nga instancat përkatëse në shtetin italian. Ndërsa shpenzimet e jetesës për periudhën 1.1.1996 – 31.7.1996 dhe 1.7.2000 – 18.10.2008, periudhë për të cilën janë konsideruar të ardhurat, përllogariten në vlerën 4.368 euro²²¹.

17.22. *Lidhur me të ardhurat nga interesat në firmat rentiere (150.000 lekë)*, subjekti paraqiti një përgjigje nga Shoqëritë Huamarrëse në Administrim, ku bëhet me dije se bashkëshorti Th. L. ka pasur të depozituar në shoqërinë “****” kapitalin në shumën 437.430 lekë, ka tërhequr shumën 34.995 lekë dhe ka pasur detyrim për të marrë shumën 402.435 lekë. Subjekti deklaroi se bashkëshorti figuron si kreditor për këtë shumë që mbeti ende e pashlyer, ndërkohë nuk gjenden të gjitha depozitimet e mëparshme që janë tërhequr. Gjatë kësaj periudhe, bashkëshorti, një pjesë të interesave që përfitonte, i depozitonte në këto shoqëri, për këtë arsye shuma neto e përfituar prej tij nga shoqëritë rentiere ka qenë në shumën rreth 150.000 lekë.

17.23. Sa më lart, mundësia për kursim nga të ardhurat e përfituara në emigracion nga bashkëshorti i subjektit duket të ketë qenë në vlerën totale 762.998 lekë²²² (ekuivalenti i 5.755 euro²²³) e, për rrjedhojë, ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën 1.237.002 lekë për depozitim e kryer në datën 30.4.2003, në shumën 2.000.000 lekë.

b) Depozitim në vlerën 1.100.000 lekë, në datën 18.5.2004

17.24. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1²²⁴, subjekti deklaroi se burimi i krijimit për këtë depozitim është tërheqja dhe mbyllja e aktivitetit të bashkëshortit si person fizik. Më tej, shpjegoi se bashkëshorti është regjistruar si person fizik me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në datën 30.10.2001 dhe paraqiti 2 fletë njoftim-tatimi për vitet 2001 dhe 2002, respektivisht me data

²¹⁹ Vlerësuar me kursin mesatar të këmbimit (për 1.000 ITL) për vitet 1994 – 1995 (për vitet 1992 – 1993 nuk rezultojnë të dhëna në faqen zyrtare online të BSH-së.

https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/

²²⁰ Vlerësuar me kursin mesatar të viteve 1999 – 2000, 1 euro = 132,58 lekë.

²²¹ Përllogaritur si total: (i) vlera 2.574 euro për periudhën 1.1.1996 – 31.7.1996 (7 muaj x 4.412 euro/12 muaj); (ii) vlera 1.794 euro për periudhën 1.1.1996 – 31.7.1996 (3.6 muaj x 5.981 euro/12 muaj)

https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI01_custom_6908726/default/table?lang=en

²²² Vlerësuar me kursin mesatar të viteve 1999 – 2000, 1 euro = 132,58 lekë.

²²³ Diferenca e të ardhurave të provuara me dokumentacion ligjor (10.123 euro) me shpenzimet e jetesës (4.368 euro).

²²⁴ Përgjigje datë 12.7.2023.

1.11.2001 dhe 29.3.2002²²⁵. Aktiviteti i personit fizik ka vazhduar edhe gjatë vitit 2003, periudhë në të cilën bashkëshorti ka krijuar shoqërinë “***” sh.p.k., duke shtuar aktivitetin dhe krijuar bashkëpunim me furnitorët e huaj për importimin e artikujve të kancelarisë.

17.25. Konkretisht, lidhur me shumën 1.100.000 lekë, subjekti deklaroi: *“Aktiviteti i personit fizik vazhdoi deri në fund të vitit 2003, ku mblodhi të gjitha arkëtimet nga klientët që mbetën pa likuiduar dhe u shit i gjithë malli gjendje në emër të personit fizik. Fitimi i realizuar në vite, si dhe mbledhja e të gjitha arkëtimeve nga klientët është tërhequr nga personi fizik, duke mbyllur plotësisht aktivitetin në këtë shoqëri. Me mbylljen e vitit ushtrimor 2003, fitimet e tërhequra në fillim të vitit 2004 së bashku me kursimet deri në maj 2004 kanë krijuar shumën 1.100.000 lekë”.*

17.26. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti si person fizik – Komisioni vëren se në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim kursimet nga emigracioni në vitet 1992 – 1997, ndërsa në pyetësin nr. 1 ka deklaruar se për depozitimin 1.100.000 lekë në vitin 2004, kanë shërbyer si burim të ardhurat nga aktiviteti si person fizik. Konstatohet se deklaratimet e subjektit në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 (830.000 lekë të ardhura nga aktiviteti i bashkëshortit “Kancelari”) dhe në DIPP-në e vitit 2004 (3.000.000 lekë të ardhura nga paga e bashkëshortit) nuk përputhen me shumën e të ardhurave nga paga sipas dokumentacionit të administruar dhe as me deklarin e subjektit në pyetësin nr. 1 për të ardhurat nga aktiviteti i personit fizik.

17.27. Në dokumentacionin e administruar nga QKB-ja²²⁶ është administruar vendimi për regjistrim si person fizik nr. ***, datë 30.10.2001, sipas kërkesës së shtetasit Th. L. për hapjen e aktivitetit me objekt “Tregtim i mallrave të ndryshëm në fushën e kancelarisë e pajisjeve të zyrës”.

17.28. Referuar informacionit të përcjellë nga DRT Vlorë²²⁷, personi fizik Th. L., me kod fiskal *** e vendim gjykate nr. ***, datë 30.10.2001, ka paguar TBV në vlerën totale 40.000 lekë²²⁸ dhe taksë solidariteti në vlerën 2.000 lekë²²⁹.

17.29. Gjithashtu, bashkëlidhur procesverbaleve të përcjella nga ILDKPKI-ja²³⁰, u administruan: (i) vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për regjistrimin e personit fizik nr. ***, datë 30.10.2001; (ii) certifikatë regjistrimi në organin tatimor si biznes i vogël, me kod fiskal ***, në emër të shtetasit Th. L., me datë regjistrimi 1.11.2001; (iii) fletë njoftim-tatimi datë 29.3.2002, regjistrim i ri, tatim gjithsej 25.000 lekë, nga të cilat 20.000 lekë për xhiro deri në 2 milionë lekë dhe 5.000 lekë për xhiro 2-5 milionë lekë²³¹; (iv) fletë njoftim-tatimi datë 29.3.2002, reregjistrim, tatim gjithsej 40.000 lekë për xhiro deri në 2 milionë lekë²³².

²²⁵ Për vitin 2001 është lëshuar “Fletë Njoftim Tatimi” në datën 1.11.2001 tatim gjithsej 15.000 lekë dhe për vitin 2002 është lëshuar nga Dega e Tatim - Taksave Vlorë dokumenti “Fletë Njoftim Tatimi” në datën 29.3.2002 për aktivitetin e bashkëshortit si person fizik me nivel xhiro deri në 2 milionë lekë, tatimi i paguar është në shumën 40.000 lekë, tatim përkatësisht në shumën 25.000 lekë në datën 29.3.2002 dhe 15.000 lekë në datën 8.8.2002.

²²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 11.2.2021.

²²⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2020, paraqitur nga subjekti në pyetësin standard.

²²⁸ Datë 29.3.2002, vlerë 25.000 lekë, vlerë 8.8.2002, vlerë 15.000 lekë.

²²⁹ Datë 29.3.2002, vlerë 2.000 lekë.

²³⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 3.3.2023.

²³¹ Dorëzuar sërish nga subjekti në pyetësin nr. 1.

²³² Dorëzuar sërish nga subjekti në pyetësin nr. 1.

17.30. Sa më lart, Komisioni vëren se aktiviteti si person fizik është zhvilluar gjatë periudhës 2001 – 2002²³³, ndërsa më 28.1.2003 është themeluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “***”.

17.31. Sa më lart, Komisioni konstaton se deri në këtë fazë të hetimit provohet zhvillimi i aktivitetit si person fizik në vitet 2001 dhe 2002 dhe nuk provohet zhvillimi i këtij aktiviteti në vitin 2004 sikundër deklaroi subjekti në pyetësin nr. 1.

17.32. Për këtë arsye, si dhe duke konsideruar edhe që këto të ardhura nuk janë deklaruar si burim në deklaratën *Vetting*, Komisioni nuk paraqiti të ardhura nga aktiviteti si person fizik në vitin 2004.

17.33. Në konkluzion, Komisioni nuk përllogariti të ardhura për vitet 2001 dhe 2002 (për të cilat rezultojnë të paguara detyrimet tatimore), pasi subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* fitimin e realizuar nga ky aktivitet për këtë periudhë.

c) Të ardhurat nga dividendi (bashkëshorti), periudha 1.1.2010 – 15.12.2010, në vlerën 1.352.000 lekë

17.34. Nga analizimi i të ardhurave të përfituara nga dividendi rezultoi se dividendi i përfitur në vitin 2010 ka qenë në shumën 540.000 lekë (trajtuar në pikën 18 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht), ndërkohë që diferenca e depozitimeve me gjendjen *cash* të pakësuar rezultoi 1.352.000 lekë.

17.35. Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2010, për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit, personat e lidhur dhe prindërit e subjektit. Në kushtet që depozitimi i shumës 40.000 euro²³⁴ është kryer në datën 15.12.2010, analiza u krye për të gjithë vitin 2010, nga ku rezultoi një balancë negative prej 1.029.846 lekësh.

17.36. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: *Subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e depozitave në Intesa Sanpaolo Bank dhe në Union Bank, si në vijim: (i) Bashkëshorti i subjektit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 1.237.002 lekë për kryerjen e depozitimit prej 2.000.000 lekësh në datën 30.4.2003, pasi nuk provohet shuma e pretenduar e të ardhurave nga emigracioni; (ii) Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën 1.100.000 lekë për kryerjen e depozitimit prej 1.100.000 lekësh në datën 18.5.2004, pasi mungon dokumentacioni ligjor justifikues për të provuar zhvillimin e aktivitetit të bashkëshortit si person fizik gjatë viteve 2003 – 2004 e, për rrjedhojë, nuk provohen as të ardhurat e realizuara; (iii) Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për shtimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2010, në vlerën 1.029.846 lekë.*

²³³ Në pritje të përgjigjes nga Bashkia Vlorë.

²³⁴ Në datën 15.12.2010 kryhen dy depozitime në llogaritë dyemërore në emër të babait dhe të bashkëshortit të subjektit, konkretisht depozitim në vlerën 20.000 euro pranë Union Bank, me përshkrimin “Depozitim ne llogari A. Ç.” dhe depozitim në vlerën 20.000 euro pranë OTP Bank, me përshkrimin “Depozituar nga A. Ç. ose Th. L./A. Ç.”.

17.37. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se:

17.38. *Së pari, për sa i përket mungesës së burimeve të ligjshme për depozitim në shumën 2.000.000 lekë, në datën 30.4.2003*, me burim të ardhurat e përfituara në emigracion, shpjegoi se bashkëshorti i saj deri në fund të vitit 1995 nuk ka mundur të ketë leje qëndrimi dhe puna e tij ka qenë informale. Më tej, subjekti sqaroi se dokumentacioni që bashkëshorti disponon nga qëndrimi i tij në Itali është deklarata e shtetasit V. G., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” s.r.l., i cili konfirmon se ka përfituar një pagë mujore prej 800.000 lireta italiane gjatë periudhës shkurt 1992 – nëntor 1995. Bashkëshorti, si çdo emigrant ekonomik të atyre viteve, ka pasur për qëllim sigurimin e një marrëdhënieje të qëndrueshme pune dhe nuk i ka dhënë rëndësi nëse të ardhurat e siguruar nga puna tatoheshin ose jo, vijoi subjekti.

17.39. Subjekti theksoi se Komisioni duhet të mbajë parasysh në vlerësimin e tij se të ardhurat nga emigracioni në periudhën 1992 – 1997 janë krijuar në pjesën më të madhe të tyre para lidhjes në martesë dhe ato janë depozituar në bankë përpara se subjekti të bëhej gjyqtare²³⁵.

17.40. *Së dyti, për sa i përket mungesës së burimeve të ligjshme për depozitim në shumën 1.100.000 lekë, në datën 18.5.2004*, me burim të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit si person fizik, deklaroi se bashkëshorti i saj ka arritur të gjejë në arkivin e dokumenteve tabelën e llogaritjes për taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2003, dokument i cili ishte ngatërruar në dosjen e shoqërisë “****” sh.p.k. dhe ndodhej së bashku me dokumentet e shoqërisë tjetër. Në këtë dosje janë gjetur edhe disa dokumente të tjera që tregojnë tej çdo dyshimi të arsyeshëm vazhdimin e aktivitetit edhe pas regjistrimit të shoqërisë “****” sh.p.k. Referuar formularit të vitit 2003 rezulton se qarkullimi i deklaruar për këtë vit është në shumën 3.000.000 lekë, nëse llogaritet marzhi i fitimit që ka pasur dyqani i kancelarisë, 50% e qarkullimit, duke zbritur detyrimet e paguara, do të rezultojë në një fitim neto 1.360.000 lekë, vijoi subjekti.

17.41. Subjekti shpjegoi se fitimi i vitit 2003 është tërhequr nga personi fizik në momentin kur janë mbyllur të gjitha të drejtat dhe detyrimet e personit fizik dhe menjëherë pasi bashkëshorti e ka mbyllur ka tërhequr fitimin dhe ka depozituar në datën 18.5.2004 shumën 1.100.000 lekë, me përshkrimin “Cash deposit”. Në deklaratën *Vetting*, fitimi i personi fizik nuk është deklaruar, pasi nuk kanë pasur dijeni për mënyrën e llogaritjes së fitimit dhe pasqyrimin të këtij fitimi në deklaratë, por realizimi i këtyre të ardhurave është i provuar në përputhje të plotë me parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, prandaj këto të ardhura nuk mund të mohohen vetëm për shkak të pasaktësisë (harresës së mosdeklarimit të tyre), përfundoi subjekti.

17.42. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti deklaratën noteriale të shtetasit V. Xh.²³⁶, në cilësinë e kontabilistit të bashkëshortit të subjektit në kohën kur ka ushtruar aktivitet privat me personin fizik, i cili deklaroi se një nga subjektet, të cilit i ka mbajtur dokumentacion financiar nga momenti i hapjes dhe në vazhdim, është personi fizik “Th. L.”. Aktiviteti me kod fiskal *** ka qenë

²³⁵ Subjekti deklaroi: “Ashtu si në çështjen S., kemi të bëjmë me të ardhura të fituara ekskluzivisht nga bashkëshorti në emigracion në periudhën 1992 – 1997 (shihni Sevdari, §88), në një periudhë përpara se unë të isha gjyqtare dhe përpara se të isha e martuar (shihni Sevdari, §90). Në këtë rast, GJEDNJ-ja ka konsideruar se një kujdes i veçantë duhet treguar sa i përket parimit të proporcionalitetit (ibid, §88)”.

²³⁶ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 4.10.2023.

kryesisht kancelari, aktivitet të cilin e ka ushtruar deri në 6-mujorin e parë të vitit 2004, si person fizik, pasi aktiviteti vazhdoi të ushtrohej vetëm nëpërmjet personit juridik, thuhet në deklaratën noteriale, për shkak të periudhës së largët që është mbyllur aktiviteti i personit fizik dhe tejkalimit të afatit bazë të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i cili e detyron të mbajë dokumentet e subjektit në arkivën e tij personale si kontabilist, nuk disponon dokument ligjor apo kontabël në lidhje me personin fizik “Th. L.”, përfundoi shtetasi V. Xh..

17.43. *Së treti, për sa i përket mungesës së burimeve të ligjshme financiare për shtimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2010, në vlerën 1.029.846 lekë, subjekti kërkoi se në analizën financiare për vitin 2010 të përfshihen edhe kursimet cash të disponuara nga prindërit e saj në shumën 1.200.000 lekë.*

17.44. Fillimisht, subjekti sqaroi se përveç kursimeve cash në shumën 4.200.000 lekë, për shtesat e depozitave dhe llogarive në vitin 2010 ka shërbyer shpërndarja e dividendit në shumën 540.000 lekë dhe se shpërndarja e dividendit u destinua edhe për shtesat në llogarinë e OTP Bank (nr. ***, gjendje në datën 31.12.2010 në shumën 339.394 lekë), ndërsa depozita e babait në BKT, në shumën 300.000 lekë, ka si burim kursimet nga të ardhurat që dispononte nëna nga shitja e tokës dhe kursimeve të saj, që gjithsej ka pasur 1.200.000 lekë gjendje, shpjegoi subjekti.

17.45. *Më tej, subjekti shpjegoi: “Nëna E. Ç. ka ndërruar jetë në datën 21.2.2010 dhe me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. ***, datë 24.3.2010, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësen E. Ç., duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë A. Ç., i cili trashëgon ½ pjesë të pasurisë trashëgimore dhe Herila Çela, e cila trashëgon ½ pjesë të pasurisë trashëgimore të saj. Për pasuritë e paluajtshme ndryshoi përqindja e pjesës takuese si rrjedhojë e çeljes së dëshmisë së trashëgimisë, por përveç pasurive të paluajtshme nëna kishte të ruajtura cash shumën 1.200.000, që ne ia kishim kthyer në vitin 2006. Babai, duke jetuar së bashku me mua, në momentin që ne kemi depozituar dhe kemi krijuar depozitat ka përfshirë në këto shuma edhe vlerën 1.200.000 lekë. Dy depozitat e krijuara nga 20.000 euro/secila, përfshijnë edhe kursimet e babait që mbetën pas vdekjes së nënës. Këto janë kursime të prindërve të mi, që u depozituan së bashku me lekët që dispononte bashkëshorti e, për këtë arsye, bashkëshorti vendosi emrin e babait dhe ka lënë atë administrues të këtyre dy depozitave, por, pavarësisht këtij fakti, në DPV-në vjetore dhe në deklaratën Vetting ka deklaruar se kjo depozitë nuk është vetëm e babait tim. Edhe është fakt se depozitat e mëparshme, të cilat janë tërhequr dhe më kanë shërbyer për këtë arkëtim kanë qenë edhe në emër të bashkëshortit. Babai im nuk ka qenë subjekt deklarues në vitin 2010 (prandaj nuk janë deklaruar edhe kursimet e tyre), bashkëshorti ka deklaruar burimet e krijimit për mjete monetare të kontribuuar nga bashkëshorti, sikurse kanë qenë kursimet cash në shumën 4.200.000 lekë dhe të ardhurat nga dividendi për këtë vit. Ndërkohë babai, në cilësinë e mbajtësit të depozitave, ka kontribuuar me kursimet cash që dispononte nëna, pasi bashkëshorti tërhoqi dy depozitat në Raiffeisen Bank sh.a.”.*

17.46. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. ***, datë 16.10.2023, ku babai i subjektit deklaroi se pas ndarjes nga jeta të bashkëshortes E. Ç. të gjitha kursimet që ata dispononin cash janë depozituar së bashku me kursimet e vajzës Herila Çela dhe bashkëshortit të

saj Th. L. dhe se ai jetonte me vajzën dhe ekonominë e familjes e kishte lënë në administrim të tyre.

17.47. Në konkluzion, subjekti pretendoi se në analizën financiare për vitin 2010 duhet të përfshihen edhe kursimet *cash* të disponuara nga prindërit, duke rezultuar me balancë pozitive në shumën 170.154 lekë për të krijuar depozitat në vitin 2010.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

17.48. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

17.49. *Së pari, për të mbajtur një qëndrim lidhur me burimet e përdorura për depozitimin e shumës 2.000.000 lekë, në datën 30.4.2003, Komisioni analizoi disa rrethana, si më poshtë vijon:*

- i) provohet qëndrimi i shtetasit Th. L. në shtetin italian përpara lidhjes së martesës me subjektin²³⁷, konkretisht për vitin 1995 (referuar kartës së lëshuar nga Ministria e Financave të Republikës Italiane²³⁸) dhe gjatë periudhës 1.1.1996 – 31.7.1996 (referuar ekstraktit të llogarisë së sigurimeve shoqërore);
- ii) subjekti ka paraqitur një deklaratë të shtetasit V. G., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “***” s.r.l., i cili konfirmon se shtetasi Th. L. ka përfituar një pagë mujore prej 800.000 lireta italiane gjatë periudhës shkurt 1992 – nëntor 1995;
- iii) deklarimi i subjektit në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 dhe në deklaratën *Vetting* lidhur me të ardhurat që kanë shërbyer si burim (të ardhurat nga emigracioni);
- iv) depozitimi në llogari është kryer në datën 30.4.2003, përpara emërimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit²³⁹.

17.50. Sa më lart analizuar, Komisioni krijon bindjen se të ardhurat e përdorura për depozitimin e datës 30.4.2003 janë përfituar nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit gjatë punësimit të tij në shtetin italian, në pjesën e tyre më të madhe në një kohë që nuk e kishte statusin e personit të lidhur e, për më tepër, ato janë përdorur si burim për financimin e një pasurie që provohet se është krijuar përpara emërimit në detyrë të subjektit, duke përjashtuar dyshimet se deklarimi i tyre mund të ketë lidhje me qëllimin për mbulime me burime të ligjshme të pasurive të krijuara më pas, gjatë kohës kur subjekti ushtronte detyrën si gjyqtare.

17.51. Për pasojë, Komisioni vlerëson se subjekti shpjegoi bindshëm burimin e këtyre të ardhurave, pra se ato vijnë nga emigracioni dhe subjekti nuk ka ushtruar funksionin e gjyqtares në kohën e krijimit të këtyre të ardhurave.

²³⁷ Drejtoria e Hartimit të Procedurave dhe Dokumenteve Biometrike, shkresë nr. *** prot., datë 1.3.2023, informon se subjekti ka lidhur martesë ligjore me shtetasin Th. L. në datën 1.12.1996.

²³⁸ Dokumenti “*tesserino*”, ku pasqyrohen të dhënat personale të bashkëshortit të subjektit dhe kodi i tij fiskal.

²³⁹ Me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. ***, datë 21.10.2003, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

17.52. *Së dyti*, për sa i përket pretendimeve të subjektit lidhur me burimet e përdorura për depozitimin në shumën 1.100.000 lekë, në datën 18.5.2004, dhe për depozitimin e shumës 40.000 euro në datën 15.12.2010 (origjina e dy depozitave të deklaruara në deklaratën *Vetting*), Komisioni konstaton se burimet e deklaruara nga subjekti – të ardhurat nga aktiviteti si person fizik dhe kursimet e prindërve – nuk janë deklaruar në deklaratat vjetore dhe në deklaratën *Vetting*.

17.53. Në këto kushte, Komisioni çmon të përmendë qëndrimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit²⁴⁰, si në vijim: “[...] objekt i punës së organeve të rivlerësimit është kontrolli i vërtetësisë së deklarimeve të subjekteve të rivlerësimit të kryera në deklaratën *Vetting* dhe verifikimi i burimeve që kanë shërbyer për krijimin e pasurive. Procesi hetimor administrativ apo ai gjyqësor i zhvilluar prej organeve të rivlerësimit nuk mund të jetë një proces që fton/lejon subjektet të bëjnë deklarime të reja, më të volitshme për vlerësimin e pasurisë së tyre. Ata janë të ftuar të japin shpjegime e të paraqesin prova që mbështesin deklaratimet e tyre dhe jo të modifikojnë deklaratimet në përputhje me problematikat e prezantuara. Verifikimi i deklarimeve është një proces post factum dhe, si i tillë, nuk mund të ndërtohet mbi deklaratime të bëra rishtas, aq më tepër kur ato kundërshtojnë deklaratimet e bëra nën përgjegjësi të deklarata *Vetting* [...]”.

17.54. Në vijim, lidhur me burimin e depozitimit të shumës 1.100.000 lekë, Komisioni e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit se për këtë depozitim kanë shërbyer fitimi i realizuar në vite nga personi fizik, pas mbledhjes së të gjitha arkëtive nga klientët dhe duke mbyllur plotësisht aktivitetin në këtë shoqëri.

17.55. Përveç faktit të mosdeklarimit të të ardhurave dhe përdorimit të tyre si burim (në deklaratat periodike apo në deklaratën *Vetting*), Komisioni vëren se subjekti, në shpjegimet e saj, në mënyrë të volitshme nuk ka deklaruar tërheqje fitimi në vitin 2003 nga ky aktivitet, por vetëm në vitin 2004, vit në të cilin është kryer depozitimi i shumës 1.100.000 lekë, ndërkohë që nga organet tatimore nuk u konfirmua zhvillimi i aktivitetit për periudhën 2003 – 2004 dhe në datën 28.1.2003 u themelua shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “***” sh.p.k.

17.56. Për pasojë, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1.100.000 lekë për kryerjen e depozitimit në datën 18.5.2004.

17.57. *Lidhur me pretendimin e subjektit se në analizën financiare për vitin 2010 duhet të përfshihen edhe kursimet cash të disponuara nga prindërit, në shumën 1.200.000 lekë*, si burim për depozitimin prej 40.000 euro, të kryer në datën 15.12.2010, Komisioni vlerëson se ky pretendim lidhur me burimin, i ngritur për herë të parë pas kalimit të barrës së provës, nuk qëndron.

17.58. Referuar jurisprudencës së Kolegjit, pavarësisht pretendimit se këto kursime janë mbajtur nga babai, subjekti, ligjërish, si trashëgimtar ligjor i nënës së tij, ishte përfitues me ½ e pjesës së nënës dhe, në përmbushje të detyrimit ligjor, duhet të deklaronte përfitimin e pjesës së tij takuese nga këto kursime. Nga verifikimi i deklaratës periodike të vitit 2010²⁴¹ nuk rezulton të jetë bërë ky deklaram nga subjekti dhe pavarësisht se ky mosdeklarim nuk e ngarkon me përgjegjësi subjektin në kuadrin e procesit të rivlerësimit, ai ka vlerë në drejtim të provueshmërisë së deklarimeve të saj

²⁴⁰ Vendim nr. 26-2022 (JR), datë 6.7.2022.

²⁴¹ Nëna e subjektit/E. Ç. ka ndërruar jetë në datën 21.2.2010. Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. ***, datë 24.3.2010, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësen E. Ç.

në kuadër të këtij procesi. Në mungesë të deklarimeve në deklaratat periodike vjetore përjashtohet edhe një nga mundësitë që ka pasur subjekti i rivlerësimit për të provuar ekzistencën dhe përfitimin e kursimeve nga prindërit²⁴².

17.59. Lidhur me pretendimin se një pjesë e këtyre kursimeve të prindërve janë përdorur për depozitën prej 300.000 lekësh të babait në BKT, Komisioni vëren se kjo depozitë është krijuar nëpërmjet llogarisë dyemërore (në emër të bashkëshortit dhe babait të subjektit) dhe, si e tillë, nuk i përket vetëm babait të subjektit e, për më tepër, të dyja transaksionet që lidhen me këtë depozitë, referuar lëvizjeve të llogarisë të përcjella nga BKT-ja, janë kryer nga bashkëshorti i subjektit²⁴³. Për këtë arsye, si dhe në vijim të arsyetimit në paragrafin e mësipërm, Komisioni nuk e mori në konsideratë këtë pretendim dhe shuma e zërit “Ndryshim i likuiditeteve në bankë (përveç shtimit të vlerës 40.000 euro)” mbeti e pandryshuar në analizën financiare.

17.60. Për pasojë, mbetet i pandryshuar konkluzioni se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për shtimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2010, në vlerën 1.029.846 lekë.

17.61. Në përfundim, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 2.129.846 lekë për krijimin e depozitave pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe pranë Union Bank, pasi: (i) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1.100.000 lekë për kryerjen e depozitimit në datën 18.5.2004; (ii) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për shtimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2010, në vlerën 1.029.846 lekë, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

18. Të ardhurat nga aktiviteti privat në shoqërinë “*” sh.p.k.**

18.1. Në deklaratën *Vetting 2017*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: (i) të ardhura nga paga si ortak i vetëm në shoqërinë “***” sh.p.k., me NIPT ***, në vlerën 80.000 lekë bruto dhe 64.540 lekë neto; (ii) të ardhura nga dividendi ndër vite dhe bilanceve sipas vërtetimit të datës 24.1.2016, me nr. *** prot., lëshuar prej Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë. Vlera: 5.701.000 lekë. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues²⁴⁴.

18.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se në DIPP-të vjetore subjekti ka deklaruar: “(i) Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 – të ardhura nga aktiviteti i bashkëshortit “Kancelari”, në shumën 830.000 lekë; (ii) në DIPP/2004 – të ardhura nga paga e bashkëshortit në shumën 3.000.000 lekë; (iii) në DIPP/2005 – të ardhura nga aktiviteti “***” sh.p.k., në shumën 6.000.000 lekë (bilanci i papërfunduar); (iv) në DIPP/2006 – të ardhura në shumën 3.500.000 lekë; (v) në DIPP/2007 – bilanci i shoqërisë “***” sh.p.k. është ende i pambyllur, rezervojmë të drejtën t’ju dërgojmë të dhëna mbi xhiron dhe të ardhurat, në momentin e përfundimit, jo më vonë së data

²⁴² Vendim nr. 36-2023 (JR), datë 27.7.2023.

²⁴³ Konkretisht në datën 9.6.2010 janë depozituar 300.000 lekë nga bashkëshorti i subjektit, të cilat janë kaluar në depozitë e pas maturimit janë tërhequr në datën 28.10.2016, po nga bashkëshorti i subjektit.

²⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 24.1.2017, nga DRT Vlorë, bilancet për periudhën 2003 – 2015, të subjektit “***” sh.p.k.

31.3.2008; (vi) në DIPP/2008 – paga e bashkëshortit në shoqërinë “****” sh.p.k., në shumën 600.000 lekë, dividend i parashikuar rreth 600.000 lekë (për t’u saktësuar pas afatit të mbylljes së bilancit të vitit 2008), për ndryshime rezervoje të drejtën për ta skatësuar pas afatit zyrtar 31.3.2009; (vii) në DIPP/2009 – paga e bashkëshortit si president në shumën 600.000 lekë, dividendi i tërhequr nga “****” sh.p.k., në vlerën 600.000 lekë; (viii) në DIPP/2010 – paga e bashkëshortit si president i shoqërisë në shumën 50.000 lekë, dividendi në vlerën 1.000.000 lekë; (ix) në DIPP/2011 – paga si ortak i vetëm i shoqërisë në shumën 600.000 lekë, dividendi në vlerën 1.000.000 lekë; (x) në DIPP/2012 – paga mujore e bashkëshortit, në shumën 600.000 lekë; (xi) në DIPP/2013 – paga neto në shumën 472.800 lekë; (xii) në DIPP/2014 – të ardhura neto nga paga e bashkëshortit si ortak i vetëm, në shumën 600.000 lekë; (xiii) në DIPP/2015 – të ardhura nga paga e bashkëshortit si ortak i vetëm i shoqërisë në shumën 541.355 lekë, dividendi 700.000 lekë; (xiv) në DIPP/2016 – të ardhura nga paga si ortak i vetëm i shoqërisë në shumën 785.400 lekë”.

18.3. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga pagat, në deklaratën Vetting 2017, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga paga si ortak i vetëm në shoqërinë “****” sh.p.k., me NIPT ***, në vlerën 80.000 lekë bruto dhe 64.540 lekë neto.

18.4. Për të përcaktuar shumën e përfitur për çdo vit kalendarik, për efekt të paraqitjes së të ardhurave nga paga në analizën financiare, Komisioni iu referua dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në pyetësorin standard²⁴⁵ dhe në pyetësorin nr. 1²⁴⁶ për të ardhurat përgjatë periudhës 2003 – 2011 dhe dokumentacionit të administruar nga ISSH-ja²⁴⁷ për të ardhurat përgjatë periudhës 2012 – 2016.

18.5. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga dividendi, në deklaratën Vetting 2017, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga dividendi ndër vite dhe bilanceve sipas vërtetimit të datës 24.1.2016, me nr. *** prot., lëshuar prej Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë. Vlera: 5.701.000 lekë.

18.6. Sipas dokumentacionit të administruar nga QKB-ja²⁴⁸, rezulton se shoqëria “****” sh.p.k., me NIPT ***, është regjistruar në datën 28.1.2003 dhe ka objekt tregtar “Tregti me shumicë e pakicë, import eksport pajisje mobilierie, zyrash, kancelari, etj. [...]”, dhe ushtron aktivitetin në qytetin e Vlorës. Referuar ekstraktit historik tregtar, bashkëshorti i subjektit ka qenë ortak me 100% të kuotave që nga themelimi deri në datën 7.5.2018, datë në të cilën sipas vendimit të ortakut të vetëm është vendosur miratimi i shitjes së 50% të kuotave të kapitalit nga z. Th. L. në favor të z. J. Q..

18.7. Lidhur me shumën e dividendit të përfitur nga bashkëshorti i subjektit në secilin vit kalendarik, Komisioni, pasi analizoi të dhënat në shkresat e administruara²⁴⁹, konstatoi se informacioni i përcjellë për disa prej viteve ndryshonte nga njëra shkresë në tjetrën.

²⁴⁵ Vërtetim për bazën e vlerësuar për periudhën 2003 – 2011, lëshuar nga DRSSH Vlorë.

²⁴⁶ Vërtetim për bazën e vlerësuar për periudhat 1998, janar – mars 1999, shkurt – qershor 2001, lëshuar nga DRSSH Vlorë.

²⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 11.2.2021.

²⁴⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 11.2.2021.

²⁴⁹ (i) Shkresë nr. *** prot., datë 24.1.2017, e lëshuar nga DRT Vlorë, drejtuar shoqërisë tregtare “****”, paraqitur në deklaratën Vetting; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 21.8.2017, e lëshuar nga DRT Vlorë, ILDKPKI; (iii) shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2020, e lëshuar nga DRT Vlorë, drejtuar bashkëshortit të subjektit, paraqitur në pyetësorin standard.

18.8. Në këto kushte, Komisioni, bazuar në qëndrimin orientues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit²⁵⁰, iu drejtua sërish DRT-së Vlorë për të saktësuar të dhënat e përcjella, duke i kërkuar të specifikohet se sa është shuma e dividendit të shpërndarë në secilin vit kalendarik, duke iu referuar vitit në të cilin është marrë vendimi nga ortakët, si dhe shumat dhe datat e pagesës së tatimit në burim për dividendin e shpërndarë. Në përgjigje²⁵¹, DRT Vlorë përcolli informacionin e paraqitur në tabelën vijuese:

Viti	Dividend	Tatimi i paguar	Data e pagesës së tatimit
2003	S'ka vendim		
2004	S'ka vendim		
2005	S'ka vendim	50,000	16.8.2005
2006	S'ka vendim	<i>Shënim në fund të shkresës</i>	
2007	800,000	80,000	30.8.2007
2008	600,000	60,000	30.7.2008
2009	600,000	60,000	28.7.2009
2010	600,000	60,000	29.7.2010
2011	S'ka vendim	100,000	29.8.2011
2012	S'ka vendim	100,000	17.7.2012
2013	-		
2014	-		
2015	-		
2016	700,000	105,000	15.8.2016

18.9. Përveçse sa më lart, DRT Vlorë informon se në datën 21.11.2007, referuar informacionit nga zyra e kontabilitetit, subjekti ka kryer një pagesë për tatim mbi dividendin në vlerën 50.000 lekë. Për këtë pagesë nuk disponohet vendim asambleje, por referuar informacionit të zyrës së kontabilitetit është tatim i paguar për fitim të shpërndarë që lidhet me vitin 2005.

18.10. Nga analizimi i pasqyrave financiare²⁵², duket se kjo pagesë i përket fitimit të shpërndarë në vitin 2006 (nga fitimet e mbartura nga viti 2005). Konkretisht, Komisioni vëren se në këtë vit është shpërndarë dividend në masën 500.000 lekë²⁵³, çka përkon me shumën e tatimit të paguar sipas shkresës së DRT-së.

18.11. Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”²⁵⁴, për periudhën 2005 – 2014, norma e tatimit mbi dividendin ka qenë 10%, ndërsa për periudhën 2015 – 2016 kjo normë ka qenë 15%²⁵⁵.

²⁵⁰ Vendim nr. 15-2019 (JR), datë 17.07.2019, subjekti D. Rr., paragrafi 98: “Së bashku me këtë konkluzion Kolegji, duke konstatuar paraqitjen e dokumentacionit me të dhëna të ndryshme nga i njëjti institucion shtetëror, në përgjigjet që institucionet u japin organeve të rivlerësimit dhe atyre që u japin subjekteve të rivlerësimit, si një problematike e hasur edhe në raste të tjera, bazuar në përcaktimet e nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, orienton Komisionin që në raste të ngjashme të kryejë hetime më të thella për të arritur në zbulimin e së vërtetës, si edhe të evidentojë problematikën e hasur në rrugë institucionale, për të shmangur përsëritjen e këtyre situatave në të ardhmen”.

²⁵¹ Shkresë nr. *** prot., datë 29.6.2023.

²⁵² Paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

²⁵³ Përlogaritur në këtë mënyrë: Fitimi i vitit ushtrimor i vitit paraardhës 4.229.416 lekë + fitimi i mbartur i vitit paraardhës 3.466.050 lekë – shtesë në rezerva (në vitin aktual) 147.500 lekë – fitimi i mbartur i vitit aktual 7.047.966 lekë = 500.000 lekë (dividendi i shpërndarë në vitin aktual).

²⁵⁴ Neni 9 – dividendët, të ardhurat që rrjedhin si fitim i ortakut, qoftë ky ortak i vetëm, interesat nga huat, depozitat ose kontrata të ngjashme, të ardhurat nga e drejta e autorit ose pronësia intelektuale, si dhe të gjitha shpërblimet apo të ardhurat e tjera që nuk parashikohen ndryshe në dispozita të tjera të këtij ligji, tathohen me 10 %.

²⁵⁵ Ndryshuar me ligjin nr. 156/2014, datë 27.11.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 195, datë 24.12.2014.

18.12. Komisioni, bazuar në informacionin e përcjellë nga DRT Tiranë²⁵⁶ mbi shumat e tatimit të paguara nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe bazuar në legjislacionin në fuqi mbi normat e tatimit mbi dividendin, përlogariti dhe paraqiti në analizën financiare të ardhurat neto të bashkëshortit nga dividendi, pas zbritjes së tatimit mbi dividendin²⁵⁷, për secilin vit kalendarik, nga ku rezultoi se të ardhurat totale të përfituara nga bashkëshorti i subjektit nga dividendi kanë qenë në shumën 5.635.000 lekë.

19. Lidhur me konfliktin e interesit

19.1. Referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, Agjencia e Prokurimit Publik, me shkresën nr. *** prot., datë 15.1.2019, konfirmon se subjekti “****” sh.p.k., me NIPT ***, është shpallur fitues në disa procedura të prokurimit publik për periudhën deri më 27.1.2017. Lidhur me këtë konstatim, ILDKPKI-ja ka kërkuar sqarime nga subjekti për herë të parë në procesverbalin e mbajtur në datën 30.6.2021.

19.2. Me anë të shkresës nr. *** prot., datë 3.3.2023, Komisioni administroi procesverbalin mbi shpjegimet e dhëna nga subjekti në datën 30.6.2021, pranë ILDKPKI-së, nga ku rezultoi se APP-ja ka konfirmuar se shoqëria “****” sh.p.k. është shpallur fituese në 20 procedura prokurimi elektronik për periudhën 1.1.2017 – 31.12.2020, me autoritet kontraktor institucione publike dhe ka lidhur kontrata nga data 8.5.2017 deri më 19.11.2020, në kundërshtim me ndalimet dhe kufizimet e përcaktuara në nenin 21, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.

19.3. Subjekti në përgjigje deklaroi se bashkëshorti i saj ka qenë ortak me 50% të aksioneve në shoqërinë “****” sh.p.k., administrator ka qenë shtetasi J. Q., i cili është marrë me procedurat e prokurimeve publike dhe se deklaratat për konfliktin e interesit për prokurimet publike janë bërë nga shtetasi J. Q., i cili nuk është person i lidhur me subjektin. Në përfundim ka sqaruar se me t’u vënë në dijeni të faktit, bashkëshorti ditën e nesërme nga dita e marrjes dijeni ka aplikuar pranë QKR-së për t’u çliruar nga vlera e aksioneve që ka në këtë kompani. Në cilësinë e provës, subjekti ka paraqitur aplikimin pranë QKB-së datë 1.7.2021, si dhe vendimin e Asamblesë së Ortakëve për shitjen e 50% të aksioneve të zotëruara nga ana e bashkëshortit Th. L., duke deklaruar se ka marrë të gjitha masat për ta zgjidhur këtë situatë të ndaluar sipas ligjit.

19.4. Ndërkohë që nga hetimi i Komisionit rezultoi se bashkëshorti i subjektit Th. L. ka qenë ortak i vetëm i shoqërisë deri në datën 7.5.2018, ku me vendim të ortakut të vetëm është vendosur miratimi i shitjes së 50% të kuotave të kapitalit të shoqërisë në favor të shtetasit J. Q., pra nuk qëndron pretendimi i subjekti se ka qenë shtetasi J. Q., që është marrë me procedurat e prokurimeve publike (të paktën deri në datën 7.5.2018).

Referuar vendimit të Asamblesë së Ortakëve datë 1.7.2021, J. Q. bëhet ortak i shoqërisë me 100% të kuotave të kapitalit e barabartë me 100.000 lekë. Sipas kontratës së shitjes së kuotave, shtetasi Th. L. i shet 50% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë shtetasit J. Q., në vlerën 50.000

²⁵⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 29.6.2023.

²⁵⁷ Referuar nenit 10 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” – çdo punëdhënës, që paguan një pagë a shpërblim të parashikuar në shkronjën “a” të nenit 8 të këtij ligji, mban tatimin mbi të ardhurat personale, në përputhje me paragrafin e parë, të nenit 9 të këtij ligji, dhe e derdh tatimin e mbajtur në favor të organeve tatimore, jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës.

lekë²⁵⁸. Referuar ekstraktit historik të shoqërisë shkarkuar nga faqja e QKB-së, Komisioni vëren se shtetasi J. Q. figuron administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “****” sh.p.k.

19.5. Gjithashtu, Komisioni, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 24.5.2023, kërkoi informacion nga Agjencia e Prokurimit Publik lidhur me të gjitha prokurimet publike ku shoqëria “****” sh.p.k. ka marrë pjesë dhe është shpallur fituese me Autoritetet Kontraktore. Në përgjigjen e përcjellë²⁵⁹ rezultoi se ky subjekt ka lidhur kontrata me institucionet publike²⁶⁰ sa vijon: (i) viti 2009 – 2 institucione, ndër to Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë; (ii) viti 2010 – 7 institucione, ndër to Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, universiteti “****”, Vlorë etj.; (iii) viti 2011 – 2 institucione sh.a., Ujësjiellës Kanalizime Vlorë dhe Bashkia Vlorë; (iv) viti 2012 – 6 institucione, ndër to Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, universiteti “****”, Vlorë, Bashkia Vlorë etj.; (v) viti 2013 – 13 institucione, ndër to Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Gjykata e Apelit Vlorë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Ujësjiellës Kanalizime Vlorë etj.; (vi) viti 2014 – 8 institucione, ndër to Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Bashkia Vlorë, Këshilli i Lartë Gjyqësor etj.; (vii) viti 2015 – 4 institucione; (viii) viti 2016 – 5 institucione, ndër to Bashkia Vlorë; (ix) viti 2017 – 2 institucione, ndër to Bashkia Vlorë; (x) viti 2018 – 3 institucione, ndër to sh.a. Ujësjiellës Kanalizime Vlorë, Bashkia Vlorë, etj.; është shpallur fitues në total në 6 procedura; (xi) viti 2019 – 2 institucione, ndër to Bashkia Vlorë; (xii) vitit 2020 – është shpallur fitues në 3 procedura me Drejtorinë e Sigurimeve Shoqërore Vlorë, Dega e Thesarit Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Vlorë; (xiii) viti 2021 – është shpallur fitues në total në 4 procedura, ndër to Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Vlorë, Ministria e Drejtësisë, Kuvendi etj.

19.6. Komisioni vëren se shoqëria “****” sh.p.k., me ortak personin e lidhur/bashkëshorti i subjektit Th. L., është shpallur fituese në disa prokurime publike dhe ka lidhur kontrata me institucione të ndryshme publike, në zonën e kompetencës territoriale të gjykatës ku subjekti ushtron detyrën.

19.7. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: *Referuar dispozitave të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur gjenden në kushtet e konfliktit të interesit, për arsye se: (i) shoqëria “****” sh.p.k., me ortak personin e lidhur/bashkëshorti i subjektit Th. L. është shpallur fituese në disa prokurime publike dhe ka lidhur kontrata me institucione të ndryshme publike; (ii) personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka lidhur kontrata publike në zonën e kompetencës territoriale të gjykatës ku subjekti ushtron detyrën; (iii) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë krijuar të ardhura apo përfitime si pasojë e situatës së konfliktit të interesit; (iv) subjekti i*

²⁵⁸ Në ekstraktin tregtar datë 8.7.2021, shtetasi J. Q. figuron administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “****” sh.p.k.

²⁵⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 20.6.2023.

²⁶⁰ Gjithashtu është shpallur fitues në total: viti 2009 – 4 procedura; viti 2010 – 6 procedura, viti 2011 – 1 procedurë, viti 2012 – 7 procedura, viti 2013 – 13 procedura, viti 2014 – 8 procedura, viti 2015 – 4 procedura, viti 2016 – 5 procedura, viti 2017 – 6 procedura, viti 2018 – 3 procedura, viti 2019 – 6 procedurë, viti 2020 – 3 procedura, viti 2021 – 4 procedura.

rivlerësimit dhe bashkëshorti Th. L. nuk kanë ndërmarrë asnjë hap për të shmangur konfliktin e interesit.

19.8. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se: Për të qenë në kushtet e konfliktit të interesit, në të gjitha rastet kërkohet që zyrtari, për shkak të interesave të tij private, të ketë ndikuar, në pamje duket se ka ndikuar ose mund të ndikojë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave të tij si zyrtar. Pra, ligji kërkon që kryerja në mënyrë të padrejtë e detyrave dhe e përgjegjësive të jetë materializuar në një vendimarrje të zyrtarit. Subjekti sqaron se jo vetëm nuk ka pasur dijeni, por edhe nuk kam pasur mundësi për të ndikuar *de facto* apo në dukje në procedurat e prokurimit publik, kjo për faktin se veprimtaria si gjyqtare zhvillohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe jo pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, e cila ka në kompetencën e saj lëndore shqyrtimin e të gjitha konflikteve që lidhen me procedurat e prokurimit apo të konflikteve që lidhen me zbatimin e kontratave me institucionet publike, të cilat janë të natyrës administrative, çka do të thotë se nuk mund të konsiderohet se ka pasur konflikt interesi as në dukje²⁶¹.

19.9. Të ardhurat e përfituara nga kontratat e lidhura me institucionet publike, siç rezulton nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, zënë një përqindje të vogël në raport me të ardhurat e vitit dhe pjesa e fitimit të realizuar nga këto të ardhura në raport me fitimin e shoqërisë zë një pjesë shumë të vogël. Shoqëria “****” sh.p.k. ka qenë importuese vetëm e pajisjeve kancelarike në qytetin e Vlorës dhe në totalin e përgjithshëm të të ardhurave, të ardhurat nga kontratat publike zënë një përqindje të vogël. Kështu, në vitin 2014 të ardhurat e realizuara nga kjo shoqëri në raport me vlerën totale të kontratave të janë vetëm 7%, 15% në vitin 2015 dhe 8% në vitin 2016, ndërsa në vitin 2017 vetëm 3%.

19.10. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 44/2014²⁶² (në bazë të të cilit në nenin 21 ndër zyrtarët e tjerë u përfshinë edhe gjyqtarët e prokurorët e shkallës së parë, përpara këtij momenti gjyqtarët e shkallës së parë nuk kanë qenë në rrethin e zyrtarëve të përfshirë të përcaktuar në nenet 21, 31 apo 35 të ligjit nr. 9367/2005), nuk rezulton që shoqëria “****” sh.p.k. të ketë lidhur kontrata me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pra edhe pse nuk ka marrë pjesë asnjëherë në procedurat e prokurimit pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 44/2014, shoqëria nuk ka lidhur kontrata me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në datën 21.5.2014, shoqëria “****” sh.p.k. ka lidhur kontratë me ILDKPKI-në, fakt që tregon se natyra e kontratave është e tillë që nuk shkakton konflikt interesi, përndryshe ky institucion që ka si detyrë kryesore të kontrollojë shmangien e konfliktit të interesit nuk do të kishte lidhur një kontratë të kësaj natyre me shoqërinë ku bashkëshorti i subjektit zotëronte 100% të aksioneve, një ditë pasi ligji nr. 44/2014 ka hyrë në fuqi. Nga ana tjetër, ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, gjendjen e konfliktit të interesit e lidh me momentin e marrjes dijeni dhe mosmarrjen e masave nga subjekti për zgjidhjen e situatës. Dhe në momentin që është vënë në

²⁶¹ Ligji duhet të interpretohet në tërësinë e tij dhe jo i fragmentarizuar, ashtu siç është formuluar dispozita e nenit 21/1, pasi një interpretim i tillë i ngushtë i ligjit, ndonëse nuk provohet që zyrtari/gjyqtari nuk ka pasur asnjë mundësi qoftë dhe në dukje që të ketë ndikuar në vendimarrje, do të cenonte të drejtat dhe liritë ekonomike të shtetasve të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (kreu IV, neni 49, pika 1), sipas të cilit: “Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”.

²⁶² Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 70, më 20.5.2014.

dijeni të këtyre kontratave nga ILDKPKI-ja, për të shmangur çdolloj diskutimi ka marrë masat për të rregulluar situatën dhe i ka kërkuar bashkëshortit të shesë 50% të kuotave që zotëronte në shoqërinë “****” sh.p.k. te shtetasi J. Q., e vërtetuar kjo me kontratën e shitjes datë 1.7.2021, duke u larguar si ortak i kësaj shoqërie.

19.11. Më tej, subjekti deklaron se nuk e ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit, fakt tashmë i vërtetuar me vendim gjyqësor të formës së prerë nr. ***, datë 14.12.2022, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, vendim i cili për faktet e parashtruara jo vetëm në pjesën e dispozitivit të vendimin, por edhe në pjesën arsyetuese përbën gjë të gjykuar. Nuk rezulton se nga ana e bashkëshortit të jetë konsumuar kundërvajtja administrative për shkak se kundërvajtja administrative sipas pikës 4 të ligjit nr. 10279/2010 është shkelja me dashje direkte e dispozitive ligjore. Hipotetikusht shkelja e nenit 23 të ligjit nga bashkëshorti apo shoqëria ku ai është ortak, nuk mund të përbëjë një gjetje e cila mund të shërbejë për marrjen e masës disiplinore. Kjo kundërvajtje administrative, bazuar edhe në masën e gjobës së parashikuar (e cila fillon nga 10.000 lekë), paraqet një mospërmbushje të vogël ligjore dhe shkallë rrezikshmërie të ulët. Gjithashtu, në përfundim, subjekti referon për analogji vendimin e subjektit A. Z. të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

19.12. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

19.13. Referuar në nenin 21, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik”.*

19.14. Në nenin 24, pika 1 e këtij ligji përcaktohet se: *“Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21 dhe në nenin 22 të këtij ligji, përbëhet nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es”.*

19.15. Në interpretim të neneve të sipërcituara, rezulton se gjyqtari i shkallës së parë dhe personat e lidhur me të nuk mund të lidhin kontrata me institucione publike. Në rastin konkret, personi i lidhur me subjektin është bashkëshorti Th. L., i cili është ortak 100% i shoqërisë “****” sh.p.k.

19.16. Sipas dispozitive të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ndalohet që subjekti të zotërojë, në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital, si dhe çdolloj përfitimi tjetër, që nuk buron nga

zotërimi pasiv nga shoqëritë tregtare²⁶³. Më tej, bazuar në nenin 35, në rast se aksionet apo pjesët në kapital janë të regjistruara në emrin e personit të lidhur, ato vlerësohen njëjloj si të ishin të regjistruara në emër të vetë zyrtarit dhe personit të lidhur i kufizohen të drejtat pasurore për to, në të njëjtën masë dhe mënyrë si në rastin e vetë zyrtarit, lidhur me: (a) tërësinë e aksioneve ose pjesëve në kapital të zyrtarit dhe të personave të lidhur me të; (b) tërësinë e aksioneve ose pjesëve në kapital të personave të lidhur me zyrtarin.

19.17. Në analizë të situatës faktike, konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë krijuar të ardhura apo përfitime si pasojë e situatës së konfliktit të interesit dhe se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë hapa që të shkëpusë interesat e saj financiarë nga bashkëshorti. Bazuar në nenin 3 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, përcaktohet se konflikt faktik i interesit është gjendja në të cilën interesat privatë të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisive të tij zyrtare. Konflikt i vazhdueshëm i interesit është gjendja në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen.

19.18. Më tej, nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë krijuar të ardhura apo përfitime si pasojë e situatës së konfliktit të interesit, duke qenë se shoqëria “****” sh.p.k., me ortak personin e lidhur/bashkëshorti i subjektit Th. L., është shpallur fituese dhe ka lidhur kontrata me institucione të ndryshme publike dhe nuk ka marrë masa para vitit 2016 për të shmangur këtë situatë në të cilën ndodhej. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit Herila Çela ka ushtruar funksionin në kushtet e konfliktit të interesave.

19.19. Në përfundim, rezulton se shoqëria “****” sh.p.k., me ortak personin e lidhur/bashkëshorti i subjektit Th. L., është shpallur fituese dhe ka lidhur kontrata me institucione të ndryshme publike. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit Herila Çela ka ushtruar funksionin në kushtet e konfliktit të interesave për arsye se: (i) bashkëshorti i subjektit ka lidhur kontrata publike në zonën e kompetencës territoriale të gjykatës ku subjekti ushtron detyrën; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë krijuar të ardhura apo përfitime nga këto kontrata; (iii) subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti Th. L. nuk kanë ndërmarrë asnjë hap për të revokuar lidhjen e kontratave publike (interesat financiarë që rrjedhin prej tyre) për të shmangur konfliktin e interesit.

19.20. Në konkluzion, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë krijuar të ardhura apo përfitime si pasojë e situatës së konfliktit të interesit, duke lidhur kontrata me institucione të ndryshme publike, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “d”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

20. Konstatime të tjera

20.1. Apartament me sipërfaqe 77 m², ndodhur në Vlorë, në pronësi të bashkëshortit

20.1.1. Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK Drejtoria Vendore Vlorë, me shkresën e datës 12.5.2023, Komisioni vëren se personi i lidhur Th. L., prej verifikimit të kryer

²⁶³ Bazuar në pikën 6 të nenit 3 pronari ruan të drejtën e përfitimit të fryteve civile të pronësisë, por nuk mund të ushtrojë vetë asnjë veprim tjetër civil mbi këtë pronë. Të gjitha veprimet e tjera (administrim, zotërim, tjetërsim etj.) kryhen nga një person i besuar nga pronari, bazuar në një marrëveshje të lidhur ndërmjet tyre. I besuari nuk shkëmben asnjë mendim dhe asnjë informacion me pronarin dhe as nuk ndikohet nga ai për kryerjen e këtyre veprimeve me pasurinë.

rezulton të jetë pronar i pasurisë nr. ***, vol. ***, f. ***, e llojit apartament me sip. 77 m², ndodhur në zonën kadastrale nr. ***, lagjja “****”, Vlorë. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se ky apartament është dhuruar nga prindërit e tij me anë të kontratës së dhurimit nr. ***, datë 11.5.2020. Referuar certifikatës së pronësisë, shtetasi N. L. (babai i bashkëshortit të subjektit) është bërë pronar i kësaj pasurie në datën 17.11.2016.

20.1.2. Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues për të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie nga shtetasi N. L., si dhe dokumentacionin e plotë të kësaj pasurie. Në përgjigje, subjekti deklaroi se nëpërmjet kontratës së privatizimit të banesave shtetërore datë 3.8.1993, shtetasi N. L. bashkë me pjesëtarët e tjerë të familjes, pjesë të certifikatës familjare, kanë qenë pronarë të një apartamenti me nr. ***, rruga “****”, shk. ***, kati ***, me sip. 59,6 m², referuar certifikatës së pronësisë datë 19.3.2001. Me anë të kontratës nr. ***, datë 11.4.2005, bashkëpronarët N., F., Th. dhe A. L. e kanë shitur këtë apartament kundrejt çmimit 1.900.000 lekë.

20.1.3. Më tej, subjekti deklaroi se vjehri N. L. ka porositur apartamentin me sip. 77 m² sipas kontratës së sipërmarrjes datë 28.2.2005, vërtetim nënshkrimi nr. ***, datë 28.2.2005. Sipas kontratës, shtetasi N. L. ka porositur nga sipërmarrësi firma e ndërtimit “****” sh.p.k. një apartament me vendndodhje rruga Vlorë - ***, parku ***, vlera 3.500.000 lekë. Subjekti deklaroi se pagesa do të kryhej me këste, një pjesë e çmimit është likuiduar nga të ardhurat familjare të babait të bashkëshortit nga puna dhe shërbimi të realizuara deri në fund të vitit 2004, si dhe pjesa tjetër prej 1.900.000 lekësh është paguar pas arkëtimit të vlerës së shitjes së apartamentit në datën 11.4.2005. Për shkak të konflikteve ndërmjet ortakëve të firmës së ndërtimit “****” sh.p.k., apartamenti është regjistruar në emër të babait të bashkëshortit në datën 17.11.2016.

20.1.4. Apartamenti i është dhuruar bashkëshortit nga prindërit e tij në datën 8.5.2020, me anë të kontratës së dhurimit të pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 11.5.2020, kur ende nuk kishin dalë nga gjendja e pandemisë Covid-19. Arsyeja e dhurimit ishte se bashkëshorti, si djalë i vetëm, është kujdesur gjatë gjithë kohës për prindërit. Frika e tyre nga situata e shkaktuar nga Covid-19, gjendja shëndetësore, sidomos e nënës së bashkëshortit për shkak të sëmundjes së rëndë nga e cila vuan, si dhe pasiguria e krijuar, bëri që ata të nënshkruanin aktin noterial (deklaruar verbalisht prej tyre vazhdimisht, duke njohur ndihmën e dhënë nga bashkëshorti dhe kujdesin e treguar) për dhurimin e apartamentit në pronësi. Në këtë apartament vazhdojnë të jetojnë prindërit e bashkëshortit.

20.1.5. Në përfundim, subjekti deklaroi se apartamenti i dhuruar ka qenë pasuria e vetme që disponojnë prindërit e bashkëshortit dhe dhurimi është përfituar në vitin 2020, pas dorëzimit të deklaratës *Vetting*. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti dosjen e administruar nga ASHK-ja në datën 4.7.2023 për apartamentin me nr. ***, me sip. 59,6 m², si dhe kontratën e dhurimit nr. ***, datë 11.5.2020.

20.1.6. Komisioni vëren se me kontratën nr. ***, datë 11.4.2005, apartamenti i përfituar me privatizim me sip. 59,6 m² është shitur në vlerën 1.900.000 lekë, likuiduar në datën e lidhjes së kontratës, jashtë studios noteriale. Me kontratën e sipërmarrjes datë 28.2.2005, shtetasi N. L. (vjehri i subjektit) ka porositur apartamentin me sip. 77 m². Pas dhurimit, sipas certifikatës se

pronësisë nr. ***, datë 9.7.2020, apartamenti me sip. 77 m² është regjistruar në emër të shtetasit Th. L..

20.1.7. Sa më sipër, rezulton se ky apartament është porositur nga vjehri i subjektit/N. L. në vitin 2005, ku ky i fundit është bërë pronar *de jure* i kësaj pasurie në vitin 2016, ndërkohë që subjekti e ka përfituar këtë apartament nëpërmjet dhurimit në vitin 2020, pas deklaratës *Vetting*.

20.1.8. Duke qenë se nga hetimi i Komisionit nuk rezultoi që prindërit e bashkëshortit të subjektit të kenë në pronësi apartamente të tjera, e gjithashtu referuar dokumentacionit të administruar²⁶⁴, ata banojnë në të njëjtën adresë (siç ka deklaruar edhe subjekti), nuk ngrihen dyshime mbi ligjshmërinë e fitimit të kësaj pasurie nga ana e vjehrit të subjektit, çka zbeh mundësinë për të fshehur ndonjë burim të paligjshëm, për shkak të mosjustifikimit të tyre nga ana e subjektit dhe personave të lidhur.

20.1.9. Në përfundim, nuk u konstatuan problematika që kanë të bëjnë me procesin e rivlerësimit lidhur me këtë pasuri.

20.2. Automjet tip “BMW”, me targë *, vit prodhimi 1985**

20.2.1. Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti ka deklaruar automjetin tip “BMW 316”, vit prodhimi 1985, me targë ***, në shumën 50.000 lekë; nuk ka deklaruar burimin e krijimit. Në DIPP/2005, subjekti ka deklaruar shitje automjeti tip “BMW”, me targë ***, në shumën 7.500 lekë.

20.2.2. DPSHTRR-ja²⁶⁵ ka përcjellë kontratë shitjeje nr. ***, datë 28.8.2002, sipas së cilës shtetasi E. Q. i ka shitur bashkëshortit të subjektit automjetin tip “BMW”, me targë ***, me çmim 50.000 lekë.

20.2.3. *Për sa i përket burimit*, referuar shpjegimeve të subjektit në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 18.3.2015²⁶⁶, burim për blerjen e këtij automjeti kanë qenë kursimet nga puna ndër vite e tij dhe bashkëshortit. Më tej, në DIPP/2005, subjekti ka deklaruar shitjen e këtij automjeti në shumën 7.500 lekë, çka konfirmohet edhe me kontratën e shitjes nr. ***, datë 18.7.2005, blerës shtetasi J. M.²⁶⁷.

20.2.4. Sa më lart, Komisioni paraqiti në analizën financiare të periudhës 1997 – 2003, vlerën 50.000 lekë për blerjen e këtij automjeti dhe në analizën financiare të vitit 2005 vlerën 7.500 lekë si të ardhura nga shitja e tij.

20.3. Automjet tip “Nissan Primera”, me targë *, vit prodhimi 1992**

20.3.1. Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti ka deklaruar automjetin tip “Nissan”, viti i prodhimit 1992, me targë ***, në shumën 140.000 lekë, çka konfirmohet me kontratën e shitjes përcjellë nga DPSHTRR-ja²⁶⁸, me nr. ***, datë 6.8.2003, shitëse shtetasja S. K..

²⁶⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 1.3.2023, Drejtoria e Hartimit të Procedurave dhe Dokumenteve Biometrike.

²⁶⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 20.6.2023.

²⁶⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 3.3.2023, ILDKPKI.

²⁶⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 20.6.2023, DPSHTRR (paraqitur edhe nga subjekti pranë ILDKPKI-së, në procesverbalin e datës 27.3.2015).

²⁶⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 20.6.2023.

20.3.2. Nga dokumentacioni i administruar nga DPSHTRR-ja rezulton se ky automjet i është shitur shtetasit Sihat Selimaj, me kontratë shitjeje nr. ***, datë 27.8.2008, me çmim 200.000 lekë, shumë e cila, referuar kontratës, është likuiduar 100%.

20.3.3. Sa më lart, Komisioni paraqiti në analizën financiare të periudhës 1997 – 2003 vlerën 140.000 lekë për blerjen e këtij automjeti dhe në analizën financiare të vitit 2008 vlerën 200.000 lekë për shitjen e tij.

20.3.4. *Lidhur me aspektin deklarativ* – Komisioni konstaton se subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2008 pakësimin e kësaj pasurie, si dhe të ardhurat nga shitja e këtij automjeti, bazuar në parashikimet e shkronjave “b” dhe “e” të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, sipas të cilit mbart detyrimin të deklarojë pasuritë e luajtshme të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to sipas Kodit Civil, si dhe të ardhurat.

20.3.5. Komisioni vëren se kjo pasaktësi e konstatuar nuk përbënë shkak të veçuar për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore, për sa kohë nuk ka rezultuar asnjë e dhënë tjetër që të mund të vinte në dyshim deklaratimet e subjektit, si dhe nuk u konstatuan problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

20.4. Automjet tip “Nissan”, me targë *, vit prodhimi 1998**

20.4.1. Në procesverbalin mbi shpjegimet e subjektit datë 27.3.2015, në ILDKPKI, është paraqitur kontrata nr. ***, datë 3.2.2007, pala blerëse Th. L., e automjetit tip “Nissan”, vit prodhimi 1998, me targë ***, me çmim 350.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Gjithashtu është paraqitur kontrata nr. ***, datë 19.4.2008²⁶⁹, sipas së cilës shtetasi Th. L. e ka shitur këtë mjet në vlerën 200.000 lekë, blerës shtetasi M. J.

20.4.2. Komisioni kreu analizën financiare, duke konsideruar si burim vetëm të ardhurat nga pagat/pensionet, në datën 3.2.2007, për pasuritë, të ardhurat, shpenzimet dhe detyrimet.

20.4.3. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: *Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 235.207 lekë për blerjen e automjetit tip “Nissan”, në datën 3.2.2007.*

20.4.4. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës deklaroi se përveç kursimeve nga paga deri në datën e blerjes së këtij automjeti kanë shërbyer edhe të ardhurat familjare nga shitja e tokës. Duke qenë në një ekonomi të përbashkët familjare, bashkëshorti ka marrë shumë 250.000 lekë nga kursimet e mbajtura *cash* nga nëna. Pasi është shpërndarë dividendi dhe është paguar tatimi në burim për dividendin në datën 30.8.2007, bashkëshorti ka tërhequr vlerën neto prej 720.000 lekësh dhe i ka kthyer nënës shumë 250.000 lekë, shpjegoi subjekti. Duke pasur një ekonomi të përbashkët familjare me prindërit,

²⁶⁹ Noteri publik S. H., me anë të shkresës datë 21.6.2023 konfirmoi datën 19.4.2008 (në kontratë paraqiten dy data, 19.4.2008 dhe 19.4.2007).

kanë përdorur, në jo pak raste, madje edhe për shpejtësi veprimi, kursimet familjare të prindërve deri në momentin kur të gjitha kursimet janë depozituar në bankë.

20.4.5. Më tej, subjekti deklaroi se shpenzimet e jetesës për vitin 2007 duhet të jenë mesatare të viteve 2006 dhe 2008, pasi shpenzimet e jetesës së vitit 2007, përlogaritur nga Komisioni, janë në vlera më të larta për frymë se shpenzimet e jetesës për vitin 2013, 6 vjet më vonë. Lidhur me pasaktësitë në deklaram, e pashoqëruar me pamjaftueshmëri, subjekti u shpreh se nuk mund të shërbejë si masë shkarkimi, bazuar në praktikën tashmë të konsoliduar të Kolegjit.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

20.4.6. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaramtën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaramat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaramet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

20.4.7. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në DIPP/2007 (për rrjedhje as burimin) dhe as shitjen e tij në DIPP/2008, bazuar në parashikimet e shkronjave “b” dhe “e” të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, sipas të cilit mbart detyrimin të deklarojë pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë, dhe të drejtat reale mbi to sipas Kodit Civil.

20.4.8. Komisioni vëren se një deklaram i plotë do të jepte qartësi se cilat kishin qenë burimet e përdorura për blerjen e këtij automjeti. Mosdeklarami në DIPP/2007 i blerjes së këtij automjeti e, për rrjedhje, as i burimit të krijimit, ndonëse lidhet me pasaktësi të deklaramtës periodike, e cila nuk mund të ngrihet në nivelin e një deklarami të pasaktë sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, sërish ka krijuar premisa për vështirësinë e verifikimit të burimeve financiare të krijimit.

20.4.9. Në këto kushte, Komisioni nuk e gjen bindës pretendimin e subjektit se si burim krijimi kanë shërbyer edhe kursimet *cash* të nënës, për sa kohë kjo nuk është deklaruar në DIPP-në e vitit përkatës.

20.4.10. Për sa i përket përlogaritjes së shpenzimeve të jetesës për vitin 2007, Komisioni është bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 27.5.2008, të INSTAT-it, drejtuar ILDKPKI-së (174.072 lekë/vit për person), si pjesë e korrespondencës së administruar në shkresën nr. ***, datë 4.3.2019²⁷⁰ të ILDKPKI-së e, për rrjedhje, pretendimi i subjektit për të përlogaritur shpenzime jetese më të ulëta konsiderohet i pabazuar.

20.4.11. Sa rezulton, subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 235.207 lekë për blerjen e automjetit tip “Nissan”, në datën 3.2.2007, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

20.5. Njësi me sip. 48,2 m², Yzberisht, Tiranë – gjetje e ILDKPKI-së

²⁷⁰ Shpjegime të pasqyruara në aneksin nr. 2, vënë në dispozicion të subjektit, së bashku me kopje të shkresës së ILDKPKI-së me nr. ***, datë 4.3.2019 (përfshirë të gjithë korrespondencën ILDKPKI – INSTAT).

20.5.1. ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konstatuar veprime të kryera nga babai i subjektit lidhur me një pasuri të paluajtshme në Yzberisht, Tiranë.

20.5.2. ZQRPP-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 17.4.2018, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë, e cila konfirmon se shtetasi A. Ç. ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme në vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji i pasurisë njësi me sip. 48,2 m². Bashkëlidhur ndodhet kartela e pasurisë së paluajtshme dhe kontrata e shitblerjes datë 27.5.2015, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k.

20.5.3. Komisioni vëren se kjo pasuri nuk i përket babait të subjektit, pasi si blerës figuron shtetasi A. Ç., i biri i shtetasve S. dhe H., lindur në Lushnjë, në datën 10.12.1954, pra është në pronësi të një shtetasi tjetër dhe jo të babait të subjektit.

20.6 Lidhur me paraqitjen e vlerës 9.968.097 lekë në zërin “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve”, në pasqyrat financiare të shoqërisë “**” sh.p.k.**

20.6.1. Nga analizimi i pasqyrave financiare të shoqërisë “****” sh.p.k., për vitin ushtrimor 2010, konstatohet se në seksionin “Pasiveve Afatshkurtra/Hua dhe Parapagime”, paraqitet zëri “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve” me balancë 9.968.097 lekë, në datën 31.12.2010.

20.6.2. Në kushtet që bashkëshorti i subjektit ka qenë në cilësinë e ortakut të vetëm deri në datën 1.7.2021 dhe duke vërejtur se në pasqyrat financiare të vitit 2009, ky zë paraqitet me vlerë 0 (çka do të thotë që është shtuar me 9.968.097 lekë gjatë vitit 2010), me anë të pyetësorit nr. 2, Komisioni i kërkoj subjektit të japë shpjegime lidhur me këtë vlerë të kontribuar, të deklarojë burimin e krijimit, si dhe të paraqesë dokumentacion justifikues. Në përgjigje²⁷¹, subjekti shpjegoi se ky zë është gabim material në këto pasqyra financiare duke u paraqitur në këtë pozicion edhe në këtë shumë, duke sqaruar se: *“Për të argumentuar gabimin material në këto pasqyra financiare do më duhet të shpjegoj gabimin fillestar të kryer nga hartuesi i pasqyrave financiare. Gabimi në hartimin e pasqyrave financiare konstatuar me pyetjen e drejtuar nga ana Juaj, fillon në vitin 2009 me paraqitjen e zërit “Banka” të aktiveve monetare në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2009. Nëse i referohemi këtyre pasqyrave rezulton se zëri “Banka” është në shumën 7.308.386 lekë. Në fakt, nëse mbledhim aritmetikisht balancat e llogarive bankare të shoqërisë “****” sh.p.k. në datën 31.12.2009, do të rezultojë që kjo balancë është e ndryshme. Shoqëria “****” sh.p.k. gjatë viteve 2009 dhe 2010 ka operuar me dy banka të nivelit të dytë, Raiffeisen Bank sh.a. dhe Banka Popullore, sot OTP Bank.*

Në bilanc është deklaruar gjendja e llogarive bankare në shumën 7.308.386 lekë, por ndërkohë nuk është deklaruar depozita e krijuar në datën 30.12.2009, në shumën 7.900.000 lekë, e cila maturohet në datën 13.1.2010.

Kjo depozitë bankare është deklaruar gabim në pasqyrat financiare të vitit 2009, duke e paraqitur në zërin “Parapagesa për furnizime” në shumën 13.458.736 lekë. Ky gabim duket qartësisht edhe në raport me vlerën e zërit “Mallra për shitje”, inventari gjendje në fund të vitit 2009 ka qenë 32.575.301 lekë dhe në fund të vitit 2008 ka qenë në shumën 31.004.360 lekë. Sipas pasqyrave

²⁷¹ Datë 8.9.2023.

financiare, shoqëria ka parapaguar për furnizime 41% të inventarit gjendje, ndërkohë që në vitet paraardhëse nuk ka pasur parapagime për inventar.

*Në këtë zë “Parapagesa për furnizime” në shumën 13.458.736 lekë është përfshirë gabimisht edhe gjendja e llogarisë në datën 31.12.2009 në shumën 2.068.100 lekë që i përket transfertës së kryer në Raiffeisen Bank sh.a. në datën 23.12.2009, në shoqërinë “***” sh.p.k., shumë e transferuar në lekë për t’u konvertuar në euro, e cila është kthyer në vitin 2010, një pjesë 10.000 euro me transfertë në datën 12.1.2010 dhe një pjesë 5.150 euro dhënë cash bashkëshortit po në të njëjtën datë dhe depozituar cash prej tij.*

*Vlera e përgjithshme e këtyre dy transaksioneve, depozita me afat në Raiffeisen Bank sh.a. në shumën 7.900.000 lekë dhe transfertat e kryer në shoqërinë “***” sh.p.k. në shumën 2.068.100 lekë, janë paraqitur gabimisht në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2009, duke i paraqitur në zërin “Parapagime për furnizime”.*

Këto dy transaksione duhet të ishin paraqitur në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2009 në grupin “Aktive Monetare”, pasi një prej tyre ishte depozite me afat 2-javor dhe transaksioni tjetër ishte “Arkë tranzit”, pasi shuma e konvertuar në euro është kthyer në vitin 2010.

Duke paraqitur gabim këto dy vlera në pasqyrat financiare 2009, gabime të cilat vijnë për arsye të personit përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare, ka vazhduar ky gabim dhe në vitin tjetër pasues.

Maturimi i depozitës në shumën 7.900.000 lekë në datën 13.1.2010 dhe kthimi i konvertimit të shumës 2.068.100 lekë është trajtuar gabim në pasqyrat financiare të vitit 2010, duke u trajtuar si financim i ortakut dhe deklaruar në zërin “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve”. Gabimi në paraqitjen e pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2009 ka vazhduar duke u paraqitur gabim dhe pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2010.

Bashkëshorti nuk ka derdhje/financim në shoqëri dhe, si rrjedhojë, zëri “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve” duhet të ishte zero. Këto nuk janë fonde të financuara nga ortakët, por janë fonde të krijuara nga aktiviteti i shoqërisë.

Nëse i referohemi pasqyrave financiare të viti ushtrimor 2010 rezulton se zëri “Parapagesa për furnizime” paraqitet në vlerën 13.457.153 lekë, me një vlerë të vogël krahasuar me vitin 2009. Në këtë mënyrë, në bilancin e 2010 janë paraqitur si në aktiv ashtu edhe në pasiv shuma prej 9.968.097 lekësh, duke paraqitur gabim pasqyrat financiare dhe rritur artificialisht si aktin dhe pasivin e vitit 2010.

*Për të identifikuar saktësisht gabimet në hartimin e pasqyrave financiare të viteve 2009 dhe 2010, shoqëruar me kartelat kontabël dhe dokumentacion kontabël, kam angazhuar audituesen ligjore për t’i dhënë përgjigje pyetjeve të shtruara për zgjidhje, të cilat do më ndihmojnë për të dhënë një përgjigje sa më të saktë dhe teknike në lidhje me këtë gabim të ndodhur në hartimin e këtyre pasqyrave për shoqërinë “***” sh.p.k.. Për arsye të afatit në dhënien e përgjigjeve, raportin teknik të përgatitur nga audituesja ligjore së bashku me dokumentacionin kontabël, do e paraqes pranë Komisionit menjëherë sapo ta administroj”.*

20.6.3. Subjekti paraqiti: (i) konfirmim bankar të lëshuar nga OTP Bank Albania për gjendjet e llogarive në vitet 2009 dhe 2010, për shoqërinë “****” sh.p.k.; (ii) vërtetim mbi produktet bankare të shoqërisë “****” sh.p.k. pranë Raiffeisen Bank sh.a.; (iii) kopje të *statement*-it bankar të Raiffeisen Bank sh.a. për periudhën dhjetor 2009 – janar 2010, për shoqërinë “****” sh.p.k.; (iv) lëvizjet e llogarisë në euro pranë Societe Generale Albania, sot OTP Bank Albania, për shoqërinë “****” sh.p.k.

20.6.4. Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur, Komisioni vëren se: (i) Konfirmohet deklarimi i subjektit se gjendja totale e llogarive bankare në datën 31.9.2009 ka qenë 15.208.386,53 lekë, ndërkohë që në bilanc zëri “mjete monetare” është paraqitur 7.308.386,53 lekë – që përkon me shumën e tepricave të llogarive pranë Raiffeisen Bank dhe OTP Bank, pra duke mos e përfshirë depozitën e krijuar në datën 30.12.2009, me vlerë 7.900.000 lekë²⁷². Në lëvizjet e llogarive të paraqitura²⁷³ vërehet se shuma 2.813.522 lekë vjen nga likuidimi i faturave, ndërsa diferenca nuk mund të identifikohet se nga rrjedh, pasi ajo ka si burim gjendjen e mbartur të llogarisë; (ii) Konfirmohet transferta bankare për shoqërinë “****” sh.p.k., shoqëri me objekt aktiviteti “Këmbim valutor”, me përshkrimin “Kalim fondi për blerje 15.150 euro”, në datën 23.12.2009, me vlerë 2.068.100 lekë, vlerë e cila duhet të ishte deklaruar në seksionin “Mjetet Monetare” (nëse kundërvlera në euro nuk është arkëtuar gjatë periudhës 23.12.2009 – 31.12.2009). Në lëvizjet e llogarive të paraqitura nuk mund të identifikohet se nga rrjedh kjo vlerë, pasi ajo ka si burim gjendjen e mbartur të llogarisë; (iii) Konfirmohet se zëri i aktivitetit “Parapagesa për furnizime” është rritur gjatë vitit 2009²⁷⁴ me shumën 13.458.736 lekë, vlerë kjo që duket se i përfshin të dyja vlerat e mësipërme; (iv) Totali i dy vlerave të paraqitura në pikat (a) + (b) është i barabartë me 9.968.127 lekë – vlerë e cila sipas deklaramit të subjektit është paraqitur gabim që në vitin 2009, veprim i cili ka afektuar në vitin 2010 paraqitjen e zërit “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve”, në vlerën 9.968.097 lekë; (v) Konfirmohet se zëri i inventarit është rritur gjatë vitit 2009 me vetëm 1.570.941 lekë²⁷⁵, pra shumë më i lartë se rritja që pasqyrohet në zërin “Parapagime për furnizime”; (vi) Konfirmohet se depozita e Raiffeisen Bank prej 7.900.000 lekësh është maturuar në datën 13.1.2010 – vlerë e cila sipas deklaramit të subjektit është kontabilizuar gabimisht tek zëri “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve”; (vii) Konfirmohet një kreditim në vlerën 10.000 euro në datën 12.1.2010, nga shoqëria “****” sh.p.k., me përshkrimin “Paguara nga *** sh.p.k. ****” – vlerë e cila sipas deklaramit të subjektit është kontabilizuar gabimisht tek zëri “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve”, në kundërvlerën 1.365.100 lekë²⁷⁶; (viii) Konfirmohet një depozitim në vlerën 23.675 euro në datën 12.1.2010, nga bashkëshorti i subjektit me përshkrimin “Th. L. likuidim faturash” – vlerë e cila përfshin edhe diferencën prej 5.150 euro, vlerë e cila, sipas deklaramit të subjektit, është kontabilizuar gabimisht tek zëri “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve”, në kundërvlerën 703.027 lekë; (ix) Totali i tri vlerave të paraqitura në pikat (f) + (g) + (h) është i barabartë me 9.968.127 lekë, përkundrajt vlerës 9.968.097 lekë të paraqitur në zërin “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve”; (x) Gjatë vitit 2010 zëri “Huamarrje afatgjata” është pakësuar me 15.000.000 lekë; (xi) Në pasqyrat financiare të vitit pasardhës/viti 2011 ky zë është pakësuar me vlerën 4.542.063 lekë,

²⁷² Referuar dokumentacionit të lëshuar nga Raiffeisen Bank, lëshuar nga subjekti.

²⁷³ Lëvizjet e llogarisë pranë Raiffeisen Bank janë paraqitur për periudhën 23.12.2009 – 14.1.2010.

²⁷⁴ Në fund të vitit 2008, ky zë ka qenë me vlerën 0 (zero).

²⁷⁵ Diferenca midis gjendjes në fund të vitit 2009 më atë në fund të vitit 2008.

duke shkuar në vlerën 5.426.034 lekë dhe, më tej, ka mbetur i pandryshuar për vitet 2012 dhe 2013. Në vitin 2014, ky zë pasqyrohet me vlerën 912.967 lekë.

20.6.5. Sa më lart, në kushtet që: (i) depozitimi i shumës 23.675 euro, ku përfshihet edhe diferenca prej 5.000 euro, nga ana e bashkëshortit ka përshkrimin “Likuidim faturash”; (ii) zëri i huamarrjeve është pakësuar në të njëjtin vit që është rritur zëri i detyrimeve ndaj ortakut; (iii) mbetet i pashpjegueshëm ndryshimi i këtij zëri në pasqyrat financiare në vitet pasardhëse – Komisioni mbetet i paqartë lidhur me shumën 9.968.097 lekë të paraqitur në zërin “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve”, pasi deklarimi i subjektit nuk përputhet plotësisht me dokumentacionin e administruar e, për rrjedhojë, duket se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka kontribuar në shoqëri me këtë vlerë gjatë vitit 2010, çka e vendos atë në kushtet e justifikimit të burimeve të ligjshme të kësaj shume.

20.6.6. Deri në këtë fazë të hetimit, duket se personi i lidhur ka mungesë të të ardhurave të ligjshme në shumën 9.968.097 lekë për të krijuar të ardhurat, të cilat janë regjistruar në zërin e bilancit “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve”.

20.6.7. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: *(i) Komisioni mbetet i paqartë lidhur me shumën 9.968.097 lekë të paraqitur në zërin “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve”, pasi deklarimi i subjektit nuk përputhet plotësisht me dokumentacionin e administruar e, për rrjedhojë, duket se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka kontribuar në shoqëri me këtë vlerë gjatë vitit 2010, çka e vendos atë në kushtet e justifikimit të burimeve të ligjshme të kësaj shume; (ii) Duket se ka mungesë dokumentacioni ligjor për burimin dhe justifikimin e tij në shumën 9.968.097 lekë.*

20.6.8. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se:

20.6.9. Lidhur me konstatimin se zëri i huamarrjeve është pakësuar në të njëjtin vit që është rritur zëri i detyrimeve ndaj ortakut, shpjegoi se shlyerja prej 15.000.000 lekësh e huas ndaj palëve të treta nuk lidhet absolutisht me ndonjë financim të mundshëm të ortakut.

20.6.10. Konkretisht, vijoi subjekti, nëse analizohen pasqyrat financiare të viteve 2009 dhe 2010, do të rezultojë se gjendja monetare në bankë në fund të vitit 2009 është në shumën 15.208.386 lekë (duke përfshirë edhe 2.068.100 lekë që ishin transferuar për t’u këmbyer), do të thotë që në fund të vitit 2009 ka pasur gjendje monetare shumën 17.276.486 lekë, nëse e krahasojmë me gjendjen monetare në fund të vitit 2010 që ka qenë në shumën 3.623.274 lekë, do të thotë që në fund të vitit 2010, krahasuar me vitin 2009, gjendja e likuiditeteve është pakësuar në shumën 13.653.212 lekë. Gjatë vitit 2010 fitimi neto i krijuar nga aktiviteti ka qenë në shumën 9.440.240 lekë, rreth 7.400.000 lekë është rritur inventari gjendje, 1.350.000 lekë janë destinuar për të plotësuar kthimin e huas, ndërsa diferenca e mbetur është shpërndarë ose ka shuar rritjen e ndonjë zëri aktivi/pakësimin e ndonjë zëri pasivi.

20.6.11. Në përfundim të analizimit të pasqyrave financiare rezulton se kthimi i kësaj huaje ka pasur si burim pakësimin e gjendjes së llogarive dhe likuiditeteve nga gjendja në fund të vitit 2009,

krahasuar me gjendjen në fund të vitit 2010, si dhe nga plotësimi i diferencës me fitimin neto të realizuar gjatë vitit 2010, sqaroi subjekti.

20.6.12. Lidhur me konstatimin se depozitimi i shumës 23.675 euro nga ana e bashkëshortit ka përkrahimin “Likuidim faturash”, ndërkohë që në këtë shumë përfshihet edhe diferenca prej 5.150 euro e kthyer nga shoqëria “****” sh.p.k., subjekti sqaroi se pjesa më e madhe e shumës ka qenë për arkëtim të faturave *cash*, por pjesë përbërëse e saj është edhe shuma 5.150 euro, pasi kjo shumë është marrë *cash* nga kjo shoqëri. Me zyrën e këmbimit valutor “****” sh.p.k. është rënë dakord në datën 23.12.2009, për blerjen e 15.150 euro, me kurs të dakordësuar, duke i transferuar shumën 2.068.100 lekë. Më tej, në fillim të vitit 2010 shoqëria “****” sh.p.k. i ka kaluar shumën në euro, një pjesë e së cilës – konkretisht 10.000 euro – është dërguar me transfertë bankare dhe pjesa e mbetur prej 5.150 euro është tërhequr *cash* në zyrat e këmbimit valutor, për arsye se nuk kishte gjendje mjaftueshëm në llogari bankare.

20.6.13. Subjekti shpjegoi se me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.10.2023, të lëshuar nga përfaqësuesi i shoqërisë “****” sh.p.k., sqarohet se ata kanë pasur bashkëpunim të ngushtë prej fillim vitit 2009 për blerjen e monedhës euro nga kjo shoqëri. Kjo shoqëri blinte vazhdimisht valutë në euro, duke transferuar në llogarinë e tyre bankare shumën në lekë dhe nga ana e tyre transferohej në llogari/ose jepej *cash* shuma e të hollave në euro me kursin e këmbimit të rënë dakord midis palëve. Në datën 23.12.2009, shoqëria ka kërkuar të blejë 15.150 euro, duke u dakordësuar për kursin e këmbimit të blerjes së monedhës euro dhe në këtë datë është transferuar në llogarinë bankare shuma 2.068.100 lekë. Shuma 10.000 euro, pjesë e blerjes së shumës 15.150 euro, është transferuar nga llogaria jonë bankare në llogarinë bankare të shoqërisë në datën 12.1.2010, ndërsa pjesa tjetër prej 5.150 euro i është dhënë *cash* administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k. po atë ditë, pasi nuk dispononin në bankë vlerën e plotë prej 15.150 euro, thuhet në deklaratën noteriale.

20.6.14. Lidhur me konstatimin se *mbetet i pashpjegueshëm ndryshimi i këtij zëri në pasqyrat financiare në vitet pasardhëse*, subjekti theksoi se vendosja e zërit “Të drejta e detyrime” në shumën prej 9.968.097 lekësh është një pasaktësi në bilanc. Subjekti vijoi duke shpjeguar se ky zë në pasivin e bilancit nëse do të ishte konstatuar në vitin 2010 nuk do të ekzistonte, por edhe në vitin 2011 kontabilistja M. K. duhet të bënte *cut off* zërin në pasive “Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve”, paraqitur në shumën 9.968.097 lekë me zërin në aktiv “Parapagime për furnizime” në shumën e paraqitur prej 13.457.153 lekësh. Vlera e parapagimeve për furnizime për furnitorë importi të likuiduar në vitin 2010 për të cilët ende nuk ka mbërritur malli në Shqipëri, rezultojnë të jenë 3.489.056 lekë (13.457.153 lekë – 9.968.097 lekë).

20.6.15. Subjekti i ka paraqitur një deklaratë noteriale të kontabilistes së shoqërisë “****” sh.p.k. shtetases M. K.²⁷⁷.

²⁷⁷ Nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.10.2023: “Unë deklaroj se M. K. mbajtëse e titullit “Kontabilist i Miratuar” me nr. *** licence, regjistruar si person fizik në datën 6.3.2008, me NIPT ***, deklaroj se jam në cilësinë e kontabilistes prej vitit 2009 në shoqërinë “****” sh.p.k. me NIPT ***, vërtetuar edhe nënshkrimi im në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare. Viti 2009 ka qenë viti i parë i mbajtjes së kontabilitetit të kësaj shoqërie nga ana ime, e cila ka pasur një volum të konsiderueshëm transakcionesh, si deklarata importi ashtu dhe fatura shitje për tregtimin e mallit. Gjatë regjistrimeve të veprimeve kontabël në programin e kontabilitetit Financa 5 kam gabuar në regjistrimin e dy veprimeve kontabël. Këto veprime kontabël i përkasin muajit dhjetor 2009, muaj të cilin ne hedhim veprimet kontabël në program në momentin e mbylljes së pasqyrave, brenda datës 31 mars,

20.6.16. Më tej, subjekti deklaroi se për të marrë mendim teknik dhe të specializuar i është drejtuar auditueses ligjore E. H., mbajtëse e licencës nr. ***, e cila ka përgatitur raportin e analizës financiare për situatën financiare të shoqërisë “***” sh.p.k. në vitin 2010²⁷⁸.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

20.6.17. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyetoi se:

*dhe për këtë arsye ka ndodhur dhe ky gabim i kryer prej meje. Transaksioni bankar i datës 23.12.2009, me përshkrim veprimi “Kalim fondi blerje 15,150 euro/*** sh.p.k. ***” është regjistruar gabim në programin Financa 5. Sikurse rezultoi ky veprim është këmbim për blerje valute të huaj, ndërkohë është kontabilizuar gabim nga ana ime si kalim fondi për blerje malli dhe jo valute, duke e kontabilizuar në zërin “Parapagime për blerje”. Në pasqyrat financiare të vitit 2009 nuk është deklaruar e saktë transferi 2.068.100 lekë. Ky transaksion duhet të deklarohet si “bankë në tranzit” dhe jo si parapagim për blerje malli. Transaksioni bankar i datës 30.12.2009 me përshkrim veprimi “***” është regjistruar gabim në programin Financa 5. Sikurse rezultoi ky transaksion është depozitë me afat e krijuar nga shoqëria, ndërkohë gabimisht nga ana ime është konsideruar ky transaksion si transfertë për blerje malli duke e kontabilizuar në zërin “Parapagime për blerje”. Nga ana tjetër në pasqyrat financiare të vitit 2009 nuk është pasqyruar gjendja e saktë e bankës në datë 31.12.2009. Totali i gjendjes së bankave është deklaruar 7.308.386 lekë, ndërkohë vlera e saktë e bankave duhet të ishte më e lartë dhe me depozitën e investuar, plus 7.900.000 lekë. Në pasqyrat financiare të vitit 2009 për shoqërinë “***” sh.p.k., me NIPT ***, aktivi i bilancit ka pasaktësi. Zëri “Aktivet monetare” duhet të deklarohet me një vlerë shtesë plus 9.968.100 lekë (7.900.000 lekë + 2.068.100 lekë) dhe zëri “Parapagesa për furnizime” duhet të deklarohet me një vlerë minus 9.968.100 lekë. Natyra e transaksioneve të kontabilizuara tregon qartësisht gabimin e kryer prej meje. Në vitin 2010 gjatë regjistrimeve kontabël në programin Financa 5, maturimin e depozitës 7.909.090,41, transfertën në mbërritje nga shoqëria “***” sh.p.k. në shumën 10.000 euro (konvertuar në 1.383.200 lekë), si pagesë pjesore e konvertimit të shumës 2.068.100 lekë në 15.150 euro si dhe derdhjen në llogarinë euro në shumën 23.675 euro (ku përfshihet xhiro e realizuar dhe shuma 5,150 euro konvertuar në 675.807 lekë), të tre këto veprime i kam kontabilizuar në llogarinë e ndërmjetme “Xhirime të brendshme ***”. Në fund të vitit 2010, llogaria *** ka pasur tepricë kreditorë në shumën 9.968.097 lekë, të cilën kam menduar se është financim i ortakut duke e deklaruar në pasqyrat financiare të vitit 2010 në zërin “ Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve”. Tri arkëtimet e kryera gjatë vitit 2010 i përkasin pakësimit të dy veprimeve kontabël në vitin 2009, duket qartësisht që këto transaksione të kontabilizuara nga ana ime janë pasaktësi dhe gabim në deklarim të pasqyrave financiare. Në bilancin e vitit 2009 gabimi ka qenë klasifikim i zërave brenda Aktivit, në pasqyrat financiare të vitit 2010 kemi rritje artificiale si të “aktivit” ashtu edhe të “pasivit”, me një vlerë plus 9.968.097 lekë. Totali i aktivit dhe pasivit duhet të ishte 54.855.323 lekë nga 64.823.420 lekë që është deklaruar.*

Këto gabime janë konstatuar prej meje në vitin 2011, vit në të cilin kam korigjuar pjesërisht gabimin, duke pakësuar bilancin si në aktiv ashtu edhe në pasiv, me shumën 4.542.063 lekë. Nëse do të korigjohja gabimin për vlerën e plotë, nga ana e DRT Vlorë, pasqyrat financiare do të paraqisnin problematikë në koston e mallit të shitur për vitin 2011, pasi parapagimet për furnizime do të konsideroheshin si mallra të blera dhe të shitura në atë vit. Korigjimin përfundimtar të gabimit e kam kryer në vitin 2015, pasi ishte plotësuar periudha 5-vjeçare e kontabilizimit të transaksioneve në zërin “Parapagime për furnizime” duke shmangur gjobën për deklarim të gabuar të pasqyrave financiare parashikuar nga neni 118 i ligjit nr. 9920, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që ortakut i vetëm nuk ka kryer financim në vitin 2010 për të gjitha faktet e paraqitura më lart. Viti 2010 është rast i izoluar dhe i vetmi vit që gabimisht është deklaruar financim ortakut”.

²⁷⁸ Referuar aktit të vlerësimit, audituesja ligjore ka arritur në konkluzionin se: Si konkluzion përmbyllës, referuar të gjitha dokumenteve kontabël të shqyrtuara në sistem, dokumentacionit fizik të shoqërisë “***” sh.p.k., rezultoi se pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2010 nuk japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale; paraqitja e zërave gabim në pasqyrat financiare të vitit 2009 ka vazhduar me paraqitjen e zërave gabim në vitin 2010, duke rritur artificialisht si aktivin ashtu dhe pasivin me shumën 9.968.097 lekë. Pasqyrat financiare në këto vite nuk janë hartuar në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe ligjit nr. 9228/2004; ortakut i vetëm i shoqërisë “***” sh.p.k. nuk ka kryer financim në para në vitin 2010, konfirmuar nga tërësia e veprimeve kontabël të paraqitura në sistemin e kontabilitetit, por dhe të lëvizjeve kreditorë të maturimit të depozitës si dhe të arkëtimeve të shumës, gjithsej 15.150 euro; korigjimi i gabimeve është bërë i shtrirë në vite, përfundimisht në vitin 2015. Rezultoi e provuar se zëri “Parapagime për furnizime” është paraqitur gabim dhe u provua në jo pak raste, që vlera e saktë e likuidimeve të kryera furnitorëve të huaj ishte e ndryshme.

20.6.18. Nga hetimi administrativ i Komisionit rezultoi e provuar se sipas pasqyrave financiare të shoqërisë “***” sh.p.k., për vitin ushtrimor 2010, në seksionin “Pasive Afatshkurtra/Hua dhe Parapagime”, paraqitet zëri “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve” me balancë 9.968.097 lekë, në datën 31.12.2010 dhe në pasqyrat financiare të vitit 2009, ky zë paraqitet me vlerën 0 (zero), çka nënkupton se nga ana e personit të lidhur/bashkëshortit është shtuar me 9.968.097 lekë gjatë vitit 2010. Më tej, gjatë viteve në vazhdim, kjo shumë në zërin “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve” u pakësua në vitin 2011 në shumën 5.426.034 lekë dhe në vitin 2014.

20.6.19. Në kushtet që bashkëshorti i subjektit në cilësinë e ortakut/administratorit të shoqërisë ka detyrimin ligjor të justifikojë burimet e ligjshme të krijimit të kësaj shume, pretendimet e subjektit lidhur me lapsuset apo gabimet materiale të ekspertit kontabël mbeten në nivel deklarativ dhe nuk kanë vlerë provuese për këtë proces.

20.6.20. Referuar dokumentacionit ligjor të administruar nga ana e Komisionit, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit është ortak dhe administrator i shoqërisë “***” sh.p.k. dhe, si i tillë, ka pasur tagrin e verifikimit dhe konfirmimit të këtyre pasqyrave financiare të dorëzuara në organet tatimore dhe në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, pra i gjithë dokumentacioni i dorëzuar pranë organeve kompetente është firmosur nga personi i lidhur në cilësinë e ortakut dhe administratorit të shoqërisë. Për rrjedhojë, nuk mund të justifikohet pretendimi i subjektit se është një lapsus apo gabim material i ekspertit kontabël.

20.6.21. Gjithashtu, vlen të vihet theksi në faktin që ky gabim material ka vazhduar deri në vitin 2014 dhe nuk është konstatuar, qoftë nga personi i lidhur/ortaku, por edhe nga ana e ekspertit kontabël.

20.6.22. Në përfundim, duke pasur parasysh se: (i) personi i lidhur/ortaku i shoqërisë “***” sh.p.k. në pasqyrat financiare të shoqërisë e ka vlerën 0 (zero) në zërin “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve”; (ii) në pasqyrat financiare për vitin 2010 ka shtuar shumën 9.968.097 lekë në zërin “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve”; (iii) më tej, në vitet në vijim, deri në vitin 2014 ka vazhduar të jetë ky zë; (iv) pasqyrat financiare janë verifikuar dhe firmosur nga ana e personit të lidhur si ortak/administrator i shoqërisë – Komisioni arrin në përfundimin se kjo shumë është shtesë nga ana e personit të lidhur dhe duhet të vërtetohet burimin e ligjshëm të krijimit.

20.6.23. Në analizë të parashtrimeve sa më sipër, edhe në rast se do të merrnim në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit se: (i) transaksionet e kryera në vitin 2009 për shumën 9.968.097 lekë – e pasqyruar në zërin “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve” - korrespondon me totalin e dy transaksioneve bankare të vitit 2009, *depozita me afat në Raiffeisen Bank sha në shumën 7.900.000 lekë dhe transferta e kryer në shoqërinë *** ShPK në shumën 2.068.100 lekë, pra duket se shuma 7.900.000 lekë dhe shuma 2.068.100 lekë, vinë nga shlyerja e faturave nga klientët; ii) nga dokumentacioni i depozituar kokretisht pasqyrat financiare të aktivitetit tregtar provohet se huaja prej 15.000.000 lekë ishte shlyer nga pagesat e kryera nga klientët, iii) pretendime për lapsuse të ekonomistes, në raport me të dhënat e tjera trajtuar në këtë vendim, çmohen nga trupi gjykues si rrethana që e vendosin Komisionin në pamundësi për të arritur në një konkluzion real të kësaj çështje, e për rrjedhojë konkludon se problematikën e tjera të vlerësuar në*

procesin e rivlerësimit për këtë subjekt janë të mjaftueshme për aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

20.6.24. Në konkluzion, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk paraqitën dokumentacion ligjor justifikues lidhur me shumën 9.968.097 lekë, shtuar në vitin 2010, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, duke rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar krijimin e kësaj shume.

21. Analiza financiare

21.1. Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1997 – 2016, duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur, duke përfshirë në analizën financiare të periudhës 2005 – 2016 babain e subjektit dhe në analizën financiare të periudhës 2005 – janar 2010 të ndjerën/nënën e subjektit (kjo analizë paraqet të dhënat në fund të çdo viti kalendarik, përkundëjt vlerës së kaluar në barrë prove, e cila paraqet balancën negative në datën e blerjes së pasurisë).

21.2. Më tej, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: *(a) Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në datat e krijimit të pasurive, në një vlerë totale prej 8.527.079 lekësh, të detajuar si në vijim: (i) subjekti dhe prindërit kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 631.777 lekë për investimin në shtesën e apartamentit (barra e provës kaluar në paragrafin përkatës në rezultatet e hetimit administrativ); (ii) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në periudhën 1997 – 2003, në vlerën 1.318.906 lekë, për krijimin e depozitës bankare pranë Raiffeisen Bank (nr. ***) dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera (barra e provës kaluar në paragrafin përkatës në rezultatet e hetimit administrativ); (iii) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 84.341 lekë për krijimin e depozitës bankare pranë Raiffeisen Bank (nr. ***), pasi prindërit e subjektit nuk justifikojnë plotësisht me burime të ligjshme shumën e dhuruar (barra e provës kaluar në paragrafin përkatës në rezultatet e hetimit administrativ); (iv) bashkëshorti i subjektit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 1.237.002 lekë për kryerjen e depozitimit prej 2.000.000 lekësh në datën 30.4.2003, pasi nuk provohet shuma e pretenduar e të ardhurave nga emigracioni (barra e provës kaluar në paragrafin përkatës në rezultatet e hetimit administrativ); (v) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën 1.100.000 lekë për kryerjen e depozitimit prej 1.100.000 lekësh në datën 18.5.2004, pasi mungon dokumentacioni ligjor justifikues për të provuar zhvillimin e aktivitetit të bashkëshortit si person fizik gjatë viteve 2003 – 2004 e, për rrjedhojë, nuk provohen as të ardhurat e realizuara (barra e provës kaluar në paragrafin përkatës në rezultatet e hetimit administrativ); (vi) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 1.000.000 lekë për krijimin e depozitave pranë OTP Bank, pasi nuk provohet që të ardhurat e përfituara nga nëna e subjektit nga shitja e tokës (burimi fillestar për depozitimin e datës 29.9.2006) të jenë arkëtuar përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes në datën 21.3.2007 (barra e provës kaluar në paragrafin përkatës në rezultatet e hetimit administrativ); (vii) subjekti dhe personat e lidhur*

kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për shtimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2010, në vlerën 1.029.846 lekë (barra e provës kaluar në paragrafin përkatës në rezultatet e hetimit administrativ); (viii) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 1.890.000 lekë, për blerjen e automjetit tip “Chevrolet”, në datën 14.1.2012 (barra e provës kaluar në paragrafin përkatës në rezultatet e hetimit administrativ); (ix) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 235.207 lekë për blerjen e automjetit tip “Nissan”, në datën 3.2.2007 (barra e provës kaluar në paragrafin përkatës në rezultatet e hetimit administrativ).

b) Lidhur me shumën 9.968.097 lekë, mbetet e paqartë paraqitja në zërin “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve”, pasi deklarimi i subjektit nuk përputhet plotësisht me dokumentacionin e administruar e, për rrjedhojë, duket se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka kontribuar në shoqëri me këtë vlerë gjatë vitit 2010, çka e vendos atë në kushtet e justifikimit të burimeve të ligjshme të kësaj shume. Për rrjedhojë ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues të kësaj shume (barra e provës kaluar në paragrafin përkatës në rezultatet e hetimit administrativ).

21.3. Bashkëlidhur rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni i dërgoi subjektit të rivlerësimit analizën financiare (përfshirë faqet shpjeguese) dhe metodikën e analizës financiare, duke e vënë në dijeni se kjo analizë do të ndryshojë në varësi të provave që do të paraqesë subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës.

21.4. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se:

21.5. Krahas pretendimeve të trajtuara në seksionin përkatës të këtij vendimi (të ardhurat nga aktiviteti i personit fizik, të ardhurat nga emigracioni, data e blerjes së automjetit Chevrolet, përdorimet e kursimeve të prindërve), subjekti shpjegoi se, referuar analizës financiare të përpiluar nga ana e tij për periudhën 1997 – 2003, rezulton një mungesë burimesh prej 268.906 lekësh. Kjo diferencë, sqaroi subjekti, është krijuar nga depozitat në emër të bashkëshortit pranë Raiffeisen Bank. Përgjigjja e dhënë nga Raiffeisen Bank nuk është shteruese, pasi ata nuk arritën të gjenin të gjithë regjistrat dhe të gjitha depozitat në ish-Bankën e Kursimeve, për këtë arsye shtesa e depozitës trajtuar nga Komisioni në shumën 517.488 lekë duhet marrë me rezerva, pasi nuk rezulton e provuar se kjo shumë është shtesë në principal dhe jo të ardhura nga interesi i depozitës të krijuar shumë herët nga bashkëshorti në ish-Bankën e Kursimeve. Megjithatë, edhe nëse konsiderohet e tillë, shtesa është kryera para emërimit tim në detyrën e gjyqtarit, sqaroi subjekti.

21.6. Subjekti paraqiti analizën financiare të hartuar nga ana e tij, ku evidentohet një balancë negative totale në shumën 405.231 lekë, pamundësi e cila bazuar në parimet e objektivitet dhe proporcionalitetit, nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore, duke qenë se në jurisprudencën e Komisionit dhe të Kolegjit është konsoliduar qëndrimi se diferenca të tilla nuk përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore shkarkim nga detyra, përfundoi subjekti.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

21.7. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të

administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyetën se:

21.8. Lidhur me interesat bankarë të depozitës bankare pranë ish-Bankës së Kursimeve, Komisioni çmon të theksojë se referuar analizës financiare, për këtë depozitë janë përlllogaritur 39.346 lekë të ardhura nga interesat (referojuni tabelës nr. 5 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht).

21.9. Në përfundim të analizave konkluduese të shprehura në këtë vendim, tabela financiare e përmbledhur, paraqitet në vijim:

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete cash	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime	Balanca negative në fund të vitit	Balanca në momentin e krijimit
1997-2003	190,000	0	3,331,890	4,422,325	0	1,748,508	-848,073	-848,073	-848,073
2004	0	0	1,306,361	1,074,404	0	502,513	-734,470	-734,470	-1,100,000
2005	1,476,000	0	150,994	1,883,011	1,000,000	1,068,088	187,930	0	0
2006	0	0	85,148	1,846,327	0	1,262,269	498,911	0	-1,000,000
2007	350,000	0	604,287	3,490,183	0	1,521,928	1,013,969	0	-235,207
2008	0	0	2,362	2,763,225	0	1,402,497	1,358,366	0	0
2009	0	4,200,000	-3,311,985	3,416,218	0	1,502,689	1,025,514	0	0
2010	0	-4,200,000	6,269,126	2,235,787	0	1,196,507	-1,029,846	-1,029,846	-1,029,846
2011	0	0	-274,509	2,921,808	0	1,465,592	1,730,725	0	0
2012	1,890,000	0	52,106	3,295,243	0	1,412,086	-58,950	-58,950	-1,890,000
2013	0	0	-482,095	2,448,691	0	1,017,566	1,913,219	0	0
2014	0	0	25,193	2,843,726	0	1,533,179	1,285,355	0	0
2015	5,781,300	0	5,000,536	14,537,261	0	1,863,353	1,892,072	0	0
2016	243,486	0	16,022,887	22,773,216	0	2,886,717	3,620,126	0	0
TOTAL	9,930,786	-	28,782,300	69,951,425	1,000,000	20,383,491	11,854,848	-2,671,339	-6,103,126

22. Në përfundim të rivlerësimit të kriterit të kontrollit të pasurisë, në momentin e krijimit të këtyre pasurive, rezultoi se:

- i. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare, **në shumën 1.000.000 lekë**, për krijimin e depozitave pranë OTP Bank në vitin 2006.
- ii. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në periudhën 1997 – 2003, **në shumën 848.073 lekë**, për krijimin e depozitës bankare pranë Raiffeisen Bank (me nr. ***) dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera.
- iii. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare **në shumën 1.890.000 lekë**, për blerjen e automjetit tip “Chevrolet”, në datën 14.1.2012.
- iv. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 2.129.846 lekë për krijimin e depozitave pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe Union Bank, pasi: (a) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare **në shumën 1.100.000 lekë** për kryerjen e depozitimit në datën 18.5.2004; (b) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për shtimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2010, **në vlerën 1.029.846 lekë**.

- v. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 235.207 lekë për blerjen e automjetit tip “Nissan”, në datën 3.2.2007.
- vi. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar krijimin e shumës prej 9.968.097 lekësh, shtuar në zërin “Të drejta e detyrime ndaj ortakëve” të pasqyrave financiare për vitin 2010.

22.1. Referuar konkluzioneve mbi balancat negative në momentin e krijimit të pasurive të trajtuara më lart, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 6, 103, 126 lekë, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

22.2. Në konkluzion, trupi gjykues i Komisionit çmon se subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronjat “b” e “d” të ligjit nr. 84/2016, të cilat, të vlerësuara së bashku, të çojnë në konkluzionin se duhet zbatuar neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i cili e vë atë në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, si një shkak ligjor për zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-DSIK)²⁷⁹ ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit Herila Çela ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim ka dërguar një raport me shkresat nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 14.7.2023, të KDZH-së, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

2. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit Herila Çela: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Si konkluzion, Grupi i Punës konstaton *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Herila Çela.*

3. Me shkresën nr. *** prot., datë 21.6.2022, AKSIK-ja informon se nuk disponon të dhëna të përditësuara për përfshirje në veprimtari të kurdërligjshme për subjektin e rivlerësimit.

Më tej, Komisioni, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 11.7.2023, ka kërkuar përsëri përditësimin e raportit me materialet shtesë që mund të disponohen deri aktualisht, si dhe deklasifikimin e plotë të raportit të rishikuar. Sipas informacionit të vënë në dispozicion me anë të shkresës nr. *** prot.,

²⁷⁹ Tani emërtuar Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK).

datë 17.7.2023, është përcjellë raporti i deklasifikuar dhe referuar kësaj shkrese nuk rezulton të jenë paraqitur informacione mbi të dhëna shtesë lidhur me subjektin e rivlerësimit, çka nuk e ndryshon konstatimin për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës.

4. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit Herila Çela ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, duke konkluduar se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Subjekti i rivlerësimit Herila Çela ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 9.7.1995. Me vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. ***, datë 8.2.1996, është emëruar ndihmës gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, detyrë të cilën e ka mbajtur deri në maj të vitit 2000. Më pas, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. ***, datë 21.10.2003, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku vazhdon edhe aktualisht.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit, në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka përgatitur një raport për vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit Herila Çela. Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (d) aftësitë personale dhe angazhimi profesional – bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (ii) 5 dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

Aftësitë profesionale

3. *Njohuritë ligjore* – në dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit kualifikon drejt marrëdhënien objekt shqyrtimi gjyqësor, i kushton rëndësi identifikimit të kërimit të palëve, dëgjon kërkimet procedurale të tyre, shprehet me urdhra dhe vendime të ndërmjetme të arsyetuara.

4. *Arsyetimi ligjor* – vendimet gjyqësore plotësojnë elementet e përcaktuara nga ligji, janë të ndara në tri pjesë dhe janë të kuptueshme. Struktura është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor.

Aftësitë organizative

5. *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë* – sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit subjekti Herila Çela

ka gjykuar gjithsej 1822 çështje gjyqësore, nga të cilat 1495 çështje civile dhe 327 çështje penale. Sipas të dhënave statistikore rezulton se subjekti për periudhën e rivlerësimit ka gjykuar 895 çështje civile me palë kundërshtarë e 127 çështje familjare, gjithsej 1022 çështje gjyqësore. Rrjedhimisht, ngarkesa e saj sasiore ka qenë dyfish mbi standardin minimal. Nga vëzhgimi i dosjeve konstatohet se 2 prej çështjeve janë gjykuar jashtë afatit standard, më konkretisht sa vijon:

- Çështja e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 27.10.2015, me palë paditëse E. Ç. etj., të paditur E. Z. etj., me objekt “Detyrimin për njohjen bashkëpronar në 1/6 pjesë e objektit të përfutur si rrjedhojë e trashëgimisë nga gjyshi Th. Z.”. Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 10 muaj e 15 ditë, jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

6. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e saj, duke sqaruar se *në rastin konkret rezulton të jenë zhvilluar 15 seanca përgatitore/gjyqësore. Shkaku i kalimit të afatit rezulton të jetë respektimi i të drejtave procedurale të palëve për t’u njohur me aktet dhe provat dhe për të paraqitur parashtrësat e konkluzionet me shkrim. Ndërkohë, nga ana e gjykatës rezulton të jenë shtyrë vetëm dy seanca gjyqësore, por që ka të bëjë me një shkak objektiv, ndërsa të gjitha seancat e tjera janë shtyrë me kërkesë të palëve ndërgjyqëse dhe për mungesë të njoftimit të tyre²⁸⁰. Në kushte të tilla, duke marrë në konsideratë sjelljen e palëve gjatë gjykimit, kompleksitetin e çështjes dhe plotësimin e gjithë kërkesave të nevojshme procedurale, tejkalimi i afatit referues ligjor i kohëzgjatjes së këtij procesi është i justifikueshëm, pasi nuk është shkaktuar nga sjellja e gjykatës.*

7. Vlerësimi ligjor i Komisionit – Komisioni analizoi dosjen gjyqësore të paraqitur nga subjekti në cilësinë e provës në prapësime, nga ku rezultoi se nga ana e gjykatës janë shtyrë vetëm dy seanca gjyqësore për shkaqe objektive (arsye shëndetësore dhe njoftimi i subjektit për t’u paraqitur pranë ILDKPKI-së). Seancat e tjera janë shtyrë me kërkesë të palëve dhe nuk rezulton të jetë bërë pengesë gjykata për zgjatjen e afatit të gjykimit apo zvarritjen e këtij procesi²⁸¹. Nga sa rezultoi, kohëzgjatja e gjykimit tej afatit standard nuk ka ardhur si shkak i mosorganizimit të mirë të punës nga ana e subjektit dhe as të ketë pasur shtyrje të seancave për shkaqe të pamotivuara. Trupi gjykues vlerëson se tejkalimi i afateve të gjykimit në shqyrtimin e kësaj çështjeje nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi

²⁸⁰ Subjekti i rivlerësimit Herila Çela deklaroi se qëllimi parësor i gjykatës është që të kujdeset për garantimin e të drejtave procedurale të palëve, me qëllim dhënien e një vendimi të drejtë, të bazuar në prova të marra dhe të debatuar gjatë gjykimit. Njëkohësisht, detyrë e gjykatës (për më tepër e gjykatës së faktit) është hetimi i plotë dhe i gjithanshëm i çështjes gjyqësore, me qëllim ezaurimin e gjithë mjeteve provuese të nevojshme për gjykim.

²⁸¹ Komisioni analizoi të gjitha seancat gjyqësore referuar procesverbaleve të gjykimit: Seanca e datës 29.1.2015 është shtyrë me qëllim përsëritjen e njoftimeve për palën e paditur; seanca e datës 9.2.2015 është ndërprerë me qëllim dërgimin e kërkesës për përjashtimin e trupit gjykues. Në seancën e datës 24.2.2015 është vendosur rrëzimi i kërkesës për përjashtim. Seanca e datës 26.2.2015 është shtyrë me qëllim përsëritjen e njoftimit për palën e paditur; seanca e datës 9.2.2015 nuk u zhvillua, për shkak se subjekti nuk është paraqitur, pasi me shkresën nr. *** prot., datë 12.3.2015, është komunikuar të paraqitet në ILDKPKI. Seanca e datës 13.4.2015 nuk u zhvillua, pasi përkon me ditë pushimi zyrtar. Seanca e datës 4.5.2015 u shty me kërkesë të palës paditëse, pasi nuk ishte paraqitur avokati i saj. Seanca e datës 28.5.2015 është shtyrë me kërkesë të palëve, për të vazhduar në datën 2.6.2015. Në seancën e datës 2.6.2015 është vendosur kalimi në seancë gjyqësore dhe njoftimin e palës së paditur e ka marrë përsipër avokati i saj. Seanca e datës 24.6.2015 është shtyrë me kërkesë të palës paditëse për t’u njohur me provat e palës së paditur. Seanca e datës 16.7.2015 është shtyrë me kërkesë të palës së paditur për të paraqitur prova të tjera. Seanca e datës 9.10.2015 është shtyrë për t’u dhënë kohë palëve të paraqesin konkluzionet përfundimtare. Seanca gjyqësore e datës 14.10.2015 nuk u zhvillua, për shkak se subjekti ka qenë sëmurë, bashkëngjitur gjendet raporti për paaftësi në punë. Seanca e datës 16.10.2015 u shty, pasi nuk u paraqit pala paditëse dhe përfaqësuesit e saj. Seanca e datës 22.10.2015 u mbajt dhe, për shkak të volumit të dosjes, në datën 27.10.2015 do të shpallet vendimi i arsytuar.

gjykues në vlerësimin tërësor, që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

8. Çështja civile nr. *** regj., datë 9.12.2013, që i përket paditësit M. L., kundër të paditurës L. M., me objekt “Zgjidhja e kontratës së qirasë”. Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 10 muaj e 5 ditë, jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit (në këtë afat përfshihet edhe muaji gusht).

9. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e saj, duke sqaruar se *në rastin konkret rezulton të jenë zhvilluar 12 seanca përgatitore/gjyqësore. Shkaku i kalimit të afatit rezulton të jetë respektimi i të drejtave procedurale të palës së paditur, saktësisht njoftimi i së paditurës për gjykimin. Për shkak të mungesës së njoftimit personalisht të së paditurës, gjykata ka proceduar me njoftimin me shpallje publike, që për nga natyra e tij kërkon një afat më të gjatë kohor (të paktën 20 ditë afishim për çdo seancë). Ndërkohë, nga ana e gjykatës rezulton të jetë shtyrë vetëm një seancë gjyqësore, por që ka të bëjë me një shkak objektiv. Në kushte të tilla, me qëllim garantimin e të drejtës së të paditurit për t’u njoftuar për procesin, tejkalimi i kohëzgjatjes së këtij procesi është i justifikueshëm, pasi nuk është shkaktuar nga sjellja e gjykatës.*

10. Vlerësimi ligjor i Komisionit – Komisioni analizoi dosjen gjyqësore të paraqitur nga subjekti në cilësinë e provës në prapësime, nga ku rezultoi se nga ana e gjykatës është shtyrë vetëm një seancë gjyqësore për shkaqe objektive (arsye shëndetësore). Seancat e tjera janë shtyrë me kërkesë të palëve dhe nuk rezulton të jetë bërë pengesë gjykata për zgjatjen e afatit të gjykimit apo zvarritjen e këtij procesi²⁸². Sa rezultoi, kohëzgjatja e gjykimit tej afatit standard nuk ka ardhur si rezultat i mosorganizimit të mirë të punës nga ana e subjektit, si dhe nuk rezultoi të ketë shtyrje të seancave për shkaqe të pamotivuara. Trupi gjykues vlerëson se tejkalimi i afateve të gjykimit në shqyrtimin e kësaj çështjeje nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por mbetet një element, i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

11. Komisioni konstatoi se aftësia e subjektit për gjykimin e shpejtë të çështjeve është bërë edhe objekt ankesash (trajtuar më poshtë), ndërkohë lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore rezultoi se janë arsyetuar brenda afatit ligjor 10-ditor.

²⁸² Komisioni analizoi të gjitha seancat gjyqësore referuar procesverbaleve të gjykimit: Seanca 1 përgatitore e datës 21.1.2014 nuk u zhvillua, për shkak se gjyqtarja e çështjes është e sëmurë me raport mjekësor (bashkëlidhur raporti). Seanca e dytë përgatitore e datës 18.2.2014 u shty me qëllim përsëritjen e njoftimit. Seanca 3 përgatitore e datës 11.3.2014 u shty me qëllim përsëritjen e njoftimit. Seanca e 4 përgatitore e datës 31.3.2014 u shty, me qëllim njoftimin e palës së paditur me adresë e numër telefoni të paraqitur. Seanca e 5 përgatitore e datës 9.4.2014 u shty, pasi nuk rezulton marrja dijani, njoftimi është kthyer me shënimin adresë e pamjaftueshme. Gjykata vendosi të përsërisë edhe një herë njoftimin në adresën e dhënë nga përfaqësuesi i palës paditëse dhe i komunikon se, në rast se njoftimi do i kthehet i pavlefshëm, padia do i kthehet me të meta. Seanca e 6 përgatitore e datës 28.4.2014 u shty, pasi nuk rezulton marrja dijani, njoftimi është kthyer me shënimin i panjohur. Përfaqësuesi të përsëritet edhe një herë njoftimi. Gjykata vendosi t’i japë kohë palës paditëse të plotësojë të metat e padisë në lidhje me adresën e palës së paditur. Seanca e 7 përgatitore e datës 13.5.2014 u shty, pasi nuk u paraqit pala e paditur, nuk rezulton marrja dijani, nuk është realizuar njoftimi për këtë palë. Përfaqësuesi i palës paditëse për të plotësuar të metat ka marrë vërtetim, ku rezulton se nuk ka adresë banimi në qytetin e Vlorës. Gjykata në bazë të verifikimeve konstatoi se të metat e padisë janë plotësuar dhe vendosi njoftimin me shpallje. Seanca e 8 përgatitore e datës 2.6.2014, relatohet padia e paraqiten provat, ku vërtetohet se e paditura nuk ka bërë derdhje të shumës. Gjykata kalon çështjen në seancë gjyqësore. Seanca e 9 gjyqësore e datës 18.6.2014 shtyhet, me qëllim përsëritjen e shpalljes për palën e paditur. Seanca e 10 gjyqësore e datës 8.7.2014, subjekti vendosi të pranojë kërkesën e avokatit, me qëllim përsëritjen e shpalljes për palën e paditur. Seanca e 11 gjyqësore e datës 11.9.2014 është zhvilluar, në përfundim subjekti vendosi të deklarojë të mbyllur hetimin gjyqësor dhe fton palët për konkluzionet përfundimtare. Seanca 12 gjyqësore e datës 12.9.2014 është shtyrë, me qëllim shpalljen e arsyetuar të vendimit. Në seancën 13 gjyqësore të datës 15.9.2014 u disponua me dhënien e vendimit gjyqësor.

12. Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore – Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje në një kohë të shkurtër, duke filluar nga data e marrjes së çështjes me short, seancat gjyqësore janë caktuar përgjithësisht në një afat kohor të arsyeshëm. Në të gjitha çështjet civile, vendimi i kalimit të çështjes në seancë gjyqësore nuk është hartuar me akt të veçantë, por është pjesë e procesverbalit të veprimeve përgatitore, ndërsa urdhërimi për seancën përgatitore evidentohet vetëm në 2 raste. Gjatë gjykimit janë identifikuar veprimet procedurale që duhen kryer, duke nxjerrë urdhra e vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre.

13. Aftësia për të administruar dosjet – Nga vëzhgimi i dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, përgjithësisht nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në to.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

14. Etika në punë – Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për subjektin Herila Çela përgjatë periudhës së rivlerësimit rezulton që ministri i Drejtësisë ka propozuar pranë ish-KLD-së një kërkesë për procedim disiplinor për “Dërgim për 1-2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel, jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtarja ka emërimin e saj”. Kërkesa gjatë trajtimit të saj është ndryshuar nga vetë ministri në masën “Vërejtje me paralajmërim”, masë e cila është miratuar nga ish-Këshilli.

15. Integriteti – Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

16. Paanësia – Në dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të mos ketë respektuar rregullat procedurale, që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

17. Aftësitë e komunikimit – Në procesverbalet gjyqësore në dosjet gjyqësore të vëzhguara, është konstatuar se subjekti Herila Çela komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse në gjykim, si gjatë veprimtarisë përgatitore e asaj gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

18. Aftësia për të bashkëpunuar – Sipas të dhënave, arsyetimet e vendimeve janë realizuar brenda afateve ligjore, çka tregon se bashkëpunimi i subjektit me administratën gjyqësore edhe në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.

Hetimi i kryer nga Komisioni

19. Pavarësisht raportit të dërguar nga KLGJ-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti, pesë dosjet e shkurtra dhe ankesat e paraqitura, duke

kërkuar informacion pranë Këshillit të Lartë të Gjyqësor²⁸³, Ministrisë së Drejtësisë²⁸⁴, Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë²⁸⁵ në lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit dhe masat disiplinore të marra ndaj saj nga periudha 2006 e deri më sot. Më tej është kërkuar informacion pranë Prokurorisë së Përgjithshme²⁸⁶ dhe Prokurorisë së Posaçme e Krimit të Organizuar²⁸⁷, nëse ka të regjistruar procedim penal, mosfillim ose pushim në ngarkim të subjektit.

20. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 2.4.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioni vëren se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar këto kallëzime penale, për të cilat është marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. *** , datë 8.11.2016; nr. *** , datë 30.11.2016; nr. *** , datë 8.1.2018; nr. *** , datë 4.7.2018. Me anë të shkresës nr. *** prot., datë 2.8.2023, Komisioni kërkoi administrimin e kallëzimeve penale. Me anë të shkresës nr. *** prot., datë 2.8.2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka vënë në dispozicion kallëzimet penale si vijon: (i) nr. *** , viti 2023; (ii) nr. *** , viti 2018, (iii) nr. *** , viti 2016; (iv) nr. *** , viti 2021; (v) nr. *** , viti 2021 – për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Më tej, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë informon se ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar materiali kallëzues nr. *** , datë 3.5.2019, për të cilin është marrë vendimi për mosfillimin e procedimit penal.

21. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 5.2.2021, të Prokurorisë së Posaçme dhe Krimit të Organizuar, rezultoi se në emër të subjektit Herila Çela nuk është regjistruar ndonjë procedim penal pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

22. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 13.7.2023, të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, Komisioni vëren se ndaj subjektit janë depozituar 21 ankesa, nga të cilat 17 janë arkivuar dhe 4 prej tyre ndodhen në fazën e shqyrtimit fillestar.

23. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 24.2.2021, të Ministrisë së Drejtësisë, Komisioni vëren se ndaj subjektit janë depozituar 9 ankesa²⁸⁸. Pasi u analizuan në mënyrë të detajuar ankesat e paraqitura, vlerësohet se nuk rezultuan problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit, si dhe pretendimet ngrihen mbi themelin e vendimit, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga ana e Komisionit. Gjithashtu, rezulton se Ministria e Drejtësisë ka paraqitur dy kërkesa për procedim disiplinor ndaj subjektit, sa vijon:

23.1. Ministri i Drejtësisë, me shkresën nr. *** prot., datë 6.2.2014, i ka dërguar Këshillit të Lartë të Drejtësisë kërkesën për procedimin disiplinor ndaj gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Herila Çela. Mbi bazën e shkeljeve të konstatuara, ministri i Drejtësisë ka kërkuar që ndaj subjektit të rivlerësimit të merret masa disiplinore “Dërgim për 1-2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel, jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij”. Në përfundim të shqyrtimit të këtij

²⁸³ Shkresë nr. *** prot., datë 1.2.2021.

²⁸⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 1.2.2021.

²⁸⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 30.6.2023.

²⁸⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 1.2.2021.

²⁸⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 1.2.2021.

²⁸⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 7.3.2013, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për ankesën e znj. O. H.; ankesa nr. *** prot., datë 2.11.2017, e z. Xh. B.; ankesa nr. *** prot., datë 29.9.2017, e z. V. S.; ankesa nr. *** prot., datë 27.12.2017, e z. K. N.; ankesa nr. *** prot., datë 4.4.2018, e z. L. H.; ankesa nr. *** prot., datë 26.4.2018, e Termocentralit Vlorë sh.a.; ankesa nr. *** prot., datë 24.6.2019, e z. K. B.; ankesa nr. *** prot., datë 3.9.2019, e znj. E. Z.; ankesa nr. ** prot., datë 7.2.2020, e z. L. Z.

procedimi, në seancën plenare të datës 21.7.2014 në ish-KLD, u ndryshua kërkesa për llojin e masës disiplinore, duke kërkuar përfundimisht marrjen e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”.

23.2. Kërkesa për procedim ka marrë shkas nga shkeljet që ka konstatuar Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të evidentuara në verifikimin e 4 ankesave nga publiku, sa më poshtë vijon:

1) Lidhur me çështjen civile nr. ***, datë 4.10.2011, me palë ndërgjyqëse - paditës V. S., të paditur ZVRPP Vlorë – me objekt “Detyrim për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme”. Evidentohet se: (i) Gjykimi i çështjes ka zgjatur për një periudhë prej 6 muajsh e 26 ditë, në shkelje të afatit 6-mujor të parashikuar në vendimin e KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimitarisë gjyqësore”; (ii) Subjekti i rivlerësimit është në shkelje të neneve 154/a dhe 199 të Kodit të Procedurës Civile, në vendimmarrjen e saj për lënien e afatit prej 7 ditësh paditësit për plotësimin e të metave, sjelljen e dëshmimeve të trashëgimisë. Nga dita që gjykata jep një vendim përfundimtar civil e deri në ditën që ai të marrë formë të prerë pa u ankimuar, duhet të kalojnë 15 ditë. Pra, del se afati që i ka lënë gjyqtarja paditëses për sjelljen e dëshmisë së trashëgimisë ishte objektivisht dhe ligjërisht i pamundur për t’u realizuar prej përfaqësuesit të saj; (iii) Subjekti ka pranuar kërkesën e palës paditëse për përjashtimin e saj pa asnjë shkak ligjor të parashikuar nga neni 72 i Kodit të Procedurës Civile.

2) Lidhur me çështjen civile nr. ***, datë 22.2.2011, me palë ndërgjyqëse - paditës K. D., të paditur E. B., person i tretë Banka Popullore *** – me objekt “Detyrimin e të paditurit për shpërblim për përdorim sendi, si dhe të ardhurat nga dhënia me qira e sendit në bashkëpronësi”, gjykimi i çështjes ka zgjatur për një periudhë prej 1 viti, 9 muaj e 5 ditësh, në shkelje të afatit të caktuar nga vendimi i KLD-së. Kjo sjellje konsiderohet si zvarritje e pajustificuar dhe e përsëritur e veprimeve procedurale të kryera gjatë ushtrimit të funksionit prej saj.

3) Lidhur me çështjen civile nr. ***, datë 29.12.2009, me palë ndërgjyqëse - paditës M. T., etj., të paditur Q. F., etj. – me objekt “Goditje për falsitet të vendimit nr. ***, datë 30.5.1995, të KKKP Vlorë, etj...”, gjykimi i çështjes ka zgjatur 1 vit, 10 muaj e 10 ditë, në shkelje të afatit të caktuar nga vendimi i KLD-së. Kjo sjellje konsiderohet si zvarritje e pajustificuar dhe e përsëritur e veprimeve procedurale të kryera gjatë ushtrimit të funksionit prej subjektit të rivlerësimit.

4) Lidhur me çështjen civile nr. ***, datë 29.12.2009, me palë ndërgjyqëse - paditës D. R., kundër të paditurit Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave – me objekt “Ndryshim i pikës 1 të vendimit nr. ***, datë 23.2.1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave etj...”, gjykimi i çështjes ka zgjatur për një periudhë prej 1 viti e 3 muajsh (7 muaj e 18 ditë nga gjyqtarja Herila Çela), në shkelje të dukshme të afatit të caktuar në vendimi i KLD-së. Kjo sjellje konsiderohet si zvarritje e pajustificuar dhe e përsëritur e veprimeve procedurale të kryera gjatë ushtrimit të funksionit prej saj.

24. Shkeljet e konstatuara nga subjekti Herila Çela kanë konsistuar në mosrespektimin në mënyrë të vazhdueshme, të përsëritur dhe të pajustificuar të dispozitave procedurale civile, duke sjellë pasojë për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim, si dhe për dhënien e drejtësisë²⁸⁹. Këto shkelje

²⁸⁹ KLD-ja vlerëson se respektimi i dispozitave procedurale, të cilat lidhen me gjykimin e një çështjeje brenda një afati të arsyeshëm, në mënyrë që të mos cenohen të drejtat kushtetuese të palëve në proces dhe të mos pengohet dhënia e drejtësisë, është i lidhur

kanë diskredituar rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit²⁹⁰. Sa rezulton, KLD-ja ka vendosur pranimin e kërkesës së ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të subjektit të rivlerësimit dhe, me vendimin nr. ***, datë 21.7.2014, ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” ndaj gjyqtarës Herila Çela. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 5.12.2014, ka vendosur pranimin e padisë së subjektit dhe shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 21.7.2014, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Mbi rekursin e KLD-së, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 1.3.2017, ka vendosur “Mospranim të rekursit të paraqitur nga pala e paditur, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, kundër vendimit nr. ***, datë 5.12.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë”.

25. Më tej, nga hetimi i Komisionit rezulton se ministri i Drejtësisë, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 8.8.2018, i ka paraqitur Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor ndaj subjektit Herila Çela, lidhur me vendimin nr. ***, datë 6.8.2018, ku është vendosur pranimi i kërkesës së kërkuesit T. M., zëvendësimi i masës së sigurimit personal “Arrest në burg” me masën e sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale. Rezulton se i pandehuri, për të cilin subjekti ndryshoi masën e sigurimit personal, është person me precedent penal dhe i dyshuar si i përfshirë në krime të rënda, përplasje me armë dhe moszbatim të vendimeve të gjykatave, rrethana të cilat nuk janë vlerësuar nga gjyqtarja Herila Çela.

26. Komisioni hetoi lidhur me këtë çështje dhe, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 9.1.2023, administroi nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë fashikullin hetimor të të pandehurit T. M., si dhe vendimet e dhëna nga subjekti lidhur me këtë procedim penal, nga ku rezultoi sa vijon: *Rrethanat e faktit* – Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 28.3.2018, kishte caktuar ndaj shtetasit T. M. masën e sigurimit “Arrest në shtëpi”, masë të cilën i pandehuri e kishte thyer. Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Vlorë, në funksion të verifikimit të zbatimit të masës së sigurimit, kanë shkuar në banesën e të pandehurit dhe nuk e kishin gjetur aty. Më vonë, ai është arrestuar në flagrancë si i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake në vendet publike”, “Prodhim për shitje të narkotikëve” dhe “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”, parashikuar nga nenet 278/1, 283/1 dhe 323/1 të Kodit Penal. Për këtë arsye, prokuroria paraqiti kërkesën për caktimin e masës “Arrest në burg”. Subjekti Herila Çela, me anë të vendimit nr. ***, datë 25.6.2018, vendosi pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe caktimin e masës “Arrest në burg”.

drejtpërsëdrejti me respektimin e parimit të zhvillimit dhe përfundimit të një procesi brenda një afati të arsyeshëm. Me afat të arsyeshëm ligjor kuptohet jo vetëm koha që merr shqyrtimi i çështjes deri në shpalljen e vendimit përfundimtar nga ana e gjykatës, por edhe koha që i nevojitet gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar. Është e vërtetë se respektimi i afatit të arsyeshëm ligjor varet nga shumë faktorë të procesit të gjykimit, të cilët janë të lidhur dhe ndikojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin e këtij procesi, siç mund të jenë: sjelljet e palëve në proces, kompleksiteti i çështjes, përkushtimi dhe aftësia e gjykatës dhe administratës gjyqësore për përfundimin në kohë të procesit dhe ushtrimin e detyrës në përputhje me ligjin etj. Afati i arsyeshëm, që merret në konsideratë për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, fillon me ngritjen e padisë dhe përfundon kur vendimi merr formë të prerë.

²⁹⁰ Nuk rezulton që subjekti të ketë marrë ndonjë masë për të eliminuar çdo lloj shkak, që çështjet të mos zvarriten e të gjykohen brenda një afati të arsyeshëm, por konstatohet një mungesë kujdesi dhe operativiteti, neglizhencë, të tilla që kalojnë “kufirin e të arsyeshmes”, dhe që një sjellje e tillë nuk mund të justifikohet, sjellje e cila çon në cenimin e prestigjit të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij.

26.1. Më pas, i pandehuri T. M. paraqiti kërkesë në datën 2.8.2018 për zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”. Subjekti, me vendimin nr. ***, datë 6.8.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe zëvendësimin e masës nga “Arrest në burg” në “Arrest në shtëpi”. Subjekti i rivlerësimit në vendim arsyeton se nevojat e sigurimit janë zbutur dhe kanë ndryshuar kushtet dhe rrethanat, por pa analizuar cilat kushte dhe rrethana kanë ndryshuar.

26.2. Lidhur me pretendimin e kërkuesit, si dhe vendimmarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit Vlorë, në vendimin nr. ***, datë 15.8.2018, vlerëson se rrethanat e mbajtura në konsideratë nga subjekti, në caktimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, jo vetëm nuk kanë ndryshuar, por edhe nuk janë të tilla që të justifikojnë ndryshimin e masës së sigurimit dhe zëvendësimin e masës së sigurimit nga “Arrest në burg” në një masë më të lehtë, “Arrest në shtëpi”²⁹¹.

26.3. Nga tërësia e fakteve që paraqiten në fashikullin e dosjes, rezultoi se nuk jemi përballë ndryshimit të nevojave të sigurisë për të dyshuarin, të atilla që ligjërojnë zëvendësimin e masës “Arrest në burg” me një masë më të lehtë. Nga analizimi i dosjes rezulton se gjyqtarja Herila Çela në vendim është mjaftuar të ripërsërisë atë që i është kërkuar nga i dyshuari, duke mos shpjeguar se cilat ishin ato rrethana dhe kushte që kishin ndryshuar në favor të të dyshuarit, që bindën gjykatën të lejojë zëvendësimin e masës nga “Arrest në burg” në “Arrest në shtëpi”.

26.4. Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se: (i) *Lidhur me arsyetimin ligjor, bazuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”²⁹², vendimit të subjektit i mungon argumentimi në lidhje me konkluzionin se cilat ishin ato rrethana dhe kushte që kishin ndryshuar në favor të të dyshuarit T. M., të cilat bindën gjykatën të lejojë zëvendësimin e masës nga “Arrest në burg” në “Arrest në shtëpi”;* (ii) *Subjekti i rivlerësimit duket se ka favorizuar personin nën hetim, duke anashkaluar faktin se në ngarkim të tij ka edhe një procedim tjetër të hapur, për të cilin ai është nën masën e sigurimit personal “Arrest në shtëpi”. Në procedimin e ri, personi nën hetim është larguar nga vendi i vuajtjes së dënimit (nga shtëpia e tij) dhe në makinë i është kapur një armë zjarri pa leje, si dhe lëndë narkotike, pra ai dyshohet edhe për tri vepra të tjera penale me rrezikshmëri të madhe shoqërore, të parashikuara nga nenet 323/1, 278/1 dhe 283/1 të Kodit Penal.*

²⁹¹ Gjykata e Apelit Vlorë arsyeton se vendimi i dhënë nga subjekti është i padrejtë, në zbatim të gabuar të ligjit procedural dhe të kriterëve të posaçme të një mase sigurimi, prandaj ai duhet të ndryshohet dhe ndaj personit nën hetim të vendoset përsëri masa e sigurimit “arrest në burg”. Apeli i tërheq vëmendjen gjykatës së faktit që përpara se të citojë *copy-paste* vendime të GJEDNJ-së apo unifikuese, duhet të arsyetonte se pse rëndësia e faktit ose e dënimit që mund të caktohet, ka ndryshuar, se pse nuk vazhdon të ekzistojë dyshimi për kryerjen e veprave penale, për të cilat dyshohet personi nën hetim. Personi nën hetim ka edhe një procedim tjetër të hapur, është larguar nga vendi i vuajtjes së dënimit dhe në makinë i është kapur një armë zjarri pa leje, si dhe lëndë narkotike, pra ai dyshohet edhe për tri vepra të tjera penale, ato të parashikuara nga nenet 323/1, 278/1 dhe 283/1 të Kodit Penal, vepra këto me rrezikshmëri të madhe shoqërore. Rëndësia e faktit apo dënimit që mund të caktohet, jo vetëm nuk është zbutur, por ato janë ashpërsuar, përderisa personi nën hetim dyshohet edhe për kryerjen e veprave penale të mësipërme. Gjykata e Apelit Vlorë konkludon se nuk ka absolutisht ndryshim të kushteve të veçanta, të cilat janë marrë në konsideratë nga Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë në momentin e caktimit të masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”. Në fashikull, sikundër e ka pranuar edhe gjykata e faktit, ndodhen prova të atilla, që bindin gjykatën se i dyshuari mund të ketë kryer veprën, për të cilën ai akuzohet. Ekzistojnë të gjitha mundësitë që i dyshuari të ndërveprojë me këta elementë dhe të fshehë provat në këtë fazë të hetimit apo të kryejë të njëjtën veprë penale. Sa rezulton, masa e sigurimit “arrest në burg” është e vetmja masë e përshtatshme, pasi ekziston rreziku i ikjes së këtij personi, sikundër ekziston rreziku i manipulimit të provave në këtë fazë të hetimit.

²⁹² Ligji nr. 96/2016, neni 72: *“Me anë të kriterit të aftësisë profesionale të gjyqtarit vlerësohet aftësia profesionale e gjyqtarit në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor [...]”.*

26.5. Subjekti paraqiti shpjegimet e saj në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se ka përmbushur rigorozisht kërkesat e nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale, duke paraqitur në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit: (i) rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë gjykimit, dhe përfundimet e nxjerra nga gjykata; (ii) provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi; (iii) dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi. Gjatë këtij gjykimi janë marrë si prova akti i ekspertimit nr. ***, datë 11.7.2018 dhe akti nr. ***, datë 2.7.2018, i Institutit të Policisë Shkencore, të cilët kanë arritur në rezultatin se pas ekzaminimeve përkatëse nuk rezultojnë gjurmë papilare të të dyshuarit as në armën e gjetur në makinë dhe as në mbështjelljen e lëndës narkotike prej 0.9 gramësh *cannabis sativa*. Gjithashtu, rezultoi e provuar se, pasi është verifikuar në ILD ankesa e paraqitur nga ana e Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me rastin e sipërcituar, është arkivuar me vendimin nr. *** prot., datë 31.7.2023.

Zëvendësimi i masës së sigurimit është bërë në bazë të diskrecionit që Kodi i Procedurës Penale i lejon gjyqtarit të hetimeve paraprake, provave të administruara në seance gjyqësore, si dhe bindjes së brendshme. Komisioni nuk ka kompetencë vlerësimin e veprimtarisë profesionale, për shkak se kjo çështje është jashtë periudhës së rivlerësimit dhe, për këtë arsye, vlerësimi i aftësisë profesionale në këtë rast është kryer nga ILD-ja.

26.6. Vlerësimi ligjor i Komisionit – Lidhur me pretendimet e subjektit se kjo dosje shtrihet jashtë afatit të rivlerësimit, Komisioni arsyeton se periudha kohore për vlerësim, 8.10.2013 – 8.10.2016, e parashikuar nga pika 3 e nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, i referohet dhe është parashikuar vetëm për sa i përket përzgjedhjes në mënyrë rastësore të pesë dosjeve/akteve që vlerësohen nga organet ndihmëse. Ndërsa, rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni, nisur nga informacioni që ai disponon – sipas parashikimit të pikës 4 të nenit të sipërcituar dhe në kombinim me pikën 4 të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016 – mund të shtrihet nga data 1.1.2006 e në vijim, pra edhe mbi procedime/çështje të viteve dhe muajve të mëpasshëm.

26.7. Komisioni, bazuar në nenin E, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës²⁹³ dhe nenin 44 të ligjit nr. 84/2016²⁹⁴, ka analizuar elementet e aftësive profesionale sipas parashikimit të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”²⁹⁵, aspektin e arsytimit ligjor, duke u bazuar në tregues të tillë si cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik.

26.8. Pretendimet e paraqitura në prapësime nuk janë shteruese lidhur me konkluzionin se subjekti në vendim ka anashkaluar faktin se në ngarkim të personit nën hetim ka edhe një procedim tjetër të hapur, për të cilin ai është nën masën e sigurimit personal “Arrest në shtëpi”. Neni 260 i Kodit të Procedurës Penale shprehimisht parashikon se: “*Masat shtrënguese dhe ndaluese revokohen menjëherë kur del se mungojnë kushtet dhe kriteret e zbatimit të tyre. Kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të*

²⁹³ Neni E, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: “1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen një rivlerësimi të aftësisë profesionale, me qëllim identifikimin e atyre të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit”.

²⁹⁴ Ligji nr. 84/2016 në nenin 44 parashikon: “Relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjisllacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe aktet e tjera ligjore. Në përfundim, relatori propozon për subjektin e rivlerësimit si më poshtë [...]”.

²⁹⁵ Ligji nr. 96/2016, neni 72: “Me anë të kriterit të aftësisë profesionale të gjyqtarit vlerësohet aftësia profesionale e gjyqtarit në drejtim të njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor [...]”.

caktohet, gjykata e zëvendëson masën me një tjetër më të lehtë.” Në interpretim të kësaj dispozite, rezulton se masat e sigurimit mund të revokohen apo të ndryshohen në varësi të ndryshimit të kushteve dhe kriterëve të zbatimit të tyre. Ndryshimi i masës së sigurimit, duke u zëvendësuar me një tjetër më të lehtë ose më të rëndë (kjo e fundit vetëm me kërkesë të prokurorit), bëhet vetëm në ato raste kur masa e sigurimit e caktuar nuk u përshtatet më nevojave të sigurimit ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit apo dënimit që do të caktohet.

26.9. Sikundër është konkluduar edhe nga vendimi i gjykatës së shkallës më të lartë, rezulton se nuk jemi përballë ndryshimit të nevojave të sigurisë për të dyshuarin, të atilla që ligjërojnë zëvendësimin e masës “Arrest në burg” me një masë më të lehtë.

26.10. Subjekti në vendim është mjaftuar të ripërsërisë atë që i është kërkuar nga i dyshuari, duke mos shpjeguar se cilat ishin ato rrethana dhe kushte që kishin ndryshuar në favor të të dyshuarit, që bindën gjykatën të lejojë zëvendësimin e masës nga “Arrest në burg” në “Arrest në shtëpi”.

26.11. Sa rezulton, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, i cili i përket indikatorit të aftësive profesionale të gjyqtarit lidhur me aspektin e arsytimit ligjor.

27. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 19.2.2023, të Këshillit të Lartë të Gjqësor, Komisioni vëren se ndaj subjektit janë depozituar 41 ankesa²⁹⁶: *“Pasi u analizuan në mënyrë të detajuar ankesat e paraqitura, vlerësohet se pretendimet ngrihen mbi themelin e vendimit, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga ana e Komisionit, ndërkohë që në disa prej tyre janë konstatuar problematikat e trajtuara në vijim”.*

28. Lidhur me ankesën e shtetasit K. Sh., i cili ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit Herila Çela në gjykimin e çështjes civile me objekt “Vërtetim fakti juridik i njohjes pronar”. Ankuesi është në cilësinë e kërkuarit dhe pretendon se subjekti nuk ka respektuar ligjin në kuptimin formal, duke mos hequr dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje.

28.1. Për të hetuar pretendimet e ngritura në këtë ankesë, Komisioni me anë të shkresës nr. *** prot., datë 11.7.2023, kërkoi nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë administrimin e dosjes gjyqësore të vendimit nr. ***, datë 18.11.2008, me palë paditëse K. Sh., si dhe të gjitha vendimet/dosjet gjyqësore e gjykuara nga kjo gjykatë, me palë paditëse shtetasin K. Q. Sh.. Në përgjigje²⁹⁷, gjykata ka paraqitur kopjen e njësuar të vendimit nr. ***, datë 18.11.2008 dhe atë të formës së prerë nr. ***, datë 17.2.2021, me palë paditëse shtetasin K. Sh.. Më tej,

²⁹⁶ Ankesa nr. *** prot., datë 16.11.2006, e z. P. Gj.; 2 ankesa të z. E. M. nr. *** prot., datë 4.7.2008 dhe nr. *** prot., datë 24.7.2008; ankesa nr. *** prot., datë 12.9.2008, e Kishës Ortodokse; 3 ankesa të z. P. N. me nr. *** prot., datë 25.9.2008, nr. *** prot., datë 3.12.2008 dhe nr. *** prot., datë 16.10.2008; ankesa nr. *** prot., datë 7.11.2008, e z. M. K.; ankesa nr. *** prot., datë 27.7.2009, e z. G. A.; ankesa nr. *** prot., datë 2.9.2009, e z. N. V.; 2 ankesa të z. K. Sh. nr. *** prot., datë 11.11.2009 dhe datë 18.01.2010; ankesa nr. *** prot., datë 29.10.2010, e z. H. B.; 2 ankesa të znj. M. H. nr. *** prot., datë 15.11.2010; ankesa nr. *** prot., datë 24.11.2010, e znj. M. H.; ankesa nr. *** prot., datë 6.1.2011, e z. S. A.; ankesa nr. *** prot., datë 18.4.2011, e z. M. J.; ankesa nr. *** prot., datë 27.1.2011, e znj. L. H.; ankesa nr. *** prot., datë 24.9.2012, e znj. K. K.; ankesa nr. *** prot., datë 5.11.2012, e z. S. N.; 3 ankesa të znj. O. H. nr. 1 prot., datë 15.1.2013, nr. *** prot., datë 25.1.2013 dhe nr. 728 prot., datë 7.3.2013; ankesa nr. *** prot., datë 30.3.2013, e znj. D. R.; ankesa nr. *** prot., datë 23.4.2013, e znj. F. Xh.; ankesa nr. *** M prot., datë 28.4.2013, e znj. M. Z.; ankesa nr. *** prot., datë 1 8.6.2013, e z. K. B.; ankesa nr. *** prot., datë 17.6.2013, e znj. L. D.; ankesa nr. *** prot., datë 28.1.2014, e znj. N. A.; ankesa nr. *** prot., datë 4.9.2014, e z. V. G.; ankesa nr. *** prot., datë 22.9.2014, e z. V. Gj.; ankesa nr. *** prot., datë 26.4.2016, e z. S. K.; 3 ankesa të z. P. C. nr. *** prot., datë 10.10.2016, nr. *** prot., datë 10.10.2016 dhe nr. *** prot., datë 20.10.2016; - ankesa e Raiffeisen Bank nr. *** prot., datë 1.2.2016; ankesa nr. *** prot., datë 2.11.2016, e znj. Xh. B.; ankesa nr. *** prot., datë 23.01.2017, e z. J. P.; ankesa nr. *** prot., datë 8.3.2017, e z. F. A.

²⁹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 29.8.2023.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka dërguar shkresën nr. *** prot., datë 14.9.2023, duke vënë në dispozicion të Komisionit kopje të njësuara të vendimit nr. ***, datë 10.5.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe vendimin e formës së presë të Gjykatës së Apelit Vlorë nr. ***, datë 6.7.2022²⁹⁸. Gjithashtu ka vënë në dispozicion shkresën e datës 4.9.2023, përpiluar nga arkivistet e gjykatës Xh. D. dhe L. K. Referuar kësaj shkrese, rezulton se gjykata ka dhënë vendimin nr. ***, datë 5.2.2009, me palë kërkuese shtetasin K. Sh., person i tretë shoqëria “***” sh.p.k., me objekt “Vendosje masë sigurimi e padisë”. Nga verifikimi i kryer nga arkivi në lidhjen e dosjeve civile të veçanta, me nr. ***, viti 2009, dosja me nr. ***, datë 5.2.2009, nuk ndodhej e vendosur në këtë lidhje. Megjithëse kjo dosje futet te dosjet e veçanta, për të cilat nuk janë krijuar volume vendimesh, pasi palët në vijim mund të kenë bërë procese gjyqësore dhe kërkesë pranë gjyqtarëve për administrimin e saj, në lidhje nuk ndodhej asnjë informacion.

28.2. Faktet e konstatuara – Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datën 23.10.2008 është regjistruar çështja civile me nr. *** akti, që u përket palëve – kërkues K. Sh., person i interesuar Bashkia Vlorë etj. – me objekt “Vërtetim fakti juridik i pronësisë”. Komisioni vëren se në cilësinë e provave subjekti ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 8.8.2008, të lëshuar nga Arkivi Qendror Shtetëror, ku rezulton se nga kërkimet e bëra për shtetasin Q. Sh. disponojnë 4 fletë fotokopje dokumentesh të nxjerra nga fondi ***, viti 1949, dosja 3, fleta 19. Bashkëlidhur 4 fletë regjistri formularë për regjistrimin e pasurive shtetërore në juridiksionin e qarkut. Më tej ka paraqitur grafikët e pronësisë së pretenduar nga trashëgimtarët e shtetasit Q. Sh.. Pronësia ndodhet në Vlorë, në vendin “***”, sip. 7.200 m² (6 vreten).

28.3. Çështja është hedhur në short në datën 28.10.2008, duke i rënë për gjykim gjyqtarës Herila Çela. Në datën 30.10.2008, subjekti ka marrë vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore në datën 7.11.2008, ora 09:30. Në datën e caktuar është zhvilluar seanca gjyqësore dhe, meqenëse kërkuesi nuk u paraqit, pasi nga fletëthirrja rezulton se “ky person nuk njihet në këtë adresë”, gjykata ka vendosur t’i japë 10 ditë afat për plotësimin e të metave të padisë.

28.4. Subjekti në vendimin e ndërmjetëm, datë 7.11.2008, arsyeton se: *“Nga ana e gjykatës, pasi u shqyrtuan provat shkresore të ndodhura në fashikullin e gjykimit, u verifikua se kërkesa rezulton me të meta. Kërkuesi K. Sh. është njoftuar për seancën e datës 7.11.2008 në adresën që ka pasqyruar në kërkesë dhe njoftimi është kthyer me shënimin “Nuk njihet në këtë adresë”. Në kushtet kur nga ana e palës kërkuese kjo kërkesë rezulton të jetë me të meta, arrihet në përfundimin se duhet t’i jepet kohë kërkuesit që të plotësojë të metat, bazuar kjo në nenin 154/a, paragrafi 2, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: “Kur paditësi nuk plotëson të metat brenda*

²⁹⁸ Referuar këtyre vendimeve, rezultoi sa vijon: (i) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 10.5.2023 (paditësi shtetasi K. Sh., të paditur A., M., S. P. dhe G. K., person i tretë ASHK Vlorë dhe H. V., me objekt “Detyrimin e të paditurve të njohin pronar mbi një sipërfaqe trualli prej 1.649, 6 m², me nr. pasurie *** dhe ***, të ndodhura në z. k. ***, në vendin e quajtur “***”, duke e liruar dhe dorëzuar atë etj.”), ka vendosur kthimin e padisë pa veprime, duke arsyetuar se ka të meta thelbësore, të cilat pengojnë gjykatën të vijojë shqyrtimin e procesit gjyqësor; (ii) Ndërkohë, referuar vendimit nr. ***, datë 20.6.2022, rezulton se ndaj shtetasit K. Sh. është dhënë masa e sigurimit “Arrest në burg” për veprat penale “Mashtrim” më shumë se një herë, “Falsifikim të dokumenteve”, e kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, të parashikuara në nenet 143/2, 186/2 dhe 190/2 të Kodit Penal. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 6.7.2022, ka vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit personal në atë “Arrest në shtëpi”.

afatit të caktuar, kërkesëpadia quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit, së bashku me aktet e tjera. Në këtë mënyrë veprohet edhe kur të metat konstatohen gjatë gjykimit të çështjes”.

28.5. Komisioni vëren se në procesverbalin gjyqësor nuk është shënuar koha e fillimit dhe e mbarimit të seancës gjyqësore dhe as ora e seancës gjyqësore e caktuar për t’u mbajtur në datën 18.11.2008. Seanca gjyqësore e planifikuar në datën 18.11.2008 është çelur dhe, meqenëse nuk janë plotësuar të metat e padisë, subjekti me vendimin nr. ***, datë 18.11.2008, ka vendosur kthimin e padisë me të meta kërkesit K. Sh.. Ndaj këtij vendimi nuk është bërë ankim. Përsëri në procesverbal nuk është shënuar koha e fillimit dhe e mbarimit të seancës gjyqësore. Nga sa rezulton, subjekti nuk ka zbatuar nenin 118/b të Kodit të Procedurës Civile, pasi në seancat gjyqësore nuk është shënuar koha/orari i zhvillimit të tyre, duke mos i dhënë mundësinë ankuesit K. Sh. të paraqitet në seancën e zhvillimit të procesit gjyqësor.

28.6. *Lidhur me konfliktin e interesit* – Pretendimet e ankuesit K. Sh. se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte dhënë dorëheqjen nga shqyrtimi i çështjes civile me nr. *** akti, me objekt “Vërtetim fakti juridik i pronësisë”, duke qenë se në thelb të kërkesës pretendohen tokat e shpronësuara në emër të shtetases E. Ç., ngre dyshime se subjekti mund të ketë shqyrtuar edhe çështjen gjyqësore për vendosjen e masës së sigurimit të padisë²⁹⁹ ndaj shoqërisë “***” sh.p.k., bazuar kjo në vendimin nr. ***, datë 24.12.2008, të KLD-së “Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore”. Sipas këtij vendimi, është përcaktuar se kur nga të dhënat paraprake evidentohet se çështja është e njëjtë, me atë për të cilën gjykata më parë ka disponuar në mënyrë jopërfundimtare, atëherë kalon për shqyrtim tek i njëjti trup gjykues, në rastin konkret çështja duhet të ketë kaluar për gjykim te subjekti i rivlerësimit Herila Çela³⁰⁰.

28.7. Ajo çka shtoi dyshimet e Komisionit, është edhe fakti se përputhen pretendimet e ankuesit se çështja u pushua me pretendimin se “Unë nuk isha paraqitur në orar, në një kohë kur unë kisha gjysmë ore që prisja para derës së saj”, ndërkohë që nga hetimi rezultoi se në seancat gjyqësore nuk është shënuar koha/orari i zhvillimit të tyre, si dhe në dosje nuk administrohen fletëthirrjet e gjykatës me datën dhe orën e saktë të zhvillimit të seancës gjyqësore të datës 18.11.2008, duke mos i dhënë kështu mundësinë ankuesit K. Sh. të paraqitet në gjykim. Gjithashtu, nga hetimi i Komisionit rezultoi se referuar shkresës nr. *** prot., datë 2.7.2006, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanistikës, Bashkia Vlorë³⁰¹, bëhet me dije se sipas Studimit të Zonave Qendër të qytetit të Vlorës, të miratuar me vendimin nr. ***, datë 19.2.2003, të KRRTRSH-së, prona e pretenduar nga subjekti i shpronësuar E. Ç. ndodhet brenda vijës kufizuese të qytetit të Vlorës, në fashën e “zonës qendër”, me destinacion “zonë banimi”. Në hartën e pronës së pretenduar është azhurnuar rruga në perspektivë në veri të ish-Kombinatit, me gjerësi 24 m, sipas Studimit të rrjetit rrugor të parku “Rinia”, të miratuar nga KRRT-ja e Bashkisë Vlorë, vija e ndërtimit të Rrugës Transballkanike, 30 m larg nga aksi i rrugës ekzistuese sipas projektit të zgjerimit të rrugës së miratuar. Sipas

²⁹⁹ Vendimi nr. ***, datë 5.2.2009, me palë kërkuese shtetasin K. Sh., person i tretë shoqëria “***” sh.p.k., objekti “Vendosje masë sigurimi e padisë”.

³⁰⁰ Gjithashtu, bazuar në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. ***, datë 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore”, është përcaktuar se përjashtohen nga shorti çështjet gjyqësore kur nga të dhënat paraprake evidentohet se çështja është e njëjtë me atë për të cilën gjykata më parë ka disponuar në mënyrë jopërfundimtare, atëherë çështja kalohet automatikisht tek i njëjti trup gjykues nëpërmjet sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Në rastet kur çështja nuk mund të shqyrtohet nga i njëjti trup gjykues, ajo përfshihet në shortin elektronik të radhës.

³⁰¹ Administruar në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 4.4.2023, të lëshuar nga Agjencia e Trajtitimit të Pronave.

vërtetimit nr. *** prot., datë 25.1.2017, të lëshuar nga Bashkia Vlorë³⁰², rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë e punësuar pranë kësaj bashkie nga periudha 24.2.2002 deri më 27.10.2003 në pozicionin përgjegjëse e seksionit juridik³⁰³.

28.8. Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se: *Duket se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e konfliktit të interesit lidhur me gjykimin e çështjes civile nr. *** akti, që u përket palëve - kërkues K.Sh., person i interesuar Bashkia Vlorë etj., me objekt “Vërtetim fakti juridik i pronësisë”, pasi: (i) Në kërkesën objekt gjykimi pretendohen tokat e shpronësuara në emër të së ndjerës E. Ç., nëna e subjektit; (ii) Rezulton se paditësi më tej ka kërkuar masën e sigurimit të padisë, ku person i tretë është shoqëria “***” sh.p.k., me të cilën subjekti ka qenë në një marrëdhënie kontraktore; (iii) Subjekti i rivlerësimit në procesverbalin e seancës gjyqësore datë 7.11.2008 nuk ka shënuar kohën e fillimit dhe mbarimit të seancës gjyqësore dhe as orën e seancës gjyqësore të caktuar për t’u mbajtur në datën 18.11.2008. Gjithashtu, në seancën e datës 18.11.2008 nuk është shënuar koha e fillimit dhe mbarimit të seancës gjyqësore; (iv) Subjekti i rivlerësimit nuk ka zbatuar dispozitat e nenit 118/b të Kodit të Procedurës Civile, pasi në seancat gjyqësore nuk është shënuar koha/orari i zhvillimit të tyre, duke mos i dhënë mundësinë ankuesit K. Sh. të paraqitet në seancën e zhvillimit të procesit gjyqësor; (v) Komisioni ngre dyshime të arsyeshme se subjekti ka ndërmarrë veprime për të penguar paditësin të ushtrorë të drejtën e tij, për shkak të qenies në kushtet e konfliktit të interesit.*

28.9. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet e saj në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se në referim të të dhënave të çështjes civile nr. *** akti, që u përket palëve – kërkues K. Sh., person i interesuar Bashkia Vlorë etj. – me objekt “Vërtetim fakti juridik i pronësisë”, në pjesën përshkruese të saj nuk jepet asnjë e dhënë, sipas së cilës gjykata të krijonte përshtypjen se prona e pretenduar e shtetasit K. Sh. shtrihej mbi pronën mbi të cilën është njohur e drejta e pronësisë së nënës së subjektit. Nisur nga ky fakt, subjekti nuk kishte mundësi objektive për të krijuar kushtet e konfliktit të interesit me palën në gjykim.

28.10. Sa i përket kërkesës nr. *** akti të kërkuesit K. Sh., person i tretë shoqëria “***” sh.p.k., me objekt “Sigurimi i padisë, pezullimi i punimeve që po kryen kjo shoqëri ndërtuese”, rezulton se kjo çështje gjyqësore nuk është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit, por nga një tjetër gjyqtar, z. A. M.. Në kushte të tilla, çmojmë se nuk ka vend të diskutojmë për situatën e konfliktit të interesit në një çështje ku subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar funksionet e gjyqtarit.

Sa i përket konstatimit të Komisionit se në procesverbalin e seancës gjyqësore datë 7.11.2008 subjekti i rivlerësimit nuk ka shënuar kohën e fillimit dhe të mbarimit të seancës gjyqësore dhe as orën e seancës gjyqësore të caktuar për t’u mbajtur në datën 18.11.2008, ajo deklaroi se në praktikën e gjykimit të çështjeve civile në atë periudhë kohore nuk shënohej në procesverbal ora e fillimit të gjykimit të çështjes civile, por vetëm për çështjet penale. Ndërkohë, në letërthirrje pala ndërgjyqëse njoftohej për datën dhe orën e gjykimit, si dhe për pasojën ligjore në rast të mosparaqitjes në gjykim. Në atë periudhë kohe, kërkuesi K. Sh. nuk kishte ngritur asnjë pretendim pronësie kundrejt nënës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim që kjo e fundit të kishte dijeni mbi

³⁰² Paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*.

³⁰³ Periudha 9.4.2003 – 27.10.2003.

pretendimin e tij. Për pasojë, subjekti nuk ka pasur mundësi objektive për të njohur pretendimet e këtij shtetasi, në mënyrë që të shmangte konfliktin e interesit.

28.11. Rezulton se kërkuesi ka marrë dijeni rregullisht për vendimin e dhënë nga subjekti dhe nuk ka ushtruar ankim. Kërkuesi ka paraqitur të njëjtën kërkesë, pasi ka përmbushur detyrimin e plotësimit të elementeve formale të padisë sipas neneve 154 dhe 154/a të Kodit të Procedurës Civile. Kjo çështje nuk është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit, por nga një tjetër gjyqtar i kësaj gjykate, z. S. K..

28.12. Në përfundim, subjekti deklaroi se shtetasit K. Sh. nuk i është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë, për më tepër që subjekti i rivlerësimit nuk ka asnjë vendimmarrje për themelin e pretendimit të tij.

28.13. Vlerësimi ligjor i Komisionit – Konstatohet se subjekti i rivlerësimit e ka lidhur kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “****” sh.p.k. në datën 30.5.2008, leja e miratimit për ndërtimin e objektit 8-9-katësh është dhënë në datën 24.11.2008 dhe se punimet kanë filluar në muajin dhjetor të vitit 2008. Ndërkohë që çështja civile me nr. ***, me objekt “Vërtetim fakti juridik i pronësisë”, është regjistruar në gjykatë në datën 23.10.2008 dhe në datën 18.11.2008 subjekti ka vendosur kthimin e padisë me të meta. Më tej, referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në cilësinë e provës në prapësime, rezultoi se vendimi nr. ***, datë 5.2.2009, me objekt “Vendosja e masës për sigurimin e padisë, pezullimin e punimeve që po kryen shoqëria “****” sh.p.k.”, person i tretë “****” sh.p.k., KRRT Bashkia Vlorë, është gjykuar nga gjyqtari A. M. dhe jo nga subjekti i rivlerësimit. Me anë të këtij vendimi është vendosur rrëzimi i kërkesës së kërkuesit K. Sh., duke arsyetuar se në rastin në shqyrtim nuk jemi përpara një konflikti të mirëfilltë civil, por përpara një konflikti administrativ, që ka një procedurë të veçantë gjykimimi. Masa e përkohshme e sigurimit të padisë mund të merret brenda shqyrtimit të një çështjeje administrative ku, krahas kundërshtimit të një akti administrativ, kërkohet edhe pezullimi i një akti administrativ, në rast se paditësi provon se ekziston rreziku i shkakut të një dëmi të rëndë dhe të pazëvendësueshëm. Komisioni vëren se pezullimi i aktit administrativ si një veprim procedural gjyqësor kushtëzohet nga një sërë elementesh, siç janë ngritja e padisë për shfuqizimin e aktit administrativ etj. Pra, në rastin konkret, ankuesi duhet të kishte paraqitur më parë një kërkesë për shfuqizimin e aktit administrativ - vendimit nr. ***, datë 31.7.2006, të KKKP-së Vlorë, me anë të të cilit i është njohur e drejta e pronësisë subjektit të shpronësuar E. Ç. për sipërfaqen tokë truall prej 2.680 m².

28.14. Ndërkohë që shtetasi K.Sh. ka paraqitur disa padi të tjera në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, të cilat nuk janë gjykuar nga subjekti i rivlerësimit: (i) Çështja e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 28.4.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, gjykuar nga shtetasi Th. N., i cili ka vendosur pushimin e çështjes, me palë paditëse K. Sh., të paditur ZRKK Pronave Vlorë, E. Ç., L. N., P. Ç., person i tretë KRRT Bashkia Vlorë, shoqëria “****” sh.p.k., me objekt “Detyrimin e të paditurve të njohin pronësinë e babait Q. Sh. në vendin e quajtur “****”, në Vlorë. Shpalljen e vendimit nr. ***, datë 31.7.2006 të KKKPronave, si absolutisht të paligjshëm; detyrimin e personit të tretë KRRT Bashkia Vlorë të bëjë çregjistrimin e truallit me sip. 2.680 m² në pronësi të të paditurve. Detyrimin e personit të tretë të urdhërojë pezullimin e punimeve të filluara prej firmës së ndërtimit “****” sh.p.k.”; (ii) Çështja e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 18.6.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, gjykuar nga S. K., i cili ka vendosur pushimin e çështjes me

objekt “Vërtetim fakti juridik për të drejtën e pronësisë”, kërkues K. Sh., person i tretë Bashkia Vlorë, L. N.. Rezulton se kjo çështje është pushuar për shkak se përfaqësuesi i palës së paditur ka kërkuar të heqë dorë nga gjykimi i kësaj kërkesëpadie, për arsye se do të ngrejë një kërkesëpadi tjetër pasi të ketë bërë një gjyq vërtetim fakti, pastaj do t’i drejtohet gjykatës. Shtetasi K. Sh. ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit ndaj këtij vendimi, duke parashtruar se nuk është e vërtetë se ka hequr dorë nga gjykimi i çështjes. Shpallja e një vendimi të tillë është rrjedhojë e një presioni të vazhdueshëm të gjyqtarit. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 2.2.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 28.4.2009.

28.15. Gjithashtu, shtetasi K. Sh. ka ngritur kallëzim penal ndaj subjektit të rivlerësimit Herila Çela për veprën penale “Falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Prokurori i çështjes Ç. S. ka vendosur pushimin e procedimit. Ky vendim është kundërshtuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, ku me vendimin nr. ***, datë 1.7.2010, është vendosur rrëzimi i kërkesës së ankuesit K. Sh., lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 13.10.2010.

28.16. Në konkluzion, pas provave të administruara në prapësime, Komisioni vlerëson se nga shqyrtimi dhe analizimi i kësaj çështjeje nuk u provuan pretendimet e denoncuesit se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi objektive për të njohur pretendimet e këtij shtetasi dhe, për pasojë, të shmangte konfliktin e interesit.

Lidhur me tri ankesat e paraqitura nga shtetasi P. di C. në vitin 2016

29. Rrethanat e çështjes – Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë është paraqitur për gjykim çështja civile me palë kërkuese shtetasin T. M., palë e tretë M. C., me objekt “Marrjen e masës provizore të sigurimit të padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakes, znj. M.C., që kërkohet të përjashtohet, si dhe pezullimin e të gjitha të drejtave të tjera që rrjedhin nga zotërimi i kësaj kuote prej 46% në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “T. M.””. Kjo çështje është depozituar në gjykatë në datën 29.8.2016 dhe i ka kaluar menjëherë për shqyrtim magjistratit të gatshëm F. K., i cili në përfundim ka vendosur se kjo çështje duhej të shqyrtohej nga subjekti Herila Çela, që kishte marrë në shqyrtim padinë e themelit. Subjekti i rivlerësimit e ka marrë në shqyrtim kërkesën për sigurim padie në datën 9.9.2016 dhe ka planifikuar seancë gjyqësore në datën 16.9.2016, seancë e cila u shty për shkak të kërkesës së avokates së palës kërkuese dhe vonesa e shqyrtimit të kësaj kërkesë pas datës 16.9.2016 nuk i atribuohet subjektit. Seanca e radhës dhe e fundit u planifikua në datën 21.9.2016.

29.1. Sa rezulton, kërkesa për sigurimin e padisë është shqyrtuar brenda një afati prej 12 ditësh, në shkelje të afatit ligjor. Subjekti në deklaratimet pranë Inspektoratit të KLD-së është shprehur se datat 10, 11 dhe 12 shtator kanë qenë pushim, fundjavat dhe Festa e Bajramit (datë 12), prandaj shqyrtimi i kërkesës u planifikua në datën 16.9.2016. Vlerësohet se pretendimi i subjektit për të mos respektuar afatin ligjor për caktimin, shqyrtimin dhe marrjen e vendimit për sigurimin e padisë është ligjërisht i pabazuar. Kërkesa për sigurimin e padisë përfaqëson një kërkesë të ngutshme dhe marrja e saj në shqyrtim brenda afatit 5-ditor të caktuar nga ligji është e detyrueshme.

29.2. Duke qenë se ky tejkallim afati në shqyrtimin e çështjes vjen në kohë pas vërejtjes së marrë nga ish-KLD-ja, lidhur me vonesat në gjykimin e çështjeje, Komisioni vendosi të kërkojë

shpjegime në lidhje me konstatimin se: *Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar kërkesën për sigurimin e padisë në kohëzgjatje prej 12 ditësh, në tejkalim të afatit ligjor 5-ditor të parashikuar në nenin 202 të Kodit të Procedurës Civile.*

29.3. Subjekti paraqiti shpjegimet e saj në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se ka caktuar seancën gjyqësore në datën 16.9.2023, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Në këtë seancë nuk është paraqitur përfaqësuesja e palës kërkuese, e cila ka kërkuar shtyrjen e seancës gjyqësore. Subjekti i rivlerësimit, me qëllim garantimin e së drejtës së përfaqësimit dhe mbrojtjes ligjore në proces gjyqësor, shton seancën gjyqësore për t'i garantuar të drejtat procedurale palës kërkuese. Vetë pala kërkuese, duke zgjedhur midis garancisë të së drejtës së mbrojtjes ligjore dhe gjykimit brenda afatit ligjor, ka zgjedhur të parën, për pasojë nuk duhet të konsiderohet penalizues për subjektin e rivlerësimit shqyrtimi i kërkesës në kohëzgjatje 12 ditë, kur vetë pala e interesuar ka kërkuar shtyrjen e seancës gjyqësore.

29.4. Vlerësimi ligjor – Komisioni nuk i gjen bindëse dhe shteruese pretendimet e subjektit në prapësime, duke qenë se rezultoi e provuar nga hetimi se subjekti i rivlerësimit e ka marrë në shqyrtim kërkesën për sigurim padie në datën 9.9.2016 dhe ka planifikuar seancë gjyqësore në datën 16.9.2016, çka bën që kërkesa për sigurimin e padisë të shqyrtohet brenda një afati prej 12 ditësh, në shkelje të afatit ligjor 5-ditor të parashikuar në nenin 202 të Kodit të Procedurës Civile, duke cenuar indikatorin e parashikuar në nenin 74, që u përket aftësive organizative të subjektit sipas ligjit nr. 96/2016. Ky vlerësim i Komisionit do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes sipas pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me tri ankesat e paraqitura nga shtetasja L. D. në vitin 2013

30. Rrethanat e çështjes – Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë është paraqitur për gjykim çështja civile me palë paditëse Prefekti i Qarkut Vlorë, palë e paditur Dh. D., Bashkia ***, ndërhyrës kryesor J. D., me objekt “Shpallja e pavlefshmërisë ligjore të pjesshme të aktit administrativ “Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi” nr. ***, datë 10.2.1996, dhënë në favor të paditëses Dh. D. Kthimin e saj në pronësi të shtetit”. Shtetasja Dh. D. ka përfituar në pronësi gjithsej 11.200 m² tokë arë në bazë të ligjit nr. 7501 në datën 10.2.1996³⁰⁴. Pala paditëse pretendon se Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi në favor të shtetases Dh. D. është nxjerrë në mënyrë abuzive dhe në kundërshtim me ligjin³⁰⁵, pasi, duke qenë vetëm dy frymë, u takon të përfitojnë vetëm 2.900 m².

30.1. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 6.6.2012, ka vendosur rrëzimin e padisë si e pambështetur në prova dhe në ligj, duke arsyetuar se vendimi nr. **, datë 7.9.2000, i Komisionit Vendor të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, është marrë pa e thirrur, pa dijeninë dhe ballafaqimin e shtetases Dh. D. Në rastin konkret nuk rezulton sipërfaqe toke e dhënë më tepër të

³⁰⁴ Sipas regjistrimit themeltar të qytetit nr. *** të vitit 1974, familja e saj përbëhet nga i biri, N. D., ndërsa ndërhyrësi kryesor, J. D., është djali tjetër i së paditurës dhe është ndarë nga trungu në datën 30.6.1986 dhe nuk ka përfituar tokë nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991.

³⁰⁵ Për shkak se familja e saj ka në përbërje vetëm dy frymë, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit ka përfshirë në përbërje të familjes edhe ndërhyrësin kryesor, J. D., i cili është ndarë nga trungu në vitin 1986. Nga ana tjetër, ligji nr. 7501/1991 përcakton se e përfitojnë tokën bujqësore ata persona që janë në një familje, sipas gjendjes që rezultojnë nga certifikata familjare në datën 1.8.1991.

paditurës, Komisioni Vendor duhej t'i ofronte mbajtjen dhe ligjërimin e këtij titulli pronësie deri në 10% mbi normën e tokës për frymë, kundrejt detyrimit të pagimit të çmimit.

30.2. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 10.10.2013, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 6.6.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton shkelje të rëndë procedurale në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe në Gjykatën e Apelit³⁰⁶.

30.3. Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se: *Subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë hapat e duhur proceduralë në gjykimin e çështjes, çka ka evidentuar zbatim të gabuar të ligjit lidhur me kriteret dhe sipërfaqen e përfitimit të tokës në rastin objekt gjykimi.*

30.4. Subjekti paraqiti shpjegimet e saj në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se në rastin objekt gjykimi gjykata më e lartë ka konstatuar vetëm shkelje të natyrës procedurale dhe nuk ka disponuar lidhur me kriteret dhe sipërfaqen e përfitimit të tokës në rastin objekt gjykimi. *Nga ana e Komisionit janë ngritur disa konstatime, që lidhen me interpretimin e provave apo fuqinë e tyre provuese, konstatime këto që janë në tejkalim të kompetencës lëndore që kanë organet e rivlerësimit në drejtim të kontrollit e verifikimit të aftësisë profesionale të subjekteve të rivlerësimit.*

30.5. Vlerësimi ligjor – Komisioni çmon aftësitë profesionale pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet, por bazuar në aftësinë e subjektit për interpretimin dhe arsyetimin e dispozitave ligjore. Bazuar në nenin 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e gjyqtarit për të marrë vendime gjyqësore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën.

30.6. Gjatë hetimit rezultoi se ka qenë gjykata e shkallës më të lartë, që ka konstatuar shkelje të rëndë të dispozitave procedurale dhe ka vendosur prishjen e vendimit të dhënë nga gjykatat e shkallës më të ulët. Gjithashtu, vetë subjekti në prapësimet e paraqitura ka pranuar konstatimet lidhur me shkeljet e natyrës procedurale. Për të shmangur trajtimin e themelit në vendimin e dhënë nga ana e subjektit lidhur me vlerësimin e gabuar të ligjit dhe provave, i cili nuk është objekt

³⁰⁶ Për shkak të shkeljes së rëndë procedurale, vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë është i cenueshëm dhe çështja duhet të rigjykohej në themel, ku edhe të trajtohen disa nga shkaqet e ngritura në rekursin e palës paditëse Prefekti i Qarkut Vlorë, të mbështetura në ligj, të cilat evidentojnë jo vetëm zbatim të gabuar të ligjit nga gjykatat në kriteret mbi të drejtën e përfitimit dhe sipërfaqen e përfitueshme të tokës sipas ligjit nr. 7501/1991, por edhe mosrespektim të detyrimit, që në zgjidhjen e çështjes gjykata duhet të mbështetet dhe të zbatojë vetëm ligjin dhe jo qasjen lokale ekstraligjore për njohjen e të drejtave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me të drejtën e përfitimit të pronësisë mbi tokën në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 7501/1991. Sa rezultat, Gjykata e Lartë ka vendosur se vendimi nr. ***, datë 10.10.2013, i Gjykatës së Apelit Vlorë duhet të prishet si i dhënë në shkelje të rëndë të dispozitave procedurale dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Pas ndryshimeve që janë miratuar në Kodin e Procedurës Civile me ligjin nr. 38/2017, në nenin 485 të tij është hequr shprehimisht kompetenca e mëparshme e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që, pas shqyrtimit të rekursit në seancë gjyqësore, mund të dispononte prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, duke e dërguar çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë me tjetër trup gjyqësor.

shqyrtimi nga ana e Komisionit, në rastin konkret trupi gjykues limitohet vetëm mbi konstatimet e evidentuara në aspektin procedural të çështjes.

30.7. Sa rezulton, gjetjet e Komisionit lidhur me këtë çështje do të konsiderohen nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor sipas pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

31. Nga hetimet e Komisionit u vlerësuan si *indicie* informacionet e marra nga mediat *online* lidhur me denoncimin e bërë në emisionin “****” nga shtetasja L. L., e cila denoncon marrjen e dyqanit me sip. 144 m² nga efektiv i policisë, D. B.: *“Ajo tregon si e dha vilën 3-katëshe në zonën e Rrugës ***, në Vlorë, për ndërtimin e një pallati dhe dokumentet u përpiluan sikur dyqani ishte paguar. Pasi priti plot 7 vjet, zonja L. iu drejtua rrugës gjyqësore, dy shkallët e gjyqësorit e konsiderojnë fiktive kontratën e shitjes së dyqanit dhe përmbauesi gjyqësor privat Y. H. nis kthimin e dyqanit tek e zonja. Shtetasi D. B. e çon sërish çështjen në gjyq dhe gjyqtarja Herila Çela jep një vendim ku L. L. duhet t’i kthejë mbarsht D. B. 160 mijë eurot, që nuk i pagoi kurrë”*.

31.1. Komisioni, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 21.6.2023, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, administroi vendimin e dhënë nga subjekti, nr. ***, datë 11.10.2016, si dhe vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë nr. ***, datë 18.1.2018. Nga analizimi i këtyre vendimeve rezultoi sa vijon: Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë është shqyrtuar çështja gjyqësore me palë paditëse D. B., të paditur përmbauesin gjyqësor privat Y. H., dhe personat e tretë L.e L. L., me objekt “Kundërshtimin e urdhrin të pezullimit nr. ***, datë 29.8.2016, të përmbauesit gjyqësor. Detyrimin e të paditurit të vijojë procedurat përmbaimore për ekzekutimin e kredisë së paditësit D. B. në shumën 160.000 euro, që rrjedh nga titulli ekzekutiv vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. ***, datë 15.6.2015, lënë në fuqi me vendimin e Apelit Vlorë nr. ***, datë 10.5.2016”.

31.2. Rrethanat e faktit – Pala paditëse dhe personat e tretë kanë lidhur një marrëveshje me objekt shitjen e një dyqani. Për shkak të mungesës së dokumentacionit të këtij objekti mes palëve është lidhur deklarata noteriale nr. ***, datë 3.9.2011, e nënshkruar nga person i tretë L. L. dhe paditësi D. B.. Mes paditësit dhe personave të tretë më parë ishte zhvilluar një gjykim, në përfundim të të cilit, me vendimin nr. ***, datë 15.6.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: “Pranimin e padisë. Deklarimin si absolutisht të pavlefshëm të deklaratës noteriale nr. ***, datë 3.9.2011, realizuar para noterit G. B.. Detyrimin e të paditurit D. B. të lirojë e dorëzojë paditësve sendin e identifikuar pasuri e paluajtshme e llojit njësi; detyrimin e palës paditëse t’i kthejë të paditurit D. B. çdo shumë të marrë prej tij në vazhdimësi apo para deklaratës noteriale nr. ***, datë 3.9.2011, në funksion të kësaj të fundit të deklaruar të pavlefshme. Rrëzimin e kundërpadisë”. Ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi është lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë nr. ***, datë 10.5.2016.

31.3. Në vijim ka filluar procedura e ekzekutimit të këtij vendimi nga ana e përmbauesit gjyqësor Y. H. Kjo procedurë ka vazhduar deri në datën 29.8.2016, datë në të cilën nga ana e përmbauesit gjyqësor është disponuar nëpërmjet urdhrin të pezullimit të veprimeve përmbaimore. Në këtë urdhër është argumentuar se: *“Për ekzekutimin e këtij titulli kanë përfunduar procedurat e ekzekutimit për pikën një, dy dhe tre të dispozitivit. Kanë ngelur pa u ekzekutuar pika katër dhe shpenzimet gjyqësore të këtij titulli”*. Shtetasi D. B. ka bërë kërkesë për ekzekutimin e pikës 4 të

titullit ekzekutiv “Detyrimin e palës paditëse t’i kthejë të paditurit çdo shumë të marrë në vazhdimësi apo para deklaratës noteriale, datë 3.9.2011”. Pala e paditur ka prapësuar se nisur nga fakti që nga ana e gjykatës nuk është përcaktuar shuma që duhet të kthehet, përmbaruesi nuk mund të ekzekutojë këtë pjesë të dispozitivit³⁰⁷. Pala paditëse ka pretenduar se shuma që duhet të ekzekutohet është e qartë dhe është ajo prej 160.000 euro sipas deklaratës noteriale, shumë e cila ka qenë dhe objekt i hetimit gjyqësor. Pala paditëse ka pretenduar se kthimi i shumës 160.000 euro është disponuar nga gjykata në kuadrin e zgjidhjes së pasojave të një veprimi juridik absolutisht të pavlefshëm, pasi kërkimi i paditësit D. B. synonte fitimin e pronësisë mbi sendin.

31.4. Subjekti, me vendimin nr. ***, datë 11.10.2016, ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë së paditësit; kundërshtimin e urdhrin të pezullimit nr. *** prot., datë 29.8.2016, të përmbaruesit gjyqësor privat Y. H. Detyrimin e të paditurit, përmbaruesit gjyqësor privat, të vijojë procedurat përmbimore për ekzekutimin e kredisë së D. B. në shumën 160.000 euro, që rrjedh nga titulli ekzekutiv vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. ***, datë 15.6.2015, lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë nr. ***, datë 10.5.2016”.

31.5. Gjykata e Apelit Vlorë çmon se vendimi i subjektit është i pabazuar në prova dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet dhe kërkesëpadia të rrëzohet. Në analizë të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, provave të administruara në gjykim, si dhe pjesës arsyetuese të vendimit të ankimuar, konstatohet se gjykata e faktit ka bërë një cilësim të gabuar të fakteve, si dhe një hetim jo të plotë për të saktësuar natyrën e mosmarrëveshjes. Gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar dhe analizuar drejt provat që i janë nënshtruar debatit gjyqësor. Pala paditëse në çështjen objekt gjykimi kundërshton veprimet përmbimore në lidhje me urdhrin e pezullimit nr. *** prot., datë 29.8.2016, të përmbaruesit gjyqësor privat Y. H., ku si bazë ligjore i referohet nenit 615 të Kodit të Procedurës Civile. Në thelb, ekzekutimi i detyrueshëm është mjet juridik me natyrë procedurale, që mundëson realizimin e të drejtave të kreditorit, nëse ato nuk janë përmbushur vullnetarisht sipas përcaktimeve ligjore. Gjykata e Apelit çmon të drejtë pretendimin e personave të tretë për sa i përket faktit se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm, përderisa në vendimin përfundimtar të gjykatës nuk është përcaktuar shuma që do i nënshtrohet procedurës së ekzekutimit.

Në mënyrë të gabuar, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se shuma 160.000 euro është kredi e paditësit D. B., e përcaktuar në titullin ekzekutiv objekt gjykimi, pa pasur parasysh përmbajtjen e vendimit nr. ***, datë 15.6.2015. Gjykata nuk është shprehur se cili është detyrimi i saktë i personave të tretë dhe, në të tilla kushte, përmbaruesi gjyqësor nuk mund të vendosë në ekzekutim një vendim gjyqësor me detyrim të papërcaktuar e ndaj nuk ka asnjë paligjshmëri në urdhrin e pezullimit të ekzekutimit prej përmbaruesit.

31.6. Komisioni arsyeton se në çështjen civile për të cilën është lëshuar urdhri i ekzekutimit, konstatohet se objekti i padisë ka qenë detyrimi i shtetasit D. B. për kthimin e sendit (njësi shërbimi) shtetasve L. e L. L., ndërkohë që nëpërmjet kundërpadiës shtetasi D. B. ka kërkuar

³⁰⁷ Ndodhur në këto kushte, me shkresën nr. ***, datë 22.7.2016, palët e atij gjykimi janë njoftuar nga përmbaruesi: “Të bëjnë ekzekutimin e pikës 4 të dispozitivit në mënyrë vullnetare; të përcaktojnë vlerën e detyrimit që i përket kësaj pike. Në rast se palët nuk gjejnë mirëkuptim për sa më lart, të gjejnë zgjidhjen ligjore duke iu drejtuar gjykatës për të zgjidhur këtë pjesë të ekzekutimit. Megjithëse ka kaluar një periudhë më shumë se 30 ditë dhe palët nuk kanë bërë ndonjë zgjidhje, është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të titullit ekzekutiv nr. ***, datë 15.6.2015, të Gjykatës të Shkallës së Parë Vlorë.”

detyrimin e bashkëshortëve L. ta njohin pronar. Në kushtet kur shtetasi D. B. nuk ka kërkuar nëpërmjet kundërpadisë kthimin e shumës, nuk mund të kërkojë kthimin e saj me procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm. Gjithashtu, as vendimi gjyqësor titull ekzekutiv nuk ka përcaktuar masën konkrete të shumës që personat e tretë duhet t'i kthejnë atij, kështu që, për këtë pjesë vendimi është i paekzekutueshëm; kthimin e shumës se pretenduar prej 160.000 euro nuk mund ta kërkojë, duke detyruar përmbaruesin të anulojë urdhrin e pezullimit të ekzekutimit; kthimin e shumës që paditësi ka dhënë në favor të personave të tretë, paditësi ka të drejtë ta kërkojë nëpërmjet padisë së kthimit të shumës, sepse përcaktimi i saktë i saj nuk mund të bëhet kryesisht nga gjykata, pra pa kërkesën e palës.

31.7. Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se: *Subjekti i rivlerësimit ka disponuar për kthimin e shumës prej 160.000 euro, në një kohë kur gjykata nuk është shprehur në vendimin nr. ***, datë 15.6.2015, se cili është detyrimi i saktë i personave të tretë. Subjekti i rivlerësimit ka bërë përcaktimin e shumës në tejkallim të objektit të padisë, pra pa kërkesën e palës, në kushtet kur ky përcaktim nuk mund të bëhet kryesisht nga gjykata.*

31.8. Subjekti paraqiti shpjegimet e saj në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se: *“Megjithëse në pikën 4 të dispozitivit të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 15.6.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nuk është specifikuar shuma 160.000 euro, kjo shumë i është referuar interpretimit literal të dispozitivit të vendimit gjyqësor. Në rastin konkret, ka qenë një paqartësi nga ana e përmbaruesit sa i përket shumës së detyrimit të përcaktuar nga gjykata, ndaj kjo e fundit, me qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor të zgjidhjes definitive të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, ka specifikuar shumën monetare që duhej të ekzekutohej sipas detyrimit të vendimit gjyqësor”.*

31.9. Vlerësimi ligjor – Komisioni çmon aftësitë profesionale pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet, por bazuar në aftësinë e subjektit për interpretimin dhe arsyetimin e dispozitivave ligjore.

Gjatë hetimit rezultoi se ka qenë gjykata e shkallës më të lartë që ka konstatuar një vlerësim të gabuar ligjor nga ana e subjektit dhe ka vendosur prishjen e vendimit dhe se rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit ka disponuar për kthimin e shumës 160.000 euro në një kohë kur gjykata nuk është shprehur në vendimin nr. ***, datë 15.6.2015, se sa është detyrimi i saktë i personave të tretë. Pra, subjekti ka bërë përcaktimin e shumës në kushtet kur ky përcaktim nuk mund të bëhet kryesisht nga gjykata, por mund të kërkohet nëpërmjet padisë së kthimit të shumës.

Gjykata e mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor (neni 8 i Kodit të Procedurës Civile) dhe nuk vepron me iniciativë (*ex officio*) për hetimin e fakteve që nuk paraqiten nga palët në themel të pretendimeve të tyre.

31.10. Sa rezulton, subjekti i rivlerësimit ka mangësi në indikatorin e vlerësimit profesional, duke u gjendur në kushtet e pikave 2 dhe 3 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016. Gjetjet e Komisionit lidhur me këtë çështje do të konsiderohen nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor sipas pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

DENONCIME NGA PUBLIKU

32. Pranë Komisionit, për subjektin e rivlerësimit Herila Çela janë administruar 21 denoncime nga publiku, si vijon: Në 15 prej këtyre denoncimeve ngrihen pretendime për dhënien e vendimeve të padrejta dhe nuk përmbahen fakte apo rrethana, që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit të subjektit, përkatësisht: (1) denoncimi nr. *** prot., datë 20.3.2018, i shtetasit G. T.; (2) denoncimi nr. *** prot., datë 25.4.2018, i shtetasit F. D; (3) denoncimet nr. *** prot., datë 18.5.2018 dhe nr. *** prot., datë 17.10.2022, të shtetasit F. A; (4) denoncimi nr. *** prot., datë 26.11.2018, i shtetasit K. L. (5) denoncimet nr. *** prot., datë 10.7.2019, nr. *** prot., datë 18.7.2019 dhe nr. *** prot., datë 26.10.2020, të shtetases F. K; (6) denoncimi nr. *** prot., datë 31.7.2019 i shtetasit A. Dh.; (7) denoncimet nr. *** prot., datë 3.9.2019, nr. *** prot., datë 23.9.2019 dhe nr. *** prot., datë 23.9.2019, të shtetases E. Z.; (8) denoncimi nr. *** prot., datë 23.7.2021, i shtetasit A. V.; (9) denoncimi nr. *** prot., datë 23.9.2021, i shtetasit H. D.; (10) denoncimi nr. *** prot., datë 12.7.2022, i shtetasit M. B.

33. Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e mësipërme, konstaton se pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve dhe themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

34. Ndërkohë që Komisioni kërkoi shpjegime lidhur me denoncimet si vijon:

ii. Denoncimet nr. *** prot., datë 9.5.2018 dhe nr. *** prot., datë 8.6.2018, të shtetases L. A., e cila e akuzon subjektin për zhvillimin e një procesi jo të rregullt ligjor. Denoncuesja është në cilësinë e palës paditëse, së bashku me shtetasit J. dhe N. A., palë e paditur shtetasi F. H., me objekt “Padi shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror, si dhe fitimin e munguar”.

34.1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 14.9.2017, ka vendosur kthimin e akteve të çështjes civile me nr. ***, datë 9.5.2017. Në vendim, subjekti arsyeton se pala paditëse kishte pasur disa mangësi në paraqitjen e padisë në lidhje me mungesën e provave në gjykim. Duke qenë se pala paditëse nuk mundi të plotësonte të metat e kërkesës, gjykata e ka kthyer padinë me të meta. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 8.2.2018, arsyeton se vendimi i dhënë nga subjekti është marrë në zbatim jo të drejtë të ligjit dhe të provave të paraqitura në gjykim dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet dhe çështja të dërgohet për vazhdimin e gjykimit me të njëjtin trup gjykues. Vendimi i subjektit për kthimin e akteve, për shkak se nuk është paraqitur dëshmia e trashëgimisë, është i pabazuar në ligj. Kërkesëpadia është paraqitur në përputhje me nenin 154 të Kodit të Procedurës Civile, pasi i janë bashkëngjitur certifikatat familjare e personale, nëpërmjet të cilave paditësit provojnë cilësinë e të dëmtuarit si prindër apo vëlla i të ndjerit³⁰⁸.

34.2. Komisioni vëren se në vendim nuk përmendet as afati në dispozicion i palës paditëse për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm, ndërkohë që dokumentet e tjera të kërkuara, si ekstrakti i QKR-së dhe vendimi nr. ***, datë 9.4.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, janë paraqitur

³⁰⁸ Mosparaqitja e një dokumenti dytësor (dëshmia e trashëgimisë) nuk parashikohet nga ligji si mundësi procedurale, që nuk e lejon gjykatën të vazhdojë gjykimin e çështjes, gjykata duhet të vazhdonte gjykimin e çështjes. Paditësit në cilësinë e të dëmtuarve nga fakti i paligjshëm kanë provuar lidhjen familjare me të ndjerin nëpërmjet certifikatave familjare të paraqitura dhe nuk është e nevojshme të paraqitej dëshmia e trashëgimisë.

në seancën gjyqësore të datës 14.9.2017. Sa rezulton, vendimit të subjektit i mungon argumentimi në lidhje me konkluzionin se “pala paditëse kishte disa mangësi në paraqitjen e padisë në lidhje me mungesën e provave në gjykim”, pasi në këtë vendim nuk renditen provat e kërkuara nga gjykata dhe që nuk u paraqitën nga paditësi dhe as ato prova, të cilat u paraqitën nga paditësi në seancën gjyqësore të datës 14.9.2017.

34.3. Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se: (i) Vendimi i subjektit për kthimin e padisë (me objekt detyrim për shpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror) me të meta për shkak të mosparaqitjes së dëshmisë së trashëgimisë, bie ndesh me vendimin uniflikues të Gjykatës së Lartë nr. 12, datë 13.9.2007, ku përcaktohet se legjitimi aktiv, në parim, nuk kushtëzohet me gëzimin e cilësisë së trashëgimitarit të një personi të dëmtuar, por vetëm me cilësinë e vetë paditësit si i dëmtuar nga fakti i paligjshëm; (ii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka caktuar një afat të arsyeshëm për plotësimin e të metave, në mënyrë që t’u jepte mundësi palëve të siguronin dokumentacionin e kërkuar, bazuar kjo në nenin 154/a, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile; (iii) Subjekti i ka lënë paditësit vetëm 1 ditë afat për plotësimin e të metave, ndërkohë që ky afat është i pamjaftueshëm në kushtet kur procesi i lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë zgjat 7 ditë; (iv) Subjekti i rivlerësimit nuk ka proceduar me vendim tjetër për zgjatjen e afatit për plotësimin e të metave, në mënyrë që pala paditëse të kishte mundësi të siguronte dokumentacion e kërkuar; (v) Lidhur me arsyetimin ligjor, bazuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”³⁰⁹, vendimit të subjektit i mungon argumentimi në lidhje me konkluzionin se “pala paditëse kishte disa mangësi në paraqitjen e padisë në lidhje me mungesën e provave në gjykim”, pasi në këtë vendim nuk renditen provat e kërkuara nga gjykata dhe që nuk u paraqitën nga paditësi dhe as ato prova të cilat u paraqitën nga paditësi në seancën gjyqësore të datës 14.9.2017.

34.4. Subjekti paraqiti shpjegimet e saj në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se: *“Lënia e afatit 1-ditor në përmbushjen e të metave të padisë lidhet me faktin se pala paditëse ka deklaruar në gjykim se i dispononte këto akte dhe nuk kishte asnjë pengesë për t’i paraqitur ato. Ndërkohë, në seancën pasardhëse, pala paditëse nuk i përmbushi të metat e konstatuara, duke mos treguar kujdesin e duhur për zhvillimin e procesit. Gjithashtu, paditësi duhet t’i bashkëngjisë padisë dokumentet dhe mjetet e tjera provuese, mbi të cilat do të mbështesë pretendimin e tij. Mungesa e dokumentacionit të nevojshëm provues do të vlerësohet nga gjykata në përputhje me elementet e barrës së provës”.*

34.5. Vlerësimi ligjor i Komisionit – Në prapësime, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës procesverbalet e seancave gjyqësore, nga analizimi i të cilave rezultoi se nuk qëndrojnë pretendimet e subjektit se lënia e afatit 1-ditor në përmbushjen e të metave të padisë lidhet me faktin se pala paditëse ka deklaruar në gjykim se i dispononte këto akte dhe nuk kishte asnjë pengesë për t’i paraqitur ato. Në procesverbalin e datës 13.9.2017 rezulton se pala paditëse ka paraqitur si provë në gjykim fashikullin gjyqësor të vendimit të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. ***, datë 9.4.2013 dhe vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë nr. ***, datë 6.5.2014. Lidhur me legjitimitetin e palëve, paditësit kanë pohuar në seancë lidhjen familjare me

³⁰⁹ Ligji nr. 96/2016, neni 72: *“Me anë të kriterit të aftësisë profesionale të gjyqtarit vlerësohet aftësia profesionale e gjyqtarit në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor [...]”.*

të ndjerin dhe kanë paraqitur në cilësinë e provës certifikatat personale, certifikatën familjare datë 3.5.2017 dhe certifikatën e vdekjes së shtetasit E. A., datë 3.5.2017. Provat e mësipërme janë administruar nga ana e gjykatës. Ndërkohë që, referuar procesverbalit, gjykata është shprehur se në dosje mungon dëshmia e trashëgimisë ligjore të shtetasit E. A., mungon ekstrakti i QKR-së dhe vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë, dhe i ka dhënë kohë palës paditëse për plotësimin e të metave vetëm një ditë, duke caktuar seancën e radhës, ditën e nesërme të gjykimit, në datën 14.9.2017.

Në lidhje me dëshminë e trashëgimisë, në asnjë moment nuk konstatohet që pala e paditur të ketë pohuar gjatë shqyrtimit të seancës gjyqësore se e dispononte këtë akt dhe nuk kishte asnjë pengesë për ta paraqitur atë. Përkundrazi, në seancën e datës 14.9.2017 ka kërkuar një afat kohor prej 7 ditësh për paraqitjen e dëshmisë së trashëgimisë.

34.6. Sa më sipër, rezultoi e provuar se paditësi ka depozituar fashikullin gjyqësor të gjykimit të çështjes penale, ku gjenden edhe ekstraktet e QKR-së, si dhe vendimin nr. ***, datë 6.5.2014, të Gjykatës së Apelit Vlorë, çka vërteton edhe një herë faktin se nuk jemi para një kërkesëpadie me të meta.

34.7. Komisioni nuk i gjen bindëse dhe as të provuara pretendimet e subjektit në prapësime, si dhe vlerëson të theksojë faktin se gjithashtu edhe gjykata e shkallës më të lartë ka konstatuar analizim ligjor të gabuar nga ana e subjektit dhe ka vendosur prishjen e vendimit.

34.8. Sa rezulton, subjekti i rivlerësimit ka mangësi në indikatorin e vlerësimit profesional, duke u gjendur në kushtet e pikave 2 dhe 3 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016. Gjetjet e Komisionit lidhur me këtë çështje do të konsiderohen nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor sipas pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Denoncimet nr. *** prot., datë 13.7.2018 dhe nr. *** prot., datë 15.5.2019, të shtetasit A. Sh., i cili ankohet për 15 subjekte rivlerësimi, ndër ta edhe Herila Çela, për dhënien e vendimeve të padrejta.

34.9. Rrethanat e faktit – Pala paditëse E. Z. ka pretenduar të jetë pronar i një pasurie ndërtesë, e cila është e regjistruar në regjistrat e ish-ZVRPP-së Vlorë në emër të paditësit. Ai ka pretenduar se e ka fituar pronësinë e tij mbi këtë pasuri me kontratën e dhurimit datë 18.12.1991, të lidhur me dhuruesin N. Z. dhe ky i fundit e ka fituar pronësinë me kontratën e shitjes nr. ***, datë 25.3.1960, nga ish-Ndërmarrja Lokale e Shërbimeve Komunale Vlorë. Paditësi ka pretenduar se, për shkak të posedimit të qetë e të pandërprerë prej mbi 20 vjetësh, duke u sjellë edhe si pronar, ka fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues mbi pasurinë e llojit truall, me sip. 101 m², në qytetin e Vlorës dhe që është pikërisht trualli nën objektin në pronësi të paditësit. Këto kërkime paditësi i ka ngritur ndaj të paditurve A. Sh. dhe A. S. si personat që, sipas paditësit, rezultojnë të jenë pronarë të pasurisë me sip. 101 m².

34.10. Subjekti, me vendimin nr. ***, datë 28.6.2016, ka vendosur “Pranimin e padisë së paditësit. Detyrimin e të paditurve të njohin pronar paditësin me parashkrim fitues të pasurisë së llojit truall, me sip. 101 m²”. Ndërkohë, Gjykata e Apelit vlerëson se vendimi i shkallës së parë është akt procedural absolutisht i pavlefshëm, i marrë në shkelje të rënda të dispozitave procedurale, që kanë të bëjnë me arsyetimin e vendimit, formimin e drejtë të ndërgjyqësisë dhe zgjidhjen e të gjitha kërkimeve të ngritura nga palët në gjykim. Po kështu, Gjykata e Apelit konstaton se mungon një

analizë shteruese e titullit të pronësisë mbi pasurinë objekt gjykimi, çka ka ndikuar në evidentimin e rrethit të plotë të trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar dhe, për pasojë, mosndërtimin e drejtë të ndërgjyqësisë, për shkak të mosthirrjes edhe të tyre në këtë gjykim, sikundër edhe ASHK, Drejtoria Vendore Vlorë, subjekt ky që duhet të reflektojë pasojat e rrjedhura nga zgjidhja e padisë në rast të pranimit të saj. Në përfundim, Gjykata e Apelit çmon se vendimi i dhënë nga subjekti është i paarsyetuar, në kuptim të nenit 142, pika 1 e Kushtetutës, si dhe neneve 126, paragrafi 2 dhe 310, pika 2 e Kodit të Procedurës Civile, duke e bërë një akt procedural absolutisht të pavlefshëm. Sa rezulton, ka vendosur prishjen e vendimit të shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

34.11. Rezulton se në datën 23.11.2015 i padituri A. Sh. ka paraqitur kundërpadi ndaj paditësit E. Z., duke kërkuar detyrimin e këtij të fundit të lirojë dhe dorëzojë pasurinë ndërtesë që pretendohet nga paditësi, se është në pronësi të tij dhe truallit nën të. Në vendimin e subjektit nuk është thënë asnjë fragment, e aq më pak të evidentohet, arsyetohet e t'i jetë dhënë zgjidhje kundërpadisë së paraqitur nga i padituri A. Sh. Mungesa e arsytimit të gjykatës së shkallës së parë dhe shmangia e kundërpadisë ka ndikuar në zgjidhjen e çështjes, duke mos evidentuar asnjë prapësim të të paditurit A. Sh. për mungesën e posedimit të qetë e të sjelljes si pronar të paditësit mbi truallin nën ndërtesë.

34.12. Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se: (i) *Subjekti nuk ka arsytuar në mënyrë të qartë lidhur me mosformimin e rregullt të ndërgjyqësisë, pasi ka vijuar gjykimin në themel të çështjes, duke mos vlerësuar faktin që ndërgjyqësia e rregullt është një ndër parakushtet procedurale për vlefshmërinë e procesit gjyqësor civil dhe administrativ dhe sjell si pasojë pushimin e gjykimit;* (ii) *Lidhur me arsyetimin ligjor, bazuar në nenin 72 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", rezulton se vendimit të subjektit i mungon argumentimi në lidhje me prapësimet e të paditurve mbi mënyrën e fitimit të pronësisë së tyre mbi pasurinë objekt gjykimi;* (iii) *Subjekti i rivlerësimit në vendimin e dhënë nuk është shprehur lidhur me kundërpadinë e paraqitur në gjykim nga pala e paditur. Në interpretim dhe zbatim të drejtë të nenit 160 të Kodit të Procedurës Civile, magjistrati ka detyrimin që ta trajtojë shqyrtimin e kundërpadisë njësoj sikurse edhe ajo vepron në rastin e padisë.*

34.13. Subjekti paraqiti shpjegimet e saj në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se: *"Në lidhje me konstatimin për mosformim të rregullt të ndërgjyqësisë sipas parimit të disponibilitetit (nemo iudex sine actore), është paditësi ai që inicion procesin gjyqësor, përcakton rrethin e të drejtave të kërkuara gjyqësisht dhe palën ndaj së cilës kundërdrejtohen pretendimet e tij. Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen që i paraqitet për gjykim, duke vlerësuar nëse kërkimet e palës paditëse janë të mbështetura në ligj apo jo. Nga sa më sipër rezulton se është disponuar në përputhje me parimin e disponibilitetit të palës paditëse. Po kështu, ky pretendim nuk rezulton të jetë parashtuar gjatë gjykimit nga asnjë prej palëve ndërgjyqëse".*

Në lidhje me konstatimin se vendimit të subjektit i mungon argumentimi në lidhje me prapësimet e të paditurve mbi mënyrën e fitimit të pronësisë së tyre mbi pasurinë objekt gjykimi, ky vendim nuk mund të konsiderohet i paarsyetuar në kushtet kur në të janë pasqyruar rregullisht elementet e parashikuara nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile. Subjekti deklaroi se kërkon nga ana e

Komisionit të ketë në vëmendje ngarkesën si gjyqtare në këtë periudhë, ku në vitin 2016 ka gjykuar 616 çështje, në vitin 2017 ka gjykuar 702 çështje.

Në lidhje me konstatimin se nuk është shprehur lidhur me kundërpadinë e paraqitur në gjykim nga pala e paditur, subjekti deklaroi se në përfundim të gjykimit ka disponuar me vendim përfundimtar për pranimin e kërkesëpadisë dhe, rrjedhimisht, është e qartë se në këtë mënyrë është rrëzuar kundërpadia dhe pretendimet e palës së paditur.

34.14. Vlerësimi ligjor – Komisioni çmon aftësitë profesionale pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet³¹⁰, por bazuar në aftësinë e subjektit për interpretimin dhe arsyetimin e dispozitave ligjore. Arsyetimi i drejtë dhe i plotë i vendimit gjyqësor përbën një element shumë të rëndësishëm të procesit gjyqësor. E drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42, 142/1 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë³¹¹. Arsyetimi i vendimit duhet të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze, që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (shihni vendimin nr. ***, datë 18.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese).

Komisioni vëren se i gjithë arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë përmbledhet në një përshkrim të rrethanave të faktit, ndërkohë që, në pjesën ku evidentohet arsyetimi ligjor i kësaj gjykate, jepen vetëm citime të dispozitave ligjore, referenca në disa vendime gjyqësore të Gjykatës së Lartë, disa prej të cilave në inkoherencë me rrethanat e çështjes dhe vetëm në një paragraf citohet konkluzioni i asaj gjykate, se paditësi plotëson posedimin e qetë, të pandëprerë dhe mbi 20 vjet të kësaj pasurie, ndërkohë që nuk ka evidentuar, e aq më pak të ketë arsyetuar dhe analizuar prapësimet e të paditurve mbi mënyrën e fitimit të pronësisë së tyre së kësaj pasurie dhe përpjekjet e tyre për t’u rivendosur në posedim të pasurisë së fituar më parë me vendim të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

34.15. Sa rezulton, Komisioni nuk i gjen bindëse dhe as të provuara pretendimet e subjektit në prapësime. Për rrjedhojë, konkludon se subjekti i rivlerësimit ka mangësi në indikatorin e vlerësimit profesional, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016. Gjetjet e Komisionit lidhur me këtë çështje do të konsiderohen nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor sipas pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

iv. Denoncimi nr. *** prot., datë 20.11.2019, i shtetases Y. L., e cila ngre pretendime për dhënien e një vendimi të padrejtë nga ana e subjektit të rivlerësimit Herila Çela.

34.16. Rrethanat e faktit – Denoncuesja ka qenë e punësuar pranë shoqërisë “***” sh.p.k., me detyrë punëtore dhe është larguar për arsye të shkeljes së disiplinës në punë. Për këtë shkak ka

³¹⁰ Bazuar në nenin 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me anë të kriterit të aftësisë profesionale të gjyqtarit vlerësohet aftësia në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e gjyqtarit për të marrë vendime gjyqësore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën.

³¹¹ Vendimi nr. ***, datë 24.6.2013, i Gjykatës Kushtetuese.

ngritur padi në gjykatë. Subjekti i rivlerësimit ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se pala e paditur provoi se zgjidhja e kontratës së punës është bërë për shkak se pala paditëse me sjelljen e saj ka kryer faj të rëndë, duke mos lejuar sipas parimit të mirëbesimit t'i kërkohet punëdhënësit vazhdimi i marrëdhënieve të punës. Në këto kushte, shkak i ndërprerjes së marrëdhënies së punës konsiderohet i justifikuar dhe kërkimi i paditëses për të përfituar dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës pa shkaqe të justifikuara konsiderohet i pabazuar në ligj dhe në prova dhe, si i tillë, duhet rrëzuar; si rrjedhojë, edhe pretendimet e tjera të palës paditëse.

34.17. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se paditësja nuk ka kryer veprime të cilat, në kuptim të nenit 153 të Kodit të Punës, do të ligjëronin të paditurin të zgjidhte menjëherë kontratën e punës. Në mungesë të shkaqeve justifikuese të provuara për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës, punëdhënësi duhet të zgjidhë kontratën e punës në kushte normale, që kanë të bëjnë pikërisht me respektimin e afatit të njoftimit sipas nenit 143 të Kodit të Punës, gjë që në rastin konkret nuk është respektuar. Sipas Apelit, vendimi i shkallës së parë është marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe të provave, duke vendosur ndryshimin dhe pranimin e padisë pjesërisht.

34.18. Në zbatim të nenit 153 të Kodit të Punës, zgjidhja e kontratës së punës bëhet në mënyrë të menjëhershme nga punëdhënësi vetëm në ato raste kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë ose të lehtë në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimet me shkrim të punëdhënësit³¹².

34.19. Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se: *Subjekti nuk ka arsyetuar në mënyrë të qartë lidhur me pretendimet e palës së paditur për shkelje me faj të përsëritur të detyrimeve kontraktore nga paditësja. Zgjidhja e menjëhershme e kontratës së punës përbën një veprim të justifikueshëm vetëm në rastin e veprimeve të fajshme të kryera nga punëmarrësi, të cilat rezultojnë të paprovuara në rastin konkret.*

34.20. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet e saj në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se, *referuar rastit konkret, janë përmbushur rigorozisht kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, duke paraqitur në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë gjykimit, dhe përfundimet e nxjerra nga gjykata, provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi dhe dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi. Rezultoi e provuar se zgjidhja e marrëdhënies së punës së paditësit është kryer për shkaqe të justifikuara, "shkelje e rëndë e etikës në punë", duke u konsideruar prej gjykatës si një shkelje e rëndë, pasi është provuar se paditësja ka shkaktuar një debat, i cili ka degraduar deri në konflikt fizik ndërmjet punonjësve. Gjatë gjykimit është lejuar të merren prova me dëshmitarë, konkretisht janë pyetur dëshmitarët E. K., I. A. dhe F. L., të cilët kanë dëshmuar se paditësja ishte përfshirë në konflikt, i cili kishte degraduar deri në dhunë fizike. Në kushte të tilla, subjekti ka arsyetuar mbi bazën e*

³¹² Në rastin konkret, i padituri nuk ka provuar në gjykim se nga paditësja janë kryer veprime, të cilat të përbëjnë shkelje me faj të rëndë ose të përsëritur të detyrimeve kontraktuale dhe të cenojnë parimin e mirëbesimit në marrëdhënien e punës në atë masë sa vazhdimi i këtyre marrëdhënieve të jetë i pamundur. Nuk është respektuar procedura e zgjidhjes së kontratës së punës, e parashikuar nga neni 144 i Kodit të Punës. Nga hetimi gjyqësor rezultoi se paditësja nuk është njoftuar 72 orë para takimit për shkaqet për të cilat punëdhënësi mendon të zgjidhë kontratën e punës, madje nuk i është njoftuar asnjë vendim i zgjidhjes së kontratës së punës. E drejta për t'u dëgjuar është e garantuar në ligj edhe në rastet e zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar për shkelje të përsëritura. Është detyrim i punëdhënësit të vërtetojë se zgjidhja e kontratës prej tij është bërë e ligjruar.

provave të marra gjatë gjykimit për fajin e rëndë të punëmarrëses. Mbi bazën e ankimit të paditëses Y. L., kjo çështje i është nënshtruar edhe hetimit administrativ nga ILD-ja, i cili me vendimin nr. ***, datë 17.7.2023, ka konkluduar “arkivimin e ankesës”, me argumentin se “nuk konstatohet mosrespektim i legjislacionit procedural dhe material” .

Megjithëse Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë, ky fakt ka të bëjë vetëm me shqyrtim dhe vlerësim të ndryshëm të provave, në drejtim të bindjes së brendshme të gjykatës në procesin e vendimmarrjes, gjë e cila nuk ndikon në kornizën ligjore procedurale.

34.21. Vlerësimi ligjor i Komisionit – Pasi u analizuan shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura në prapësime, vlerësohet se gjendemi në kushtet e trajtimit të themelit të vendimit të dhënë, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga ana e Komisionit.

v. Denoncimi nr. *** prot., datë 30.5.2022, i shtetasit J. D., i cili ankohet lidhur me aftësitë profesionale të subjektit Herila Çela.

34.22. Rrethanat e faktit – Me vendimin nr. ***, datë 14.6.2006, KVKKP Qarku Vlorë ka vendosur: “T”i njohë të drejtën e pronësisë subjektit të shpronësuar I. D. për sipërfaqen prej 70 ha, tokë kullotë të ndodhur në Berdenesh. T”u kthejë trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar I. D., sipas dëshmisë së trashëgimisë ***, datë 7.11.1996, sipërfaqen prej 69.505 ha, tokë kullotë të ndodhur në ***”. Bazuar në rekomandimet e Task-Forcës pranë Kryeministrit, ka rezultuar se janë hedhur dyshime për falsitetin e disa prej dokumenteve që janë përdorur si prova për marrjen e vendimit nr. ***, datë 14.6.2006, të KVKKP-së Qarku Vlorë.

34.23. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur për pranimin e pjesëshëm të padisë duke anuluar vendimin nr. ***, datë 14.6.2006, të KVKKP-së Vlorë, duke njohur të drejtën e pronësisë së shtetit shqiptar mbi pasurinë e trajtuar në këtë vendim, duke rrëzuar padinë për kërkimet për goditjen për falsitet të dokumenteve të pronësisë dhe zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë së këtij vendimi, si dhe duke ligjësuar sigurimin e padisë, me arsyetimin se: *“Duke iu rikthyer çështjes objekt gjykimi, gjykata konstaton se ndërsa rezulton e vërtetuar se i ndjeri I. D. ka qenë pronar i pasurisë objekt gjykimi, nuk rezulton e vërtetuar vijimësia e së drejtës së tij mbi këtë pasuri dhe marrja në mënyrë të padrejtë e saj prej shtetit pas datës 29.11.1944”*.

34.24. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, pasi shqyrtoi çështjen brenda kufijve të ankimit, çmon se arsyetimi dhe disponimi i gjykatës së shkallës së parë janë rrjedhojë e shkeljeve të parimeve procedurale të disponibilitetit të padisë dhe të kontradiktoritetit, si dhe e shkeljes së dispozitave procedurale, neneve 5, 6, 16, 18, 19, 20 dhe 28 të Kodit të Procedurës Civile, me pasojë moskryejën e shqyrtimit gjyqësor të kërkimeve në lidhje me objektin e mosmarrëveshjes³¹³.

³¹³ Nga leximi në tërësi i pretendimeve të paditësit në kërkesëpadi, nga sjellja apo qëndrimet e paditësit deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, si dhe nga shqyrtimi i tyre në raport me dispozitat procedurale, rezulton se gjykata e shkallës së parë nuk e ka përcaktuar në mënyrë të saktë objektin e mosmarrëveshjes në gjykim, si dhe shkakun e padisë, duke e zgjidhur këtë mosmarrëveshje pronësie në kundërshtim me shkakun e përcaktuar nga paditësi, pasi, pavarësisht renditjes formale të katër kërkimeve të paditësit në objektin e kërkesëpadisë, nga leximi i vëmendshëm dhe tërësor i të gjitha pretendimeve të paditësit në kërkesëpadi, rezulton se kërkimi kryesor në kërkesëpadi, prej të cilit varet edhe zgjidhja për tri kërkimet e tjera, është kërkimi për falsitetin e dokumenteve të pronësisë, ku është bazuar dhënia e vendimit nr. ***, datë 14.6.2006, e KVKKP-së Vlorë.

Përveçse ka shkelur parimin e disponibilitetit të padisë, duke trajtuar, analizuar dhe shqyrtuar një shkak të ri padie, të ndryshëm nga shkakun i pasqyruar në pretendimet e paditësit, gjykata e shkallës së parë rezulton të ketë shkelur edhe parimin e kontradiktoritetit,

34.25. Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit duhet të shqyrtojë kërkimet në kërkesëpadi vetëm bazuar në shkakun e padisë, që lidhet me pretendimin kryesor dhe të vetëm në themel të paditësit dhe që në rastin konkret është ai i falsitetit të dokumenteve të pronësisë, ku është bazuar dhënia e vendimit nr. ***, datë 14.6.2006, të KVKKP Vlorë, si dhe ta zgjidhë mosmarrëveshjen ndërmjet palëve ndërgjyqëse vetëm duke u bazuar në një shkak të tillë, në respektim të dispozitave procedurale, neneve 5, 6, 16 dhe 28 të Kodit të Procedurës Civile. Vetëm në rast se nga ana e paditësit do të kishte një kërkesë për ndryshimin e shkakut të padisë, atëherë në përputhje me nenin 185/1 të Kodit të Procedurës Civile dhe vlerësimit të saj si të bazuar, gjykata e shkallës së parë ka detyrimin që të shqyrtojë kërkesëpadinë e paditësit bazuar në një shkak të ri të ndryshuar, duke garantuar njëkohësisht respektimin e parimit të kontradiktoritetit të parashikuar nga nenet 18, 19 dhe 20 të Kodit të Procedurës Civile, me qëllim që të paditurit të mos gjykohen pa iu dhënë mundësia për t'u dëgjuar, debatuar apo paraqitur prova në lidhje me këtë shkak të ri.

34.26. Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se: (i) *Subjekti i rivlerësimit ka shkelur parimin e disponibilitetit të padisë, duke trajtuar, analizuar dhe shqyrtuar një shkak të ri padie, të ndryshëm nga shkakun i pasqyruar në pretendimet e paditësit;* (ii) *Subjekti i rivlerësimit ka shkelur parimin e kontradiktoritetit, të bazuar në nenet 18, 19 dhe 20 të Kodit të Procedurës Civile, pasi, duke ndryshuar kryesisht shkakun e padisë, jo vetëm që ka lejuar shqyrtimin e fakteve që nuk janë pretenduar nga asnjë prej palëve, por gjithashtu nuk i ka dhënë mundësinë palës së paditur për t'u dëgjuar, për të debatuar apo për të paraqitur prova në lidhje me këto fakte apo pretendime të reja.*

34.27. Subjekti paraqiti shpjegimet e saj në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se në referencë të vendimit nr. ***, datë 29.3.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilin është sqaruar roli i gjykatës në gjykimin civil, saktësohet se shkakun e kërkesëpadiës nuk ndodhet i pasqyruar vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadiës, por edhe në përmbajtje të saj. Subjekti deklaroi se nuk është cenuar në asnjë moment si parimi i disponibilitetit, po ashtu dhe ai i kontradiktoritetit. Gjatë gjykimit, palët kanë pasur mundësinë të debatojnë dhe paraqesin si pretendimet dhe provat e tyre. Gjithashtu, rezultoi se i padituri J. D. ka paraqitur kallëzim ndaj subjektit, duke pretenduar se ka shpërdoruar detyrën në lidhje me vendimmarrjen për riçelje të hetimit gjyqësor. Ky kallëzim është mosfilluar me vendimin datë 15.5.2019 nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Sarandë, pasi është verifikuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë kundër riçeljes së hetimit.

34.28. Vlerësimi ligjor i Komisionit – Komisioni nuk i gjen bindëse shpjegimet e subjektit pasi, referuar vendimit nr. ***, datë 29.3.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje, është në disponibilitetin ekskluziv të palëve dhe gjykata nuk mund të ndërhyjë në formulimin e tij. Janë palët ato që parashitrojnë kërkimet para gjykatës dhe që i kërkojnë asaj dhënien e një vendimi të caktuar (detyrimi, njohje apo transformues). Gjykata nuk ka të drejtë të dalë tej kërkimeve të

të pasqyruara në nenet 18, 19 dhe 20 të Kodit të Procedurës Civile³¹³. Nga zbatimi i këtyre dispozitave në raport me rrethanat e çështjes objekt gjykimi, rezultoi se gjykata e shkallës së parë nuk e ka respektuar këtë parim të rëndësishëm procedural, pasi, duke ndryshuar kryesisht shkakun e padisë jo vetëm që ka lejuar shqyrtimin e fakteve që nuk janë pretenduar nga asnjë prej palëve, por faktikisht nuk u ka dhënë mundësinë palëve ndërgjyqëse dhe veçanërisht palës së paditur për t'u dëgjuar, për të debatuar apo për të paraqitur prova në lidhje me këto fakte apo pretendime të reja.

palëve, që përbëjnë objektin e mosmarrëveshjes, pasi ajo zgjidh mosmarrëveshjen që i paraqitet për gjykim dhe nuk e zgjeron *ex officio* fushën e gjykimit.

Pala paditëse ka detyrimin të saktësojë kërkimet e saj ndaj të paditurit, por një gjë të tillë nuk ka detyrim ta bëjë domosdoshmërisht në mënyrë të plotë, në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë, por mund t'i fjalëzojë pretendimet në çdo pjesë të kërkesëpadisë. Në këto kushte, si gjykata, ashtu edhe palët e tjera, duhet të vlerësojnë me kujdes të gjithë kërkesëpadinë, për të kuptuar objektin e saj dhe kërkimet apo pretendimet që paditësi ngre.

34.29. Sa rezulton, subjekti i rivlerësimit ka mangësi në indikatorin e vlerësimit profesional, duke u gjendur në kushtet e pikave 2 dhe 3 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016. Gjetjet e Komisionit lidhur me këtë çështje do të konsiderohen nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor sipas pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të rivlerësimit të aftësive profesionale

35. Bazuar në nenin 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me anë të kriterit të aftësisë profesionale të gjyqtarit vlerësohet aftësia në drejtim të njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor³¹⁴. Komisioni çmon aftësitë profesionale pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

36. Vlerësohet se në disa nga çështjet gjyqësore të trajtuara më sipër, ka problematika të cilat lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale sipas neneve 72 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016, por duke marrë në konsideratë: (i) numrin e çështjeve të analizuara, ku janë konstatuar mangësi në aspektin e aftësive profesionale në raport me kohën e gjatë të ushtrimit të profesionit; (ii) kërkesat e shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59, i cili përcakton se konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet: “[...] kur arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale [...]” – vlerëson se problematikat e rezultuara në rivlerësimin e aftësive profesionale, duke pasur në konsideratë natyrën e këtyre gjetjeve, të përshkruara më lart në arsytimin e këtij vendimi, nuk plotësojnë kushtin e parashikuar nga pika 4 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që subjekti i rivlerësimit të konsiderohet “i papërshtatshëm”, porse çmohen të tilla se ato përbëjnë bazë të mjaftueshme edhe për vlerësimin në tërësi të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

a. Lidhur me kriterin e pasurisë, trupi gjykues çmon se subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronjat “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, të cilat, të vlerësuara së bashku, të çojnë në konkluzionin se duhet zbatuar neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i cili e vë atë në kushtet

³¹⁴ Me anë të kriterit të aftësisë organizative vlerësohet aftësia e magjistratit për të përballuar ngarkesën e punës dhe për të kryer procedurat hetimore ose gjyqësore, si dhe aftësia për të administruar dosjet gjyqësore, duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga magjistrati dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit.

e një deklarami të pamjaftueshëm, si një shkak ligjor për zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

b. Lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

c. Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni çmon se subjekti arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

d. Lidhur me vlerësimin tërësor të çështjes, trupi gjykues çmon se duke marrë në konsideratë problematikat lidhur me situatën e konfliktit të interesit në përfitim të të ardhurave nga fondet publike, përfshirë edhe gjykatën në të cilën subjekti ushtronte funksionin, si dhe problematikat e evidentuara në vlerësimin profesional dhe denoncimet nga publiku, si më lart arsyetuar, subjekti i rivlerësimit e ka cënuar me me sjelljen e tij besimin e publikut të sistemi i drejtesise. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se numri më i madh i problematikave të evidentuara në vendim janë nga ankesat e publikut dhe denoncimet nga publiku, të cilat kanë rezultuar të drejta pas hetimit nga ana e Komisionit. Pesha e këtyre mangësive në vlerësimin tërësor të subjektit është e tillë që e bën të pamundur riparimin e tyre nëpërmjet programit të trajnimit të Shkollës së Magjistraturës dhe, si rrjedhojë, Komisioni konkludoi se vazhdimi i ushtrimit prej saj të funksionit të gjyqtarës do të ishte jo në përputhje me qëllimin dhe parashikimet e nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 61, pika 5 dhe 4, pika 2 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet Ç, D, dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, në bazë të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 58, si dhe pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Herila Çela, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 30.10.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI

Kryesuese

Etleda ÇIFTJA

Relatore

Lulzim HAMITAJ

Anëtar

Sekretare gjyqësore

Resilda Bilaj